



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

TRANSKRIPT

NGA SEANCA PLENARE E KUVENDIT TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS, E MBAJTUR MË
9 dhe 10 KORRIK 2009

SA PLENARNE SEDNICE SKUPŠTINE REPUBLIKE KOSOVA, ODRŽANE 9.i 10. JULA
2009. GODINE

KORRIK – JULI
2009

Seancën e kryesoi **Jakup KRASNIQI**, Kryetar i Kuvendit.

KRYETARI: Të nderuar deputetë,
Të nderuar zëvendëskryeministra dhe ministra të Kabinetit qeveritar,
Mirë se keni ardhur në seancën e sotme plenare!

Ju njoftoj se me rregullat 6.2 dhe 23 të Rregullores së Punës të Kuvendit, Kryesia, në marrëveshje me grupet parlamentare, ka përgatitur dhe Kuvendit i ka paraqitur rendin e ditës për seancën e sotme plenare.

Në rend dite është fjalimi vjetor i Presidentit të Republikës së Kosovës.

Të nderuar deputetë,
Presidenti i Republikës së Kosovës, në bazë të nenit 84.30 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, së paku një herë në vit i drejtohet Kuvendit të Republikës së Kosovës me një fjalim vjetor lidhur me fushëveprimtarinë e tij.

Ftoj Presidentin e Republikës së Kosovës, zotin Fatmir Sejdiu, që ta marrë fjalën.

(Duartrokitje)

PRESIDENTI I KOSOVËS, FATMIR SEJDIU:

I nderuar zoti Kryetar i Kuvendit të Republikës së Kosovës, Jakup Krasniqi,
Të nderuar zëvendëskryeministra, ministra dhe deputetë,
Të nderuar ambasadorë të vendeve mike të akredituar në Kosovë dhe përfaqësues të institucioneve ndërkombëtare,
Të dashur qytetarë të Republikës së Kosovës,
Zonja dhe zotërinj,

Jam shumë i nderuar që kam mundësinë të paraqes para jush, deputetë të Kuvendit të Republikës së Kosovës, si dhe para qytetarëve të vendit, fjalimin tim vjetor.

Sikundër deri më tani, dua t'ju njoftoj nga ky institucion më i lartë i legjislativit në vendin tonë, për angazhimet e mia gjatë këtij viti, të cilin, për shumë arsye e kam cilësuar vit të mbarë të dëshimit, vit të funksionimit të suksesshëm dhe të rritës së përgjithshme të Republikës sonë të pavarur dhe demokratike.

Republika e Kosovës ka pasur gjatë këtij viti arritje që mund të vërehen në të gjitha fushat e jetës, ashtu siç ka pasur edhe sfida dhe vështirësi të shumta.

Institucionet e vendit, në të gjitha nivelet, janë forcuar, është shtuar përgjegjësia, është dinamizuar jeta dhe debati demokratik dhe për këtë merita kanë të gjithë, edhe ata që aktualisht janë bartës së qeverisjes, edhe ata që janë në opozitë, por që kanë ndikuar drejtpërdrejt në shtimin e përgjegjësisë së qeverisjes.

Jemi në vitin e dytë të shtetësisë së Kosovës dhe tanimë kemi pranuar 61 njohje nga vende të ndryshme anekënd globit. Institucionet përkatëse të vendit, Presidenti, Qeveria, përkatësisht

Ministria e Punëve të Jashtme, kanë punuar me përkushtim për të arritur sa më shumë njohje. Në këtë proces ne kemi pasur përkrahjen e pazezervë të vendeve tona mike, Shteteve të Bashkuara të Amerikës dhe vendeve më të fuqishme të Bashkimit Evropian. Gjithsesi, duhet të veçohet edhe roli i diplomacisë së Shqipërisë dhe të Republikës së Turqisë, të cilat punuan me vullnet të përhershëm për të siguruar mbështetje për shtetin më të ri në botë, për Republikën e Kosovës. Këto vende kanë merita të mëdha sidomos për miratimin e Rezolutës për Kosovën nga Organizata e Konferencës Islamike.

Me qëllim të sigurimit të sa më shumë njohjeve dhe të afirmimit të vendit tonë në botë, gjatë kësaj periudhe, në mes paraqitjeve të mia vjetore para jush, unë kam realizuar takime të shumta me përfaqësues të vendeve nga të gjitha kontinentet.

Si rezultat i gjithë këtyre angazhimeve, kemi realizuar takime dhe vizita tepër të rëndësishme, ndër të cilat duhet të veçohet vizita në SHBA dhe takimi historik me Presidentin Bush në Shtëpinë e Bardhë, më 21 gusht 2008 bashkë me përfaqësuesit e tjerë të Republikës. Këtij takimi i paraprinë takimet me Sekretaren e Shtetit Condoleezza Rice dhe me Sekretarin e Mbrojtjes, z. Robert Gates.

Me kënaqësi pohojmë se Republika e Kosovë vazhdon të ketë vëmendjen e veçantë të SHBA-ve dhe të administratës së Presidentit Obama, me zyrtarët më të lartë të së cilës tashmë kemi pasur takime si në Uashington, ashtu edhe këtu në Prishtinë. Gjatë vizitës sonë të fundit në Uashington, në fillim të muajit mars të këtij viti, ne kemi takuar Zëvendëspresidentin Joseph Biden, Sekretaren e Shtetit Hilary Clinton, ambasadoren e Shteteve të Bashkuara të Amerikës në Kombet e Bashkuara, zonjën Susan Rice. Po kështu, në shtator 2008, gjatë punimeve të Asamblesë të Përgjithshme të Organizatës së Kombeve të Bashkuara, kam takuar mbi 30 përfaqësues të vendeve që ende nuk e kanë njohur Republikën e Kosovës, presidentë, kryeministra dhe ministra të jashtëm.

Përkushtimi i veçantë i Shteteve të Bashkuara të Amerikës për Kosovën u ridëshmua fuqishëm edhe gjatë vizitës së Zëvendëspresidentit Joseph Biden në vendin tonë. Me këtë rast, dua t'u shpreh falënderimet e mia të gjithë qytetarëve dhe zyrtarëve të vendit, që organizuan një pritje vërtet të dinjitetshme për të.

Përveç marrëdhënieve intensive me Shtetet e Bashkuara të Amerikës, ne kemi vazhduar të mbajmë raporte të ngushta me të gjitha vendet e tjera mbështetëse të Kosovës. Jemi pritur në Londër, nga Kryeministri i Mbretërisë së Bashkuar, z. Gordon Braun, dhe nga Ministri i Jashtëm Miliband, si dhe kemi mbajtur kontakte të përhershme me përfaqësuesit kryesorë të diplomacisë evropiane, në rend të parë, me kryediplomatën e Bashkimit Evropian, zotëri Javier Solana, por edhe me funksionarë të tjerë të rëndësishëm, si Presidenti i Komisionit Evropian Jose Manuel Barroso, Komisionari Evropian për Zgjerim Oli Rehn e shumë të tjerë.

Si President i vendit, gjatë gjithë kësaj kohe, kam mbajtur korrespondencë të rregullt me homologët e mi nga të gjitha anët e globit. Më 23 dhe 24 qershor 2009 kam marrë pjesë edhe në samitin e Presidentëve të rajonit, të mbajtur në Vlorë. Përveç me mikpritësin, Presidentin Topi, atje jam takuar edhe me Presidentin e Malit të Zi, Vujanović dhe me Presidentin e Maqedonisë, Ivanov. Së bashku, jemi zotuar për thellimin e bashkëpunimit ndërshtetëror e rajonal, në mënyrë që të japim provën e gatishmërisë dhe të pjekurisë sonë për të qenë pjesë e barabartë e familjes së madhe dhe demokratike evropiane.

Më 29 qershor 2009, unë dhe Kryeministri Thaçi nënshkruam në Uashington dokumentet e

pranimi të Republikës së Kosovës në institucionet më të rëndësishme financiare ndërkombëtare - Fondin Monetar Ndërkombëtar dhe në Bankën Botërore.

Gjithashtu, gjatë gjithë vitit, unë kam takuar qoftë në zyrën time, qoftë jashtë vendit, kryeministra, ministra të jashtëm, kryetarë parlamentesh dhe përfaqësues të tjerë të shteteve të shumta, si të Gjermanisë, Zvicrës, Turqisë, Shqipërisë, Danimarkës, Luksemburgut, Estonisë, Kroacisë, Sllovenisë dhe shumë të tjerë. Në të gjitha këto takime kam vënë në pah se Republika e Kosovës ka një shoqëri multietnike, e cila dallohet me diversitetin dhe trashëgiminë e pasur të saj shpirtërore e kulturore, që e bën vendin tonë një mozaik të veçantë në kuadër të shtetit laik, i cili i respekton dhe i garanton edhe me ligj dhe Kushtetutë të drejtat dhe specifikat e secilit etnit.

Prandaj, s'është e tepërt asnjëherë të rikujtojmë se Kosova është një shembull unikat i tolerancës, i mirëkuptimit dhe i bashkëjetesës në mes qytetarëve të kombeve dhe besimeve të ndryshme.

Kosova mirëpret raportet pozitive të organizatave dhe mekanizmave të ndryshëm ndërkombëtarë për arritjet në vendin tonë. Gjithashtu, ne i marrim me dashamirësi dhe i shqyrtojmë me shumë kujdes vërejtjet e dhëna nga këto mekanizma dhe zotohemi për të punuar edhe më shumë në këto fusha.

Të nderuar deputetë dhe pjesëmarrës të tjerë të kësaj seance,

Si President i Republikës së Kosovës, po edhe si ekspert, unë kam qenë i ftuar të mbaj ligjërata në institucione e universitete me renome ndërkombëtare, si në Gjermani, në Britani të Madhe, në Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe në Republikën Turke.

Ndërkohë, Presidenti Topi më ka dekoruar me Urdhrin "Gjergj Kastrioti Skënderbeu", Bashkia e Shkodrës më ka akorduar titullin "Qytetar nderi i Shkodrës", Instituti Co-Plan nga Tirana më vlerësoi me çmimin special "Leadershipi shqiptar 2008", kurse Arizona State University në Phoenix më dha çmimin "Distinguished Global Leadership Award". Në të gjitha ceremonitë e organizuara për çmimet që më janë akorduar, unë kam theksuar se ato i konsideroj po kështu si një vlerësim që i bëhet popullit dhe vendit tim, Kosovës.

Në agjendën time të këtij viti vend me peshë i takon edhe pjesëmarrjes në Konferencën e Sigurisë në Munihi të Gjermanisë, në shkurt 2009, në të cilën ishin të pranishëm mbi 300 pjesëmarrës nga e gjithë bota, presidentë, kryeministra dhe udhëheqës të lartë shtetërorë të vendeve më të fuqishme të botës. Ky ishte rasti i parë i përfaqësimit të Kosovës në këtë mekanizëm dhe do të jetë praktikë e vazhdueshme edhe për të gjitha takimet pasuese të këtij niveli.

Gjithashtu, dua të potencoj edhe pjesëmarrjen në Forumin Ekonomik të Euroazisë në Stamboll, të mbajtur në maj të këtij viti, në të cilin ishin të pranishëm presidentë dhe ish-presidentë, ministra dhe ekspertë nga 41 vende euro-aziatike. Edhe në këtë forum, unë takova personalitete të rëndësishme shtetërore e politike nga shumë vende, të cilëve u bëra thirrje që të ndikojnë te qeveritë e tyre për njohjen e pavarësisë së Kosovës.

Republika e Kosovës çdo ditë po e forcon subjektivitetin e saj ndërkombëtar nëpërmjet anëtarësimit në organizata ndërkombëtare, aderimit në mekanizma e iniciativa rajonale e

ndërkombëtare dhe nënshkrimit të traktateve dypalëshe. Kemi nevojë që numri i këtyre anëtarësimeve dhe traktateve të shtohet, në mënyrë që Kosova të ketë vendin e saj meritator në mekanizmat ndërkombëtarë.

Që nga shpallja e pavarësisë, institucionet e Republikës së Kosovës kanë dëshmuar para qytetarëve dhe bashkësisë ndërkombëtare se janë partnerë seriozë dhe se shteti ynë është një faktor i rëndësishëm i paqes dhe i stabilitetit në rajon. Kushtetuta e Republikës së Kosovës, si akti më i lartë juridik mbetet shtylla e vendimeve më të rëndësishme për të ardhmen e shoqërisë sonë, të shtetit tonë. Ajo na obligon për sundimin e ligjit dhe për sigurimin e barazisë së secilit qytetar në tërë territorin e Republikës sonë.

Siç e dini, vendi ynë do të hyjë sivjet në ciklin normal të zgjedhjeve. Duke u mbështetur në Kushtetutën e Republikës së Kosovës, unë kam zhvilluar një varg takimesh me drejtuesit e partive politike për të caktuar datën e mbajtjes së zgjedhjeve lokale. Pas konsultimeve të bëra, kam marrë vendim që këto zgjedhje të mbahen më 15 nëntor.

Pa dyshim, këto zgjedhje janë shumë të rëndësishme, sepse janë të parat në Kosovën e pavarur dhe organizohen kryekëput nga institucionet vendore. Prandaj, mbarëvajtja e tyre dhe siguri i një procesi korrekt dhe të ndershëm zgjedhor duhet të shndërrohet në synim dhe zotim të të gjithë neve, institucioneve, subjekteve konkurruese dhe qytetarëve të vendit, të cilët me të drejtë duan garanci se vota e tyre si elektor do të respektohet.

Tashmë unë kam pasur disa takime me drejtuesit e Komisionit Qendror Zgjedhor, të cilët kanë premtuar se do të bëjnë gjithçka që është e mundur për t'i kryer me kohë përgatitjet e nevojshme për këto zgjedhje. Sikur që kamë zhvilluar konsulta intensive edhe me partner të rëndësishëm ndërkombëtar që do të jenë partner të rëndësishëm mbështetës për këtë proces të rëndësishëm zgjedhor për Kosovën.

Të

nderuar

deputetë,

Kushtetuta e Republikës së Kosovës siguron ndarjen e qartë të tri pushteteve themelore: legjislativit, ekzekutivit dhe gjyqësorit. Nga pozita ime, jam angazhuar që të sigurohet shkalla e duhur e funksionalitetit koheziv. Si President i Republikës së Kosovës, unë mora kompetenca më thelbësore, sidomos në fushat që janë me atribute të ekzekutivit dhe të sovranitetit shtetëror. Duke e pasur parasysh këtë, kam punuar me gjithë dijen dhe fuqitë e mia, gjithnjë me moton për të cilën jam zotuar dhe që më takon - të jem në shërbim të unitetit demokratik të popullit dhe të institucioneve të Republikës së Kosovës.

Republika e Kosovës ka themeluar edhe shtyllën më të rëndësishme kushtetuese - Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, së cilës i parapriu themelimi i Komisionit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës. Ky komision hartoi dhe është miratur pastaj nga Parlamenti edhe Ligjin për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, që është në fuqi. Funksionimi dhe zbatimi i Kushtetutë së Republikës garantohej nga gjyqtarët e këtij institucioni të lartë, të cilët tashmë kanë dhënë betimin solemn para meje.

Përkitazi me reformat e gjyqësorit, kam kënaqësinë t'ju informoj se në përputhje me kompetencat e mia kushtetuese, kam shpallur Ligjin për Përbërjen e Përkohshme të Këshillit Gjyqësor të Kosovës. Duke u bazuar në këtë ligj, unë bëra edhe emërimet e para të anëtarëve të këtij këshilli,

që ka rëndësi jetike për reformat e parapara në gjyqësor. Në përputhje me kushtet e parapara me ligj, anëtarët e këtij institucioni me rëndësi të veçantë për zhvillimin e drejtësisë në vend kanë dhënë betimin para Presidentit të vendit dhe mbetet obligimi i tyre që të shpejtojnë punë dhe proceset për të ndërtuar një sistem të mirë të gjyqësorit në Kosovë duke e futur në procesin e rëndësishëm të reformave që i ka para vetes.

Si president i një vendi që ka nevojë për reforma rrënjësore në gjyqësor dhe prokurori, do të luaj rolin që më takon për t'i mundësuar bazat e kësaj reforme, në mënyrë që të krijohet një gjyqësor dhe prokurori tërësisht e pavarur. Ky, madje, është parakusht për sundimin e plotë të ligjit.

Insistoj përherë që radhët e gjyqtarëve dhe prokurorëve të Republikës së Kosovës të plotësohen me njerëz të rinj, profesionistë, të dijsëm e të përkushtuar, jashtë ndikimeve e preferencave të tjera formale dhe joformale, personalitete me respekt për të drejtën, të paanshëm dhe, para së gjithash, të papërfshirë në veprime apo afëra korruptive.

Besoj se Ligji për Noterinë dhe Ligji për Ndërmjetësim, që i shpalla para pak kohësh, si dhe fillimi i aplikimit të arbitrazhit si metodë alternative për zgjidhjen e kontesteve, do t'i ofrojnë gjyqësorit të Republikës së Kosovës lehtësimin e barrës shumë të ndjeshme që ka pasur deri tani.

Me rastin e njëvjektorit të Pavarësisë së Republikës së Kosovës, ne treguam në praktikë, për herë të parë në historinë tonë moderne, se drejtësia në këtë vend ka edhe vlerën domethënëse të humanizmit, mëshirën e shtetit dhe të shoqërisë së lirë. Duke u bazuar në kompetencat e mia kushtetuese, në Ligjin për Faljen dhe legjislacionin përkatës, pas shqyrtimit të hollësishëm të të gjitha dosjeve të kompletuara, sipas propozimeve të Komisionit add-hoc, me ekspertë të pavarur, më 17 shkurt 2009 në ditën e pavarësisë më 2009, unë fala plotësisht apo pjesërisht 62 të dënuar. Mendoj se ky akt do të shërbejë si shembull i mëshirës shtetërore, si busull për të gjithë ata që ranë në kundërshtim me ligjin. Kujtoj se në mënyrë institucionale u dhamë rast personave të falur të integrohen në rrjedhat e jetës normale dhe të bëhen sërish pjesë aktive dhe e dobishme e shoqërisë sonë. Njëkohësisht, dhamë shembull konkret se Republika e Kosovës nuk synon të ndërtohet mbi filozofinë e dorës së hekurt të shtetit, por mbi vlerat e demokracisë moderne, të ndjenjës së thellë të humanizmit dhe të respektimit të plotë të ligjit.

Të dashur deputetë,

Dua të veçoj me këtë rast se kemi punuar përherë që të jemi pjesë e dinamikës së ndërtimit të ligjeve dhe institucioneve të reja. Që nga hyrja në fuqi e Kushtetutës së Republikës së Kosovës, kam dekretuar mbi 90 ligje të miratuara nga Kuvendi i Republikës, që janë analizuar me kujdes të posaçëm nga bashkëpunëtorët e mi, për të bërë edhe vlerësimin tim dhe filtrimin e fundit para hyrjes së tyre në fuqi.

Duke pasur parasysh faktin se avancimi ekonomik i vendit zë një vend parësor në politikat tona shtetërore, kam shpallur ligje nga fusha e ekonomisë që shpresojmë se do ta drejtojnë Republikën e Kosovës drejt një zhvillimi substancial ekonomik. Gjithashtu, ne vazhduam bashkë me ju ndërtimin e strukturës legjislative për themelimin e institucioneve që janë shtylla të rëndësishme të një shteti të pavarur dhe sovran, që ndër të tjera përfshijnë edhe institucionet e sigurisë, Forcën e Sigurisë së Kosovës dhe Agjencinë e Inteligjencës së Kosovës, me shenja konkrete të një sistemi funksional. Shteti ynë ka tanimë Forcën e Sigurisë dhe Agjencinë e Inteligjencës të cilat duhet të shkojnë në përsosje, për të cilat unë do të vazhdoj të kontribuoj që të jenë plotësisht në shërbim të

qytetarëve dhe të institucioneve Republikës së Kosovës, duke mbetur gjithmonë të pandikuara nga qendrat politike apo nga grupet e interesit çfarëdo qofshin ato.

Më 15 qershor 2009, kam dekretuar emërimin e eprorëve të lartë të Forcës së Sigurisë së Kosovës. Besoj se ky akt do të ketë efektet e dëshiruara në qëllimin tonë të përbashkët për të pasur një forcë moderne dhe të disiplinuar. Me këtë rast, më lejoni të theksoj se Kosova ofron gatishmërinë e saj për të kontribuar në misionet ndërkombëtare për paqe dhe siguri në botë në partneritet dhe në koordinim të plotë me NATO-n.

Të nderuar deputetë,

Po ashtu, shteti kërkon edhe përfaqësim dhe bashkëpunim ndërkombëtar, prandaj kam shpallur ligje që ju i keni miratuar edhe në fushën e politikës së jashtme dhe të diplomacisë. Tani jam në fazën e fundit të konsultimeve me Qeverinë e Republikës së Kosovës, përkatësisht me Kryeministrin dhe Ministrin e Punëve të Jashtme, për caktimin e ambasadorëve të parë të vendit tonë në botë. Përzgjedhja e ambasadorëve dhe zyrtarëve të tjerë në ambasadat dhe misionet konsullore të Republikës së Kosovës do të

përfundojë shpejt dhe jam i bindur se vendi ynë do të përfaqësohet nga një staf diplomatik i përgatitur për t'i mbrojtur dhe prezantuar interesat e qytetarëve dhe shtetit të Kosovës kudo që do të jenë.

Gjatë shqyrtimit dhe shpalljes së ligjeve të miratuara nga Kuvendi i Republikës së Kosovës, unë si President i Republikës, gjithmonë do të kem parasysh detyrën primare, pra mbrojtjen e interesave legjitime të Republikës së Kosovës dhe qytetarëve të saj. Për këtë arsye, siç e dini, ia kam kthyer për rishqyrtim Kuvendit të Republikës së Kosovës tri ligje, pas vlerësimit se ato, si të tilla, kishin elemente që e cenonin interesin e qytetarëve dhe të vendit tonë, si dhe binin ndesh me konventat ndërkombëtare.

Në kuadër të avancimit të pozitës së komuniteteve në Republikën e Kosovës dhe me qëllim të përmbushjes së zotimeve tona për Planin Gjithëpërfshirës të Presidentit Ahtisaari, unë kam themeluar Këshillin Konsultativ për Komunitete që funksionon si pjesë e Zyrës së Presidentit. Kam kënaqësinë e veçantë t'ju informoj se ky këshill tanimë ka kryesuesin e vet dhe zëvendësit e tij dhe është tërësisht funksional që t'i përmbushë detyrat e shtruara. Këshilli Konsultativ për Komunitete do të jetë një mekanizëm i rëndësishëm i shprehjes së vullnetit të të gjitha komuniteteve që jetojnë në Republikën e Kosovës.

I nderuar zoti Kryetar Krasniqi,

Të dashur qytetarë të Republikës së Kosovës,

Të nderuar deputetë,

Kosova ka përjetuar ndihmën bujare të vendeve mike në Konferencën e Donatorëve dhe nëpërmjet mbështetjes së rëndësishme që kanë dhënë vendet e caktuara veç e veç. Këto vende, siç janë

Shtetet e Bashkuara të Amerikës, vendet e Bashkimit Evropian, si dhe vende të tjera të botës demokratike, e kanë ndihmuar Kosovën edhe në kohët më të rënda të saj, por edhe në dhjetë vjetët e rimëkëmbjes së ekonomisë sonë të rrënuar nga lufta dhe nga një shkatërrim sistematik që i është bërë sidomos gjatë regjimit të Millosheviçit.

Duke ritheksuar mirënjohjen tonë për këtë bujari të jashtëzakonshme të këtyre vendeve, ne insistojmë që institucionet e vendit tonë dhe ndërmarrësit privatë duhet të bëjnë gjithçka që është e mundur, me qëllim që ekonomia e vendit tonë të qëndrojë në këmbët e veta. Mbështetja nga jashtë është shumë e rëndësishme, por qytetari ynë ka nevojë të shohë përparime edhe më të prekshme e më konkrete në sektorin tonë ekonomik. Atij i duhen argumente të përditshme se institucionet e vendit të tij kanë një vizion të qartë, të cilin synojnë ta arrijnë.

Anëtarësimi i Kosovës në Fondin Monetar Ndërkombëtar dhe në Bankën Botërore është një e arritur e jashtëzakonshme, që duhet të shfrytëzohet për t'i dhënë impulse të reja përparimit ekonomik të vendit. Prandaj, Ministria e Ekonomisë dhe Financave, po edhe segmentet e tjera të pushtetit qendror e lokal duhet t'i shtojnë përpjekjet e tyre për t'i zvogëluar në mënyrë të vazhdueshme efektet e krizës ekonomike, aq më tepër kur pasojat e krizës globale nuk mund të mos prekin edhe vendin tonë.

Bazamenti i një ekonomie të shëndoshë është respektimi i marrëveshjeve në mes të dy palëve. Duke pasur parasysh këtë kontekst thelbësor juridiko-ekonomik, nxis të gjitha palët kompetente që të bëjnë çmos për realizimin e kushteve të domosdoshme për ndërmarrjet e privatizuara me spin-off special. Mosrespektimi i kushteve të parapara për privatizuesit e ndërmarrjeve shoqërore është shndërruar në një dukuri kronike, e cila po i dëmton punëtorët, ndërmarrjet e privatizuara dhe ekonominë e Kosovës. Janë të rralla rastet e mira kur dikush ka bërë punën më ët mirë në përmbushjen e obligimeve.

Prandaj, shfrytëzoj rastin të kërkoj nga organet kompetente të Republikës së Kosovës që të ndërmarrin të gjithë hapat e nevojshëm për realizimin e këtyre kushteve të privatizimit, apo, në të kundërtën, pra nëse kushtet e parapara me kontratën e privatizimit nuk përmbushen nga investitori brenda afatit kohor, të ndërmarrin të gjithë hapat juridikë që lejohen nga legjislacioni përkatës dhe marrëveshjet e privatizimit. Pra, njëherë e përgjithmonë të kuptojmë se ekonomia e tregut të lirë nuk do të thotë ekonomi pa përgjegjësi.

Po ashtu, ekonomia e tregut të lirë, nuk nënkupton një Laissez-faire absolute. Një ekonomi e shëndoshë duhet të ndërtohet mbi një legjislacion përkatës dhe efektiv që nxit ekonominë dhe siguron një konkurrencë korrekte në mes operatorëve të ndryshëm ekonomikë. Natyrisht, legjislacioni ekonomik dhe licencimi garantojnë një cilësi të lartë të ofertave dhe pjesëmarrësve që paraqiten në treg. Mirëpo, është tejet e rëndësishme që kjo rregull juridike, përkatësisht licencimi, assesi të mos përdoret si vegël për promovimin e monopoleve dhe interesave personale. Një qasje e tillë është në kundërshtim me synimet tona për një treg të lirë ekonomik, me interesat tona shtetërore dhe me vlerat tona qytetërore evropiane.

Në mes dy paraqitjeve të mia vjetore para jush, të dashur deputetë, unë kam zhvilluar shumë takime me qytetarët e vendit. Vlerësoj se institucionet e Kosovës mund të bëjnë më tepër për të

mirën e qytetarëve duke hapur perspektivën e zhvillimit ekonomik dhe duke shtuar shkallën e përkujdesjes sociale. Ende kërkohet të nxitet krijimi i lehtësive për zhvillimin e bizneseve, për përcaktimin e qartë të prioritetëve në shëndetësi, në agrokulturë, në energjetikë, në arsim dhe në kulturë. Na duhen shumë më tepër vende të reja pune dhe përkujdesje e qëndrueshme sociale për ta pakësuar varfërinë dhe papunësinë që mbetet ende në shkallë kërcënuese.

Përsëri i ftoj institucionet tona që punonjësit e arsimit dhe të shëndetësisë në Kosovë të nxirren prej kategorisë së shërbyesve civilë, në mënyrë që të krijohet mundësia e diversifikimit dhe e konkurrencës së shërbimeve në rrethana të ekonomisë së tregut. Qeveria duhet t'i shtojë investimet në shëndetësinë publike dhe të punojë për valorizimin e edukimit në vendit tonë konform arritjeve dhe trendeve bashkëkohore. Gjithashtu, u bëj thirrje institucioneve tona në të gjitha nivelet që të tregojnë edhe më shumë kujdes për pensionistët, të cilët dekada me radhë kanë dhënë kontribut të madh për ndërtimin e Republikës së Kosovës.

Po e ritheksoj me këtë rast edhe çështjen e regjistrimit të popullsisë, ngecje kjo që sjell vështirësi për zhvillimin e ardhshëm të Kosovës dhe është shumë i rëndësishëm vendimi që është marrë se regjistrimi i popullsisë në Kosovë do të ndihmojë shumë institucionet e Republikë së Kosovës dhe prioritetet e tyre në drejtimit e shumta strategjike që duhet të ndërmerren në aspektet zhvillimore.

Të nderuar deputetë,

Më 17 shkurt dhe më 8 gusht 2008, në emër të institucioneve të Republikës së Kosovës, unë i kam bërë ftesë Bashkimit Evropian që të dërgohet në vendin tonë Misioni Civil Ndërkombëtar i udhëhequr pikërisht nga Bashkimi Evropian dhe me prezencë të Shteteve të Bashkuara. Në bazë të kësaj kërkesë, EULEX-i tashmë është në Kosovë dhe pavarësisht disa vonesave, që nga fillimi i shtrirjes së tij në terren, ka shënuar disa rezultate të rëndësishme. Kthimi gradual i rendit në pikat kufitare në veri të vendit, përpjekjet për funksionalizimin e plotë të doganave dhe mosnënshtrimi ndaj presioneve që vazhdimisht i kanë ardhur nga Serbia, kanë bërë që ky mision të ketë besimin e institucioneve dhe të qytetarëve të Republikës së Kosovës pa dallim . Prandaj, ne i garantojmë EULEX-it bashkëpunimin tonë, me qëllim të arritjes së rezultateve të reja dhe të përbashkëta në fushë të sigurisë dhe të sundimit të ligjit.

Po ashtu, ritheksoj kërkesën tonë për rikonfigurimin e UNMIK-ut, me qëllim të përmbylljes së këtij misioni, i cili, përkundër vonesave, mund të quhet një storje e suksesshme e angazhimit ndërkombëtar në Kosovë.

Një falënderim të veçantë kemi për komandantët dhe ushtarët e KFOR-it, të cilët si me punën e tyre profesionale për ruajtjen e Kosovës, ashtu edhe me angazhimet e tjera në fushën civile, siç janë ndërtimi i rrugëve dhe i urave, ndërtimi i shkollave dhe objekteve të tjera për qytetarët e vendit tonë, janë pa dyshim shembull më vete i suksesit në Kosovë.

Përderisa flasim për çështje të sigurisë, me kënaqësi mund të theksojmë se në Republikën e Kosovës, gjatë këtij viti, nuk është shënuar asnjë incident me motive etnike. Ky është një argument i fuqishëm se Kosova është atdhe i përbashkët për të gjithë qytetarët e saj të barabartë, pa dallim kombi, feje apo etnie. Me bindje pohojmë se prishësit e rendit dhe të qetësisë publike, kundërshtarët e paqes dhe të ardhmërisë së përbashkët dhe evropiane të qytetarëve të Kosovës,

janë në shërbim të atyre që nuk e duan Kosovën e pavarur, që nuk e duan demokracinë e saj, që nuk e duan Kosovën pro perëndimore.

Me këtë rast, ju shprehim mirënjohjen tonë ministrave, deputetëve dhe të gjithë bashkëqytetarëve tanë të komunitetit serb, të cilët kanë punuar me zell në institucionet e Kosovës, megjithëse kanë pasur presione të vazhdueshme që të tërhiqen dhe t'i bojkotojnë këto institucione. Puna e tyre është në të mirë të Kosovës, në të mirë të bashkëkombësve të tyre serbë që jetojnë në Kosovë, po edhe në të mirë të gjithë qytetarëve të tjerë.

Përsëritës kthimin e policëve serbë në vendet e tyre në Policinë e Kosovës dhe i ftoj nga kjo foltore e Kuvendit qytetarët serbë të Kosovës dhe subjektet e tjera politike të tyre, që ende hezitojnë të bashkëpunojnë me institucione, të integrohen sa më parë në jetën tonë të përbashkët politike e qytetare. Pjesëmarrja e tyre në zgjedhjet e sivilizimit lokale do të ishte një hap shumë domethënës për të gjithë në Kosovë, po edhe një mesazh i mirë për komunitetin ndërkombëtar një mesazh dhe punë e mirë për të ardhmen e përbashkët dhe perspektivën tonë.

Po ashtu, u bëj apel të gjithë të zhvendosurve, kudo që ndodhen, që të kthehen në shtëpitë e tyre, sepse Republika e Kosovës u garanton jetë të qetë dhe një të ardhme të sigurt.

Si gjithmonë, edhe kësaj radhe, duhet të veçojmë ndihmesën e madhe që kanë dhënë dhe po japim për mbarëvajtjen e proceseve të përgjithshme politike e shoqërore përfaqësuesit e të gjitha bashkësive të tjera etnike në Kosovë, të turqve, boshnjakëve, romëve, ashkalinjve, egjiptasve etj., të cilat janë faktorë shumë domethënës të stabilitetit dhe të progresit të Republikës së Kosovës.

Të nderuar deputetë,

Institucionet e Republikës së Kosovës, Kuvendi, Qeveria, pushteti lokal dhe të gjitha hallkat e shtetit tonë, duhet dhe do të vazhdojnë të punojnë me përkushtimin më të madh për përmirësimin e jetës së qytetarëve dhe për thellimin e stabilitetit e të sigurisë për të gjithë.

Vendi ynë do të mbetet faktor i paqes së qëndrueshme në rajon, por njëkohësisht do të këmbëngulë për paprekshmërinë e sovranitetit dhe integritetit territorial. Nuk do të lejojmë në asnjë çast cenimin e interesave tona nacionale, ndërkohë që do të pohojmë fuqishëm se jemi jetësisht të interesuar për marrëdhënie të mira me të gjitha vendet fqinje të rajonit, pse jo edhe me Serbinë, me kusht që ajo të heqë dorë nga politikat e destruktivitetit dhe të shantazhit ndaj Kosovës. Rindërtimi i këtyre marrëdhënieve është i pamundur, sa kohë që Serbia do t'i sponsorizojë strukturat paralele në veri të vendit tonë, në mesin e të cilave ka plotë persona të inkriminuar në krime të rënda, të cilët i kanë shumë borxh popullit të Kosovës, por edhe popujve të tjerë të rajonit, dhe në rend të parë drejtësisë.

Ne na gëzon gatishmëria e vendeve të tjera të rajonit që ta thellojnë bashkëpunimin me Republikën e Kosovës, si dhe fakti se ato kanë treguar mirëkuptim për idenë tonë që të krijohet një zonë e lirë e lëvizjes së njerëzve dhe e qarkullimit të mallrave në mes vendeve tona. Jetësimi i kësaj ideje, pa dyshim, do ta përshpejtonte shkëmbimin tregtar dhe zhvillimin ekonomik në rajon, dhe, njëkohësisht, do të jepte një dëshmi të fuqishme se kjo pjesë e Evropës Juglindore ka vullnet, ka dije dhe gatishmëri për të qenë pjesë e

Evropës së bashkuar, pjesë e botës së lirë e demokratike, në të cilën liria e individit, respektimi i diversiteteve etnike, religjioze e kulturore çmohet si pasuri e mozaikut të përgjithshëm të qytetërimit bashkëkohor.

Po ashtu, ritheksojmë se jemi të lumtur për sukseset e vendeve të rajonit dhe përshëndesim anëtarësimin me të drejta të plota të Republikës së Kroacisë dhe të Republikës së Shqipërisë në NATO, të bindur se ky është një moment shumë i rëndësishëm për sigurinë dhe ardhmërinë e të gjithë rajonit. Një mirënjohje të veçantë i japim Qeverisë së Shqipërisë, e cila po e jetëson ëndrrën e kamotshme të lidhjes fizike në mes dy vendeve tona me ndërtimin e autostradës Durrës-Morinë, të cilën besojmë se do ta vazhdojmë edhe ne, në një afat sa më optimal, drejt Prishtinës dhe më tej deri në Merdar. Kjo udhë, pa dyshim, do t'i japë hov bashkëpunimit në mes të Republikës së Shqipërisë dhe Republikës së Kosovës, por do t'i ndihmojë edhe zhvillimit të rajonit në përgjithësi.

Përfundimisht, e themi si gjithmonë, integrimi i Republikës së Kosovës në Bashkimin Evropian, në NATO dhe në mekanizmat e tjerë ndërkombëtarë, si dhe forcimi i bashkëpunimit dhe i miqësisë speciale me Shtetet e Bashkuara të Amerikës është motoja kryesore e angazhimeve tona. Ky përcaktim shpreh vullnetin politik të popullit të Kosovës, të institucioneve dhe subjekteve të saj politike dhe prej tij nuk heqim dorë për asnjë çmim.

Zoti e bekoftë Kuvendin e Republikës së Kosovës!

Zoti e bekoftë popullin e Republikës së Kosovës!

Zoti i bekoftë të gjithë miqtë tanë!

(Duartrokitje)

KRYETARI I KUVENDIT: Të nderuar deputetë,

Të nderuar mysafirë,

Zonja dhe zotërinj,

Falënderoj Presidentin e Republikës së Kosovës, zotin Fatmir Sejdiu, për fjalimin vjetor para deputetëve të Kuvendit të Republikës së Kosovës dhe me këtë kjo pjesë e seancës përfundoi. Tani bëjmë një pauzë prej 15 minutash. Ju faleminderit!

KRYETARI: Të nderuar deputetë, fillojmë seancën e punës. Ju njoftoj, gjithashtu, se deri në fillim të seancës plenare nuk kam pranuar asnjë propozim për amendamentin e rendit të ditës ose propozim për shqyrtimin e një çështjeje urgjente në pajtim me rregullat procedurale.

Fillojmë me rendin e punës:

2. Miratimi i procesverbaleve të seancave plenare të mbajtura më 12 dhe 23 qershor 2009.

A ka ndokush vërejtje në procesverbalet e mbajtura më 12 dhe 23 qershor 2009? Nuk ka.

Konstatoj se Kuvendi miratoi procesverbalet e seancave plenare të mbajtura më 12 dhe 23 qershor 2009.

Pika e radhës e rendit të ditës është:

3. Pyetjet parlamentare

Ju njoftoj se në mes dy seancave janë parashtruar 22 pyetje parlamentare, ndërsa koha e parashtruar është e kufizuar në 50 minuta.

Procedimi i pyetjeve do të bëhet sipas kohës së parashtruar dhe numrit rendor të pyetjeve.

Deputetja Gjylnaze Syla, pyetje për Kryeministrin, zotin Hashim Thaçi. Deputete, mund ta lexoni pyetjen!

GJYLNAZE SYLA: Zoti Kryetar, Kryeministri prapë nuk është këtu. Megjithatë, po e lexoj pyetjen dhe shpresoj se ai diku do ta dëgjojë dhe mbase në të ardhmen do të përgjigjet, të jetë i përgjegjshëm.

Pyetja ime ka të bëjë kryesisht me djegien e pikave kufitare në veri të pikës 1 dhe 31 pas shpalljes së pavarësisë së Kosovës, kurse vetë i dogjën këto dy pika. Duke marrë parasysh rëndësinë që ka ndërtimi i këtyre pikave doganore, kontrolli i tyre, si dhe humbjet e mëdha ekonomike që po i shkaktojnë Kosovës në vlerë prej miliona eurosh dhe kontrabandës me naftë dhe mallra, pyes Kryeministrin Hashim Thaçi - pse nuk ka rindërtuar Qeveria e Kosovës deri më sot dy pikat doganore 1 dhe 31 në veri të Kosovës dhe kur do të rindërtohen ato? Gjithashtu, zoti Kryetar, në qoftë se ndonjë anëtar i Qeverisë do të përgjigjet në këtë pyetje, unë po e dëgjoj. Faleminderit!

KRYETARI: Përgjigjet ministri për Ekonomi e Financa, zoti Ahmet Shala.

MINISTRI AHMET SHALA: Faleminderit, i nderuar Kryetar!

E nderuara deputete,

Sigurisht që ju jeni në rrjedhë të informacioneve sa u përket problemeve që janë në dy pikat e veriut. Tani për tani ne jemi në proces të instalimit të kamerave dhe ato janë bërë funksionale, më në fund. Sigurisht që gjatë kësaj periudhe vere, tanimë pasi që EULEX-i ka marrë faktikisht një mision të ri dhe është duke monitoruar dy pikat kufitare, procesi i kontrabandimit, nëse mund të themi, ose i mospërfilljes së ligjit është futur në një rrugë, konsideroj, mjaft të kontrolluar edhe pse nuk mund të them 100% se e kemi reduktuar, por sipas të dhënave statistikore, diku 85% ka rënë kontrabanda në dy pikat e veriut. Të gjitha shënimet e doganës janë në web-site për çdo ditë faktikisht se çfarë qarkullimi kemi aty.

Procesi i ndërtimit do të fillojë këtë vit dhe procesi i vendosjes së kontrollit në kufi është në progres, konsideroj, mjaft të konsiderueshëm. Vetë fakti që në dy pikat kufitare në gjashtë muajt e fundit ka një ngritje të jashtëzakonshme, sidomos në terminalin e Trepçës, aty ku alokohen kamionët, shifrat janë vërtet inkurajuese dhe ne besojmë që së bashku me Misionin e EULEX-it do ta përmbyllim këtë mision jo të lehtë.

Nuk është diçka që, vërtet, kemi thënë ndonjëherë që është ndonjë mision i arritshëm në një kohë të saktë, konform rrethanave ne jemi, konsideroj, mirë duke progresuar në atë drejtim. Tanimë bëhet kontrollimi i dokumentacioneve dhe bëhet evidentimi i saktë. Nga 29 maj ka filluar faktikisht edhe fotokopjimi i të gjitha dokumentave. EULEX-i është duke dhënë një vullë jo të doganave të Kosovës, por një vullë të EULEX-it, i cili rrit efikasitetin e kontrollimit të çdo lloj malli që hyn. Çdo kamion që hyn në të dy pikat, është i obliguar me një fletëlëshim që është faza e parë, faktikisht, dhe neve diku në tetor do të kalojmë në një fazë më të avancuar me EULEX-in për të kontrolluar në mënyrë më të avancuar këto dy pika.

Sigurisht që kjo nuk do të jetë vetëm një ballafaqim i Ministrisë së Ekonomisë dhe të Financave, por i gjithë shoqërisë kosovare, edhe i këtij institucioni dhe konsideroj shumë të ligjshme ngritjen e kësaj pike. Ne, në bashkëpunim me partnerët tanë ndërkombëtarë, jemi duke hulumtuar dhe ecën përpara në rrugët më efikase të kontrollimit jo vetëm të atyre dy pikave, por edhe të aspekteve tjera të administratës tatimore në komunat e veriut, si dhe në komunat tjera me popullatë shumicë serbe. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Deputete, ke pyetje shtesë?

GJYLNAZE SYLA: Zoti ministër, masat që ju i përmendët, prapë nuk sigurojnë kontrollin e një shteti të mirëfilltë të pikave doganore. Në qoftë se janë kamerat dhe në qoftë se EULEX-i bën vetëm regjistrimin ose fotokopjimin e dokumenteve, kjo nuk është masë që do ta ndryshojë gjendjen ose kontrollin e doganës.

Pos kësaj, para shpalljes së pavarësisë kemi pas doganierë të Kosovës. Kur do të kthehen doganierët e Kosovës që të punojnë aty dhe a mund të ma jepni një datë të saktë kur Qeveria mund t'i rindërtojë këto dy pika. Faleminderit!

KRYETARI: Ministër, do të përgjigjesh?

MINISTRI AHMET SHALA: Natyrisht që do të ishte mirë të isha në gjendje të jap datën e saktë. Nuk mund ta jap datën e saktë, më vjen keq. Besoj që të gjithë do të donim ta kemi atë datë të saktë, jo vetëm në kontrollimin e plotë të dy pikave kufitare, por edhe të elementeve të tjera të shtetësisë së Kosovës. Gjithsesi, ne jemi në rrugë të mirë për ta bërë atë dhe unë jam shumë i sigurt që javët, muajt që po vinë, janë duke shkuar në drejtim të kontrollimit të plotë të çdo cepi të territorit të Kosovës edhe në aspektet tatimore, edhe në aspektet doganore.

Doganierët serbë janë kthyer, një pjesë e tyre, të cilët besoj do jenë një aset i mirë i Ministrisë së Ekonomisë dhe Financave, përkatësisht i doganave në mënyrë që t'i përshtaten kulturës dhe klimës politike që ndodhet në atë pjesë dhe në bashkëpunim me organet tjera, me Ministrinë e Punëve të Brendshme dhe me faktorin ndërkombëtar, unë jam i sigurt se një ditë, shpejt, brenda muajve të ardhshëm, besoj, ne do të kemi mundësi që të raportojmë këtu për rezultate të arritura. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit, ministër! Deputeti Driton Tali, pyetje për ministrin e Ekonomisë dhe të Financave, zotin Ahmet Shala. Deputet, mund ta parashtroni pyetjen!

DRITON TALI: Faleminderit, zoti Kryetar!

KRYETARI: I ke dy pyetje, mund t'i bësh!

DRITON TALI: Zoti ministër, krijimi i Postë-Bankës ka qenë iniciativë e hershme e menaxhmentit të PTK-së. Një iniciativë të tillë e konfirmoi edhe drejtori apo menaxhmenti aktual i PTK-së dhe u përkrah nga disa udhëheqës të Qeverisë, por ka edhe zëra të tjerë të cilët e kundërshtojnë këtë iniciativë. Andaj, më intereson të di, po edhe qytetarët e Kosovës, se ky projekt çfarë do të përmbajë në vete dhe kur mund të presim që të realizohet diçka më konkrete? Faleminderit!

KRYETARI: Para se ta marrë fjalën ministri, ju njoftoj se në sallë janë 62 deputetë.

MINISTRI AHMET SHALA: I nderuar deputet Tali, iniciativa për themelimin e Postë-Bankës ka qenë një ide qysh në vitin e kaluar. Ajo është ende në fazën e shqyrtimit. Sigurisht që Komisioni ndërmarrës për ndërmarrjet publike është duke e shqyrtuar së bashku me institucionet e tjera të rëndësishme, edhe me Bankën Qendrore. Janë disa sfida aty, të cilat janë në tavolinë, të cilat janë duke u shqyrtuar. Nuk mund të jap ndonjë deklaramë të madh se çfarë do të jetë rezultati përfundimtar i këtij projekti. Sigurisht, Qeveria e Kosovës do ta shqyrtojë çdo iniciativë, edhe të Postës dhe të Telekomunikacionit të Kosovës. Tani, kur jemi në fazën e shqyrtimeve të opsioneve të ndryshme të involvimit të sektorit privat në Postë dhe Telekom të Kosovës, duhet një analizë shumë e thuktë për përparësitë dhe anët tjera të iniciativave të tilla dhe, sigurisht, pas shqyrtimeve ne do të raportojmë para jush këtu për rezultatet finale.

KRYETARI: Faleminderit, ministër! Deputet, ke pyetje shtesë?

DRITON TALI: Po, zoti Kryetar! Unë nuk po shoh arsye pse kjo të prolongohet nga fakti se paraja ekziston, 270 e sa milionë të PTK-së gjenden në këto bankat private. Dëgjohet shpesh se bankat private, ndërkombëtares e prolongojnë apo e stopojnë këtë projekt, por duhet t'ia bëjnë të qartë çdokujt se ato para janë të Kosovës dhe bankat ndërkombëtare që janë këtu, nuk i kemi ftuar që të vinë të bëjnë biznes me paratë tona, por me paratë e tyre. Kosova ka nevojë që të na sjell dikush para, jo me paratë tona dikush tjetër të bëjë biznes. Po ashtu, bankat ndërkombëtare janë private dhe si çdo ndërmarrje private, aksionarët e atyre ndërmarrjeve duhet t'ia mbajnë gajle vetvetes e jo qytetarët e Kosovës. Po them, duke pasur parasysh nevojën që ka ekonomia kosovare, sidomos ndërmarrësit për ato para, krijimi i Postë-Bankës është domosdoshmëri e kohës. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Pyetje nuk pate? Po e keni pyetjen e radhës përsëri, do të thotë, Driton Tali, pyetje për ministren e Energjisë dhe të Minierave, zonjën Justina Shiroka-Pula.

DRITON TALI: Faleminderit! Po, pyetja ka të bëjë me privatizimin e Distribucionit, do me thënë të distribuimit dhe shpërndarjes së pjesës së parë të KEK-ut. Siç dihet, kjo ndërmarrje disa herë është thënë se do të privatizohet dhe është në proces të privatizimit. Andaj, pyetja është se a do të ketë konkurrencë në privatizimin e shpërndarjes dhe të distribuimit. Faleminderit!

KRYETARI: Ministre, e ke fjalën!

MINISTRJA JUSTINA SHIROKA-PULA: Faleminderit!

I nderuari Kryetar,

I nderuari Zëvendëskryeministër, ministra, deputetë,

Privatizimi i parashikuar nga ana e Qeverisë për sektorin e shpërndarjes dhe furnizimit të KEK-ut duhet bërë në parim dhe nga qasja evropiane dhe ligjet në fuqi të cilat ekzistojnë në Kosovë. Kjo qasje dhe këto ligje parashikojnë shpërndarjen e aseteve të shpërndarjes dhe të furnizimit dhe kjo do të bëhet sipas parashikimeve deri në vitin 2015.

Shpërndarja apo privatizimi i shpërndarjes dhe të furnizimit parashikohet me ligjet dhe standardet evropiane, që do të thotë se mund të furnizohen të gjithë konsumatorët joamvisnorë, ndërsa pas vitit 2015 me energji elektrike nga tregu evropian mund të furnizohen edhe konsumatorët tjerë.

Çka do të thotë kjo? Të gjithë konsumatorët pas vitit 2015 nëse dëshirojnë të blejnë energji elektrike nga furnizuesit e ndryshëm dhe nga furnizuesit në tregun ku është konkurrent, mund të furnizohen pa ndonjë ndërhyrje të Qeverisë apo të sektorit konkret, të sektorit të KEK-ut. Deri më tani këtë privilegj e kanë pasur vetëm kompanitë të cilat kanë qenë të lidhura në trafostacionin 10 kilovoltë e më shumë.

KRYETARI: Faleminderit! Ke pyetje shitesë?

DRITON TALI: Zoti Kryetar, pyetja ishte se a do të privatizohet nga një ndërmarrje, do me thënë, monopoli shtetëror a do t'i jepet monopolistit privat. Unë këtë përgjigje s'e mora. Kur ta marr këtë përgjigje, do ta bëj edhe pyetjen shitesë.

JUSTINA SHIROKA-PULA: Deri në vitin 2015 nuk do të ketë konkurrencë në rrjet dhe në furnizim. Pas vitit 2015 do të ketë konkurrencë vetëm në sektorin e furnizimit dhe rrjeti do t'i mundësojë të gjitha asetet që këta furnizues të jenë. Domethënë, sa i përket rrjetit, nuk ka konkurrencë. Vetëm në furnizim do të ketë konkurrencë.

KRYETARI: Jo, u krye Driton! Faleminderit! Mund ta bësh pyetjen e radhës. Pyetje për ministrin e Financave, zotin Ahmet Shala.

DRITON TALI: Po unë, tash e pata. Unë do ta jap një koment të shkurtër, se më mbete borxh, është shumë me rëndësi kjo.

Zonja ministre, nuk i jepet monopoli shtetëror një monopolisti privat, aq më shumë kur kemi të bëjmë me një produkt aq strategjik, siç është autostrada e rrymës, do të thotë, po flas për rrjetin apo shpërndarjen. Askund në Evropë, pos në Maqedoni dhe në disa vende ish-socialiste, ku dyshohet për korrupsion, e kanë bërë atë gabim dhe sot Maqedonia tenton që ta kthejë mbrapa. Në Evropë, pasi u përmend Evropa, nuk jepet askund më shumë se 10% të ketë influencë në monopolet natyrore, madje në disa nuk e lënë tavanin as 5%. Po them, edhe t'ia jepësh monopolin shtetëror një monopolisti privat, është më shumë se marrëzi.

Sidoqoftë, tash e bëj pyetjen për ministrin Shala, nëse kam kohë.

Ministër Shala, kohë më parë u publikua raporti se objekti me qira i PTK-së, i cili paguhet 25.000...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYETARI: Urdhëro! Pasi ai e keqpërdori të drejtën e vetë, urdhëro ministre, përgjigju!

MINISTRJA JUSTINA SHIROKA-PULA: Vetëm pak, zoti Tali! Rrjeti dhe furnizimi nuk është autostrada. Autostrada është transmissioni. Transmissioni nuk privatizohet. Do me thënë, ato i kanë të gjitha asetet të cilat kanë prej 10 kilovoltë e më shumë. Do me thënë, rrjeti ka trafostacione të cilat janë nën 10, prandaj privatizohet rrjeti, ndërsa furnizimi do të ketë konkurrencë, deri në vitin 2015 nuk kemi shans...

Autostrada është transmissioni, nuk është rrjeti. Duhet të bëjmë dallimin në rrjetin, furnizimin dhe transmissinin – KOSTT-i, faktikisht, nëse keni dëgjuar.

(Ndërhyrje nga deputeti)

KRYETARI: Deputet, ke nevojë vërtet ta njohësh mirë Rregulloren e Punës të Kuvendit dhe t'i respektosh rregullat. Zoti ministër, a do të përgjigjesh në pyetjen që e bëri për ju?

(Ndërhyrje)

Po, e keni marrë ndoshta pyetjen?

MINISTRI AHMET SHALA: Faleminderit, Kryetar!

I nderuari deputet,

Mbase gjysma e pyetjes nuk u dëgjua, dua ta përsëris. Pyetja juaj ishte: “Kohë më parë është publikuar raporti se objekti me qira i PTK-së në “Qafë” të Prishtinës rrezikon shëndetin dhe jetën e punëtorëve të saj. Çfarë ka ndërmarrë Ministria që të mos ndodhë ndonjë tragjedi e mundshme”. Kjo ishte pyetja juaj, sa di unë.

Natyrisht, unë për t’u përgjigjur në këtë pyetje, është dashur të konsultohem me Bordin dhe menaxhmentin e Postë-Telekomit të Kosovës, të cilët kanë përgatitur një përgjigje, të cilën, pas shqyrtimit edhe në Ministri, dua ta paraqes para jush.

Posta e Telekomit të Kosovës, si shoqëri aksionare, ka në shfrytëzim objektin afarist në lokacionin “Qafa” në Prishtinë. Ky objekt është i ri për nga ndërtimi, me një dukje moderne, kështu thotë përgjigja, e cila i përshtatet imazhit të kompanisë. Korporata nuk disponon ndonjë raport të organit kompetent se shfrytëzimi i objektit në fjalë paraqet ose përmban ndonjë rrezik në vete për jetën ose shëndetin e të punësuarve. Afarizmi në objekt zhvillohet në përputhje me funksionet e përcaktuara të Koorporatës dhe pa probleme, ndërsa për shfrytëzimin e objektit posedojnë të gjitha lejet – leje vendimet e organeve kompetente të komunës së Prishtinës.

Dispozitat e kontratës mbi qiranë e objektit në fjalë sigurojnë të gjitha interesat dhe funksionimin e korporatës në rast të ndonjë rreziku, i cili do të pamundësonte shfrytëzimin efikas të objektit për desitnimin e përcaktuar.

Për informim më të detalizuar, objekti në fjalë posedon edhe sistemin e alarmit ndaj zjarrit, sistemin e hidrantit për fikje të zjarrit, aparatet kundër zjarrit, sistemin e klimatizimit dhe të ventilimit, rezervat e naftës për nxehje qendrore, posedojnë edhe valvulat për ajrosje, pra, të këtyre rezervave për nxehje, në objekt janë të vendosura edhe llambat emergjente, ndërsa në objekt gjithashtu janë të vendosura të gjitha shenjat ndaluese dhe parandaluese dhe sipas informatave unë që kam nga Posta, i ka të gjitha lejet dhe dokumentet tjera të nevojshme.

Një vërejtje që është dhënë nga Inspektorati komunal, është dhënë për oxhakun, nuk i di detajet, për të cilin Bordi dhe menaxhmenti i Postë-Telekomunikacionit i ka marrë të gjitha masat për zbatimin e instruksioneve të këtij inspektorati. Faleminderit!

KRYETARI: A ke pyetje shtesë?

DRITON TALI: Po, zoti Kryetar! Me një kërkesë që mos e keqpërdorni edhe ju mikrofonin atje, të lutem!

Sidoqoftë, unë i referohem një raporti, zoti ministër, që është publikuar edhe në media më 12 prill të vitit 2008. Siç po shihet, dikush këtu e ka gabim, ose menaxhmenti i PTK-së, ose raporti i cili është publikuar. Sidoqoftë, mendoj se këtu ka nevojë edhe për hetime më të thukëta. Faleminderit!

KRYETARI: Deputet Tali, vazhdimisht e keqpërdor mikrofonin dhe si pasojë e kësaj, unë kërkoj nga administrata që pyetjet që i bën deputeti Driton Tali të renditen në fund. Kjo do të jetë vërejtja e parë. Vërejtja e dytë, pyetjet tuaja nuk do të lexohen fare, prandaj mos e keqpërdor.... Lexoje Rregulloren, mësoje Rregulloren dhe pastaj mbi bazën e Rregullores bëre pyetjen dhe pyetjen tjetër.

(Ndërhyrje e deputetit Tali)

Vazhdojmë. Deputetja Zylfije Hundozi, pyetje për ministrin e Arsimit, zotin Enver Hoxhaj.

(Ndërhyrje e deputetit Tali)

Deputete, do ta lexosh pyetjen? Unë, nuk lëshoj mikrofon. Unë jap fjalën.

ZYLFIJE HUNDOZI: Ministri i Arsimit s'është këtu. Unë e kam pyetjen për ministrin e Arsimit.

KRYETARI: Deputetja Luljeta Shehu, pyetje për ministrin e Arsimit, zotin Enver Hoxha. Deputete, a doni ta lexoni pyetjen? Urdhëroni!

LULJETA SHEHU: Po, Kryetar!

I nderuari, Kryetar,

Të nderuar ministra,

Të nderuar deputetë,

Çështja është: Qytetarët e Prizrenit, si dhe ata të rajonit të tij, janë tejet të interesuar për hapjen e Universitetit Publik në qytetin e Prizrenit, pasi që vendimi për hapjen e Universitetit Publik është marrë paraprakisht në fund të vitit 2007.

Pyetja është, zoti ministër: Kur mendoni të bëni hapjen e Universitetit Publik në Prizren? Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Deputetja Gjylnaze Syla, pyetje për Kryeministrin, zotin Hashim Thaçi. Deputete, doni ta lexoni pyetjen?

GJYLNAZE SYLA: Zoti, Kryetar! Para se ta lexoj pyetjen, po dua të shpreh pakënaqësinë e thellë për papërgjegjësinë e Qeverisë. Nga 6 pyetje që i kam parashtruar këtu, për asnjërën nuk kam marrë përgjigje, duke përcjellë edhe këtë që do ta lexoj tani.

Një nga pasuritë më të mëdha të historisë së Kosovës, që nga periudha e Neolitit, 6 mijë vjet më parë e deri në mesjetë, është koleksioni arkeologjik dhe etnologjik i Kosovës, i cili gjendet më shumë se dhjetë vite në Serbi. Këto eksponate janë marrë për një ekspozim të përkohshëm dhe, tash më shumë se dhjetë vjet, nuk janë kthyer ende. I vetmi eksponat që është kthyer është "Hyjnesha në Fron". Pra, kanë ngelur 676 eksponate arkeologjike dhe 571 eksponate etnologjike në Beograd.

Pyetja për Kryeministrin Hashim Thaçi: Çfarë veprimesh ka ndërmarrë Qeveria e Kosovës për të rikthyer këtë pasuri të Kosovës dhe kur do të jenë këto eksponate në Kosovë?

KRYETARI: Faleminderit, deputete! Zëvendëskryeministër, a do të përgjigjesh në pyetje? Jo, faleminderit!

Deputetja Fatmire Berisha, pyetje për ministrin e Punëve të Mirëqenies Sociale, zotin Nenad Rashi. Ministri s'është këtu. A do ta bëni pyetjen?

FATMIRE BERISHA: Faleminderit, i nderuar Kryetar i Kuvendit!

I nderuari zëvendëskryeministër,

Të nderuar ministra,

Deputetë të respektuar,

Në Mitrovicë, më 3 dhe 4 shkurt të vitit 2000, në prani të familjarëve u vranë dhjetë qytetarë – fëmijë, gra dhe burra prej 13 vjeç deri më 61 vjeç, si dhe u plagosën shumë të tjerë. Për nëntë vite, familjarët e të vrarëve, të dëbuar nga vendbanimet e tyre, ndihen të lënë pas dore, pa mbështetje institucionale.

Pyetja ime për ministrin Rashiq, është kjo: Çfarë statusi do të kenë këta të vrarë dhe familjarët e tyre. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit deputete! Deputetja Nerxhivane Dauti, pyetje për ministrin e Ekonomisë dhe Financave, zotin Ahmet Shala. Deputete, mund ta parashtroni pyetjen.

NERXHIVANE DAUTI: Faleminderit, zoti Kryetar!

Përshëndetje zoti zëvendëskryeministër Kuçi,

Të nderuar kolegë deputetë,

Duke u bazuar në Rregullën 26.2 të Rregullores së Punës të Kuvendit të Republikës së Kosovës, bëj pyetje për përgjigje me gojë.

Çështja: Projektligji për masat doganore për mallra që cenojnë të drejtat e autorit dhe markat tregtare, sipas Strategjisë së legjislativit të Qeverisë së Kosovës duhej t'i paraqitej Kuvendit për miratim në maj të këtij viti. Duke pasur parasysh rëndësinë e këtij ligji për mbrojtjen e pronësisë intelektuale të Kosovës dhe nevojën e madhe që të mbrohen liritë dhe të drejtat themelore të njeriut në Kosovë në këtë fushë, që garantohen me Deklaratën Universale për të Drejtat e Njeriut, si dhe duke marrë parasysh mungesën e mbrojtjes së interesave morale dhe materiale të autorëve, që rezultojnë nga veprat e tyre shkencore, letrare dhe artistike, shkelja e të cilave është rrjedhojë e mungesës së këtij ligji, për ministrin për Ekonomi dhe Financa e bëj këtë pyetje: Ku qëndron shkak i vonës së procedimit të këtij projektligji për miratim në Kuvendin e Kosovës?

KRYETARI: Faleminderit! Zoti ministër!

MINISTRI AHMET SHALA: Faleminderit, Kryetar!

E nderuara deputete,

Projektligji për masat doganore për mbrojtjen e pronësisë intelektuale është përfshirë në Strategjinë legjislative të Qeverisë së Republikës së Kosovës për vitin 2009 dhe e miratuar nga Qeveria e Republikës së Kosovës me Vendimin Nr. 18/48 me datë 24.12. 2008.

Në këtë strategji, Ministria e Ekonomisë dhe Financave është sponsor për hartimin e këtij projektligji. Me Vendimin Nr. 12, datë 4.05.2009 të ushtruesit të detyrës së sekretarit të përgjithshëm të Ministrisë së Financave, është formuar Grupi punues, në të cilin marrin pjesë institucione të rëndësishme qeveritare për hartimin e këtij projektligji. Grupi punues në muajin maj ka përfunduar draftin e parë të projektligjit. Pas propozimit të Ministrisë së Financave, me datë 16.6.2009, me vendimin 203/2009 të Qeverisë së Republikës së Kosovës është formuar edhe Grupi punues ndërqeveritar për hartimin e këtij projektligji. Në vijim, pas diskutimit të Grupit punues ndërqeveritar, Projektligji për masat doganore për mbrojtjen e pronësisë intelektuale, sipas procedurave ligjore, është dërguar në Agjencinë për Integrime Evropiane për deklaratën e pajtueshmërisë dhe në Departamentin e buxhetit për vlerësim financiar.

Strukturat tona përgjegjëse janë në pritje të marrjes së këtyre dokumenteve, të cilat janë të domosdoshme para se ligji të aprovohet përfundimisht dhe të vijë në Parlament.

Unë mund t'ju informoj se brenda afateve të parapara me legjislacion të Ministrisë së Ekonomisë dhe Financave, ky ligj do të procedohet në Kuvend për aprovim dhe besoj se, mbase, edhe brenda

korrikut do të sillet në Parlament për t'u shqyrtuar dhe besoj se brenda këtij viti, konform kohës tonë të paraparë, do të aprovohet.

KRYETARI: Faleminderit, ministër! Deputete, ke pyetje shtesë?

NERXHIVANE DAUTI: Unë e përshëndes veprimin që keni ndërmarrë, zoti ministër, për shpejtimin e punës së formimit të Grupit punues për hartimin dhe procedimin e ligjit në fjalë dhe konsideroj se në cilësinë e anëtares së Komisionit për të Drejtat e Njeriut, shumë çështje na vinë në komision për t'u shqyrtuar mu nga kjo lëmi dhe kërkoj që puna të përshpejtohet edhe më tutje. Ju falënderoj!

KRYETARI: Faleminderit! Deputetja Nerxhivane Dauti, pyetje për ministrin e Punës dhe Mirëqenies Sociale, zotin Nenad Rashiq. Mund ta bëni pyetjen, deputete.

NERXHIVANE DAUTI: Duke u bazuar në Rregullën 26.3 të Rregullores së Punës të Kuvendit të Republikës së Kosovës, bëj pyetje për përgjigje me gojë.

Çështja: Ligji për Inspektoratin e punës, sipas strategjisë legjislative të Qeverisë së Kosovës duhej t'i paraqitej Kuvendit për miratim në maj të këtij viti. Duke pasur parasysh rëndësinë e tij, për faktin se ky ligj krijon bazën juridike për ushtrimin e mbikëqyrjes së zbatimit të ligjeve që përcaktojnë të drejtat e punëtorëve në fushën e marrëdhënies së punës dhe në fushën e mbrojtjes në punë, për ministrin e Punës dhe Mirëqenies Sociale e bëj këtë pyetje: Në cilën fazë të përgatitjes gjendet ky ligj? Ju falënderoj, zoti Kryetar!

KRYETARI: Faleminderit, deputete! Deputetja Myrvete Pantina, pyetje për ministrin e Bujqësisë, Pylltarisë, Zhvillimit Rural, zotin Idriz Vehapi. Mund ta parashtroni pyetjen, deputete.

MYRVETE PANTINA: Faleminderit, zoti Kryetar!

Unë nuk do ta parashtroj pyetjen, meqenëse ministri nuk është prezent, do ta lë për herë tjetër.

KRYETARI: Herën tjetër shkon në Buletin. Faleminderit, deputete!

Deputeti Naser Rugova, pyetje për ministren e Energjisë dhe të Minierave, zonjën Justina Shiroka-Pula. Jo, një herë pyetja është e deputetit.

NASER RUGOVA: Faleminderit, zoti Kryetar!

Të nderuar kolegë deputetë,

Pasi që Qeveria e Republikës së Kosovës nuk ka strategji konkrete për sektorin minerar e, po ashtu, edhe në Kornizën afatmesme të shpenzimeve 2009/2012 nuk parashihet ndonjë veprim konkret nga ana e Qeverisë, bile përmendet edhe status-kuoja, cila është strategjia e Qeverisë së Republikës së Kosovës mbi të ardhmen e Kombinatit "Trepça"? Faleminderit!

KRYETARI: Ministre, e keni fjalën!

MINISTRJA JUSTINA SHIROKA PULA: I nderuari deputet,

Ne në kuadër të Ministrisë së Energjisë dhe Minierave e kemi një Draft strategji të minierave, e cila së shpejti do të jetë publike. Ndërkohë, derisa kemi ardhur deri te ky draft, kemi bërë shumë diskutime, me shumë akterë profesionalistë të kësaj lëmie dhe në kuadër të kësaj strategjie është parashikuar edhe politika dhe ristrukturimi i Trepçës – politikat, masat dhe ristrukturimi i Trepçës.

KRYETARI: Faleminderit! Pyetje shtesë, deputet?

NASER RUGOVA: Zonja ministre, ne e dimë që Kombinati “Trepça” dhe minierat që gravitojnë atje, janë edhe problem politik dhe jemi të vetëdijshëm, por përgjigja juaj nuk jep shpresë që ai kompleks do të rivitalizohet, një nga gjigantët që dikur Kosova është krenuar me të dhe kjo nënkupton, siç e keni thënë edhe në Kornizën afatmesme të shpenzimeve, gjendje e njëjtë status-kuo. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Vazhdojmë. Deputeti Naser Rugova, pyetje për ministrin e Administratës së Pushtetit Lokal, zotin Sadri Feratin. Mund ta parashtroni pyetjen, deputet.

NASER RUGOVA: Faleminderit, zoti Kryetar!

Pasi që ministri nuk është këtu dhe besojmë se është duke e kryer punën e vet për çka është zgjedhur nga ky Kuvend, kam një pyetje konkrete, pasi që edhe ministri vjen nga regjioni i Mitrovicës. Cilat janë shkaqet e mosfunksionimit të tregut multietnik në afërsi të urës lindore në Mitrovicë, për të cilin më shumë se një herë janë investuar mbi 500.000 euro. Cilat janë veprimet konkrete të Ministrisë dhe të Pushtetit Lokal për funksionalizimin e këtij tregu? Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit, deputet! Deputetja Synavere Rysha, pyetje për ministrin e Administratës së Pushtetit Lokal, zotin Sadri Ferati. Deputetja nuk është këtu. Vazhdojmë.

Deputetja Dritë Maliqi, pyetje për ministrin e Administratës së Pushtetit Lokal, zotin Sadri Ferati. Deputete, mund ta parashtroni pyetjen. Regjia, fjalën deputetes Dritë Maliqi!

DRITA MALIQI: Faleminderit, zoti Kryetar!

Edhe përkundër asaj që ministri, si çdo ministër, shumica e ministrave të kësaj Qeverie të papërgjegjshme që po mungojnë, unë kam vendosur të gjitha pyetjet që i kam rend, nja 3 a 4, t'i paraqes, sepse dua ta ngris zërin në emër të qytetarëve të Republikës së Kosovës, që jam edhe e thirrur për të qenë këtu sot.

Pyetja e parë për ministrin, zotin Sadri Ferati. I nderuar, zoti ministër, qytetarët shqiptarë që kanë shtëpitë në veri të Mitrovicës dhe nuk i kanë shitur, nuk iu paguhet qiraja nga Qeveria, ndërsa ata që i kanë shitur, Qeveria ua kompenson qiranë. Cili është arsyetimi për këto veprime?

A mund të vazhdoj pyetjen e radhës?

KRYETARI: Mund ta vazhdosh pyetjen e radhës.

DRITA MALIQI: Faleminderit shumë, zoti Kryetar!

Pyetja e dytë është për ministrin e Arsimit, zotin Enver Hoxhaj, që është radha e dytë që e kam parashtruar pyetjen, por fatkeqësisht këtu nuk është prezent ministri. Unë prapë do ta paraqes, sepse çështjeve gjinore veç po shihet, nuk po iu kushtohet rëndësi nga kjo Qeveri, që shihet se edhe Agjencia ende punon me ushtrues detyre, që 5 vjet e kështu me radhë.

Zoti ministër, Enver Hoxhaj, çfarë jeni duke bërë për ndryshimin e Kurrikulit në mënyrë që të përfshihet perspektiva gjinore në tekstet shkollore. Lus që ta shqyrtoni mundësinë të vendosen eksperte gjinore në komision, sepse në komisionin prej 20 anëtarëve vetëm një është femër. Mundësisht të ketë hapësirë për gjininë femërore, sepse e dini që shumë kemi profesioniste në Republikën e Kosovës, kështu që Kurrikuli të ndryshohet edhe në librat e tjerë, duke filluar nga parafilloret e deri në klasat e nënta. Faleminderit!

Pyetja e radhës është për zotin Valton Beqiri, ministrin e Kulturës.

Zoti ministër, edhe përkundër që s'është këtu, unë do ta parashtoj pyetjen, ju lutem: Ku qëndrojnë shkaqet e vonesës tani e dhjetë vjet të rivarrimit të heroit tonë kombëtar, Isa Buletini, kur vendi ynë është i hapur tani e dhjetë vjet. Tani jemi shtet i pavarur, kur do të realizohet ky obligim i institucioneve tona? Faleminderit!

Dhe pyetja e katërt, është për Kryeministrin, zotin Hashim Thaçi, i cili nuk është prezent edhe sot, si shumicën e herëve.

Zoti Kryeministër, çfarë ka ndërmarrë Qeveria e Republikës së Kosovës për lirimin e 723 banesave të qytetarëve shqiptarë në veri të Mitrovicës, të cilat padrejtësisht shfrytëzohen nga uzurpuesit dhe nuk marrin kurrfarë kompensimi për pronën e tyre? Faleminderit, zoti Kryetar!

KRYETARI: Faleminderit, deputete!

Unë jam i obliguar të sqaroj se edhe Kryeministri, ministri i Punëve të Jashtme dhe ministri Hoxhaj janë në udhëtime zyrtare, do të thotë, mungesa e tyre është për këtë arsye. Unë po flas për mbledhjen e sotme.

Pyetja e radhës: Deputeti Naim Rustemi, pyetje për ministrin e Ekonomisë dhe të Financave, zotin Ahmet Shala. Naim Rustemi, mungon.

Vazhdojmë. Deputeti Emrush Xhemajli, pyetje për ministrin e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, zotin Idriz Vehapi. Doni ta lexoni pyetjen?
E keni fjalën!

EMRUSH XHEMAJLI: Faleminderit, zoti Kryetar!

Pyetja është për ministrin e Bujqësisë, zotin Idriz Vehapi. Unë desha ta pyes ministrin pse ende nuk është kthyer në punë zoti Ali Buzhala, në detyrën e drejtorit të Drejtorisë koordinuese të Agjencionit të Pyjeve të Kosovës, në Prizren, edhe pse është sqaruar rasti i tij. Dihet se kohë më parë ai është suspenduar, i motivuar politikisht, sipas preferencave politike, është ndërmarrë dhe është suspenduar. Është sqaruar rasti, por ende nuk është kthyer. Unë kisha kërkuar prej ministrit që ai të kthehet. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit, deputet! Pyetja e parafundit. Deputeti Riza Smaka, pyetje për ministrin e Shëndetësisë, zotin Alush Gashi, ose ministrin e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, zotin Idriz Vehapi. Deputet, mund ta parashtroni pyetje, pasi kemi këtu ministrin e Shëndetësisë, zotin Alush Gashi.

RIZA SMAKA: Faleminderit, zotëri Kryetar!

Konform me nenin 20, paragrafi 1 të Ligjit për ushqimin e importuar në Kosovë, ushqimi i importuar duhet ta ketë deklaratën e ushqimit. Deklarata e ushqimit, sipas paragrafit 3 të po kësaj dispozite, duhet të jetë e shkruar në mënyrë të dukshme, të jetë e lexueshme, të jetë e kuptueshme. Rrjedhimisht, me paragrafin 4 të po kësaj dispozite, sipas enumeracionit taksativ, janë definuar elementet konstitutive të deklaratës së ushqimit. Ndërkaq, për ushqimet e importuara në Kosovë, e të tilla ka shumë, pothuaj se deklarata e ushqimit nuk njihet.

Zotëri ministër, pyetja i është adresuar Deklaratës së ushqimit, e cila është tepër relevante për ushqimin, për shëndetin e secilit qytetar të vendit tonë. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit deputet!
Ministër Gashi, urdhëroni!

MINISTRI ALUSH GASHI: I nderuar, zoti Kryetar!

I nderuar zëvendëskryeministër, ministra,

Deputetë,

I nderuari deputeti Smaka,

Pyetja juaj është një prej pyetjeve shumë të rëndësishme për mirëqenien e qytetarëve të Republikës së Kosovës, ndërsa sa i përket kontrollit të ushqimit në kufi, nuk është pjesë e kompetencave të Ministrisë së Shëndetësisë. Ne kohë më parë së bashku kemi votuar Ligjin për ushqim, do të jetë Laboratori i ushqimit dhe ajo pjesë e kompetencave është e drejtuar në Kryeministri.

Mund t'ju them se Instituti Kombëtar i Shëndetit Publik bën ekzaminimin dhe analizat e ushqimit së bashku me institucionet e veterinarisë dhe të bujqësisë. Aktualisht vetë fakti që ne nuk kemi pasur një përhapje të epidemive apo intoksikime me ushqim, fatmirësisht tregon se kjo mbikëqyrje është duke u bërë. Këto ditë, në kërkesë të afaristëve është bërë edhe një rishikim i disa neneve të Ligjit dhe mendoj se me zhvillim të Laboratorit për ushqim, gjendja apo siguria e ushqimit dhe cilësia e tij për vendin tonë do të jetë edhe më e mirë. Ju faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit, ministër! Keni pyetje shtesë, deputet?

RIZA SMAKA: E vlerësoj lartë prononcimin e zotit ministër Gashi dhe jam i vetëdijshëm për kapacitetet tona të limituara. Megjithatë, pletoj që ministri edhe në nivelin e Qeverisë ta ngrejë këtë çështje, sepse është e ndjeshme, tepër e ndjeshme. Unë, pa keqkuptime do të kisha theksuar faktin se nuk është paraqitur ende ndonjë epidemi, nuk është aq ngushëllues, sepse mund të paraqitet. Natyrisht, nuk kemi dëshirë të ndodhë një gjë e tillë dhe në masë të konsiderueshme, pa dyshim, është edhe shkak se populli ynë është i atakuar shumë dhe ka fituar njëfarë imuniteti, ndoshta shumë më të lartë se popujt tjerë, të cilët janë shumë të mbrojtur mirë, si duhet dhe sa duhet. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Pyetja e fundit. Deputeti Riza Smaka, pyetje për ministrin e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, zotin Idriz Vehapi. Mund ta lexoni pyetjen, deputet.

RIZA SMAKA: Faleminderit! Pyetje kuvendore për përgjigje gojore, referuar Codex Alimentarius. Codex Alimentarius është një trup ndërkombëtar, i krijuar nga FAO & VHO – organizata ndërkombëtare për shëndetësi, për t'i monitoruar programet referuar standardeve të ushqimit për higjienën ushqimore, për vlerat nutritive ushqimore, për normat mikro-biologjike, për aditivët, për mbetjet e pesticideve e të metaleve, për kontaminimet dhe për etiketimet për marrjen e mostrave ushqimore.

Zotëri ministër, çfarë janë relacionet zyrtare të Ministrisë tuaj, të cilën ju aktualisht e administroni, në funksion të implementimit konsekuent dhe konsistent të Ligjit Nr. 03-1/016 për ushqimin? Kjo ishte pyetja. Faleminderit!

Drejtimin e seancë e merr Xhavit Haliti, anëtar i Kryesisë

XHAVIT HALITI: Faleminderit! Konstatoj se pika e paraparë për pyetje ministrave ka përfunduar. Vazhdojmë me pikën e katërt të rendit të ditës, që është:

4. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për dhënien e dekoratave nga Presidenti i Republikës së Kosovës.

Në bazë të Rregullës 35.1 të Rregullores së Punës, janë përmbushur kushtet për shqyrtim dhe miratim, në parim, të këtij projektligji.

Ftoj ministren Kelmendi, si përfaqësuese nga Qeveria, që në emër të Qeverisë së Republikës së Kosovës para deputetëve të prezantojë Projektligjin.

MINISTRJA NEKIBE KELMENDI: I nderuari, zoti kryesues!

Të nderuar kolegë deputetë,

I nderuar zëvendëskryeministër dhe kolegë ministra,

Kam nderin që sot para jush ta paraqes ekspozitën për Projektligjin për dhënien e dekoratave të Republikës së Kosovës nga ana e Presidentit të Republikës së Kosovës.

Këto dekorata, sipas këtij ligji, u jepen individëve dhe institucioneve, përkatësisht qytetarëve të Republikës së Kosovës, qytetarëve të huaj, si dhe personave juridikë që shquhen për merita të veçanta të raportit me Republikën e Kosovës dhe interesat tona kombëtare.

Ky projektligj rregullon, pra, dhënien e dekoratave nga Presidenti i Republikës së Kosovës dhe përcakton procedurat për dhënien e tyre. Baza juridike për dhënien e dekoratave sipas këtij ligji, buron nga neni 84, pika 28 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, pastaj do të pasojnë edhe aktet e brendshme, të cilat do të miratohen nga Zyra e Presidentit të Kosovës.

Projektligji, siç jeni në dijeni, është legjislacion i ri. Deri më tash nuk kemi pasur ligj të tillë dhe është i pari që nxirret në Republikën e Kosovës. Ekzistojnë disa akte ligjore që e rregullojnë këtë lëmi, por ato nuk kanë qenë të kodifikuara apo të unifikuara në një ligj, siç është ky ligj, por aty-këtu përmenden në Kushtetutën e Republikës së Kosovës.

Projektligji përmban gjithsej 4 kapituj dhe ka 37 nene. Çështja e ndarjes së dekoratave nga Presidenti i shtetit nuk mund të konsiderohet si çështje që duhet doemos t'i nënshtrohet *acquis-communitaire*, sepse secili shtet në vete e rregullon fushën e dhënies së dekoratave, llojin e dekoratave, numrin e dekoratave e tjera.

Përkritazi me implikimet buxhetore ka deklaraten përkatëse, andaj në emër të Qeverisë së Republikës së Kosovës ju ftoj që ta votoni dhe ta miratoni këtë ligj në lexim të parë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Të nderuar deputetë, tani, pas prezantimit të Projektligjit, hap debatin për diskutim, në parim. Sipas radhës, fjalën e ka kryetari i Komisionit funksional për Legjislacion dhe Gjyqësi, kuptohet nëse është paraqitur për të marrë fjalën. Nuk e ka kërkuar fjalën. Kryetari i komisioneve të përhershme, nëse e kërkon fjalën? Prapë, nuk është paraqitur.

Vazhdojmë me përfaqësuesit e grupeve parlamentare. Në emër të Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike të Kosovës, Bahri Hyseni.

BAHRI HYSENI: Faleminderit shumë, zoti kryesues!

Përshëndetje, zëvendëskryeministër!

Ministra të nderuar,

Kolegë deputetë,

Po flas edhe në emër të Komisionit për Legjislacion, meqë e kemi pasur në parim projektligjin në fjalë, por edhe në emër të Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike të Kosovës.

Meqë Kushtetuta e Republikës së Kosovës i jep autoritet Presidentit të Republikës që të shpërndajë apo të dekorojë me medalje qytetarët e Kosovës dhe qytetarët jashtë vendit, ne si komision e kemi shqyrtuar projektligjin në fjalë dhe kemi konstatuar se projektligji në fjalë i plotëson kriteret që sot të lexohet, në parim.

Megjithatë, si komision dhe si grup parlamentar i kemi disa vërejtje rreth përmbajtjes së projektligjit. Ndoshta vërejtja e parë është rreth preambulës, është bërë zakon që në projektligje po thirren edhe në nenet përkatëse të Kushtetutës dhe natyrisht se është mirë të mos thirren në nenet tjera, përveç nenit 65, sepse i vetmi autoritet është Kuvendi që të nxjerrë tligje dhe nenet e tjera nuk i japin apo nuk e fuqizojnë në preambulë, sepse asnjë nen tjetër i Kushtetutës nuk i jep autoritet askujt të nxjerrë ligje. Prandaj, është mirë që edhe projektligjet tjera që do të na vijnë, të mos thirren në nene tjera të Kushtetutës.

Si çështje tjetër, ndoshta është mirë që ky Kuvend, sot, ta mendojë edhe çështjen a duhet ndoshta titulli i Projektligjit të ndryshohet, duke pasur parasysh se nëse e lexojmë kështu, lë të kuptohet se edhe dikush, përveç Presidentit të Kosovës, ka të drejtë për të dhënë dekorata, meqë është i vetmi President i Republikës së Kosovës që ia njuh Kushtetuta për të dhënë dekorata, është mirë që ndoshta vetëm të shikojmë që projektligji të quhet vetëm Projektligj për dekorata dhe jo të vazhdojë që Presidenti të japë dekorata, sepse nëse e lexojmë parimisht, nënkupton se ka edhe autoritete tjera që të japin dekorata.

Projektligjit i mungojë, të them të vërtetën, edhe çështja e përcaktimit, ndoshta të kohës se kur duhet të jepen dekoratat dhe vlera e dekoratave apo e mirënjohjeve që do të shpërndahen, nuk është e përcaktuar në ligj.

Duke pasur parasysh se Projektligji ka një rëndësi të veçantë dhe duke pasur parasysh se është mirë që të rregullohet sa më parë me ligj, unë thashë që duhet në parim ta kalojmë projektligjin dhe do të mundohemi që në bashkëpunim me deputetët, me komisione të tjera, të hartojmë amendamente për ta bërë, por është mirë të vërehet edhe një vërejtje konkrete, për shembull, neni 36, dispozitat shfuqizuese. Unë po e lexoj dhe është mirë që ndoshta edhe sot në parim kur ta aprovojmë, ta aprovojmë me vërejtjet që të mos kemi mandej probleme rreth amendamentimit. Ja si shkruan. Thotë, dispozitat shfuqizuese: “Nga dita e hyrjes në fuqi të këtij ligji, pushojnë së vepruari të gjitha dispozitat që bien në kundërshtim me këtë ligj”. Domethënë, është diçka e panevojshme, e paqartë, sepse nuk e kuptojmë cilat dispozita, thotë – dispozitat. Aktualisht nuk ka asnjë ligj që e rregullon këtë çështje, përveç Kushtetutës së Republikës së Kosovës.

Edhe Komisioni për Legjislacion e Gjyqësi dhe Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës e mbështetin, në parim, me këto vërejtje që u dhanë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Në emër të Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike të Kosovës, deputeti Kolë Berisha.

KOLË BERISHA: Ju faleminderit, zoti kryesues!

Të nderuar kolegë deputetë,

I nderuar Kabinet qeveritar,

Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike të Kosovës e ka shqyrtuar Projektligjin për dhënien e dekoratave nga Presidenti i Republikës së Kosovës dhe përkundër disa vërejtjeve të vogla, si në nenin 2, te përkufizimet, nenin 3, te fushëveprimi i ligjit, nenin 5, nenin 12 dhe nenin 32.1, me kënaqësi konsideron se i njëjti është ndër tekstet e rralla të këtij niveli që vijnë pranë këtij Kuvendi.

Projektligji ka një gjuhë të pastër dhe të pastër juridike, në aspektin teknik i përmbush kriteret e nevojshme, ka një shtrirje solide të lëndës dhe të neneve e kapitujve, duke ruajtur harmoninë e tekstit në tërësi, është i kuptueshëm, i shkurtër, i qartë dhe i aplikueshëm në praktikë.

Prandaj, Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike të Kosovës konsideron se me një intervenim të lehtë, në procedurën e mëtejme dhe me një redakturë profesionale do të mund ta kemi një ligj solid dhe, si të tillë, e miraton në parim. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit!

Në emër të Grupit Parlamentar të Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës, deputeti Ahmet Jusufi

AHMET JUSUFI: Ju faleminderit, zoti kryesues!

Të nderuar deputetë,

Kabinet qeveritar,

Grupi Parlamentar i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës e ka shqyrtuar ligjin të cilin e kemi përpara, por kemi vërejtje substanciale në këtë ligj, sepse nuk ka një harmonizim të tekstit në përgjithësi, bazuar në nenet e ofruara dhe, po ashtu, kemi edhe disproporcion në atë që thuhet në nenin e parë, me nenin 5, ku është ndarja e dekoratave.

Për shembull, në nenin e parë, përveç tjerash, thuhet: personat të cilët kanë dhënë kontribut në Republikën e Kosovës, qytetarët e huaj dhe persona juridikë po ashtu që shquhen për merita të veçanta ndaj Republikës së Kosovës dhe interesave kombëtare. Ne kemi vlera të mëdha, të cilat nuk përkufizohen vetëm në kufijtë e Kosovës, por kanë tejkaluar kufijtë e Kosovës dhe kemi personalitete të cilat janë shquar gjatë historisë sonë, e që meritojnë një urdhër më të lartë se sa ai Urdhër i Heroit të Kosovës edhe mund të jetë hero i kombëtar, që na takon ta vlerësojmë në mënyrë të tillë, sepse kemi personalitete të cilat kanë dhënë kontribute të tilla.

Po ashtu, vërejtja jonë është në ndarjen e medaljeve, ku në fakt, po të shikohet deri në fund në nenin 5, kemi të gjitha medaljet e arta. Në të gjitha vendet demokratike, ku ka një klasifikim të figurave, bëhet edhe ndarja sipas meritave që i kanë ato personalitete ose ato institucione. Dhe, në këtë rast, mund të them se në çdo nen ku bëhet ndarja e medaljeve, e keni të punuar me ar. Kosova, edhe për gjendjen që e ka, edhe për mënyrën se si do duhej të bëhet ndarja e medaljeve, konsiderojmë se ka këtu edhe metale tjera qysh i kanë gjithë bota, që e bëjnë një klasifikim dhe një ngjarje, qoftë me medalje të punuara me arë, qoftë me argjend të, qoftë me bronz, por një klasifikim i tillë duhet të bëhet dhe këtu nuk është i bërë.

Dhe, ajo që është themelore, po ashtu sa i përket vlerës, e cila e përcjell ndarjen e dekoratave, është e përgjithësuar dhe nuk është e saktësuar në ndarjen e medaljeve. Prandaj, konsiderojmë se në mënyrë të përgjithësuar nuk mund të bëhet kjo, por duhet të bëhet ndarja e veçantë për secilën medalje që ofrohet dhe vlerën e asaj medalje.

Prandaj, ne nuk e përkrahim, si të tillë, kërkojmë që të punohet më shumë ky ligj. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit!

Në emër të Grupit Parlamentar Aleanca Kosova e Re, deputeti Ibrahim Makolli, por është i regjistruar me kartelën e Ibrahim Gashit. Jo, tash doli Ibrahim Makolli dhe mirë është.

IBRAHIM MAKOLLI: Ju faleminderit, zoti kryesues!

Të nderuar kolegë,

Të nderuar zëvendëskryeministër, ministra,

Edhe Grupi Parlamentar i AKR-së e ka shqyrtuar projektligjin në fjalë. Natyrisht, i bashkëngjitemi shqetësimeve të të tjerëve, në veçanti të diskutuesve të fundit përkitazi me një mori lëshimesh që ka ky projektligj.

Ne e mbështesim, në parim, dhe do të japim kontributin tonë të mëtutjeshëm në komisionet e Kuvendit. Gjithsesi, këtu duhet të kihet parasysh edhe një çështje, sepse nuk ka mbulesë buxhetore. Parashihet që ky draftligj të jetë i kushtueshëm për tri vitet e ardhshme dhe po ashtu nuk është i përfshirë në Kornizën afatmesme të shpenzimeve.

Nuk e besoj dhe nuk e mendojmë se në Kosovë kemi një komoditet të tillë që në këtë gjendje çfarë është Kosova dhe qytetari i saj, në gjendje të rëndë ekonomike, të shpërndahen dekorata të tilla që kanë vlerë dhe gjithsesi do të duhej të shënohej edhe vlera e këtyre dekoratave dhe, po ashtu, që të mos jetë tash një garë se sa dhe kush do të shpërndajë, në cilën periudhë kohore do të shpërndajë më shumë dekorata për të mbuluar këto çështje. Natyrisht, do të japim kontributin tonë dhe besojmë që ky ligj do të plotësohet me të gjitha nevojat që i parasheh. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Në emër të Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike të Dardanisë, cili e do fjalën? Deputeti Adem Salihaj.

ADEM SALIHAI. Faleminderit, zoti kryesues!

Edhe Grupi Parlamentar i LDD-së e ka shqyrtuar edhe herën e kaluar, edhe tash këtë projektligj dhe ne kemi ardhur në disa përfundime që unë do t'i theksoj shumë.

Së pari, edhe ky Projektligj, sikur ai i pari, ndonëse është reduktuar numri i dekoratave, megjithatë mendojmë që ka numër të madh, që e ulë edhe vlerën e dekoratave, por e ulë edhe vlerën e vet Presidentit nëse ai devalvohet duke shpërndarë shumë dekorata.

Çështja e dytë, lidhet me nenet kur numërohen dekoratat dhe me nenet ku përshkruhen ato, pra me nenin 5 dhe 11, dhe mendojmë që nuk është në rregull te dekorata me emrin e Presidentit Rugova. Mendojmë se ai nuk e paraqet esencën e rolit të punës dhe kontributit të Presidentit Rugova. Këtu është emërtuar si deklarata për paqe, demokraci dhe tolerancë, e mendojmë që do të duhej të ishte krejt tjetër në përputhje me rolin e tij, pra dekorata për liri, pavarësi dhe demokraci dhe do të duhej të jepej për arsyet që do t'i përshkruante edhe vetë titulli i dekoratës.

Me këtë si është dhënë këtu, edhe herën e kaluar, devalvohet, injorohet dhe minimizohet roli i Presidentit Rugova, që mendojmë se nuk është në rregull edhe në këtë formë si është bërë këtu.

Çështja tjetër ka të bëjë përsëri me radhitjen e dekoratave. Ne do të mendonim që do të duhej të ishte një radhitje tjetër sipas rëndësisë së tyre.

Pastaj, te çështja kush mund t'i propozojë Presidentit ndarjen e dekoratave, janë radhitur këtu Kryetari i Kuvendit, Kryeministri, ministrat, drejtori i Policisë së Kosovës, komandanti i Forcës së Sigurisë, kryetari i komunës e të tjera, por nuk është deputeti i Parlamentit të Kosovës dhe mendoj që nuk është në rregull të mos jetë edhe deputeti një personalitet që mund të propozojë dhënien e dekoratave te Presidenti i Kosovës.

Po ashtu, nuk është specifikuar fare si do të duhej një dekoratë e veçantë, cilado prej tyre, e mendoj se ligji do të duhej ta kishte këtë, si dhe vlera e dekoratave. Pra, një dekoratë mund të jetë në një vlerë të caktuar më të madhe ose më të vogël, kush vendos për këtë, do të duhej të ishte e rregulluar me ligj, sepse hap mundësitë edhe keqpërdorimeve dhe do të ishte tepër e pahijshme që të ndodh kjo te dekoratat që i ndanë Presidenti i Kosovës.

Te aspektet buxhetore është diçka interesante. Për vitin 2009 dekoratat kushtojnë 150 mijë euro, kurse për vitin 2010 180 mijë, dhe për 2011 -180 mijë. Ku është arsyeja për një vlerësim kështu, a

do të shtrenjtohen dekoratat apo cila është arsyeja? Mendoj që nuk është një vlerësim ndoshta edhe shumë korrektë.

Dhe, ana tjetër është se në Kornizën afatmesme buxhetore nuk është paraparë buxheti, e për këto tri vjet do të kushtonin këto dekorata që ndanë Presidenti i Kosovës 510 mijë euro, pra, më tepër se gjysmë milioni euro, që nëse nuk janë të parapara në buxhet, do ta bëjë të pamundur ndarjen e këtyre dekoratave.

Këto janë arsyet që Grupi Parlamentar i LDD-së mendon që duhet të rikthehet, të ripunohet ky ligj në aspektet esenciale. Në aspektet formale i plotëson kushtet, por ka të meta substanciale dhe mendojmë që duhet t'i rikthehet edhe një herë të ripunohet nga ministria përkatëse. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit!

Grupi Parlamentar "7+", deputeti Xhezair Murati.

DŽEZAIR MURATI: Hvala vam, gospodine predsedavajući!

Dozvolite da pozdravim vas, zamenika premijera, ministre, kolege i goste!

Mislim da sve uređene države regulišu ovu oblast, pa evo i mi pokušavamo. Mi smo takođe detaljno razmotrili sadržaj ovog zakona, kao i propratnog memoranduma i prihvatajući odredjene primedbe koje su ovde iznete, mi kao načelo prihvatamo i smatramo da je dosta širok spektar ljudi koji mogu da predlože ovaj zakon i da svakako, što je rekao kolega Salihaj, treba da poslanici ne samo da mogu da predlažu, jer imaju legitimitet naroda, gradjana, nego i trba i sami da budu ukoliko ispunjavaju kriterijume, nosioci nekih nagrada, normalno ako ispunjavaju.

E sad, kada je reč o kriterijumima za predlaganje onih koji trebaju da daju odlikovanje, mislim da to nije dovoljno doradjeno, da kriterijume za one koji trebaju dobiti odredjena odlikovanja, mislim da je dosta širok spektar odlikovanja koja može Predsednik Republike Kosova da da. Treba poraditi na kriterijumima kako ne bi bilo subjektivizma, kako bi zaista bili ljudi, lica koja to zaslužuju. Mislim da pošto ovaj zakon ne uređuje Evropsko zakonodavstvo, nego se to ostavlja na suverenim zemljama da to čine, tako da će praksa pokazati da li postoji potreba proširenja vrsta odlikovanja, ali je činjenica da treba razmisliti, ne treba nagrada da bude mislim, ipak su nagrade simbolika koja pojedina lica nagradjuje za ono što su postigli. Ne moraju uvek da budu u zlatu, postoje i drugi jeftiniji plemeniti metali koji se mogu ugradjivati pored zlata, pa će finansijske implikacije sigurno biti manje dovedene u pitanje, tako da mi kažemo još jednom, računajući sve ono što je rečeno, kriterijumi da se porede na njima. Mi ga u načelu prihvatamo kao Parlamentarna grupa „7+“. Hvala!

KRYESUESI: Ju faleminderit, zoti Murati!

Në emër të Grupit Parlamentar SLS, nuk është paraqitur askush. Tani po vazhdojmë me diskutimet e deputetëve të paraqitur sipas radhës. Fjalën e ka deputeti Sabri Hamiti.

SABRI HAMITI: Zoti kryesues,

Zoti Kryeministër,

Ministra,

Deputetë,

Ky ligj duhet të kalojë për shkak se mendoj që duhet të bëhemi serioz, është një ligj që njëherë ka ardhur në banka të Parlamentit, është kthyer dhe sot më nuk kemi arsye të bisedojmë në mënyrën a ka nevojë të kalojë apo jo?

E dyta, kjo është një materie që ka një traditë në Kosovë dhe këtë duhet ta dinë të gjithë. Presidenti i Republikës së Kosovës, edhe ky i tashmi, Fatmir Sejdiu, edhe i pari, dr. Ibrahim Rugova, kanë dhënë dekorata, nëse jo të gjitha të këtyre nivele, të shumicës së niveleve që i ka në regjistër edhe ky ligj.

Çka do të thotë kjo? Do të thotë, kjo është një veprimtari e ushtruar kushtetuese e presidentëve të Republikës së Kosovës, në disa vitet e fundit. Është mirë që përfundimisht kjo veprimtari të kodifikohet me një ligj, sepse është e drejtë kushtetuese e Presidentit të Republikës së Kosovës. Unë e përmenda me qëllim, që ka një të kaluar, një përvojë të dhënies së dekoratave, por për të mos menduar se ne sot po fillojmë dhe po e zbulojmë Amerikën, se nganjëherë këtu, unë kam bindjen, kolegët e mi deputetë, ose janë harrestar të mëdhenj, ose dinë shumë pak.

Një ligji i tillë s'ka ekzistuar kurrë në Kosovë, por ka ekzistuar një rregullore shumë e mirë e strukturuar, nëse doni, unë mendoj që ka qenë edhe më e mirë se ky, në bazë të së cilës janë ndarë. Nuk janë ndarë ad-hoc këto dekorata. Ka rregullore të botuar për këtë punë, por meqë tash kemi dhe Kushtetutë, do ta bëjmë ligjin dhe unë mendoj që duhet ta bëjmë sa më shpejt. Pa marrë parasysh që unë respektoj të drejtën e mendimit të çdokujt, sepse mendimi është personal, unë mendoj që kur të studiohet dhe të bisedohet për ligje të këtilla, të studiohet prej fjalisë së parë deri në të fundit, për shkak se nganjëherë njerëzit nga vullneti për ta artikuluar një ide personale, s'e lexojnë mirë tekstin. Ligji ka një seri dekoratash që për kah rëndësia, ju e dini, ato nuk specifikohen, por dihet që e para është sigurisht më e rëndësishmja dhe shkon, deri diku e mbajnë një rëndësi të veçantë, mbasandaj janë të lëmenjve të ndryshme dhe ju i keni parë vetë.

Ju keni në fillim katër dekorata që u drejtohen atyre, që dikush e tha me kuptimin nacional, unë do të thosha vetë përbërja brenda tyre e ka kuptimin e asaj që i themi nacional në kuptimin e gjerë të fjalës, jo në kuptimin shtetëror.

Më tutje vijnë katër dekorata, të cilat në fusha të ndryshme të vlerave e të meritave kanë katër emra shumë të nderuar të Kosovës, që janë, unë mendoj emra përtej Kosovës. Njëra e mban emrin përplotësues karakterizues të Adem Jasharit, një të Ibrahim Rugovës, një të Nënës Terezë dhe një të Anton Çettës. Unë mendoj që ky rangim i tillë, pas katër të parave dhe këto, është një rangim i menduar mirë, pa marrë parasysh në cilësimin a është e saktë ose jo, më duket kolegu i LDD-së tha te formulimi, te Dekorata "Ibrahim Rugova", duhet të jetë për Liri, Pavarësi, Demokraci. Ndoshta është përkufizimi më i mirë i figurës së Rugovës, por problemi është në strukturën e dekoratave se ju e keni numrin 2 për Liri, 3-shin për Pavarësi, domethënë, në strukturën e dekoratave keni pak a shumë emërtime të këtyre fushave, kështu që është mirë kur të merren të diskutohen këto cilësime të dyta, të saktësohet ky problem, edhe humanizëm, se tolerancën e kanë dhënë me variant humanizëm, sepse e kemi mbasandaj Medaljen "Nënë Tereza", që pak a shumë e ka cilësimin themelor - humanizëm.

Në këtë kuptim, sigurisht që do të ketë mundësi precizimi, por unë mendoj, megjithatë, që këtu nuk ka probleme të mëdha. Ajo që unë dua të vë në spikamë tash për tash për këtë, është që në ligj ashikare ka materie që nuk janë precizuar, por me aktet përcjellëse që propozohen, që do të hartohen nga Presidenca, natyrisht me urdhra të veçantë nënligjor duhet të ketë një që precizon punën dhe strukturën e komisionit vlerësues dhe, dy, që precizon peshën e vlerën e secilës dekoratë, duke marrë parasysh formën dhe dizajnimin e saj. Këto mund të bëhen me këto dy akte nënligjore që e plotësojnë ligjin.

Ka nevojë për precizime, për shembull, Dekorata për Studim, përshkrimi nuk është i saktë, se atje hyjnë edhe nxënës, edhe studentë, nëse është për dije dhe për studim, nxënësit e studentët nuk mund të hynë aty. Sigurisht janë reduktuar numri i madh e mbasandaj janë futur edhe kritere ku

nuk rrinë bashkë. Dhe, një vërejtje tjetër te propozimet, më duket është neni 27. 1.12, propozime mund të bëjë edhe njeriu që ka një reputacion publik dhe organizata të tjera. Kjo organizata të tjera, unë propozoj të fshihet menjëherë, në rast se nuk emërohen ato, se kjo s' ka kuptim, sepse është mbasandaj arbitraritet total nëse thua dhe organizata. thua edhe një person i njohur publik dhe organizata të tjera, ky është arbitraritet. Nëse duhet, duhet të emërohen ato. Pra, kemi të bëjmë me nenin 27.1.12.

Kolegu, kryetari i Komisionit e përmendi një problem të dispozitave që kanë funksionuar parandej. Nuk është e precizuar, mirë e ka ai, por unë do të thosha rregulloret paraprake, sepse të thuhet saktë, sepse edhe një herë po ua theksoj, ekziston një rregullore paraprake që ka funksionuar dhe pse po e theksoj edhe një herë? Ju e keni në dispozitat kalimtare, që mbas daljes të këtij ligji, pranohen të gjitha dekoratat që janë dhënë deri tash. Dhe, ju e dini që janë dhënë dhe nuk është numër i vogël. Kjo është shumë me rëndësi. Ato dekorata nuk janë dhënë arbitrarisht, por janë dhënë në bazë të një rregulloreje. Pra, në momentin kur hyn në fuqi ky ligj, pushon Rregullorja e përparshme e dhënies së dekoratave. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka deputetja Gjylnaze Syla.

GJYLNAZE SYLA: Ju faleminderit!

I nderuari zoti kryesues,

E nderuara ministre,

Të nderuar ministra,

Deputetë të nderuar,

Projektligjin për dhënien e dekoratave nga Presidenti i Republikës së Kosovës e kemi shqyrtuar edhe vitin e kaluar në seancën e 25 shtatorit. Në atë seancë ka pasur vërejtjeje të shumta në leximin e parë dhe i është kthyer sponzoruesit, Zyrës së Kryeministrit, në përpunim të mëtejshëm, prandaj pritjet e mia kanë qenë që projektligji i sotëm do të jetë shumë më preciz, më i qartë e bile edhe më i shkurtër se që është tani.

Të nderuar deputetë,

Krijimi i infrastrukturës ligjore për dhënien e dekoratave nga Presidenti është përgjegjësi kushtetuese, kurse vetë dhënia e dekoratave është kompetencë e Presidentit, ashtu siç është definuar në Kushtetutë. Qëllimi i cili synohet të arrihet me këtë projektligj, është që të bëhet rregullativa ligjore për dhënien e dekoratave shtetasve të Kosovës, të huaj, por edhe personave juridikë, të cilët janë shquar ose shquhen për merita të jashtëzakonshme ndaj Republikës së Kosovës dhe interesave kombëtare. Po ashtu, me projektligj është përcaktuar edhe procedura e dhënies së dekoratave, mirëpo, të drejtën e inicimit për dhënien e dekoratave e ka vetë Presidenti, por edhe bartësit e institucioneve publike dhe zyrtare. Derisa në Projektligjin, të cilin e ka sjellë Zyra e Kryeministrit, vitin e kaluar, kanë qenë të përfshira diku 26 lloje të dekoratave, në Projektligjin e sotëm janë paraparë 17 dekorata presidenciale, nga të cilat: 1 urdhër, 8 medalje të arta, 2 tituj, 3 çmime, 2 dekorata dhe një trofe. Sipas mendimit tim, edhe 17 dekorata janë shumë për shtetin tonë, për buxhetin e kufizuar dhe për nevojën që të limitohet, të kursehet dhe që buxheti të shfrytëzohet edhe për çështje tjera.

Zgjidhje praktike, do të kisha konsideruar, është në zvogëlim e numrit të dekoratave, e me këtë edhe të shpenzimeve për to.

Të lidhemi pak me përvojën e dekoratave në rajon. Shqipëria, për shembull, maksimum i ka deri në 10 dekorata, derisa vendet e tjera kanë edhe më pak, kurse vendet e zhvilluara edhe numër më të vogël. Me këtë konsideroj se dekorata e veçantë, si Çmimi Presidencial për Biznes dhe për Shërbim të Eksportit, nuk duhet të jetë me këtë projektligj, ndoshta më vonë me zhvillimin e

ekonomisë, por jo në këtë stad, apo kemi edhe dekorata të cilat jepen për të njëjtin kontribut, si për shembull, 3 dekorata të veçanta që jepen për lirinë dhe pavarësinë janë: Urdhri i Heroit, Medalja e Artë e Lirisë dhe Medalja e Artë e Pavarësisë. Ndërsa, dispozita ligjore e cila përcakton dhënien e Medaljes së Artë Lidhjes së Prizrenit, është shumë e përgjithësuar, është e paqartë dhe thuhet se jepet për mirëkuptim ndërmjet shqiptarëve dhe kombeve të tjera në të gjitha fushat e jetës në frymën e Lidhjes, a mendoj se kjo dispozitë kërkon sqarim dhe definim të qartë.

Disa dispozita të veçanta janë po ashtu kontradiktore, të paqarta dhe të mangëta. Do ta veçoj përmbajtjen e dispozitës për Urdhrin Hero i Kosovës. Kjo dekoratë është paraparë t'u jepet qytetarëve të Kosovës dhe të huaj, siç thuhet, të kohës moderne që nga Lidhja e Prizrenit e këndej. A do të thotë kjo se për Kosovën koha moderne është nga Lidhja e Prizrenit e këndej? Nëse është ashtu, atëherë me siguri do të ketë dekorata për njerëzit meritore të cilët nuk janë gjallë, por nga ana tjetër në projektligj nuk janë paraparë dispozita të veçanta për dhënien e dekoratave trashëgimtarëve, do të thotë, atyre të cilët janë meritore, pra dekoratat të cilat u jepen familjarëve të personit të dekoruar.

Tjetër, nuk është precizuar, e tha edhe deputeti Hamiti se kush janë organizatat e tjera apo, sipas mendimit tim, duhet të precizohet se kush është personi me reputacion publik. Pra, duhet të definohet personi i respektuar me reputacion publik.

Vërejtja tjetër është se dekorata duhet të përmbajë edhe dokumentin që është publik. Unë propozoj që dekreti për dekorim të publikohet në ueb-faqen zyrtare të Presidentit të Kosovës. Mangësi janë edhe dispozitat ndëshkuese në rast të keqpërdorimeve, si në rastet e paautorizuara, të shitjes së dekoratave, të bartjes dhe të dëmtimit, si të çështjeve të tjera të pandershme.

Sa i përket rregullores, siç është paraparë në projektligj, mendoj se duhet të definohet dhe precizohet se me akt nënligjor përcaktohet edhe mënyra e mbajtjes së dekoratave. Nuk është e paraparë edhe koha e dhënies së deklaratave, propozoj që të shkruhet së paku një herë në vit- Ditën e pavarësisë, por që njëkohësisht të shtohet se mund të jepet edhe në kohë të tjera.

Sa i përket pajtueshmërisë me *acquis communautaire*, kjo rregullohet në mënyrë të veçantë nga secili shtet anëtar i BE-së. Kusht me rëndësi për zbatimin e këtij ligji është patjetër edhe vetë kostoja buxhetore. Sipas vlerësimit të ndikimeve buxhetore, del se duhet kosto shtesë deri në 120.000 euro, me fjalë të tjera, diku në vitin 2009, -20.000 euro dhe në vitin 2010, 2011 nga 50.000 euro. Këto nuk ndodhin as në buxhetin e Presidentit, por as në Kornizën afatmesme të shpenzimeve. Pos kësaj, duhet marrë parasysh se mund të ketë edhe shpenzime të tjera shtesë duke marrë parasysh çmimin e arit në treg, i cili mund të rritet dhe po ashtu edhe shpenzimet e tjera, siç është shuma e të hollave që mund ta përcjellë dekoratën.

Për shkak të mangësive të cilat i përmenda, po ashtu edhe paqartësive dhe mungesës se ku do të merret buxheti lidhur me zbatimin ligjit, në parim nuk e përkrah. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit! Fjalën e ka deputeti Ibrahim Gashi. Replikë zoti Hamiti.

SABRI HAMMITI: Unë e falënderoj zonjën që ma përmendi emrin se ma dha shansin t'i them edhe dy sende. Po përmendet këtu sa kushtojnë. Është shumë është e paarsyeshme të bisedojmë sot, se njeri i gjallë s'e di brenda një viti Presidenti, në bazë të rregullave dhe të kërkesave, sa dekorata do t'i japë. Bën vaki një vit e jep një, një vit i jep pesë, kështu që nuk besoj që është sot temë diskutimi kur s' dihen as formati ende, se ato bëhen me akt nënligjor, as dizajni, as numri. S' mund të thotë kush sot brenda një viti do t'i planifikojmë që do t'i japim kaq dekorata të këtij soji që të kthehen në vlerë.

E dyta, nuk është mirë të bëjmë demagogji sociale kur bisedojmë për këto tema. A ka varfëri a s'ka, a ka para a s'ka një popull, dekoratat nacionale i jep. Ato janë dy tema. Kur të bisedojmë për gjendjen sociale, bisedojmë për gjendjen sociale. Sot po bisedojmë për një ligj që rregullon një veprimtari kushtetuese. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit! Gjylnazja e do fjalën, kundër replikë një minutë.

GJYLNAZE SYLA: Zoti kryesues, unë dëshiroj të sqaroj, edhe një herë t'ua rikujtoj deputetëve se vendet shumë më të pasura se ne, japin më pak numër të dekoratave. Në qoftë se mendoni se do të shpërblehen njerëzit me dhënien e dekoratave, duke mos pasur para as buxhet për zbatimin e tij, atëherë mendoj se secili nga deputetët duhet të mendojë për rolin e vet.

E dyta, është se numri i dekoratave edhe herën e parë ka qenë 26 dhe tani 10, prapë mendoj dhe qëndroj në atë se është shumë dhe se një numër i tyre jepet për të njëjtin kontribut. Prandaj, duhet marrë parasysh këtë që nuk është e nevojshme për të njëjtin kontribut të jepen për shembull tri dekorata, ashtu siç e përmenda unë. Faleminderit!

Drejtimin e seancës e merr zoti Sabri Hamiti, anëtar i Kryesisë

KRYESUESI SABRI HAMITI: Ju faleminderit, zonja deputete! Fjalën e ka Berim Ramosaj.

BERIM RAMOSAJ: Ju faleminderit, zoti kryesues!

Përsëritës Kabinetin qeveritar,

Ju përsëritës deputetë të nderuar,

Fjala ime nuk do të jetë aq në kundërshtim me shumë fjalë të tjera këtu që u thanë, përshtypjet e mia janë në kuptimin e asaj se dallojmë veç në perceptime.

Duke marrë parasysh se deri tash është rregulluar një çështje e tillë me një rregullore që ka qenë në fuqi dhe të gjithë kemi qenë të pajtuar dhe jemi edhe sot se me rregullore do të heqim dorë, domethënë do ta kryejmë çështjen e rregulloreve dhe do të rregullojmë me ligj këtë çështje, unë e përsëritës propozuesin e këtij ligji dhe mendoj se sado qoftë që do të jetë ndoshta një ligj jo aq i mirë, e ka kuptimin e rregullimit të kësaj çështjeje. Ndarja e tillë e dekoratave, respektivisht në përgjithësi e të gjitha mirënjohjeve, medaljeve, të gjitha dekoratat në kuptimin e plotë të fjalës, në shumicën e shteteve, qoftë në regjion, qoftë në përgjithësi, është e lidhur me anën tradicionale të ndërtimit të atij shteti. Padyshim që edhe ne nuk mund t'i ikim këtij fenomeni edhe pse jemi shumë shtet i ri dhe në kokat tona ende janë të freskëta kujtimet, qoftë të luftës për paqe, qoftë të luftës për demokraci, qoftë të luftës çlirimtare, mirëpo unë besoj që një propozim që do të ishte ndoshta më racional, është zvogëlimi i numrit të dekoratave, sepse e kemi mundësinë e gabimit më të vogël.

Nga përvoja e shumë vendeve të tjera që kanë dalë jo kaheerë nga kthetrat e ish-Jugosllavisë, që kemi sot shumicën e vendeve të regjionit, e kanë edhe ata Ligjin e dekoratave dhe padyshim edhe ata e lidhin me një përvojë, qoftë historike, qoftë të nivelit kulturor të atij vendi, qoftë të shtetit në përgjithësi.

Mua më duhet që, së pari, numërimi i katër dekoratave të para, që hyn në grupin e dekoratave, ka mund të kodifikohet në një dekoratë, sepse është e ngjashme, si është e përpiluar këtu në ligj, gjegjësisht si është e propozuar, faktikisht kontribuuesit, respektivisht ata që janë pretendues të atyre dekoratave, janë shumë të ngjashëm në përshkrim, andaj është edhe mundësia e gabimit. Kur them, zvogëlimin e numrit të dekoratave, nuk e them në zvogëlimin e numrit të dhënies së

dekoratave nga Presidenti, domethënë Presidenti edhe, nëse i ka krejt 5 dekorata, ai mund t'ua japë 20 personave. Mund t'i ketë 30 dekorata me ligj, e mund t'ua japë veç dy-tre personave, andaj këtu duhet të shikojmë anën racionale. Ndoshta gabimet tona dhe të propozuesit të këtij ligji do të ishin më të vogla në qoftë se do të jemi më racional në kuptimin e identifikimit të katër- pesë fushave. Në qoftë se e kemi një fushë të kulturës, një fushë të lirisë, një fushë të nivelit intelektual, atëherë kjo ka mundësi të grupizimit shumë më të mirë se sa ky grupizim.

Në fakt, me këtë grupizim apo me këtë renditje që kemi bërë, frikohem se do të na ofendohen, qoftë familjet e atyre që jemi thirrur në emër të tyre, qoftë të njerëzve që janë ithtarë të filozofisë politike të atyre individëve. Nuk kemi pasur nevojë të bëjmë renditje fare, sepse fusha, puna e tyre, veprimtaria e tyre në jetë, në Kosovë edhe në çlirimin e Kosovës dhe në jetën paqësore, nuk ka qenë e renditur. Ata e plotësojnë njëri- tjetrin, është çështje komplementare. Të gjejmë një variant që ta plotësojmë edhe me dekorata, ashtu si e kanë plotësuar veprimtarinë, ashtu si e ka plotësuar veprimtarinë Ibrahim Rugova me luftën çlirimtare të Adem Jasharit, ashtu mund të plotësohet ajo edhe me dekorata, e jo të bëjmë renditje.

Lus edhe një herë propozuesin ta rishikojë mundësinë e zvogëlimit të numrit dhe mundësinë jo të numërimit apo të renditjes si është bërë këtu. Ju faleminderit edhe një herë për mirëkuptim!

KRYESUESI: Ju faleminderit, zoti deputet! Fjalën e ka deputeti Riza Smaka.

RIZA SMAKA: I nderuar, zoti kryesues,

Qeveritarë, deputetë të respektuar,

Në parim angazhohem që të kalojë ky dokument, ta mbështesim hartuesin por, natyrisht, me disa korrektime. Disa vërejtje parimore do t'i kisha dhënë. Bie fjala, emërtimi është tepër i gjatë, panevojshëm i gjatë. Gjithmonë duhet të gjejmë terma çelës, që e zgjojnë asociacionin për një tematikë që mund të jetë shumë e gjerë. Po e zëmë, Kodi penal sipas kësaj logjike do të duhej ta kishte titullin nja 10 faqe, ama Kodi penal edhe janë dy terma çelës që zgjojnë asociacion për një sferë të gjerë të jetës shoqërore. Do të kisha propozuar që ta quajmë Ligji për dekoratat. Pastaj, preambula, siç tha edhe kolegu Hyseni, me vend, do të duhej kurdoherë të ketë mbështetje vetëm ingerenca, juridiksioni i Parlamentit, por jo edhe i cilido autoritet tjetër, sepse vetëm Kuvendi i Kosovës është legjislativi që miraton ligje.

Është vërejtje e përgjithshme, mjerisht, pothuaj se permanente. Tri tekstet nuk përputhen, po e zëmë. Ja një shembull ekzemplar. Neni 1, qëllimi, thotë në gjuhën shqipe: "Qëllimi i këtij ligji është rregullimi ligjor" kjo është kakofoni, nuk thuhet kështoj- ligji, rregullimi ligjor, ose në anglisht bie fjala është thënë gabimisht e do të duhej" the aim this law is legal regulatin. Reigjimenti e ka konotacionin e kontraktimit, por jo të rregullimit normativ. Po ashtu, edhe në serbisht, boshnjakisht: "Cilj ovog zakona je zakonsko regulisanje", nuk thuhet, por "uredjenje". Dua të them se me të vërtetë, nuk është fjala te cikërrimat, por në qoftë se shkruhet keq, apriori e krijon një klimë të papërshtatshme dhe e kundërta. Sidomos ligjet duhet të jenë me gjuhë të qartë. Pastaj, ligjet e kanë edhe në veçanti, e kanë edhe zhargonin legjislativ, që nëse i mungon, atëherë krijon edhe hapësira për kuazi interpretime.

Te neni 2, paragrafi i 2-të, edhe te neni 5, paragrafi i 17-të, nuk është punuar me kujdes. Bie fjala, këtu thotë: Dekoratat, çfarë nënkuptohet me to, ndërsa me nenin 5, paragrafi 17, atje veç përmendet trofeu, që nuk është dhënë në skopin e definicionit. Do të thotë, do të duhej që të inkorporohej, të insertohej edhe trofeu ose eventualisht të riemërtohej në nenin 5, paragrafi 17.

Disa vërejtje parimore esenciale, se ka, do të kisha pasur shumë. Neni 25, Presidenti i Republikës të Kosovës, me vetë nismë mund të dekorojë. Po kjo, qysh me vetë nismë mund të dekorojë. Janë

raste të tjera ku është thënë se sipas nismës, se fundi i fundit, nisma edhe nuk është edhe obligatore. Mund të propozojë, bie fjala, Kryetari i Gjykatës Supreme, mirëpo Presidenti mund ta aprovojë, por mund të mos e aprovojë, ajo është vetëm si të thuash, nismë e procedurës.

Te neni 27, paragrafi 12, ja çka thuhet: “Personi me reputacion publik”. Është çështje shumë problemore, kush është person me reputacion publik? Këtu jepet një mundësi solide për të bërë, si të thuash, interpretime arbitrare. Bie fjala, unë e vlerësoj këtë apo atë me reputacion publik, e ndoshta nuk është fare dhe, siç e thatë ju, zotëri kryesues, me vend, po e zëmë, dhe organizatat e tjera. Këtu e hap një mundësi që çfarëdo organizate të japë nismë, prandaj do të duhej të fshihej krejt atje ku është dhënë kush mund t’i propozojë Kryetarit të Kosovës këtë e këtë, se nëse thuhet edhe organizatat tjera, domethënë çfarëdo organizate, çfarëdo entiteti legal që do të mund të bënte. Prandaj, kjo do të duhej të fshihej pa kurrfarë dileme, pa kurrfarë hezitimi.

Te dispozitat kalimtare, bie fjala. Neni 34. Dekoratat e dhëna më parë do të njihen. Kjo nuk duhet, kjo duhet të fshihet, ja pse, sepse një e drejtë e fituar me një ligj valid, pavarësisht edhe sikundër ne të thoshim që nuk vlejnjë, ato do të vlenin, sepse është parim juridik ndërkombtarisht valid i aplikueshëm, kudo i pranueshëm. Një e drejtë ligjore e realizuar njëherë, kurrsesi nuk mund të mohohet, kurrsesi, domethënë është çështje, prandaj kjo do të duhej të fshihej. Ky dokument nuk përmban dispozita ndëshkimore edhe unë llogaris që në procedurë, në etapën e dytë do të pasurohet, se duhet të jenë, duhet të jetë një kaptinë për dispozitat ndëshkimore. Edhe, bie fjala, neni 36: ”Nga dita e hyrjes në fuqi të këtij ligji, pushojnë së vepruari të gjitha dispozitat që bien në kundërshtim me këtë.” Kjo nuk duhet të qëndrojë fare për faktin e thjeshtë se ligji, bile thuhet edhe në latinisht, para 2000 vjetëve njihet kjo sentencë: ”Legis posterior derogat legis prior” (Ligji që miratohet sot, e shfuqizon ligjin e djeshëm) poqe se është në kolizion, natyrisht.

Do të duhej ta inkorporonim edhe një dispozitë, ku do t’i jepnim bazë ligjore Kryetarit apo Presidencës që të miratonte rregullore për ta konkretizuar fushëveprimtarinë e implementimit të këtij ligji. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit, zoti deputet! Fjalën e ka deputeti Hydajet Hyseni-Kaloshi.

HYDAJET HYSENI: Ju faleminderit, zoti kryesues!

Të nderuar ministra,

Zonja e zotërinj deputetë,

Ju përshëndes dhe e mbështes që në fillim përpjekjen për ta rregulluar, më në fund, me ligj edhe këtë çështje gjithsesi të rëndësishme dhe në përvojën tonë të ngatërruar. Megjithatë, kam pritur edhe unë që ky ligj do të na vijë më i përmirësuar se që ka ardhur. Kam pritur që edhe lista e dekoratave të jetë pak më e racionalizuar dhe t’i ketë marrë parasysh edhe vërejtjet që janë bërë në debat përpara. Nuk më duket në rregull që lista e dekoratave të jetë kryesisht politike, humanitare, thua se fushat e tjera nuk kanë rëndësi, ose që të jenë dy dekorata të rëndësishme për paqen dhe do të jetë pastaj e vështirë pse njëri mund ta ketë njërën dhe jo tjetrën?

Për më tepër, janë përvjedhur edhe lëshime, të cilat kanë qenë adresuar edhe në debatin e mëparshëm. Në nenin 27, e drejta e paraqitjes të propozimit për dekorata u njihet institucioneve në masë të madhe me arsye, por janë përjashtuar përsëri shoqatat. Për shembull, për luftëtarët e lirisë janë përjashtuar shoqatat e veteranëve të luftës dhe shoqatat e ngjashme. Askund në botë nuk ndodhë kjo. Janë përjashtuar institucionet shkencore dhe në shumicën e vendeve janë pikërisht ato që bëjnë propozime, sepse ato edhe kanë të dhëna, ato edhe i kanë kriteret me të cilat bëjnë propozimet e tyre. Prandaj, propozoj që në amendamentim të përfshihen edhe këto mundësi propozimi për dekorata.

Në nenin 31 është përsëritur anomalia që ka qenë adresuar, ka qenë përkrahur, por, megjithatë, sipas një logjike vërtet të çuditshme, uroj që të jetë inercia jonë burokratike, por ato po na kthehen përsëri. Është përjashtuar kategoria e ish të burgosurve politikë me formulën se nuk mund të jenë të dekoruar ata që kanë qenë të dënuar, siç është thënë, për krime të rënda, pa e sqaruar kush bie në këtë kategori? Dhe, kjo tash mund të thuhet e po, një formulim jo i saktë, por këtë formulim e gjejmë në shumë ligje, zonja e zotërinj. Dhe, po e gjejmë jo vetëm nëpër paragrafët e ligjeve tona, por e gjejmë edhe në praktikë. Edhe dhjetë vjet pas lirisë së Kosovës, personalitete si Hasan Prishtina, me shokë, mbeten të përjashtuar nga dekoratat, ose Bedri Pejani, Marie Shllaku, Gjon Sereqi, Omer Çerkezi, Gjeladin Hana, Fazli Grajçevci e Rifat Berisha, madje edhe në përvjetorët jubilarë -100 vjetorin e lindjes, ata askush nuk i përmend dhe nuk inicohet procedura e nderimit të tyre.

Për të shkuar pastaj te dëshmorët e viteve 1968, 1981, se figura të shquara si Jusuf Gërvalla, Kadri Zeka, Enver Hadri, Afrim Zhitia e të tjerë, dhe kjo tash bëhet përsëri, sepse këta kanë qenë të dënuar. A do të vazhdojmë, zonja zotërinj, t'i mbajmë të dënuar? Le të jetë kjo vërejtje edhe si një vërejtje që gjithkund, ku flitet për ligjet, le të kihet parasysh realiteti i ri dhe ata që i kanë kontribuar më shumë se sa ne këtu që jemi të këtij realiteti, më shumë se sa edhe disa që mbajnë emra në dekorata.

Paragrafi, neni 34, mendoj që duhet rishikuar. Thotë ky paragraf se dekoratat e dhëna më parë edhe pas hyrjes në fuqi, si është ajo, mbeten në fuqi, që të jemi i sakët- do të njihen edhe pas hyrjes në fuqi. Çka do të thotë të dhëna më parë? Çka përfshinë kjo? Sa është kjo më parë? Më parë mund të jetë një shekull, mund të jetë gjysmë shekulli dhe ju e dini që për arsyet historike që i dimë ne, ka pasur raste kur janë dënuar ata që kanë dashur lirinë, janë dekoruar që kanë shtypur lirinë. A do t'i njohim ato dekorata? Prandaj, kërkoj që kjo të merret parasysh dhe të korrigjohet, qoftë edhe me formulën dekoratat që janë në kundërshtim me këtë ligj përjashtohen, do të thotë me përjashtim të tyre apo dekoratat që fyejnë ndjenjat e qytetarëve të Kosovës.

Unë besoj që këto do të korrigjohen gjatë amendamentimit dhe me ndryshimet si këto, e mbështes. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit, zoti deputet! Fjalën e ka deputeti Adem Hajdaraj.

ADEM HAJDARAJ: Ju faleminderit, zoti kryesues!

Zotërinj të tjerë të Qeverisë dhe deputetë,

Unë desha t'i them nja dy-tri fjalë përkitazi me zhagitjet dhe problemet që po i nxjerrim ne në leximin e parë, kur dihet se leximi i dytë i amendamenton, i rregullon dhe kështu ligji bëhet më i mirë. E di se ky ligj për të dytën herë po kthehet, ky projektligj. Unë mendoj se është përmirësuar mjaft dhe është ndër ligjet më të mira deri tash që i kemi pasur. Po e them me plot bindjen, për arsye se ne e kemi shqyrtuar edhe në Komisionin për Legjislacion dhe kemi shfaqur këtë mendim se është i mirë. Mirëpo, nëse bëhet fjalë për një person, nëse bëhet fjalë për një Qeveri që e ka hartuar ligjin, është bërë si një sëmundje patologjike e disa njerëzve këtu vetëm të kritikojnë, vetëm ta kthejnë ligjin, projektligjin mbas, pa pasur arsye që ta bëjmë këtë, domethënë që të kthehet ligji.

Ju lutem, subjektivizmi në Kuvend nuk është i mirë dhe dëmton, i dëmton të gjithë, jo vetëm e dëmton një person ose një udhëheqës, por po i dëmton të gjithë. Dhe, unë po them se kjo alergji që shfaqet, që gërshetohet në këto reagime që i bëjnë njerëzit, pa i dokumentuar, veçse a e ka dhënë opozita, a s' e ka dhënë, a kush e ka dhënë ose për ke është ai ligj? Ju lutem, nuk është mirë kështu, duhet të jemi real, të jemi preciz, të jemi të vetëdijshëm se diçka të mirë nuk ka nevojë ta kritikojmë aq shumë vetëm sa për ta hedhur.

Tjetër, desha të them edhe një gjë, që pajtohem me diskutuesit e mëparshëm, nuk po ua përmend emrat, më duket profesor Riza tha për shkurtimin e titullit. Edhe unë pajtohem plotësisht që të jetë, domethënë, për dekorata e s'ka nevojë edhe të Presidentit e tjerë, e tjerë, sepse dihet me Kushtetutë kush jep deklaratat dhe cilat janë ato.

Desha të them edhe për disa lëshime që i vërej në ligj këtu, do precizime nuk janë bash të plota. Për shembull, në faqen 2, këtu ku është dhënë neni 2, thotë: "Dekorata nënkupton dekoratat". Qysh dekorata nënkupton dekoratat? Por, duhet të thuhet: Dekoratat janë këto: medaljet, çmimet, mirënjohjet, titujt e tjera e tjera, e jo dekorata nënkupton dekoratat. Disa herë kam thënë, "nënkupton" po e marrim prej serbokroatishtes "podrazumeva", po thuaj e kupton nëse do, jo nënkupton, se s'ka nënkuptim aty.

E dyta, në faqen tjetër, domethënë 6, është precizim jo fort i qëlluar. Unë mendoj se duhet pak të shikohet në të ardhmen, që ky të jetë pak ndryshe. Për shembull, thuhet këtu, faqe 6, neni 10: "Medalja", "Luftëtari i Lirisë," "Adem Jashari", duhet: Medalja Luftëtari i Lirisë "Adem Jashari" e jo krejt të futet kështu. Kështu, sikurse është edhe për 11-shin, kur është futur vetëm "Dr. Ibrahim Rugova", domethënë të mos të jetë e tillë sikurse është. Dhe, po ashtu, në faqen 10, që e shtroi edhe profesor Sabri Hamiti atje, pajtohem me ato mendime që i dha përkitazi me, domethënë, ta gjej, vetëm ta shoh, këtu që thotë: "Çmimi Presidencial për studiues" dhe janë përfshirë këtu edhe mësuesit, edhe studentët, ashtu është si tha profesori, por nëse duhen të merren edhe këta, duhet të thuhet, të jetë titulli kështu: Çmimi Presidencial për risimtarët, për novatorët, për rinovuesit, e jo për studiues, se studiues nuk është nxënësi, sikurse u tha më parë. Prandaj, domethënë, në të ardhmen ne duhet t'i bëjmë do gjëra, përndryshe e tumirë dhe e përkrah se është ndër ligjet më të mira deri tash. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit, zoti deputet!
Fjalën e ka kërkuar deputeti Ethem Çeku.

ETHEM ÇEKU: Ju faleminderit, zoti kryesues!

Unë, në parim ndaj një opinion pozitiv për këtë ligj. Për mua është ajo që e përmendi kolegu, deputeti Hydajet Hyseni, është një periudhë e caktuar kohore, në të cilën disi nuk ka mundur që ky projektligj t'i vendosë afër një shekull veprimtari të politikës në çështjen kombëtare. Do të thotë, propozuesi duhet ta shohë se si do ta ofrojë atë periudhë, të cilën për një kohë të gjatë, do të them, rreth 100 vjet, është një periudhë e cila deri diku nuk është e mbuluar me këtë projektligj. Ndoshta, brenda medaljeve apo dekoratave, të cilat janë paraparë, duhet të vendosen edhe struktura të caktuara të veprimtarisë patriotike të kohës në të cilën kanë vepruar.

Unë mendoj, ta zëmë shembull, te neni 7, flasim për kontribute të veçanta në mbrojtjen e lirisë së Kosovës, do të thotë, ne duhet një paragraf apo një fjalë, duhet të themi në krijimin dhe në mbrojtjen e lirisë së Kosovës. Do të thotë, kur e kemi në krijimin, atëherë e shohim edhe një veprimtari apo një punë të madhe që kanë kryer gjenerata të tëra, ose te Medalja e Lirisë, Luftëtar i Lirisë "Adem Jashari", në luftën e fundit. Ne e dimë se që nga 1945-ta, që nga okupimi i Kosovës dhe i tokave shqiptare nga Jugosllavia, ka pasur shumë, shumë struktura të qytetarëve të Kosovës, të cilët nuk e kanë pranuar gjendjen e krijuar në Kosovë. Lëvizja Nacional Demokratike Shqiptare dhe strukturat deri në... prandaj mendoj që në këto dy struktura, në këto dy nene, duhet të kemi ndërhyrjen që ta përfshijmë vakuumin, them ka mbetur një vakuum shumë i madh kohor, rreth 100 vjet të lëvizjes politike që ka të bëjë me çlirimin e Kosovës. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit, zoti deputet!

Fjalën e ka kërkuar Drita Maliqi.

DRITA MALIQI: Ju faleminderit, zoti kryesues!

Përshëndetje,

Unë do ta marr fjalën në emër të Grupit të Grave Deputete dhe propozoj që të shtohet edhe një dekoratë për kontribut të veçantë të gruas. Grupi do t'ia dorëzojë amendamentin komisionit funksional. Ju faleminderit, zoti kryesues!

KRYESUESI: Ju faleminderit, zonja deputete!

Kolegë të dashur, bëhuni gati për votimin e ligjit, në parim. Regjia, gati për votimin e ligjit, në parim. Votojmë tash:

“Për” kanë votuar 44 deputetë,” kundër” 18, deputetë, 4 kanë abstenuar, me shumicë votash, votohet në parim.

Pra, është edhe një më shumë “për”, se Nait Hasani s’e ka kartelën me veti. Edhe Ramadan Gashi është “për”. Ju faleminderit.

Unë e jap një orë pushim.

KRYETARI: Të nderuar deputetë,

Vazhdojmë, do të thotë kemi 1/3 e pak më tepër, që mund t’ia fillojmë deri në votim.

Në bazë të Rregullës 35.1 të Rregullores së Punës, janë përmbushur kushtet për shqyrtim dhe miratim në parim të këtij projektligji. Pra, kemi në shqyrtim:

- Projektligjin për tatimin dhe të ardhurat e korporatave.

Ftoj ministrin e Ekonomisë dhe Financave, zoti Ahmet Shala, që në emër të Qeverisë së Republikës së Kosovës, para deputetëve të Kuvendit, ta prezantojë Projektligjin.

MINISTRI AHMET SHALA: I nderuar Kryetar,

Të nderuar kolegë ministra,

E nderuara kolege ministre,

Të nderuar deputetë,

Kam nderin që sot para jush ta paraqes Projektligjin për tatimin në të ardhurat e korporatave.

Ky projektligj është hartuar nga Ministria e Ekonomisë dhe e Financave dhe në bashkëpunim edhe me përfaqësues të komunitetit të biznesit dhe palë të tjera të interesuara dhe është bazuar në standardet të praktikave më të mira të vendeve të Bashkimit Evropian si dhe vendeve të regjionit.

Qëllimi i këtij projektligj është krijimi i një ambienti sa më të favorshëm për biznesin dhe investimet vendore dhe të huaja gjithnjë duke ruajtur stabilitetin fiskal dhe atë ekonomik.

Dispozitat e këtij ligji ose projektligji, janë përafruar, si me legjislacionet e vendeve të regjionit, ashtu edhe me praktikave dhe legjislacionet e Bashkimit Evropian. Ky projektligj duhet të jetë më i avancuar në shumë aspekte sidomos në ato të cilat trajtojnë çështjet e dividendës, amortizimit, dispozitat e borxhit të keq si dhe dispozitat e tjera administrative, të cilat janë më të favorshme, si për tatimpaguesit, ashtu edhe për Administratën Tatimore të Kosovës.

Projektligji është harmonizuar edhe me Marrëveshjen e instrumentit para anëtarësimit, nënshkruese e së cilës është edhe Republika e Kosovës dhe e cila duhet t'i përmbahet rregullave të kësaj marrëveshjeje. Përpos tjerash, në këtë ligj ose projektligj është paraparë edhe zgjerimi i të hyrave të përjashtuara në atë mënyrë që nënkontraktuesit ndërkombëtarë të jenë të liruar. Kjo bëhet dhe është e bazuar në parimin që nënkontraktuesit ndërkombëtarë paguajnë tatim në vendet e tyre, andaj nëse kontraktuesit nuk do të liroheshin në legjislacionin tatimor të Kosovës, ata do të mund të gjendeshin në situata që të paguajnë një taksë të dyfishtë. Andaj, ky ligj konsideroj që e rregullon në mënyrë mjaft koncize edhe këtë problematikë.

Nëse në legjislacion do të ishte liruar vetëm kontraktuesi, siç e thashë edhe më herët, por jo edhe nënkontraktuesi, do të krijohet një situatë ku të dy palët e angazhuara drejtpërdrejt në projektin ose programin e njëjtë, nuk do të tatoheshin në mënyrë të barabartë.

Duhet cekur që lirimet janë të lidhura me projektet specifike të investuara nga qytetarët ose organizatat ndërkombëtare, ashtu siç është e definuar edhe në këtë projektligj. Nëse kontraktuesi primar, ose nënkontraktuesi, ka të ardhura nga aktivitetet e tjera të biznesit dhe qëndron më shumë se 183 ditë, shtrohet pyetja që është kjo 183 ditë, është më shumë se sa 50% e ditëve kalendarike të vitit, nëse qëndron pra më shumë se 183 ditë në Kosovë, për këto të ardhura ai duhet të paguajë taksa.

Në Projektligj janë paraparë lirime speciale për të ardhurat e bashkësive fetare në Kosovë, të cilat janë në pajtueshmëri me nenin 2, aneksi 5 të Pakos së Ahtisarit dhe me Ligjin nr. 02-L-31 mbi liritë fetare në Kosovë. Me qëllim të eliminimit të tatimit të dyfishtë, pasi që, sipas sistemit të tanishëm dividenda tatohet dy herë, një herë në nivel të korporatës e pastaj edhe me rastin e shpërndarjes tek aksionarët, gjë që stimulon investimet dhe paraqet barrë për bizneset, projektligji ndryshon rregullat e trajtimit të dividendës në atë mënyrë që dividenda do të lirohet nga tatimi. Ka qenë një kërkesë e kamotshme e biznesit kosovar dhe të gjitha shtetet e regjionit pothuaj se e kanë larguar me kohë.

Projektligji parasheh që çdo marrëveshje ndërkombëtare e nënshkruar nga Ministria e Ekonomisë dhe e Financave apo nga një institucion tjetër qeveritar lidhur me heqjen e tatimeve të dyfishta, do t'i shfuqizojë dispozitat e këtij ligji.

Janë avancuar po ashtu edhe dispozitat që trajtojnë borxhin e keq, e të cilat janë harmonizuar me legjislacionin e vendeve të Bashkimit Evropian. Rregullat e borxhit të keq kanë qenë në një mënyrë ngarkesë për bizneset kosovare, për arsye se kriteret që një borxh të shpallet borxh i keq, aktualisht janë të komplikuar, si për tatimpaguesin, ashtu edhe për Administratën Tatimore.

Tani, rregullat për trajtimin e borxhit të keq në këtë projektligj, janë thjeshtësuar, por gjithsesi kemi pasur gjithashtu kujdes që kriteret të jenë të kufizuara deri në atë masë që nuk e ngarkojnë as biznesin me procedura të tepërta, ndërsa në anën tjetër, tatimpaguesit nuk i është lënë hapësirë për të shfrytëzuar ATK-në si mbështetje dytësore lidhur me menaxhimin e kreditimit të dobët të tyre.

Po ashtu, në projektligj është avancuar trajtimi i amortizimit për mjetet kapitale, sidomos për ato që janë të përfshirë në kategorinë e tretë dhe asetet biologjike për agrobiznes të cilat do t'i mundësojnë fermerëve kompensimin nëpërmjet zbritjeve të zhvlerësimit të aseteve të tyre biologjike, siç janë bagëtia qumështore dhe kafshët riprodhuese.

Zhvlerësimi apo amortizimi kontabël i mjeteve themelore apo aseteve biologjike si quhen, është në përputhje me praktikat më të mira të vendeve evropiane. Metoda e zhvlerësimit është metodë lineare e kategorizuar në tri kategori. Kategoria e parë 5%, e dyta 20 dhe kategoria e tretë 10%.

Asetet do të zhvlerësohen sipas rregullave të standardeve të kontabilitetit. Gjithashtu, ka ndryshuar shkalla e vlerësimit për kategorinë e tretë, nga 15 në 10. Ky ndryshim është bërë për arsye të jetëgjatësisë së aseteve që i përkasin kësaj kategorie.

Ky zhvlerësim kontabël për kafshët bujqësore është lejuar vetëm nëse kafshët e tilla janë përdorur gjatë rrjedhës së veprimtarisë ekonomike të entitetit bujqësor. Kultivimi i kafshëve, të cilat për qëllim e kanë konsumin personal, si në aspektin e rritjes së pasardhësve të tyre, ashtu edhe kafshët qumështore, nuk i nënshtrohen këtij zhvlerësimi.

Në fillim të vitit 2009, ka filluar, siç e dini, zbatimi i legjislacionit tatimor me të cilin legjislacion, norma tatimore e tatimit të ardhurave të korporatave, është reduktuar nga 20 në 10 dhe me qëllim që edhe kompanitë e sigurimit të përfitojnë nga kjo ulje tatimore, me këtë projektligj, është propozuar që të ulët norma tatimore e kompanive të sigurimit nga 7% në premitë e sigurimit sa ishte aktualisht ose sa është, në 5%. Dhe, ky ishte po ashtu një zë i biznesit kosovar me kohë, të cilin konsideroj që Qeveria e Kosovës ka shprehur edhe me kohë në një takim me Kryeministrin dhe biznesin për të marrë parasysh këtë kërkesë.

Në projektligj janë avancuar dispozitat administrative, sidomos në deklarin e tatimit në pagë dhe pagesa e tatimit do të bëhet në bazë të qarkullimit bruto, ku tatimpaguesve u është lënë mundësia të zgjedhin në bazë të qarkullimit të tyre si dhe të natyrës së veprimtarisë 3% ose 5% apo të paguajnë tatim në të ardhura reale, nëse përpilojnë, natyrisht, pasqyrat financiare ashtu siç kërkohet me standardet e kontabilitetit dhe me ligjet në fuqi.

Projektligji ka gjithsej 10 kapituj dhe 40 nene. Projektligji është në përputhshmëri me parimet themelore për hartimin e legjislacionit dhe teknikat legjislative.

Të nderuar deputetë,

Edhe një herë po e ritheksoj se me miratimin e këtij projektligji nga ana e juaj do të krijohet ambient i favorshëm për zhvillimin e biznesit dhe nxitjes së investimeve në përgjithësi në Kosovë, andaj kërkoj mbështetjen e juaj. Ju faleminderit!

KRYETARI: Ju faleminderit, ministër!

Pasi që kryetari i Komisionit nuk e ka kërkuar fjalën, atëherë shkojmë në emër të grupeve parlamentare.

Në emër të Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike, fjalën e ka kërkuar deputetja Safete Hadergjonaj.

SAFETE HADERGJONAJ: Ju faleminderit, zoti Kryetar!

Të nderuar deputetë,

Të nderuar ministra,

Ne sot po shqyrtojmë Projektligjin për tatimin në të ardhurat e korporatave. Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës e ka shqyrtuar me vëmendje këtë projektligj, si të rëndësishëm për zhvillimin e biznesit në Kosovë dhe me këtë projektligj është i mendimit se Qeveria po përmbush obligimin për ta ofruar pakon e ligjeve që po e avancojnë sistemin tatimor në drejtim të krijimit të një ambienti të favorshëm për investime.

Ne edhe më parë kemi pasur kërkesa të vazhdueshme nga komuniteti i biznesit që të krijohen kushte të favorshme përmes një politike tatimore dhe Qeveria ka shkuar në drejtim të reformimit të kësaj politike tatimore në drejtim të krijimit të kushteve të favorshme të biznesit, gjë që me këto ligje të cilat po na ofrohen, po bëhen përmirësime pozitive në këtë drejtim.

Projektligji, i cili na është ofruar në shqyrtim, vërejmë se është shumë më i avancuar edhe për tatimpaguesin, por është i avancuar edhe për Administratën Tatimore të Kosovës, gjë që ka elemente pozitive që i ka sjellë ky ligj i ri.

Megjithatë, në këtë projektligj ka nevojë të bëhen përmirësime teknike, por edhe përmbajtjesore, sidomos tek përkufizimet: në nenin 7, në nenin 9, në nenin 15, në nenin 30, kështu që Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës, e përkrah në parim këtë projektligj dhe është i mendimit se ky projektligj u ofrohet standardeve dhe praktikave të Bashkimit Evropian, është nën favor të reformës në politikat tatimore, prandaj, e përkrah në parim, kurse kontributin tonë në drejtim të përmirësimit të atyre neneve, të cilat nuk janë ashtu siç duhet, do ta japim në Komisionin FunkSIONAL nëpërmjet deputetëve tanë të cilët i kemi në Komisionin FunkSIONAL. Ju faleminderit!

KRYETARI: Ju faleminderit!

Në emër të Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike të Kosovës, Naser Osmani e ka kërkuar fjalën.

NASER OSMANI: Ju faleminderit, Kryetar!

Të nderuar deputetë, kolegë,

Projektligji për tatimin e të ardhurave të korporatave është ligji i cili rregullon funksionimin e tatimit direkt që ngarkohen me të ardhurat e tatueshme që ka realizuar korporata. Përmbajtja e këtij ligji është strukturuar në dhjetë kapituj me 40 nene, nëpërmjet të cilëve janë trajtuar definicionet e domosdoshme, është përcaktuar qartë objekti i tatuarjes, që është fitimi i personave juridikë, domethënë, korporata apo organizata e biznese që ka statusin juridik, ndërmarrja shoqërore apo publike, organizatat joqeveritare, njësitë e përhershme të personit jo rezident.

Ligji përcakton normën e tatimit të korporatave në shkallën 10%. Ligji ka përfshirë të ardhurat e liruara nga tatimi në korporata, të ardhurat e jo OJQ-ve, me status të përfitimit publik, të ardhurat e Bankës Qendrore, dividendat nga tatimpaguesit rezidentë dhe jo rezidentë, interesat nga letrat me vlerë të lëshuara nga autoritetet publike, të ardhurat e revizioneve, të ardhurat e kontraktorëve të huaj të Kombeve të Bashkuara, përfshirë këtu UNMIK-un, bile ajo pjesë që ka mbetur, KFOR-in, BE-në, Bankën Botërore dhe Fondin Monetar Ndërkombëtar. Gjithashtu janë radhitur shpenzimet e lejueshme edhe të palejueshme, si dhe ato të cilat janë pjesërisht të lejueshme. Gjithashtu, këtu është dhënë edhe sqarimi në lidhje me trajtimin e borxheve të këqija, zhvlerësimin si dhe amortizimin e tyre.

Ligji rregullon fitimet dhe humbjet në kapital si dhe humbjet biznesore, procesin e likuidimit dhe riorganizimit të ndërmarrjeve të ndonjë korporate, transferimin e çmimin dhe shmangien nga tatimi i dyfishtë, ku pranohet se kreditë, tatimi i paguar jashtë, por në shkallë vendi, obligimi i korporatave për të mbajtur tatimin në burim, përfshirë edhe mbajtja në burim për pagesat që do t'u bëhen personave jo rezidentë.

Në ligj përfshihen dispozitat e veçanta që kanë të bëjnë me tatimin e kompanive të sigurimit si dhe organizatave joqeveritare që nuk kanë ruajtur statusin e përfitimit publik. Dispozitat administrative që kanë të bëjnë me mënyrën dhe kohën e pagesës së tatimit me korporata, domethënë, pagesa me 4 këste, paradhënie dhe në fund të vitit që bëhet një deklaratë vjetore nga

korporata ku paraqiten obligimet tatimore vjetore, rimbursimi i tatimit të paguar tepër. Gjithashtu ky ligj rregullon edhe tatimin e bizneseve të cilat kanë të ardhura bruto vjetore më pak se 50.000 euro, dhe të cilat nuk kanë zgjedhur që të tatohen në bazë të ardhurave reale, do të tatohen sipas tatimit të paragjykuar, duke përlogaritur në të ardhurat bruto, domethënë 3% për tregtarët dhe prodhuesit si dhe 5% për shërbyesit, por nuk do të paguhet më pak se 37.5 euro për tremujor.

Marr në përgjithësi, ligji i plotëson të gjitha parakushtet që të aprovohet në parim dhe është konkurrent me ligjet që kanë të bëjnë me tatimet në rajon, që do të thotë një harmonizim me rajonin dhe Grupi Parlamentar i LDK-së do ta përkrahë dhe Komisioni për Buxhet dhe Financa, do ta pasurojë edhe më tepër këtë ligj. Ju faleminderit!

KRYETARI: Ju faleminderit, deputet!

Në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, deputeti Haki Shatri e ka kërkuar fjalën.

HAKI SHATRI: Ju faleminderit, zoti Kryetar!

Të nderuar deputetë,

Të nderuar ministra,

Siç jemi në dijeni, Kuvendi i Kosovës, në fund të vitit 2008, ka miratuar plotësimin dhe ndryshimin e ligjeve të pakos fiskale, janë katër ligje që kanë qenë në procedurë, me premtime nga Qeveria që ky plotësim është i përkohshëm, sepse presim që pakoja e ligjeve fiskale do ta na vijë shpejt në Kuvend, dhe në këtë pako do të fillojë të realizohet ajo që është premtuar-një reformë e politikave fiskale në Kosovë. Kjo ka qenë e pranueshme për gjithë Kuvendin dhe është përkrahur pa rezervë, me shpresë që kur të vijnë këto ligje, të cilat kanë mbërri në Kuvend, do të përmbajnë materien e cila nënkupton reformë fiskale në Kosovë.

Në fakt, ligji të cilin sot po e diskutojmë, është një rregullim i materies së ligjeve apo udhëzimeve administrative që Administrata Tatimore dhe Qeveria kanë punuar në bazë të tyre, por ligji i ofruar, në esencë, në materie në përmbajtjen e saj, nuk e përmban atë që realisht mund të konsiderohet një ndryshim më përmbajtësor që nënkupton një reformë fiskale me çka do të krijojë kushte më të favorshme për zhvillimin e bizneseve.

Në parim, Grupi ynë parlamentar është që për t'u nxjerrë këto ligje dhe është për këtë ligj, por kërkojmë domosdoshmëri që ky ligj në procedurë të plotësohet edhe me disa çështje të cilat unë do t'i përmend këtu konkretisht. Mendojmë që lehtësirat për bizneset mund dhe kanë vendin që të parashihen në këtë ligj për bizneset në zonat e caktuara. Fjalën e kam për zonat ekonomikisht më të pazhvilluara, pastaj, lirimet speciale për bizneset e reja. Ne kërkojmë që lirimet të bëhen decitive, të thuhet lirohen për një periudhë të caktuar 3 apo 5 vjet.

Ministri që është këtu, e di mirë që këto biznese në fillim të punës së tyre kur fillojnë aktivitetin biznesor, duke shfrytëzuar forma të tjera, ato i shmangen këtij tatimi ashtu, kështu. Ne kërkojmë që, me qenë se kjo ndodh në praktikë, të jetë shumë më e qartë dhe do të jetë shumë më atraktive edhe për investitorët e huaj që kjo të thuhet decidivisht- bizneset në fillim të aktivitetit të tyre, lirohen për një periudhë të caktuar kohore drejtpërdrejt e jo të përdorin metoda të tjera, që herë janë të lejuara e herë nuk janë të lejuara, por që mund t'i realizojnë bizneset në fazat e caktuara.

Pra, kjo është një kërkesë jona, e theksuar për këtë çështje. Pastaj, në projektligj mund të parashihen edhe lirime speciale për biznese të cilat kanë numër të caktuar të punëtorëve. Me aktet e deritanishme këto lirime janë të caktuara për shembull për bizneset që kanë deri në 100 punëtorë, por nuk thuhet më tutje, në qoftë se një biznes zhvillohet më tej dhe punëson edhe më tepër njerëz, a ka të drejtë që edhe më tutje t'i zgjatet periudha e lirimt apo përfundon me atë

kufizimin në 100 punëtorë? Ne mendojmë që është stimulative, në qoftë se këtu zgjerohet mundësia. Nuk dëmtohen të hyrat buxhetore as projeksionet e të hyrave buxhetore as për periudhën afatmesme as vjetore në qoftë se kjo përfshihet.

Mendojmë që duhet të bëhet një definim i qartë i humbjes dhe i fitimit të kategorisë së dytë dhe e tretë. Ministri e di çka është kjo. Pastaj të kuotat fikse 3 dhe 5%, mendojmë se është mirë të bëhet dhe është shumë më praktike të bëhet kategorizimi i bizneseve sipas veprimtarive. Këto janë kuotat për bizneset që kanë qarkullimin deri në 50.000 euro në vit, por mendojmë që, në qoftë se këto bëhen sipas lëmenjve, do të jetë shumë më e lehtë edhe për Administratën Tatimore dhe më praktike, do thotë, të bëhet vjelja më e mirë e këtyre obligimeve. Mendojmë se duhet të definohet çështja e shpenzimeve të pranueshme me ligj e jo me udhëzim administrativ siç parashihet në këtë projektligj. Pastaj, të definohet qartë tatimi pasi që këto ndërmarrje që kanë tatimin e paragjykuar, shumë herë nuk mbajnë evidencat e caktuara dhe Administrata Tatimore ka vështirësi se si t'i ngarkojë këto biznese, në raste kur nuk mbajnë evidenca që parashihen me ligj. Pra, duhet të definohen saktësisht me ligj se si të bëhet kjo. Të caktohet, pastaj metoda e zhvlerësimit të pasurisë, njëra, cila do që ta vlerësojë Ministria më të përshtatshme, ose lineare ose indirekte, por të caktohet me këtë ligj. Dhe, në fund lirimet speciale, mjetet që hyjnë për herë të parë në Kosovë, janë liruar deri tash deri në fund të vitit 2008, 10%, me këtë ligj nuk vazhdohet ajo formë e beneficioneve.

Ne mendojmë se kjo duhet të vazhdohet edhe të hyjë në këtë ligj edhe për një periudhë kjo si kuotë mund edhe të rritet prej 10- në më shumë për qind, varësisht si e vlerëson më të dobishme Ministria.

Ju faleminderit!

KRYETARI: Ju faleminderit!

Në emër të Grupit Parlamentar të AKR-së, deputetja Myzejene Selmani e ka fjalën.

MYZEJENE SELMANI: Riza Smaka...

KRYETARI: Urdhëro, deputet Riza Smaka

RIZA SMAKA: I nderuar, zoti Kryetar,
Qeveritarë dhe deputetë,

E konsiderojmë punë të mirë këtë nismë edhe dokumentin e ofruar nga MEF-i, nga zotëri Shala edhe në parim e mbështesim, por me disa vërejtje parimore, natyrisht benevolente që të bëhet më i mirë ky dokument.

Fillimisht, titulli nuk është i përshtatshëm krejtësisht, ja pse. Thuhet Projektligji për tatimin e të ardhurave të korporatave. Korporatat janë entitet juridik, biznesor, por janë vetëm njëra nga forma, a ka të tjera, e sipas këtij diksioni do të delte se entitete tjera biznesore do të ishin jashtë këtij ligji, po e zëmë, dhe kjo terminologji duhet të përshtatet me Ligjin për organizatat biznesore, i cili është aplikativ e ai është ligj special, "jus specialis derogat jus gjenaris", do të thotë, ai ligj është parësor në krahasim me këtë, se ky është për tatim, ndërsa ai është Ligji për organizatat biznesore. E atje janë organizata biznesore edhe biznesi individual, ndërmarrja individuale, por më pastaj e dimë partnershipet që mund të jenë gjenerale e mund të jenë këso me përgjegjësi të kufizuara, pastaj edhe këto kompanitë apo shoqëritë aksionare me përgjegjësi të kufizuar, me përgjegjësi të pakufizuar dhe mikste edhe korporatat. Prandaj angazhohem që ky term të përshtatet me Ligjin për organizatat biznesore, i cili është në fuqi edhe është special.

Më pastaj, definimi i korporatës është problematike edhe nuk është i përshtatshëm, nuk është edhe i qartë dhe është tepër i gjatë. Do të duhej të merrej krejtësisht prej atij ligji- shkurt, prej ligjit që e përmenda. Janë disa terma që nuk ekzistojnë. Po e zëmë pronë e pa prekshme, që nuk ka pronë të paprekshme, ju lutem, pronë në sendet e prekshme, pronë në sendet e paprekshme. Sendi i paprekshëm është që për shembull emri, firma, sekreti tregtar e tjera e tjera, që është pronë, ama pronë në sendet e jo pronë e paprekshme. Në të tri gjuhët gabimisht, prandaj le të përmirësohet.

Më pastaj ky ligj trajton edhe definon të drejta pronësore, bile, bile jo qartë edhe mangët, prandaj do të duhej t'i referoheshin këto dispozita, ligjit, Kodit civil, ne nuk kemi Kodin civil, por kemi ligje civile ku me kompetencë definohet prona edhe format... Madje, madje aq gabimisht është dhënë definimi për pronën sa që aty praktikisht edhe qiraja, qira marrëdhënia inkorporohet që është usus fuctus, a nuk është pronë.

Neni 6, paragrafi 2, do duhej të fshihej po e zëmë. Pse? Për shkak se dihet fare mirë nga hyrja në fuqi e këtij ligji ky ligj aplikohet, ndërsa më parë nuk ka nevojë të thuhet se më parë do të aplikohet ajo dispozitë që ajo është një sentencë e njohur edhe nuk ka nevojë të thuhet fare, ose bie fjala vlerë e hapur e tregut. Çfarë është kjo vlerë e hapur e tregut? Vlera e tregut, kështu e njeh terminologjia bashkëkohore. Ky dokument do të duhej të kishte edhe një kaptinë që do t'u referohej sanksioneve, ju lutem, medoemos, sepse pas sanksione s' ka ligj. Ne mund të bëjmë ligje, mund të miratojmë, ama kur vjen puna të aplikimi, ne e dimë fare mirë se ka shumë entitete që nuk e përfillin ligjin, edhe më pastaj, çka? Kurrigjë. Pra, ligji dallohet nga norma morale, norma juridike, sepse e ka sanksionin. E përfill, në rregull, s'e përfill sanksion juridik. Natyrisht, kam edhe vërejte të tjera që shpresoj që në procedurë të ardhshme do të angazhohemi që të bëjmë modifikime të caktuara, përfundimisht e mbështesim këtë dokument. Ju faleminderit!

KRYETARI: Ju faleminderit, deputet Smaka!

Në emër të Lidhjes Demokratike të Dardanisë, deputeti Naser Rugova e ka kërkuar fjalën.

NASER RUGOVA: Të nderuar kolegë deputetë,
Anëtarë të Kabinetit qeveritar,

Ky projektligj ka për qëllim vendosjen e një tatimi gjithëpërfshirës mbi të ardhurat e korporatave në territorin e Republikës së Kosovës për të avancuar në këtë mënyrë sistemin tatimor në favor të krijimit të një ambienti më të favorshëm për investime, si dhe përafrimin e sistemit tatimor dhe i politikave fiskale, në përgjithësi, të Republikës së Kosovës me standardet dhe praktikën e Bashkimit Evropian.

Sigurisht që Projektligji i tatimit në të ardhurat e korporatave do të jetë më i avancuar edhe në disa aspekte të cilat trajtojnë çështjen e devidendës, amortizimit, dispozitat e borxhit të keq, si dhe disa dispozita të tjera të cilat janë më të avancuara, si për tatimpaguesit ashtu edhe për Administratën Tatimore të Kosovës, që sigurisht është institucioni kyç dhe përgjegjës për vjeljen e tatimeve në Kosovë.

Po ashtu, një element pozitiv në këtë projektligj është që parashihet edhe zgjerimi i të hyrave të përjashtuara për nënkontraktuesit ndërkombëtarë, që deri me tani nuk ka qenë praktikë në Kosovë, por ky ligj i ka edhe dobësitë e veta dhe duhet të caktohen edhe norma strikte në nene të veçanta.

Reformat e politikave tatimore janë domosdoshmëri e kohës, por ky ligj nuk paraqet ndonjë reformë esenciale, vetëm sa barazon tatimin e të ardhurave të korporatave me vendet e regjionit, kurse reforma e mirëfilltë e pakos së legjislacionit të politikave tatimore për stimulimin dhe krijimin e një ambienti të mirëfilltë për bizneset dhe investitorët, sigurisht që lë shumë për të

dëshiruar. Dhe, me këtë rast inkurajojmë sponzorizuesit e pakos së legjislacionit për një reformë substanciale të politikave fiskale në Kosovë, që kjo pako të vijë në Kuvendin e Republikës së Kosovës dhe të procedohet më tutje, sepse vërtet është shumë e nevojshme për funksionimin normal të bizneseve dhe për një ambient më të volitshëm, sidomos për investitorët e jashtëm.

Vlerësohet se kemi të bëjmë me një projektligj i cili nuk do të provojë efekte shtesë rreth administrimit dhe zbatimit në praktikë dhe në këtë kontekst, Buxheti i Kosovës nuk do të ndikohet. Edhe pse buxheti i Kosovës ka prirje që t'i zvogëlojë të hyrat e tij, reforma e politikave fiskale është domosdoshmëri. Kjo kërkohet edhe nga agjenda evropiane për Kosovën, por edhe krijon ambiente më të favorshme për biznesin, qarkullimin e lirë të mallit, kapitalit dhe sidomos për investimet e huaja direkte që priten të vijnë në Kosovë.

Përfundimisht, Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike të Dardanisë, mbështet në parim këtë projektligj si dhe kontributin tonë do ta japim gjatë procedurave të mëtejme në komisionet funksionale. Ju faleminderit!

KRYETARI: Ju faleminderit, deputet!

Në emër të Grupit Parlamentar "7+", Enis Krvan e ka kërkuar fjalën.

ENIS KRVAN: Ju faleminderit, zoti Kryetar!

Shirket gelirlerine verginin saptanması Yasa Tasarısı, Kosova Cumhuriyeti yöresinde şirket gelirlerine bütünlüklü bir verginin saptanmasını amaçlamaktadır, ki bu vergi sayesinde yatırımlar için daha elverişli koşulların sağlanması amacıyla vergi sistemine katkıda bulunmuş olacak, aynı zamanda Kosovanın vergi sistemi Avrupa Birliğinin standartları ve daha iyi pratikleriyle zenginleştirilmiş olacaktır.

Şirket gelirlerine verginin saptanması Yasa Tasarısı, amortizasyon, kötü borç hükümleri ve aynı zamanda vergi ödenekleriyle birlikte Kosova Vergi İdaresine de katkıda bulunacak konuları içeren bazı alanlar için de daha faydalı olacaktır.

Şirket gelirlerine verginin saptanması Yasa Tasarısı, aynı zamanda şirket gelirlerine ait şimdiki yasamasındaki bazı eksiklikleri de ortaya atmaktadır.

Bu Yasa Tasarısıyla, uluslararası sözleşmeciler için dışlandırılmış gelirlerin genişletilmesi de öngörülmektedir. Aynı zamanda Ahtisarinin Planıyla ve Kosovada dini özgürlüklerle ilgili Yasaya bağlı olan dini inançlar gelirleri için de özel indirimler mevcuttur. Böylece ister özel gelirler, ister de şirket gelirleriyle ilgili vergi yasası olanaklarına göre uyumlaştırılmıştır.

Dolayısıyla 7+ Parlamenter grubu bu Yasa Tasarısının ilk okunuşunu benimserken, katkılarını mevcut ana komisyonlarında sunacaktır.

Falemiinderit.

KRYETARI: Ju faleminderit, deputet!

Në emër të Grupit Parlamentar SLS, Mursel Halilaj.

MURSELJ HALJILJAJ: gospodine predsediče,

Vladin kabinet,

Dame i gospodo poslanici,

Parlamentarna grupa SLS-a prihvata ovaj nacrt zakona smatrajući da će se preciziranjem objekata i subjekata obaveznih prema porezu stvoriti potrebna disciplina, istovremeno će se stvoriti povoljni uslovi za investicije koje su neophodne za ekonomski razvoj Kosova. Naravno, tekst zakona ovog nacrt zakona sadrži i druge prihvatljive i pozitivne odredbe koje direktno utiču na poboljšanje ekonomske slike. Medjutim, ovaj nacrt zakona sadrži takodje i budžetska opterećenja koja nisu poželjna u ovom trenutku, medjutim ta budžetska opterećenja i te troškove

smatramo da su deo procesa ekonomskog razvoja. S toga, Parlamentarna grupa SLS-a će dati svoj doprinos u poboljšanju nacrta zakona kroz rad u funkcionalnim komisijama. Na kraju, ponavljam, Parlamentarna grupa SLS-a će u načelu podržati ovaj nacrt zakona. Hvala!

KRYETARI: Ju faleminderit, deputet!

Tani është radha e deputetëve. Kemi dy të paraqitur për debat, tash u bën tre. Myzejene Selmani, le të përgatitet Driton Tali.

MYZEJENE SELMANI: Ju faleminderit, zoti Kryetar!

Përsëritje për ministrat që janë prezentë dhe ministren, për të gjithë deputetët prezentë brenda kësaj seance,

Mund të them shumë qartë se ky projektligj në tatimin në të ardhurat të korporatave, është pjesë e pakos të ligjeve fiskale që është dashur të punohet dhe të vijë i kompletuar për stimulimin e bizneseve në tatimet direkte të korporatave dhe t'ju mundësojë ruajtjen e ambientit të mirë të bizneseve vendore dhe bizneseve të huaja të cilat donë të investojnë në Kosovë.

Në përgjithësi, mund të them se ka vend të bëhen disa përmirësime teknike, mirëpo është një projektligj që kaherë është dashur të vijë me të gjitha këto nene në të mirë të stimulimit të bizneseve kosovare dhe bizneseve të huaja të harmonizuara me rregullat dhe ligjet në rajon.

Mund të them edhe në emër personal edhe në emër të Grupit Parlamentar, se të gjitha mundësitë që mund të përmirësohet, çështjet teknike të ligjit, mund t'i jepen brenda Komisionit për Buxhet dhe Financa, mirëpo në përgjithësi është ligji i cili është dashur të vijë në këtë mënyrë për të mirën e bizneseve kosovare në Kosovë. Ju faleminderit!

KRYETARI: Ju faleminderit! Fjalën e ka deputeti Driton Tali dhe le të përgatitet deputeti i fundit Fatmir Rexhepi.

DRITON TALI: Ju faleminderit, zoti Kryetar!

Pa gjithë kësaj që u tha, desha të ndalem vetëm në dy pika, në realitet tri pika. E para, siç po shihet, edhe ashtu veç u cek se ky ligj, projektligj në realitet, është një përmbledhje e rregullave dhe udhëzimeve administrative që i kemi pasur deri më tani. Kjo shihet edhe në përmbajtjen e këtij projektligji. Ajo që të bie në sy, është terminologjia, që duhet dikush që merret vesh në këto gjëra, një ekspert, t'ia hedhë edhe një herë një sy për shkak se ka disa devijime në terminologji nga anglishtja në shqip dhe nga shqipja në anglisht, e cila ta vret syrin. Shihet se këtë projektligj e ka përkthyer përkthyesi i zakonit, domethënë jo ai që ekonominë e ka profesion, ndonëse ne që merremi me ekonomi, kemi problem me këtë standardizimin e terminologjisë edhe një kohë të gjatë jemi munduar ta standardizojmë, por përkundër kësaj, ka lëshime që besoj që edhe, zoti ministër, pajtohet me atë. Duhet t'i bëhet edhe një rishikim, si për shembull "cost" përdoret në vend të "expenses" disa herë e tjera e tjera, pastaj me amortizim e tjera e tjera.

Për të mos ju lodhur, çështja tjetër që desha ta prek, u prek në njëfarë mënyre, është puna e tatimit të paragjykuar 3%-shi dhe 5%-shi për korporatat nuk shkon. Unë e kam parasysh se ky tatim është bërë menjëherë pas luftës për shkak të nevojave që na janë paraqitur, por ne duhet ta ndajmë ose t'i themi biznes personal, pra, "sojfeldel", atëherë automatikisht këto ndërmarrje për shkak se biznesi identifikohet me pronarin dhe pronari me biznesin, lirohen nga tatimi i korporatës, për shkak se ata edhe ashtu paguajnë tatim në të ardhura, domethënë tatim i dyfishtë për shkak se ndërmarrjen e cila edhe ashtu i bën qarkullim apo të ardhura nën 50.000 euro, nuk mund ta karakterizojmë si korporatë, por nëse donë aksionarët që t' i ikin përgjegjësisë, atëherë le t' i nënshtrohen ligjeve të zakonta si çdo kund në botë.

Çështja tjetër që desha ta shtroj këtu, e që në njëfarë forme edhe nga parafolësit u prek disi, është Ligji për pushimet tatimore. Unë do të inkurajoja Qeverinë që ta krijojë sa më shpejtë grupin e ekspertëve për shkak se tashmë është edhe kërkesë e biznesit, gjërat kanë ndryshuar që nga pas lufta, në vitet 2002-2003, nuk ishte UNMIK-u i interesuar për këtë iniciativë për shkak se mendonin se për një gjë të tillë ende Kosova nuk është përgatitur, por tash është veç kërkesë edhe e biznesit që të fillojmë me këtë benificion për bizneset për shkak se edhe rajoni veç është duke i aplikuar këto pushimet tatimore dhe mos të mbesim mbrapa, sidomos në atë garën për thithjen e investimeve të huaja.

Unë shpresoj se së shpejti Qeveria do ta krijojë grupin e ekspertëve të cilët do të merren me... ambientin dhe nuk do ta bëjnë gabimin siç e bënë tash rishtazi me këtë Udhëzimin administrativ 07-2009 për importimin e produkteve të mishit, por ta nxjerrim një projektligj i cili do t'i shërbejë ekonomisë së Kosovës.

Unë edhe një herë po apeloj te Qeveria, që sa më shpejt të na sjellin këtë ligj, i cili do ta kompletonte Ligjin për të ardhurat e korporatave. Ju faleminderit!

KRYETARI: Ju faleminderit!

E ka fjalën deputeti Fatmir Rexhepi

FATMIR REXHEPI: Ju faleminderit, zoti Kryetar!

Kolegë deputetë,

Të nderuar ministra,

Unë kam lexuar këtë projektligj për tatimin e të ardhurave të korporatave për shkak të materies që përfshinë dhe rëndësisë së veçantë që ka për çështjet që mbulohen nga ky projektligj, prandaj vlerësimi im në parim është se aty kodifikohen pra 31 fusha të veprimit, të cilat shumë mirë edhe definohen, strukturoren, duke i ndarë do të thotë të gjitha pjesët e saja që kanë rëndësi të madhe për sistemin ekonomik.

Unë, me këtë rast dua t'ia jap, do të thotë një vlerësim shumë të mirë edhe vetë ministrit dhe Ministrisë për këtë projektligj, sepse është një hap i mirë për politikën e nevojshme që duhen dhe strategjitë e reja në sistemin tatimor. Po e përfundoj me atë vlerësimin duke e përkrahur në parim, sepse vërtet ky projektligj mundëson një mjedis atraktiv për korporatat, për biznesin dhe investimin, qoftë të ndërmarrjeve vendore- korporata apo të atyre të huaja, prandaj, i jap përkrahje të plotë këtij projektligji. Ju faleminderit!

KRYETARI: Ju faleminderit!

Në vazhdim kërkohet deklarimi me votim për miratimin në parim të Projektligjit. Lus deputetët dhe regjinë të përgatiten për votim. Votojmë, tash.

Ju njoftoj se prezentë janë 64, 65 deputetë.

Konstatoj se me 54 “për”, 8 “kundër”, 3 abstenime, Kuvendi miratoi në parim Projektligjin për tatimin në të ardhurat e korporatave.

Në bazë të Rregullores së Punës së Kuvendit, ngarkohen këto komisione:

- Komisioni për Buxhet dhe Financa, si Komision funksional,
- Komisioni për Legjislacion dhe Gjyqësi,
- Komisioni për Komunitete, dhe
- Komisioni për Integritet Evropian

Komisionet duhet, që brenda 2 muajve nga shqyrtimi i parë, Kuvendit t'ia paraqesin raportin me rekomandime. Ju faleminderit!

Kalojmë në pikën e radhës:

- Shqyrtimi i parë i Projektligjit për miniera dhe minerale

Në bazë të Rregullës 35, pika 1 të Rregullores së Punës së Kuvendit, janë përmbushur kushtet që shqyrtimi dhe miratimi në parim i këtij ligji.

JUSTINA SHIROKA- PULA: I nderuar, zoti Kryetar!

Të nderuar deputetë, ministra

Kam nderin dhe kënaqësinë që në emër të Qeverisë së Republikës së Kosovës, t'ia paraqes Kuvendit për miratim Projektligjin për miniera dhe minerale.

Ligji synon ta krijoj bazën ligjore të nevojshme dhe të përshtatshme për zhvillimin e sektorit mineral. Ai ka për qëllim promovimin e aktiviteteve minerare të hulumtimit, shfrytëzimit dhe pasurimit të mineraleve, inkurajimin, nxjerrjen e investimeve dhe sektorin mineral, zhvillimin dhe modernizimin e këtij sektori në kushtet e ekonomisë së tregut, bazuar në konkurrencë dhe iniciativën e lirë, në përputhshmëri me standardet e pranuar mjedisore dhe ato të sigurisë në punë. Ajo mundëson administrimin e të dhënave minerare dhe gjeologjike, përfshirë mënyrën, e aktivizimit dhe të shfrytëzimit të dhënave gjeo-shkencore.

Struktura normative dhe përmbajtja e ligjit është në 14 pjesë dhe gjithsej 88 nene që përbëhet nga dispozitat, qëllimin, fushën e veprimit, përkufizimet dhe dispozitat e përgjithshme për Sektorin e Minerave dhe Mineraleve, licencat për hulumtim, licencat për mbajtjen e të drejtave, licenca për shfrytëzim, lejen për aktivitete të veçanta, shfrytëzimin xehetar, tantimat dhe taksat, Komisionin e Pavarur të Minerave dhe Mineraleve, Inspektoratin për miniera dhe minerale, Shërbimin Gjeologjik të Kosovës, sigurinë në punë dhe mbrojtjen e mjedisit dhe dispozitat për mjetet ndëshkimore, depozitat e përkohshme dhe përfundimtare.

Ligji që ju do ta miratoni, përcakton kuadrin ligjor, institucional dhe administrativ për ushtrimin e të drejtave minerare. Ai vendos parimet e përgjithshme të marrëdhënieve midis shtetit dhe personave juridikë e fizikë lidhur me mënyrën e dhënies së lejes minerare, hulumtim, shfrytëzim dhe pasuri.

Ligji parashikon procedura të thjeshta dhe të favorshme për tërheqjen dhe garantimin e investimeve të huaja dhe vendore në aktivitetin mineral. Ligji për miniera dhe minerale do të zëvendësoj Rregulloren e UNMIK-ut, numër 2005/3 dhe ish-Rregulloren e UNMIK-ut, numër 2005/2.

Eksperienca në aktivitetin mineral për periudhën 2000-2008, ka nxjerr në pah një mori problemesh, zgjidhja e të cilave nuk mund të arrihet me Rregulloren e UNMIK-ut. Konkretisht ky ligj, në ndryshimin nga rregulloret e UNMIK-it, do të mundësojë krijimin e një vizioni afatgjat dhe planifikimin strategjik në kuadër të një strategjie minerale, afatgjate dhe planeve për zbatimin e saj, kryerjen e reformave të domosdoshme dhe ristrukturimin e sektorit, në mënyrë që të mundësohet tërheqja e investimeve nëpërmes të partneritetit në të mirën e Kosovës.

Po ashtu, krijimin e Shërbimit Gjeologjik të Kosovës, institucion ky i rëndësishëm me rëndësi të veçantë që e kanë të gjitha shtetet në botë- gati, kujdes të veçantë për trajtimin e atyre resurseve të mëdha, që ne me ligj i kemi kategorizuar si zona me interes të veçantë, me synim të maksimizimit të benefiteve për Kosovën.

Përmirësimi dhe plotësimi i vazhdueshëm i kuadrit ligjor, është një nga sfidat e rëndësishme me të cilën përballlet zhvillimi i sotëm dhe i ardhshëm i sektorit mineral. Me miratimin dhe më pas me aplikimin e këtij ligji, Sektori mineral do të zhvillohet sipas parimit të pronësisë së shtetit për minierat dhe mineralet në përputhje me parimet e ekonomisë së tregut të lirë dhe standardeve evropiane.

Zbatimi i këtij ligji kërkon përgatitjen dhe miratimin e një numri të aktesh nënligjore, të cilat do të rregullojnë vendosjen e parametrave normale për ruajtjen dhe rehabilitimin e mjedisit, harmonizimin e interesave të administratave, subjekteve private, vendore dhe të huaja.

Projektligji që ju do ta miratoni, është në përputhje me praktikën më të mirë evropiane të këshilluara për ne edhe nga ekspertët ndërkombëtarë dhe vendor.

I nderuari, zoti Kryetar!

Të nderuar deputetë,

Duke qenë të vetëdijshëm për rëndësinë e këtij projektligji, ju propozoj që ta miratoni në parim. Ju faleminderit!

KRYETARI: Ju faleminderit!

Në emër të Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike, fjalën e ka kërkuar deputetja Sala Berisha- Shala.

SALA BERISHA- SHALA: Ju faleminderit, zoti Kryetar!

Të nderuar Kabinet qeveritar,

Zonja ministre e Energjisë dhe e Minierave,

Kolegë deputetë dhe të gjithë ju të pranishëm,

Kosova ka një potencial të konsiderueshëm të mineraleve të dobishme, të hulumtuara e të pa hulumtuara në shkallë të duhur si parakusht për shfrytëzimin e tyre për një zhvillim afatgjatë e të qëndrueshëm.

Resurset minerale, pavarësisht nga prejardhja e tyre, forma ose gjendja fizike, që gjenden në brendësi të tokës apo në sipërfaqe të saj, brenda territorit të Republikës së Kosovës, janë pasuri e Republikës së Kosovës. Strategjia afatgjatë e çdo shteti mbështetet në pasuri minerale, përderisa shteti posedon me to.

Të nderuar deputetë,

Edhe pse Kosova ka një traditë të gjatë në shfrytëzimin e resurseve minerale, si dhe një fuqi të re punëtore dinamike, rrethanat e tanishme na obligojnë që kësaj pasurie të dhuruar nga natyra, t'i krijojmë kushte për shfrytëzim dhe menaxhim të suksesshëm të këtij potenciali për një zhvillim ekonomik të qëndrueshëm. Përndryshe, tani Ministria e Energjisë dhe e Minierave, veç po përmbush obligimin e saj në ndërtimin e një infrastrukture ligjore për qëllimin e këtij segmenti.

Një ndër parakushtet është edhe infrastruktura ligjore që t'i shfrytëzojmë këto minerale me një efikasitet të duhur, prandaj pretendimi i këtij projektligji për miratim është më se i domosdoshëm. Sot, pra, kemi në shqyrtim të parë Projektligjin për miniera dhe minerale, të cilin projektligj Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës, e ka debatuar dhe analizuar me kujdes.

Pavarësisht disa mangësive që e përcjellin projektligjin në fjalë, Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës e mbështet në parim, veç tjerash, edhe për këto arsye. Duke pasur parasysh domosdoshmërinë e ndërtimit dhe avancimit të infrastrukturës ligjore në lëmin e

gjeologjisë dhe minierave, me qëllim promovimi, e në përputhje me standardet e pranuar mjedisore, duke e ditur çfarë qasje kanë pasur institucionet tona vendore në lidhje me këtë segment.

Minierat dhe pasuritë minerale në Kosovë, kanë qenë në kompetencë hermetikisht e rezervuar e UNMIK-ut. Ky projektligj e zëvendëson Rregulloren e UNMIK-ut, pra, kemi të bëjmë me një ligj bazik në këtë segment. Përpjekjet për ta ndërtuar një infrastrukturë ligjore në këtë sektor nuk kanë munguar as në mandatin e kaluar, pra është një vazhdimësi institucionale ky projektligj, siç e thashë më parë, meqë rregullon një fushë gjer më tani e rezervuar. Në mandatin e kaluar po ua përkujtoj në vitin 2005, ky projektligj i ka kaluar të gjitha procedurat e miratimit në Kuvend, por ka pasur fatin të ngelë në sirtarët e PSSP-së në pritje për nënshkrim.

Tani draftin që e kemi në shqyrtim, natyrisht se ka ndryshime dhe risi shumë të avancuara, konform rrethanave, me që dihet se tani Kosova është shtet i pavarur dhe sovran. Duke qenë të vetëdijshëm për këtë fakt, le të na shërbej si një argument i fuqishëm që ta shpejtojmë procedimin e tij duke i dhënë mbështetje në parim për t'i hapur rrugë plotësimit dhe përmirësimit të këtij drafti në fazën në fazën e amendimit.

Ajo që është me rëndësi të ceket se në projektligj është paraparë edhe themelimi i Shërbimit Gjeologjik të Kosovës. Ne mendojmë se një institucion i tillë, siç është Shërbimi Gjeologjik i Kosovës, duhet të themelohet me një ligj të veçantë, sepse në draftin që e kemi përpara, shumë përciptazi bëhet themelimi i tillë, një përshkrim i përciptë.

Qeveria parashikon që zhvillimi i ardhshëm i shpejtë dhe i qëndrueshëm i Kosovës të mbështetet në shfrytëzimin dhe përpunimin e resurseve minerale. Miratimi i këtij projektligji, do t'i hapë rrugë interesimit të investitorëve serioz në këtë sektor.

Përparësitë e këtij ligji i vërejmë edhe tek tantiemat dhe taksat, të cilat në atë kapitull rregullohen-tantimet dhe taksat, i jepet mundësi edhe Kuvendit të bëjë ndonjë ndryshim apo plotësim në listë, në qoftë se e sheh të nevojshme dhe të domosdoshme. Ka edhe plot përparësi të tjera, në mënyrë që ta kursejë kohën se i kini të gjithë në draftin që e kemi përpara. Pavarësisht nga kjo, nga ana tjetër Grupi Parlamentar i PDK-së, ka identifikuar edhe një sërë çështjesh të paqarta që e shoqërojnë projektligjin në fjalë.

Ne, gjatë fazës së amendimit, në Komision Parlamentar, mendojmë ta sqarojmë se ç'është licencë diskrecionale e cila nuk është shumë e qartë në projektligj. Mandej, Ministria dhe KPMM-ja nxjerrin akte nënligjore, thuhet në një kapitull, por mbetet e paqartë se kush do t'i nënshkruajë këto akte nënligjore. Mandej, aktivitetet e kufizuara, në bazë të përvojës së gjertanishme, duhen të precizohen, të caktohet një distancë duke përfutur nga përvojat, jo siç është e paraparë këtu 60 metra, që nuk është mirë e përcaktuar.

Neni 84.4, licenca për minerale – energjetike është e paqartë, ashtu siç jepet. Thuhet të sigurohet interesimi i tenderuesve, por nuk përmendet interesi i Kosovës. Nuk sqarohet mënyra e dhënies me koncesion të minierave dhe mineraleve, domethënë, të sqarohet mundësia e partneritetit publiko-privat në miniera dhe minerale, përderisa në Ligjin për partneritet publiko-privat dhe koncesione, është paraparë përjashtimi për miniera dhe minerale me qëllim që procedurat e dhënies së partneritetit publiko-privat ose koncesionet të rregullohen në mënyrë të veçantë tek Ligji për miniera dhe minerale. Andaj, ndoshta kjo është një shmangie e paqëllimtë, aty është përmendur se kanë menduar se kjo çështje është e rregulluar me Ligjin e koncesioneve. Prandaj, mendojmë se kjo çështje duhet të rregullohet në mënyrë më specifike. Me fjalë të tjera, duhet të bëhet harmonizimi i Projektligjit për miniera dhe minerale me Ligjin për partneritet publiko-privat.

Në ligj i kemi të paqarta dhe raportet rreth KPMM-së dhe Ministrisë së Energjisë dhe Minierave, që janë shumë të padefinuara. Një kapitull i veçantë, siç e ceka edhe më parë është Shërbimi Gjeologjik i Kosovës, i cili duhet të jetë profesional dhe jo të jetë servis i Komisionit të Pavarur për Miniera dhe Minerale.

Nëse analizohet me kujdes neni 75 i këtij projektligji, krijohet dilema a ka pasur gjeologë në Grupin punues, nëse po, atëherë vihet në pikëpyetje kontributi i tyre profesional apo më tepër kanë dominuar interesat personale mbi interesat profesionale dhe interesat e përgjithshme të Kosovës.

Duke e ditur se pjesa e Grupit punues, janë pozicionuar më tepër në interesin e vendit të punës të cilin e kanë për momentin në një institucion tjetër, jo në Ministrinë e Energjisë dhe Minierave, unë befasonem se si nuk e kanë marrë parasysh ata gjeologë një dokument shumë të rëndësishëm që i është servuar Kosovës në vitin 2005, një dokument që e ka dhënë Shërbimi Gjeologjik britanez i ashtuquajtur Këshillë për themelimin e Shërbimit Gjeologjik të Kosovës ku thuhet: “Shërbimi Gjeologjik britanez fuqishëm rekomandon krijimin e një shërbimi gjeologjik të Kosovës, transparent dhe të pavarur, të modeluar sipas normave evropiane, duke pasur misionin si në vijim: Shërbimi Gjeologjik i Kosovës ofron këshillat e pa anshme gjeo-shkencore, të cilësisë së sigurt dhe informata për partnerë të shumët, përfshirë Qeverinë, opinionin publik dhe industrinë”. Me fjalë të tjera, Shërbimi Gjeologjik është ofrues kombëtar i një shërbimi informativ gjeo-shkencor.

Menaxhimi i informatave është një ndër prioritetet e para të Shërbimit Gjeologjik të Kosovës, dhe kjo gjë mendojmë se është tepër esenciale për vendimmarrjen në politikat publike. Ky rekomandim është bazuar në mënyrën jo efikase dhe jo efektive në të cilën zbatoheshin gjeo-shkencat në Kosovë dhe rolin në të cilin do ta luante Shërbimi Gjeologjik i Kosovës në tërheqjen e investimeve të huaja direkte në sektorin e burimeve natyrore të Kosovës, si dhe në plotësimin e nevojave të vendit, si për shembull cilësia e ujit... kërkesat e Qeverisë, e tjera.

Mandej te neni 59.3, për mua është e paqartë si mund t’u vazhdohet mandati atyre anëtarëve të Bordit, të cilët nuk ju kanë nënshtruar vullnetit të Kuvendit. Më tutje vazhdojmë, po te Bordi i KPMM-së, tek pagat. Ata propozojnë që pagat ta kenë nivelin e pagave të ministrave. Dhe, unë mendoj që këtë paragraf duhet hequr fare, sepse pagat janë të rregulluara me ligje të tjera.

Krejt në fund, ne si Grup Parlamentar e përkrahim në parim dhe i ftoj të gjithë ata që mund të kontribuojnë diçka në këtë drejtim gjatë fazës së amendamentimit në Komisionin Parlamentar. Pra, ne mendojmë që ta organizojmë edhe një dëgjim publik, që të inkorporojmë edhe imputet e profesionistëve, të cilët nuk janë të paktë në Kosovë. Ju faleminderit!

KRYESUESI XHAVIT HALITI: Ju faleminderit!

Në emër të Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike të Kosovës, deputeti Fatmir Rexhepi.

FATMIR REXHEPI: Ju faleminderit, zoti kryesues!

Kolegë deputetë,

Të nderuar ministra,

Pas leximit me kujdes dhe debatit në Grupin Parlamentar të Lidhjes Demokratike të Kosovës, unë po e përcjell vlerësimin në parim për Projektligjin për miniera dhe minerale, nën një se rëndësia e tij është shumë e madhe për jetën ekonomike të vendit.

Nën dy, vlerësimi ynë është se shumë mirë është i strukturuar brenda 14 kapitujve dhe 88 neneve të cilat janë të përfshira në këtë projektligj.

Drafti i ofruar, kodifikon autoritetet përgjegjëse dhe mbikëqyrëse si dhe rregullat dhe procedurat në hulumtimin, shfrytëzimin dhe përpunimin e resurseve minerale, në pajtim me standardet mjedisore të cilave duhet t'u përmbahen të gjithë ata të cilët merren me këtë veprimtari. Projektligji vlerësohet i rëndësishëm së veçantë për vetë fushën që mbulon nga pikëpamja e potencialeve ekonomike, impakteve zhvillimore dhe të investimeve të pritshme në përpunimin e mineraleve metalike, atyre industriale, mineraleve kimike e ndërtimore, ujërave si dhe resurseve të tjera gjeo-termale.

Projektligji inkorporon po ashtu apo përcakton funksionet e një organizimi të ri të kompetencave, pra i bart përgjegjësitë edhe të Komisionit për Miniera dhe Minerale në fushën e shfrytëzimit të resurseve dhe lëshimin e licencave si dhe lejeve për këtë veprimtari. Po ashtu, në draftin e ofruar themelohet apo është përcaktuar edhe themelimi dhe detyrat e Inspektoratit për miniera, autoritetet me shumë rëndësi në inspektimin e aktiviteteve të subjekteve të licencuara për shfrytëzimin e resurseve minerale, që kur e kemi pasur raportin e Agjencionit të Pavarur, mendoj që ka munguar një aktivitet i tillë dhe pasojat janë reflektuar pastaj në ambientin dhe në shfrytëzimin ilegal të këtyre resurseve, andaj ky inspektorat do ta ketë një rol shumë të madh në përcjelljen e këtyre veprimtarive.

Është mirë njëkohësisht se projektligji parasheh që Ministria përkatëse, në këtë rast, Ministria e Energjetikës dhe Minierave, të përgatitë po ashtu strategjinë minerale dhe planin për menaxhimin e resurseve minerale si dhe themelimin e Shërbimit Gjeologjik të Kosovës. Pra, kjo është një çështje e cila po kërkohet nga Ministria dhe unë mendoj që është përfshirë këtu.

Tri vërejtjet tona në parim do të ishin. E para, lidhur me afatin kohor që përfshihet në nenin 18, lidhur me licencat 25 dhe të tjerat që janë përjashtuese deri në 40 vjet. Pra, të shikohet një mundësi e cila do të ishte një praktikë më e mirë, kur kemi parasysh, qoftë në fushën e mineraleve apo të energjetikës, e cila është një aneks i veçantë brenda këtij projektligji, pra, të debatohet dhe të shihet vërtet cili do të ishte afati më i mirë. E dyta, në parim do të ishte, bie fjala, ndoshta, mund të jetë edhe teknikisht ndonjë gabim- zonë me interes të veçantë pra, mund të caktojë, në këtë rast thuhet në projektligj- ministri, nuk e di a është me vend apo duhet pak më ndryshe kjo të kodifikohet Ministria, Qeveria apo Asambleja e dikush tjetër? Dhe, e treta, ajo që u tha nga kolegja pak më herët, pra, të harmonizohet në projektligjet që kanë kaluar para pak ditësh këtu në Parlament, sikur që u përmend Projektligji për partneritetin publiko-privat. Pra, unë mendoj që ka rëndësi që këto të debatohen.

Prandaj, Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike, e vlerëson dhe e përkrah në parim, në anën tjetër, pra gjatë procedimit do t'ia japim kontributin tonë në komisionet profesionale, që vërtet ky projektligj që po e kodifikon këtë materie shumë të rëndësishme për çështjet ekonomike, me të vërtetë të jetë një ndër projektligjet, do të thotë të del sa më i mirë. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit, deputet!

Në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, deputeti Ardian Gjini.

ARDIAN GJINI: Ju faleminderit, kryesues!

Zonja ministre,

Zoti ministër,

Ne në Grupin Parlamentar të Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës mendojmë se ky është një ligj administrativ, një ligj i cili rregullon aspekte administrative për diçka që, që në fjalën e parë e

quajnë aspekt strategjik për Kosovën, aspekt esencial, miniera, minerale, Kosova plot me miniera.

Nuk i kemi marrë disa përgjigje të para ose disa sugjerime të para fillimisht të cilat duhet të merren. Për shembull, cili është qëllimi i ligjit, është më tepër ajo që shpjegohet në memorandumet shpjeguese, është më tepër piktoreske, është diçka shumë përshkruese gati poetike, ama cili është qëllimi i ligjit? A duam t'i përdorim më shumë mineralet, a dom t'i përdorim më pak, a dom t' i konservojmë? Cili është qëllimi, do të thotë, këto qëllime në vendet sikur Kosova, mund të shpjegohen me dy fjali, me dy ose me tri fjali.

Kolegë të nderuar deputetë, nuk i keni këto fjali në memorandumin shpjegues. Edhe e gjithë materia e projektligjit nuk ju bind se çka dom ne si Kosovë të mbërrimë me këtë projektligj, i cili është një ndër projektligjet më voluminoze. Çka dom të mbërrimë ne, cili është qëllimi? Do të thotë pyetja e parë që ne nuk e dimë, në esencë nuk e kemi, të paktën nuk kemi eksplicit, çka dëshiron Kosova të mbërrijë me këtë ligj?

Çështja tjetër, kur shpjegohet Projektligji, të paktën është koha që Kosova ta **elevojë** veten, Qeveria e Kosovës ta ngritë veten në nivelin që të tregojë se çka ndodhë ditën e nesërme kur ligji bëhet i plotfuqishëm? Shembull ta marrim, ne e aprovojmë sot, e aprovojmë në lexim të dytë me amdneamente, nënshkruhet prej Presidentit të Kosovës, në momentin kur del në Gazetën Zyrtare dhe është i plotfuqishëm, çka ndodhë në Kosovë? Çka ndodhë në momentin kur ligji është i plotfuqishëm? Mund të thotë dikush fillojnë për t' u eksploruar minierat, tatimi është kaq, ama duhet ta kemi të qartë ne çka ndërron situata prej kësaj që e kemi sot, që ekziston, që është ekzistuese, çka ndodhë në momentin kur ligji është i plotfuqishëm? Nuk e kemi asnjë shpjegim në memorandum, në cilindo prej pjesëve të memorandumit, ama nuk e kemi asnjë shpjegim as nga fjala e ministres, ama as Projektligji si i tillë nuk na lënë për të kuptuar se çka ndryshon në Kosovë, në momentin kur projektligji bëhet i plotfuqishëm? Edhe njerëzit, e dini ju që shumë njerëz në Kosovë janë drejtpërdrejt të lidhur në aspektin e minierave, kemi shumë minatorë që kanë punuar, familje të tyre, kooperantë. Ata donë ta dinë nëse Kuvendi i Kosovës, organi më i lartë ligjdhënës i Kosovës e aprovon një ligj të tillë, çka ndryshon në Kosovë? Po ju them të drejtën, asgjë. Me këtë ligj asnjë gjë e vetme vetëm sa rregullohen aspekte administrative se si ka për t' u sjellë Ministria ndaj aspekteve që kanë të bëjnë me minierat, por jo në esencë? Nëse dikush di le të më tregoj çka ndodh në momentin kur ligji aprovohet? Kur ligji aprovohet, janë tri ose katër aspekte për të cilat duhet të mendohet. Çka ndodhë menjëherë, cilat institucione të reja krijohen, cilat nuk krijohen, cilat tatime rriten, cilat ulën, cilët njerëz hyjnë në punë, cilët dalin prej pune, çka bënë Ministria, ama janë edhe aspektet afatmesme dhe afatgjata? Çka ndodhë në një afatmesëm, shembull ta marrim 4 ose pesë vjet nëse ky ligj hyn në fuqi dhe çka ndodhë për 10, 15 ose 30 vjet kur ky ligj hyn në fuqi. A din dikush prej jush, a ka ndonjë shpjegim se çka ndodhë? Asnjë shpjegim, absolutisht, fare është ngrirje e situatës edhe është një ligj krejt i kotë, një ligj absolutisht pa asnjë efekt të drejtpërdrejtë në jetën e njerëzve, në punën e minierave tona, ndoshta vetëm sa shkakton edhe pak më tepër konfuzitet.

Po them edhe një herë, ne nuk e mbështesim këtë ligj për shkak se vetëm rregullon aspekte administrative dhe procedurale dhe askush nuk e din se si ka për të ndikuar drejtpërdrejt në jetën e njerëzve. Dhe, i lus deputetët e Kuvendit të Kosovës, nuk kemi nevojë, nuk është fyerje as për Qeverinë as për Kuvendin, nëse nganjëherë themi mos e apromoni, të kemi debat për një ligj kaq voluminoz, duhet të ketë debat në Kosovë, më tepër debat, e di se ka pasur, por mund të ketë më tepër debat, dhe në fund të fundit, ministrat kur vijnë para nesh këtu, duhet të na tregojnë çka ndryshon në Kosovë, në momentin kur aprovohet ligji, e jo vetëm të vijnë thonë e kemi ndryshuar ligjin... Paramendoni ju çfarë shpjegimi kur të vjen ministrja e na tregon sa nene i ka ligji, po ne e lexojmë ligjin, ne e dimë sa nene i ka, e dimë sa kapituj.

Edhe një herë po e përsëris qëndrimin e AAK-së, nuk e mbështesim Ligjin, nuk besojmë se do të ndërrojë diçka pozitivisht në Kosovë, do të jetë i dëmshëm dhe mendojmë se duhet të ketë debat shumë më të gjatë për këtë ligj. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit!

Në emër të Grupit Parlamentar të AKR-së, Myzejene Selmani.

MYZEJEJE SELMANI: Ju faleminderit, zoti kryesues!

Para se të diskutoj, do të tërheq njëherë një vërejtje, pikë së pari, pasi që kërkoja fjalën më parë edhe në emër të komisionit, por nuk mu dha, dhe për atë mund t'ju falënderoj, mbasandaj mos kërkonit shumë punë prej komisionit, në rast se nuk i jepet fjala kryetares së komisionit. Do të flas në emër të AKR-së,

Përshëndetje për ministren dhe për dy ministret dhe ministrin që është prezent dhe të gjithë deputetët brenda kësaj seance.

Duke marrë parasysh rëndësinë e Ligjit për miniera dhe minerale, Grupi Parlamentar i AKR-së, ka shqyrtuar këtë projektligj duke ditur arsyen se ky projektligj është i një rëndësie të madhe për Kosovën dhe ka ardhur në përfundim se ligji ka mangësi të mëdha, mirëpo të gjitha këto mangësi apo vërejtje do t'i përmend këtu, ndërsa Grupi Parlamentar i AKR-së në parim e përkrah këtë projektligj për arsye të zhvillimit të ekonomisë së Kosovës. Por, pasi ministrja është këtu prezent, unë do t'i them vërejtjet e mia në këtë projektligj një nga një.

Pikë së pari ky projektligj bazohet në strategjinë minerale, ku duke marrë parasysh se atë strategji ende Ministria e Energjisë dhe e Minierave nuk e ka sjell në Kuvendin e Kosovës.

Shtrohet pyetja se si do të rregullohet me këtë projektligj raporti KPMM dhe MEM, ku kompetencat e KPMM-së përfshihen direkt në këtë projektligj, duke ditur se me pakon e Presidentit Ahtisari, Rregullorja e UNMIK-ut është kthyer në ligj për KPMM-në? Dallimet janë ndërmjet lejes dhe licencës, është shumë i pa definuar, ministre. Licencat për shfrytëzim janë shumë pikëpyetje se kush duhet të kujdeset për to. Nuk di si do të nxirren aktet nënligjore kur dihet se këtu, në këtë projektligj, ka një jo harmonizim ndërmjet MEM-it dhe KPMM-së. Çështja e pengut të licencave është shumë e paqartë, si mund të kryhet çështja e pengut të licencave? Kush vendos për bartjen e të drejtës së licencës brenda KPMM-së?

Vërejtje tjetër është dhënia e licencës me konkurrencë jo shumë e qartë e definuar në nen. Qeveria duhet të shpallë zonë të veçanta e jo Ministria ku është potencuar se Ministria duhet të shpallë zonë të veçantë.

Duhet të vendosen rregullat e tenderimit e jo të vendosen rregullat e tenderimit me një komisioni ad-hoc. Mund të them me një përgjegjësi shumë të madhe se gjatë shqyrtimit të këtij projektligji, dhënia me koncesion e minierave, duke marrë parasysh se para dy javëve është miratuar Projektligji për partneritetin-publiko-privat dhe koncesione dhe në atë projektligj nuk janë përfshirë minierat, atëherë do t'ia ofroja një mundësi ministres që gjatë amendamentimit në Komision, të gjithë të japim mundësitë më të mëdha që të bëhet harmonizim dhe njëkohësisht të merret një vendim kur është çështja e dhënies së minierave me koncesion apo me partneritet-publiko-privat, absolutisht nuk është e qartë të merren vendime brenda këtij Kuvendi të Kosovës, si organi më i lartë.

Me të gjitha këto vërejtje, prapëseprapë për arsye të rëndësishme të veçantë të këtij projektligji, AKR-ja përkrah në parim këtë projektligj. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit!

Në emër të Grupit Parlamentar të LDD-së, Qamile Morina.

QAMILE MORINA: Ju faleminderit zoti, kryesues!

Ministra,

Deputetë të nderuar,

Projektligji për minerale dhe miniera, padyshim paraqet projektligjin më të rëndësishëm në sferën ekonomike dhe të prodhimit material të Republikës së Kosovës, andaj, me të drejtë paraqet Kushtetutën e ekonomisë kosovare. Është pritur që ky projektligj të jetë më efikas, me qartësi të nevojshme, pa përsëritje, pa retorikë dhe operativisht të jetë i aplikueshëm.

Projektligji mundëson mos efikasitet, neglizhencë dhe sjellje burokratike të KPPM-së, duke zvarritur me muaj të tërë dhe deri në 6 muaj dhënien e përgjigjes, gjegjësisht lejes – licencës, pas kompletimit të dokumentacionit nga institucioni publik..

Projektligji për miniera dhe minerale, është projektligj, nuk përmban rregullativë për miniera ose shumë pak dhe në këtë mënyrë merr nocionin e Ligjit për miniera, më falni, domethënë për miniera -është më tepër për minerale se sa për miniera.

Projektligji njëkohësisht tenton t'i rregullojë çështjet e lëndëve të para minerale, por njëkohësisht abstrakton lëndën energjetike si monopol i administratës pa një strategji të shfrytëzimit të resurseve energjetike.

Projektligji përpunon propozimin e tenderit dhe formimin e komisioneve të tenderimit dhe përcakton dhënien e licencës për shfrytëzim të resurseve energjetike brenda 30 ditësh, ndërhyrje në punët e Agjencionit të Pavarur. Ne mendojmë që më efikase dhe e qëndrueshme do të jetë, që tenderimi, formimi i komisioneve për tenderë dhe propozimi për dhënien e licencës të rregullohet me një ligj të veçantë, sepse kjo nuk është detyrë e përhershme që të përfshihet në këtë ligj.

Projektligji parasheh KPMM-n si organ, i cili nga aspekti gjyqësor dhe aplikativ nuk është i qëndrueshëm ngase me Kushtetutë kërkohet themelimi i agjencionit të pavarur e jo komisioni. Nga përvoja dhe aplikimi, komisioni është grup ekspertësh për zgjidhje të një problemi ose çështje ekonomike, por edhe institucion me rëndësi të veçantë shtetërore ku vendosen çështje të rëndësishme.

Raporti i KPMM-së, të cilën e kemi shqyrtuar para disa ditësh në këtë Kuvend, tregoj jo profesionalizmin e këtij bordi të KPMM-së, ndërsa Projektligji e propozon vazhdimin e mandateve të po të njëjtit bord, që është absurditet i paparë. Projektligji parasheh formimin e shërbimeve të gjeologjisë në Ministri, e ky shërbim ekziston në KPMM. Do të thotë kemi dyfishim të shërbimeve dhe rritje të administratës. Shërbimi i Gjeologjisë është më se i nevojshëm, pra, duhet analizuar dhe propozuar shërbim efikas dhe me profesionalizëm, kështu që ne mendojmë që duhet të jetë një ligj i veçantë.

Në propozim të projektligjit parashihen aftësi teknike, por ato nuk detajohen që lejon të komentohet sipas dëshirës. Projektligji parasheh vlerësime të ndikimit të mjedisit dhe precizon se duhet përgatitur nga ekspertët me përvojë. Kjo materie është tërësisht e përpunuar me Ligjin për mbrojtjen e mjedisit, andaj, kjo është e tepërt ose duhet të shfuqizohet në ligjin e aprovuar.

Në pjesën e kërkesave të veçanta, nenet janë kontradiktore, sepse kërkojnë licencat për leje të veçanta me gjithë se në nenet paraprake mundësojnë që krijuesi i lejes për punë të veçanta, nuk ka nevojë për licencë.

Edhe një herë në disa nene të ligjit mundësohet që mos azhureteti i KPMM-së, që ia mundëson zgjatjen e dhënies së licencës për edhe tre muaj që është e papranueshme dhe, në qoftë se dëshirojmë të kemi administratë efikase dhe në interes të biznesit dhe qytetarit.

Në kapitullin e 7-të të Projektligjit parashihet centralizimi për shfrytëzimin e resurseve për zejtari dhe materiale inerte, që është në kundërshtim me Kushtetutën dhe decentralizimin e komunave. Kjo materie, ne mendojmë se duhet të përfundohet në tërësi, që të jenë komunat bartëse të aktiviteteve të shfrytëzimit të materialeve inerte dhe ato për zejtari.

Projektligji të pjesa e aktiviteteve të jashtëligjshme, parasheh procedurë të komplikuar për pengimin e palejueshëm të hulumtimeve dhe të shfrytëzimit. Me procedura parashihet konstatimi nga inspeksioni, dhënia e kohës për evitim, lajmërimi i KPMM-së dhe tek mandej zbatimi i ligjit. Kjo procedurë mundëson shkatërrimin e vendburimeve dhe shfrytëzimin e mijëra toneve të resurseve.

Projektligji në kapitullin e 12-të, parasheh krijimin e strategjisë minerale dhe planin për menaxhimin e resurseve minerale. Propozimi i paraparë në projektligje, paraqet dyfishimin e shërbimeve dhe jo efikasitetin, andaj duhet ndarë këtë aktivitet dhe caktohet në bazë të kompetencave që i ka KPMM-ja. Prandaj Lidhja Demokratike e Dardanisë, mendon që ky projektligj, duhet të jetë i qartë dhe mbi të gjitha i implementueshëm dhe si i tillë nuk duhet të kalojë në Kuvend. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit!

Në emër të Grupit Parlamentar “7+”, deputetja Myfera Shinik

MÜFERA ŞİNİK: Teşekkür ederim.

Sayın Başkan, Sayın Bakanlar ve Milletvekilleri

Maden ocakları ve Minerallerle ilgili Yasa Tasarısı hazırlanmış bulunmaktadır. Hazırlanan Yasa Tasarısıyla ilgili daha geniş bir stratejinin belirlenmesi gerekiyor.

Aynı zamanda bu konuyla ilgili Kosova Hükümeti’nin politika beklentisini bilmemiz gerekir. Bununla birlikte Jeoloji hizmetlerinin çalışmalarıyla beraber geniş çaplı aleni tartışmalar, yuvarlak masa toplantıları yapılarak, Yasa Tasarısına eklemeler yapılabilir.

Maden ocakları ve Mineraller Yasa Tasarısını şimdiki haliyle 7+ Parlamento grubu olarka birinci okunuşunu kabul ediyor, ikinci okunuşu için hazırlanmasında fonksiyonel grubuna katkımızı ve önerilerimizi sunacağız.

Teşekkür ederim. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit!

Në emër të Grupit Parlamentar SLS, deputeti Mursel Halili

MUSELJ HALILI: Gospodine predsedaavajući,

Dame i gospodo prisutni,

Parlamentarna grupa SLS-a je razatrala nacrt zakona i izmedju ostalog, došla je na stanovište da ovaj nacrt zakona ima pozitivnih stvari, medjutim ima i dosta nejasnoća, koje u ovom trenutku Parlamentarna grupa SLS-a ne može da podrži, stoga ćemo mi pokušati da u funkcionalnim komisijama i kroz amandmane damo svoj doprinos da se to razjasni.

U principu, gode i veoma pozitivno cenimo odredbe koje se odnose na zaštitu životne sredine, to je pozitivan stvar. Medjutim, naravno tu postoje i neki troškovi koji su prihvatljivi u ovom trenutku, medjutim kažem vam da stav Parlamentarne grupe SLS je da u načelu podržavamo ovaj tekst nacrta zakona i naravno da čemo dati svoj doprinos da se taj tekst zakona doradi u budućnosti. Hvala!

KRYESUESI: Ju faleminderit!

Sipas radhës, tani e kanë fjalën deputetët e paraqitur. Fjalën e ka deputetja Kaqusha Jashari.

KAQUSHA JASHARI: Ju faleminderit, zoti kryesues!

Të nderuar të gjithë të pranishmit,

Ligji për minierat dhe mineralet është tejet i nevojshëm për ta vu në rend aktivitetin e mineralet, duke filluar nga: hulumtimi, eksploatimi, shfrytëzimi dhe pasurimi i lëndëve minerale në vendin tonë.

Me Kushtetutë, resurset minerale janë pasuria e Republikës së Kosovës dhe ky projektligj edhe në fillim, ka filluar bash në këtë mënyrë në nenin 2, që resurset minerale janë pronë e shtetit. Në këtë projektligj, pjesa e ndarjes në 5 grupe të mineraleve, mendoj se është përpunuar mirë, është filluar prej grupit të parë ku janë mineralet energjetike edhe mineralet industriale, ndërtimore, metalore dhe gurë të çmuar dhe të tjera, dhe gjithashtu mendoj se edhe është përfshirë mirë edhe mënyra e licencimeve, të cilat janë ato kritere të lejeve. Gjithashtu në këtë projektligj i kemi 6 grupe të licencave edhe janë shumë të qarta. Por, unë e kam një dilemë se me këtë projektligj me mënyrën e mëtutjeshme, a jemi në rrugë të ruajtjes të resurseve minerale si pronë e shtetit dhe a kemi mekanizma ligjor që ta ruajmë atë?

Mund të ndodhë që nuk kam të drejtë, por me disa argumente që janë paraqitur tek unë, duke e lexuar dy-tri herë këtë ligj, unë do ta shtroj këtë dilemë. E marrim vetëm një pjesë ku është licenca për shfrytëzimin nga aspekti i kohëzgjatjes së shfrytëzimit ku janë dy grupe minerale që mund të jepen për shfrytëzimin për 25 vjet dhe mineralet energjetike për 40 vjet. Minierat mund të jepen në shfrytëzim me koncesion. Është përmendur edhe para meje që Ligji për koncesion nuk i ka përfshirë minierat dhe paraqitet një vakum, e këtu thirret në këtë ligj për koncesionet, prandaj këtu duhet të rregullohet. Në qoftë se nuk rregullohet po jepet në shfrytëzim 40 vjet ose 25 vjet, në një mënyrë sikur të ishte tjetërsimi i përkohshëm i pronës në emrin e atyre që e kanë licencën për shfrytëzim, dhe unë mendoj se kjo është në kundërshtim me obligimin, në të vërtetë, nga Kushtetuta edhe nga neni 2 i këtij ligji, i cili është sot këtu duke u shqyrtuar.

Gjithashtu, në pjesën tjetër thuhet tek ata që hulumtojnë, e kanë licencën për hulumtim, e kanë edhe të drejtën e shfrytëzimit edhe e drejta e firmës e cila e ka bërë atë ose e personit juridik, çka do të thotë edhe në qoftë se nuk mund të fillojë me shfrytëzimin edhe nuk e ka, ai e ka të drejtën e shfrytëzimit. Pra, ku është këtu mundësia e shtetit në qoftë se me hulumtim janë zbuluar mineralet e çmuara ose mineralet energjetike? Edhe aty duhet të sigurohet intervenimi ose ndikimi i shtetit.

E kam edhe një çështje për mua shumë të rëndësishme, sa licenca do të jepen, sa kapaciteti do të shpenzohet? Mos po bëjmë me licencimin edhe mundësitë e zhvillimit sikur që po punohet shembulli i keq është, por duhet ta përmendi Feronikelin edhe shfrytëzimin e minierës, e cila shfrytëzohet pamëshirshëm. A kemi mundësi të kontrollit të shfrytëzimit të kapaciteteve në qoftë se jepet në këtë mënyrë dhe ku është mundësia e intervenimit, po them prapë, ndoshta shumë kështu decidiv e shtetit, ani që me ligj i kemi inspekcionet, por inspekcioni po shihet se në cilën mënyrë dhe sa mund të intervenojë

Ndoshta prej Ministrisë ose prej Qeverisë mund të jepen përgjigja në këto dilemat e mia se strategjia është ajo e cila mund të ketë rregulla edhe ta rregullon përveç Ligjit edhe këtë veprimtari, por strategjia e mineraleve dhe plani për menaxhimin e resurseve minerale është obligim i Ministrisë së Energjisë dhe Minierave, në bashkëpunim me Komisionin e Pavarur dhe Shërbimin Gjeologjik, dhe këtu në kapitullin 12, Ministria i propozon Qeverisë ta shqyrtojë edhe eventualisht ta ndryshojë, por në fillim të këtij kapitulli, në pasusin e dytë shkruan se Qeveria e shqyrton, ndryshon dhe nëse e sheh të arsyeshme, jo obligative, nëse e sheh të arsyeshme, e miraton dhe ia dorëzon Strategjinë e mineraleve - Kuvendit. Në vazhdim është obligim i Kuvendit ta aprovojë strategjinë. Mund të ndodhë që është gabim, ose nuk është thënë qartë, por decidivisht po shkruan: “nëse e sheh të arsyeshme”.

Prandaj, unë mendoj se strategjia mund të plotësohet, të ndryshohet edhe nuk mendoj se me strategjinë ne mundemi ta përfshijmë edhe obligimin që të ruhet pasuria e shtetit. Unë mendoj se është edhe një pjesë, e cila ndoshta nuk kam mund me këtë ligj, por diku duhet të ekzistojë- çka të bëjmë me minierat energjetike të cilat janë tash duke punuar? Nuk është përfshirë në Ligjin e partneritetit publiko-privat asgjë për këtë lëmi, e gjithashtu as në Ligjin për koncesion. Unë mendoj se, qysh e kam kuptuar që minierat nuk mund të privatizohen pasi janë pasuri e shtetit., por, ato duhet t’i ruajmë me ligj.

Unë jam shumë e vetëdijshme se ky ligj është urgjent, është shumë i nevojshëm, por jam edhe e vetëdijshme edhe për diçka tjetër, në qoftë se është shumë më i mirë se Rregullorja e vitit 2005, që është aprovuar këtu edhe UNMIK-u e ka propozuar ose është aprovuar, atëherë ne sot, pas 4 vjetëve me siguri ligjin e kemi shumë më të mirë, shumë më të avancuar, por përgjegjësia e asaj kohe edhe e kësaj kohe nuk matet. Përgjegjësinë ne e kemi për ligjet tona të sodit, prandaj, në qoftë se mundet ky ligj të përfshijë në këtë kohë të leximi i dytë me këto dilema që parashtrova, atëherë unë kërkoj përgjigjen nga ministresh se këtu janë jo të vogla, por shumë të mëdha. Pasurinë e shtetit, kush e ruan, kush intervenon edhe a kemi nevojë? Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit!
Sipas radhës, deputeti Driton Tali

DRITON TALI: Ju faleminderit!

Unë, që në fillim deklarova se nuk e mbështes këtë projektligj për një arsye kryesore dhe ajo është afati për licencat për shfrytëzim. Mendoj se afati 25 vjet, kohëzgjatja është shumë e gjatë dhe nuk është në interes tonin për shumë arsye. Njëra është se këto praktika më nuk bëhen në botë për shkak se tempoja e zhvillimeve është shumë më e madhe se që ka qenë në shekullin e kaluar. Unë propozoj që kohëzgjatja të jetë 15 vjet edhe për faktin se ne e dimë që institucionet kosovare janë ende të brishta dhe na mungon... ndaj, për të mos ia lidhur duart vetes për këtë kohë aq të gjatë 25 vjet, propozoj që të jetë 15 vjet dhe vazhdimi po ashtu të jetë 15 vjet, t’ia lëmë kohës dhe të shikojmë se çka na sjellë koha, ndërsa kohëzgjatjen për licencën për shfrytëzimin e mineraleve energjetike, atë hiq më pak nuk e përkrah për 40 vjet, mendoj se kjo kohë është shumë e zgjatur. Duhet të jetë po ashtu 15 vjet, eventualisht 20 vjet, po them eventualisht, por me theks të posaçëm 15 vjet, pastaj mund t’i jepet e zgjatja.

Këto kohëzgjatje, po them edhe një herë, janë jashtë kohës, ne nuk jemi në shekullin 19 apo 20, kemi hyrë në shekullin 21, gjërat kanë ndryshuar. Pra, mos të bëjmë gabime të cilat, po them edhe një herë, gjeneratat do të na e zënë për të madhe, por edhe do të pendohemi, duke marr parasysh se tonelata e qymyrit tash vlerësohet, shitet apo është të paktën një shifër që përflitet që të jetë një euro, domethënë do të jenë edhe çmimet aq qesharake.

Çështje tjetër për të cilën po them, më pak e rëndësishme, por e rëndësishme për vlerën e vet, por po them edhe një arsye kryesore pse nuk e mbështet këtë projektligj, është kohëzgjatja. Janë këto lejet për aktivitetet e veçanta. Këtu flet gjerë e gjatë, por nuk na tregojnë çka janë këto aktivitete të veçanta, tash mund të ketë keqkuptime këtu, këto aktivitete të veçanta. Po them edhe një herë, të paktën unë e kam lexuar disa herë dhe nuk kam ardhur në përfundim se çka mund të jenë këto aktivitete të veçanta.

Pastaj, flitet në faqen 122, kemi leja apo licenca diskrecionale, pjesa e 8-të, po ashtu këtu flet gjerë e gjatë, por nuk na tregojnë se çka domethënë kjo, është shumë e përzier. Madje, kemi këtu te paragrafi 1.1, thuhet se një person, po e lexoj që t'ju tregoj se sa e pakuptimtë është, një person dëshiron të marrë ose mbajë një licencë ose leje, mirëpo ky person nuk ka të drejtë të marrë ose mbajë këtë licencë ose leje vetëm për shkak se ky person më nuk i plotëson kriteret e përcaktuara nën paragrafin 1.3 dhe 1.4 të nenit 6 të këtij ligji. Dhe, nëse shkojmë te neni 6, që është faqe 22 dhe e lexojmë, e shoh se sa më e pa kuptimtë bëhet, domethënë nuk ka shpjegime konkrete dhe flasim për diçka shumë serioze, flasim për minerale që i kemi pak këtu në Kosovë dhe ka shpresa Kosova, që në bazë të këtyre pasurive që i kemi, ta zhvillojë një farë ekonomie, po them, dhe nëse nuk dimë ta ruajmë apo ta maksimizojmë profitin, atëherë çka është arsyeja e gjithë neve këtu që jemi votuar.

Andaj, unë po them, sinjerisht këtu po apeloj në ndërgjegjen e çdo deputeti që mos ta votojë këtë ligj në këtë mënyrë derisa nuk qartësohet çdo pikë dhe çdo presje për shkak të rëndësisë që ka. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Deputeti Mahir Yagcilar.

MAHIR YAGCILAR: Po, ju faleminderit, zoti kryesues!

Unë së pari dëshiroj t'i përshëndes të gjithë deputetët,

Të nderuar ministra,

Zonja ministre,

Unë dëshiroj gjithashtu të përkrah Ligjin për mineralet dhe minierat, sepse mendoj se është i nevojshëm dhe edhe nga aspekti i zhvillimit ekonomik, por edhe për një qëndrueshmëri ekonomike në Kosovë.

Por, gjithashtu dëshiroj të bëjë edhe disa vërejtje, sepse mendoj ligji në disa pika ose në disa nene duhet të jetë në një harmoni më të mirë me ligjet tjera, sidomos me ligjet të cilat dalin nga pakot e ligjeve mjedisore, kështu që unë dëshiroj të theksoj vetëm se në përkufizimet ekziston edhe një ndryshim ndoshta edhe terminologjisë me terminologjinë në ligjet mjedisore. Për shembull, thuhet vlerësimi i ndikimit mjedisor, por në ligjet e pakos mjedisore është vlerësimi në ndikim në mjedis. Gjithashtu ekziston një përkufizim në ligjin mjedisor që nënkupton vetëm një ligj, por janë disa ligje nuk janë vetëm Ligji për mbrojtjen e mjedisit. Gjithashtu edhe sipas Rregullores së UNMIK-ut, tashmë janë aprovuar sidomos tri ligje: Ligji për mbrojtjen e mjedisit, Ligji për vlerësimin, ndikimin në mjedis, por gjithashtu edhe vlerësimin strategjik mjedisor edhe ligjet e tjera. Gjithashtu, dëshiroj, nga aspekti , prapë si deputet të vërej se ekziston në terminologji gjykata kompetente, por nënkupton Gjykatën Supreme të Republikës së Kosovës. Në qoftë se është vetëm një gjykatë, atëherë nuk ka nevojë të përsëritet gjykata kompetente mund të thuhet drejtpërdrejtë Gjykata Supreme e Republikës së Kosovës. Por, gjithashtu ftoj edhe Komisionin për Bujqësi, Zhvillim Rural, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor të inkuadrohet në përmirësime dhe harmonizime nga aspekti i ligjeve mjedisore. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit!

Fjalën e ka deputeti Bahri Hyseni,

BAHRI HYSENI: Ju faleminderit, zoti kryesues!

Të nderuar ministra,

Kolegë deputetë,

Në fillim, projektligjin e përkrahim në parim dhe mendojmë se projektligji e ka edhe qëllimin edhe fushëveprimin dhe nuk është ndonjë arsye që të mos përkrahet në parim, por megjithatë konsiderojmë që për ta ndihmuar Komisionin funksional, qëllimi i të gjithë deputetëve është që të ndihmojnë, është mirë t'i japim disa sqarime të cilat janë të domosdoshme dhe do të duhej, që me rastin e shqyrtimit në leximin e dytë, Komisioni funksional dhe komisionet e tjera t'i kenë parasysh. Është një shqetësim që po na përcjell vazhdimisht dhe çështja është që thirrja që po bëhet në nenet e panevojshme të Kushtetutës dhe sa po e përmendëm edhe para dite, që po thirren në nenet për të cilat nuk i jep autoritet Kuvendit të Kosovës të miratoj ligjin. Edhe ky projektligj po thirret në nenin 122 dhe në nenin 142 që janë nene të panevojshme, sepse neni 122 tregon për pasuritë të cilat munden t' i shfrytëzojnë qytetarët e Kosovës dhe neni 142 flet për agjencitë, prandaj është e panevojshme për t' u thirrur në këto dy nene, sepse i vetmi nen, neni 65 jep autoritet Kuvendit të Kosovës, për ta nxjerrë ligjin.

U ngrit një çështje rreth përkufizimeve dhe mendoj që Komisioni Funksional, duhet t'i ketë shumë të qarta, përkufizimet janë të pakuptueshme dhe është mirë që të intervenohet në të gjitha përkufizimet që t'i bëjmë të qarta.

Neni 61 i Projektligjit në fjalë flet për konfliktin e interesit. Është mirë që ky nen komplet të fshihet, sepse nuk ka nevojë ky projektligj të flasë për konfliktin e interesit. Ekziston Ligji për konfliktin e interesit dhe sapo jemi edhe në përfundim të amendamenteve tjera që vijnë për këtë ligj dhe konsideroj se nuk kanë nevojë ligjet tjera të flasin për konfliktin e interesit sepse në mënyrë decitive rregullon konfliktin e interesit, të gjitha konfliktet e interesave, në këtë rast edhe për rastin në fjalë. Prandaj, është mirë që të bëhet amendament dhe të fshihet neni 61, sepse vetëm e bën ligjin vëllimor dhe nuk ka fare nevojë të ekzistojë.

Është çështja tjetër në nenin 63 kur flitet që Këshilli i Pavarur për Miniera dhe Minerale do të ketë apo do të emërojë Bordin e KPM-së dhe gjithashtu Bordi i KPM-së do të ketë një drejtor.

Është e kuptueshme, mirëpo menjëherë paragrafi 2 thotë – drejtori emërohet nga Bordi i KPM-së, mandej paragrafi 3 thotë – drejtori është kryeshef ekzekutiv. S'mundet! Ose ka për të qenë drejtor ose ka përtë qenë kryeshef ekzekutiv. Drejtori s'mundet të jetë kryeshef ekzekutiv dhe, për dijeni, është mirë që komisioni funksional çështjen e strukturës për menaxhimin brenda strukturës organizative të KPM-së, në këtë rast, e organizojnë ligjet të cilat jemi duke i përgatitur dhe ligjet të cilat janë në fuqi. Ne jemi duke përgatitur Ligjin për shërbimin civil, ekziston një ligj për shërbimin civil, por jemi duke e përgatitur edhe Ligjin për administratë publike. Dhe, varësisht ku bie drejtori apo kryeshefi ekzekutiv, edhe pse është shërbyes civil, është mirë që kjo nuk i shkon dhe gjithsesi duhet neni 63 të fshihet, sepse nuk mundet ose drejtor ose kryeshef.

Neni 64 flet për buxhetin dhe financat. Është plotësisht e panevojshme. Të gjitha organizatat buxhetore në Kosovë, të gjitha organizatat të cilat kanë vi buxhetore veprojnë në përputhje me Ligjin për menaxhimin e financave publike, prandaj është e panevojshme. Edhe ky nen nuk ka nevojë të ekzistojë komplet dhe duhet të eliminohet. Bile, në këtë rast, ky nen bie ndesh me ligjin aktual që e përdorin organizatat buxhetore apo me Ligjin e financave publike. Prandaj, nuk duhet fare të ekzistojë.

Vazhdojmë më tutje. Neni 64.2, flet për pagat, u përmend edhe nga diskutues, po unë po e ngreh edhe një herë si problem, kjo fare nuk duhet të ekzistojë. Nuk ka mundësi që çdo ligj në Kosovë

t'i rregullojë pagat e drejtorëve, të inspektorëve, sepse ne jemi duke krijuar Ligjin për pagat dhe aktualisht përdoret një rregullore për të gjitha pagat në Kosovë. Është për çudi, çdo ligj që po e nxjerrim, i caktojnë pagat për menaxherët të cilët i drejtojnë dhe kjo do të na bie në dilemë a do të ketë mundësi ndonjëherë të u implementohet kjo në praktikë. Edhe për bordet do të ketë ligj, apo do të ketë një rregullore, së paku për shërbimin civil do të ketë ligj edhe për paga të funksionarëve të lartë, edhe për shërbyes civilë, prandaj është e panevojshme dhe nuk ka nevojë dhe duhet të fshihet.

Neni 67, ndoshta është me vëmendje të veçantë dhe nuk duhet të kalojë kurrsesi, sepse do të kemi problemin që ndoshta Presidenti i Republikës së Kosovës do ta shfrytëzojë rastin për të mos e dekretuar, sepse flet për vepër penale. Thotë, vepër penale konsiderohet shkelje e këtij ligji nëse një person duke përfshirë, duke përfshirë personat nga KPMM ushtron ose tenton të ushtrojë ndikim politik, administrativ, financiar. Veprat penale i përcakton Kodi penal dhe nëse ka ndikim politik, administrativ, nuk është vepër penale.

Prandaj, edhe po të ishte vepër penale, nuk ka mundësi tash ky projektligj të përcaktojë veprën penale, sepse Kodi penal i Kosovës i përcakton edhe veprën penale, edhe elementet e veprës penale, prandaj do të biem në kundërshtim me Kodin penal, edhe pse në këtë rast unë konsideroj se kjo nuk është vepër penale, ashtu siç është shkruar në ligj, andaj duhet të eliminohet.

Çështje tjetër. Neni 68. Edhe pa kryesues, sepse është shumë e nevojshme të ngrihen këto çështje, sepse përndryshe nuk do të kalonin mandej as në dekretim.

Neni 68 flet për kryeinspektorin dhe më poshtë flet – kryeinspektori, thotë, emërohet nga Qeveria dhe me një përkujdesje të veçantë Ministria duhet të shohë a i plotëson kriteret dhe kërkohet përvoja dhjetëvjeçare. Edhe këtu po ndeshemi me Ligjin e shërbimit civil. Mënyra e përzgjedhjes së zyrtarëve të lartë është e përcaktuar qartë. Ose shkon përmes Këshillit për Emërime të Larta Publike ose shkon përmes shpalljeve të rëndomta të konkursit publik. Përvoja që është kërkuar këtu, është në kundërshtim me ligjet aktuale. Si zyrtar më i lartë në shërbimin civil merret aktualisht sekretari i përhershëm dhe për të kërkohen pesë vjet përvojë pune. Prandaj, edhe kjo bie ndesh me Ligjin e shërbimit civil dhe nuk duhet të ekzistojë, sepse do të ishte pengesë serioze. Bile, këtu është shkruar edhe më keq, të ketë përvojë në xehetari, që nuk ka lidhje me menaxhime tash me xehetarinë, e kështu me radhë.

Dhe, krejt në fund, ne e përkrahim dhe unë do ta përkrah dhe do të jem në dispozicion që të ndihmoj për të gjitha këto që i ngrita dhe të bëjmë amendament e të mos e lejojmë ligjin të kalojë me defekte të tilla. Faleminderit, shumë!

KRYESUESI: Faleminderit! Radhën e ka deputeti Riza Smaka.

RIZA SMAKA: I nderuari, zoti kryesues,

Kolegë të nderuar,

Radhitja – Ligji për minierat dhe mineralet, do të duhej të meditohej, po e zëmë, se i referohet minierave apo më tepër të parës apo të dytës.

Jepet shoqëria tregtare. Po shoqëria tregtare është vetëm njëra nga format e organizatave biznesore, prandaj do të duhej të harmonizohej ky term me termin adekuat nga Ligji për organizatat biznesore, që është në aplikim.

Kur jepet definicioni ç'është gjykata kompetente, thuhet se ajo është Gjykata Supreme e Kosovës, e nuk mund të jetë Gjykata Supreme e Kosovës, sepse Gjykata Supreme e Kosovës në këtë ose në

atë mënyrë është gjykatë e kasacionit, është gjykatë e apelacionit apo nuk është gjykatë e faktit, a gjykatë e faktit do të duhej të ishte, sipas logjikës dhe pragmatikës – Gjykata Ekonomike apo Gjykata Komerciale, si quhet në anglisht. Gjykatë e shkallës së parë, apo jo. Prandaj, fjala është për gabim në koncept.

Poseduesi i lejes mund të jetë ilegal mund të jetë legal. Këtu është fjala në qoftë se e lexojmë me kujdes tekstin, del se nuk është fjala për poseduesin, por është fjala për pronarin e lejes, se poseduesi mund të jetë i autorizuar – e autorizuar i pronarit apo e pronares së lejes, prandaj kjo do të duhej të ridefinohej.

Në tekst përdoret herë mineral herë minerar. Të konsultohet fjalori terminologjik, unë mendoj se duhet mineral.

Kur jepet definicioni për ndërmarrje, thotë, ndërmarrje nënkuptohet projekti. Si mund të nënkuptohet apo të kuptohet apo të barasnjëhtësohet, si të them, projekti – ndërmarrje, ose thotë zyra. A më së keqi është kur thuhet shoqata. Shoqata, ju lutem, është asociacion zakonisht jo fitimprurës. Ndryshe, do të ishte shoqëri. Shoqëria është organizatë fitimprurëse, ndërsa shoqata zakonisht nuk është, prandaj nuk mund të jepet nocioni i ndërmarrjes edhe për shoqatën, apo për shoqatat.

I jepet mundësia teknoburokratizmit, që kërkesat, në vend që të shqyrtoheshin sipas Ligjit për procedurën e përgjithshme administrative, së paku, apo eventualisht për ligj të veçantë ku zakonisht afatet janë një muaj ditë. Këtu jepen tre muaj ditë, pra jepet një komoditet i panevojshëm se edhe në kundërshtim me logjikën e ekonomisë së tregut, bie fjala, jep kërkesën parashtuesi i kërkesës, ajo do të thotë organi do të kishte autorizim që tre muaj mos ta prekë me dorë dhe mos ta qortojë askush se e ka zhagitur se ja, që këtu është, është parapa, është përcaktuar në ligj tre muaj ditë, ama maksimumi do të duhej të ishte një muaj ditë, mundësisht menjëherë, kërkesa menjëherë, se pritet se do të pasonte eventualisht ankesa, e më pastaj procedura. Ne e dimë në praktikë ajo zgjatë me vite, po qëllimi është që çështjet juridike administrative të vendosen shpejt, mirë, ligjshëm, se shkon në favor të ekonomisë së tregut.

Ju lutem, ekziston një term, për herën e parë e shoh këtu dhe nuk ekziston ky term kudo qoftë, vetëm në këtë projektligj. Thotë - dispozitat e përziera. Me të vërtetë të përziera janë në kuptimin e definimit të mangët dhe kontradiktor, ama nuk ka dispozita të përziera. Qysh dispozita të përziera?

Ose bie fjala, thotë, kërkesat për kryeinspektor përcaktohen me këtë ligj. Nuk është praktikë e mirë që kërkesat apo kushtet e konkursit të përcaktohen me ligj, pos për presidentin e Republikës, apo jo, që me Kushtetutë në njëfarë mënyre, se ndryshe me ligj nuk përcaktohen kushtet e konkursit.

Unë përpiqem për t'iu shmangur disa vërejtjeve parimore që i dhanë kolegët, që ishin me vend.

Pagat. Sa iu përket pagave, është bërë një cirkus, karikaturist në praktikën tona. Pothuaj se çdo institucion përpiqet nëpër dyer të vogla, që quhet, t'i përcaktojë statuset e pagave, t'i rrisë pagat dhe zakonisht kanë sukses ata që janë nën dardha. Shembull konkret, anëtarët e Kryesisë së Kuvendit kanë paga dy herë më të larta se të deputetëve dhe i pengojnë harmonizimet e pagave të deputetëve. Ngjashëm edhe këtu. Ligji për pagat, e tha kolegu Hyseni, me vend, atje rregullohen në mënyrë unike dhe duhet të rregullohen në mënyrë unike.

Ky dokument nuk ka dispozita për kundravajtje, për ndëshkimet dhe duhet medoemos të ketë, ama ka dispozita, ka dispozitë me të cilën jepen definicionet për veprën penale, që është qesharake. Ju

lutem, Kodi penal e përcakton figurën e veprës penale, jo me këtë ligj që s'ka të bëjë fare me veprën penale.

Edhe përfundimisht, zoti kryesues, angazhohem që shqyrtimet parimore, unë mendoj se këto janë shumë të rëndësishme, sesa faza e dytë, se këtu jepen vlerësimet, në parim, që po të isha unë një ndër ata që do ta kisha hartuar këtë dokument, me kujdesin më të madh në notes do t'i kisha shënuar sugjestionet, propozimet, idetë e kolegëve deputetë, që i dhanë deri më tash, e që do të japin me siguri edhe më tutje, dhe ato do të duhej të inkorporoheshin në këtë mënyrë ose në atë mënyrë nëpërmjet amendamenteve. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Ju lutem, përmbajuni rendi të ditës dhe shënimet janë të regjistruara të gjitha dhe i merr të regjistruara, çdo fjalë të secilit, nuk ka nevojë me mbajt shënime. Sipas radhës, deputeti Shkumbin Demaliaj.

SHKUMBIN DEMALIAJ: Faleminderit, zoti kryesues!

Të nderuar ministra të Kabinetit qeveritar,

Kolegë deputetë,

Do të mundohem që të mos i përsëris kolegët më herët, mirëpo është kërkesë e imja që projektligji t'i kthehet sponsorizuesit, për atë do të vendosin me votim deputetët, mirëpo shihet se është një kamuflim në këtë projektligj. Ministria apo sponsorizuesi, në këtë rast, e minierave, të energjisë dhe minierave nuk e ka konsultuar Strategjinë legjislative të Qeverisë, që vetë është si ministri brenda këtij dikasteri. Është një mosharmonizim me ligjet që kanë dalë pikërisht në këtë vit, u thanë edhe më herët, me Ligjin për partneritet publik0-privat dhe atë për koncesione. Do të thotë, nuk është harmonizuar ky projektligj me ato ligje, sepse nuk është konsultuar strategjia legjislative e vetë kësaj Qeverie. Më shumë është rregullimi i një organogrami të punës të Ministrisë dhe marrje e kompetencave, çka bie në kolizion. Përpos të gjitha atyre që u përmendën, që është kolizion kompetencash me ligjet tjera, është edhe ndërhyrja në aspektin e sigurisë në punë.

Kosova ka Ligjin për siguri në punë 2003/19 dhe këtë çështje Ministria e Energjisë dhe Minierave mund ta rregullojë me një akt nënligjor duke u bazuar në atë ligj, sepse në këtë rast mund të fitet vetëm për minierat nëntokësore, sepse ndërhyhet edhe në kompetencat e Ministrisë së Ambientit. Këtu kisha pasur dëshirë dhe është kërkesë që të kthehet, por në qoftë se Kuvendi vendos që të shkojë, iu mbetet shumë punë komisioneve funksionale dhe thuaja se duhet ta mbarojmë një ligj të ri krejt duke ndërhyrë, sepse është ndërhyrje në të gjitha ligjet, pothuaj se është pjesë që sponsorizuesi e ka përfunduar.

Personalisht, nuk do ta publikoj se a do ta votoj apo jo projektligjin. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Deputeti Armend Zemaj.

ARMEND ZEMAJ: Faleminderit, zoti kryesues!

U thanë ato ndoshta çka janë më kryesore, por me të vërtetë ndonjëherë po na ndodhë që kur të vihet te çështja e interpretimit të ligjit, duhet t'i kushtojmë shumë rëndësi edhe karakterit gjuhësor dhe përkthimit, sepse ne e dimë që shumica e ligjeve edhe ashtu merren nga shtetet tjera, shtetet perëndimore dhe përkthehen, por sinqerisht duhet të kemi kujdes, sepse po të shikohet për shembull me një vëmendje, shumicën e rasteve kemi përkthim të drejtpërdrejtë nga gjuha, për shembull, angleze ose gjuha serbokroate. Është shumë e pakuptimtë te përkufizimet, për shembull, kur e dimë se përemri "ai" është përemër, ndërsa mbiemri i tij, edhe ai nuk është mbiemër por është përemër, prandaj kjo e humb kuptimin në interpretim. Kemi rastin edhe kur thuhet se ligji, njëjësi është njëjës dhe shumësi shumës, nëse është fjala për nen dhe nenet, atëherë duhet ta kenë

kuptimin dhe t'i jepet kuptimi, nuk ka nevojë të thuhet është njëjës dhe shumës, sepse ato janë çështje tjera gramatikore.

Dhe, në brendinë e ligjit, në shumë kapituj apo gati në çdo... janë kriteret e dhënies. Duhet të specifikohet kriteri i dhënies se kujt, sepse mbetet shumë i pakuptimtë. Ka edhe pjesë ku thuhet në nëntitujt -kërkesat dhe kërkesa dhe çdoherë është kërkesa, prandaj këto duhet të sqarohen, sigurisht i mbetet komisionit funksional. Ne edhe ashtu e mbështesim dhe do të japim kontributin gjatë procedurës së mëtutjeshme. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Deputeti Berim Ramosaj.

BERIM RAMOSAJ: Faleminderit, zoti kryesues!

Të nderuar deputetë,

Të nderuar ministra,

Ne e kemi shqyrtuar këtë ligj dhe ju kërkoj falje kolegëve të mi opozitarë, duke marrë parasysh rëndësinë e këtij ligji, në kuptimin e partneritetit privato-publik, në kuptimin e pjesëmarrjes konsensuale të Kosovës në miniera dhe minerale, duke marrë parasysh shumë arsye tjera në aspektin e investimeve qoftë direkte, qoftë indirekte në Kosovë, kërkoj edhe mirëkuptim edhe nga deputetët e opozitës, vetë kam qenë anëtar i komisionit funksional që e kemi shqyrtuar këtë. Ne kemi shansin t'i rregullojmë të gjitha ato mangësi që i ka ligji, por apeloj edhe një herë që ligjit t'i japim përkrahje. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Konstatoj që s'ka më diskutues të paraqitur. Ju lus për prezencë të deputetëve. Përfaqësuesi i Qeverisë nuk dëshiron ta marrë më fjalën. Konstatoj se në sallë janë prezent 64 deputetë, prandaj kërkoj që të bëhemi gati për votim. Pra, lus regjinë dhe deputetët që të përgatiten për votim. Votojmë tani:

A ka pa kartelë që votojnë “për”? S'ka pa kartelë.

Pa kartelë, “kundër”? S'ka.

Atëherë, konstatoj që Ligji miratohet me 45 vota “për”, 14 “kundër” dhe 4 abstenime. Faleminderit!

Në bazë të Rregullores së Punës, Kuvendi ngarkon këto komisione:

1. Komisionin për Ekonomi, Tregti, Industri, Energjetikë, Transport dhe Telekomunikacion, si komision funksional,
2. Komisionin për Legjislacion dhe Gjyqësi,
3. Komisionin për Buxhet e Financa,
4. Komisionin për Komunitete dhe
5. Komisionin për Integritet Evropian.

Komisionet duhet që brenda 2 muajve nga shqyrtimi i parë, Kuvendit t'i paraqesin raportet me rekomandime. Faleminderit! A jeni dakord për një dhjetë minuta pauzë? Ose doni të vazhdojmë? Jo, nesër jo. Kemi shumë pika. Deri para shtatëve nuk e përfundojmë seancën.

(Reagime)

Jo, jo, sepse mbesim për javën e ardhshme pastaj, 17 pika i kemi. Atëherë, meqë nuk doni pauzë, vazhdojmë me pikën e shtatë të rendit të ditës:

- **Shqyrtimi i parë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr 2-L/36 për duhanin.**

Konstatime hyrëse: Në bazë të Rregullës 35.1 të Rregullores së Punës, janë përmbushur kushtet për shqyrtimin dhe miratimin, në parim, të këtij projektligji.

Ftoj ministrin e Shëndetësisë, zotin Alush Gashi, që në emër të Qeverisë së Republikës së Kosovës para deputetëve të Kuvendit ta prezantojë projektligjin. Zoti ministër, e keni fjalën.

MINISTRI ALUSH GASHI: Faleminderit shumë!

I nderuari kryesues, ju faleminderit për mundësinë e prezantimit të këtij ligji shumë të rëndësishëm për shëndetin e qytetarëve të Republikës së Kosovës.

Në zbatim të nenit 33 paragrafi 2 të Rregullores për Punën e Qeverisë, Projektligji për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit për duhanin Nr 02-L/36 ka kaluar të gjitha procedurat e parapara sipas Rregullores së Qeverisë së Kosovës, andaj ju ofrohet sot për miratim.

KRYESUESI: Ju lutem për qetësi, zotëri deputetë, kujt s'i rrihet – jashtë!

MINISTRI ALUSH GASHI: Projektligjin për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit për duhanin Nr. 02-L/26 së bashku me memorandumun shpjegues lidhur me këto ndryshim-plotësime i keni marrë të gjithë me kohë.

Me këtë rast ju kujtoj se pas shpalljes së Ligjit për duhanin nga ana e Përfaqësuesit Special të Sekretarit të Përgjithshëm, më 9 janar të vitit 2007, është ngritur shqetësim substancial i Shoqatës së prodhuesve, distributorëve dhe importuesve të duhanit në Kosovë, të Odës Ekonomike Amerikane, të Odës Ekonomike të Kosovës lidhur me nenin 6 të Ligjit për duhanin dhe në nenin 5 të Udhëzimit administrativ Nr 5 të vitit 2007, të nënshkruar nga ministri, zoti Sadik Idriz, më 1 tetor të vitit 2007.

Vërejtjet e dhëna i referohen zbatimit praktik të këtij udhëzimi administrativ dhe Ligjit për duhanin në vendosje të shenjëzimeve për paketime të prodhimeve të duhanit dhe shtyrjes së afatit për zbatimin e këtyre dispozitave të lartcekura.

Me shumë punë dhe përkushtim grupet punues këto çështje i kanë definuar qartë në 8 nene, të cilat ju keni në mundësi t'i shqyrtoni.

Andaj, në pajtim me nenin 93.4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe me nenin 35 paragrafi 2 të Rregullores së Punës së Qeverisë, rekomandojnë aprovimin e këtyre ndryshim-plotësimeve.

Qëndrojmë në disponim për dhënie të sqarimeve shtesë. Ju faleminderit për mundësi të...

KRYESUESI: Faleminderit! Kryetari ose raportuesi i Komisionit funksional për Shëndetësi është paraqitur, deputetja Nurishahe Hulaaj.

NURISHAHE HULAJ: Faleminderit!

I nderuar kryesues i Kuvendit,
Ministra dhe deputetë të nderuar,

Unë tani flas edhe në emër të Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike të Kosovës, e gjithashtu edhe Komisioni parlamentar për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale më ka autorizuar që unë të paraqes pikësynimet e këtij projektligji.

Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike të Kosovës e ka shqyrtuar Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për duhanin dhe në parim e përkrah plotësisht.

Gjithashtu, Komisioni parlamentar për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale e ka shqyrtuar Projektligjin dhe ka dhënë rekomandimet që ky ligj të procedohet në Kuvendin e Republikës së Kosovës për miratim në shqyrtim të parë.

Paraprakisht do të japim disa aspekte të aktiviteteve, se pse ka ardhur Ligji për ndryshim dhe plotësim për duhanin.

Pra, Ligji për duhanin Nr. 02-L/36 është aprovuar më 3.10.2005 dhe ka hyrë në fuqi me Rregulloren e UNMIK-ut 1/2007, pra 15 muaj me vonesë dhe prapëseprapë nuk ka gjetur zbatueshmëri sepse ka ardhur në kundërshtim me rregulloren.

Në bazë të nenit 11.2 të Ligjit bazik për duhanin dhe akteve tjera në fuqi, Qeveria e mëparshme, kryeministri, në bazë të Rregllores së Qeverisë, neni 4.3, me Vendim Nr. 10/256 të datës 20.6.2007, ka themeluar Këshillin profesional për mbikëqyrje të Ligjit për duhanin dhe Këshilli ka mbajtur gjithsej 12 takime pune, duke avokuar gjithëherë për të vënë kriteret e standardet në baza ligjore, ashtu siç i kanë shumë vende të botës. Këshilli e ka Rregulloren e punës dhe Planin e punës, në bazë të cilave edhe punon.

Një ndër aktivitetet është përgatitur edhe letra e përkushtimit lidhur me nevojën për iniciimin e aktiviteteve të mbikëqyrjes së implementimit të ligjit sipas nenit 12 të Ligjit për duhanin, e cila letër është dërguar te kryeministri për nënshkrim me qëllim që të përkrahet Këshilli profesional për kontrollin e duhanit. Në këtë qasje, të gjitha ministratë do të kishin ndikim të rëndësishëm në implementimin e ligjit të cekur dhe një gjë e tillë nuk ka ndodhur gjë tani.

Unë konsideroj se ky projektligj nuk është vetëm përgjegjësi e Ministrisë së Shëndetësisë, por është përgjegjësi e të gjitha dikastereve të Qeverisë së Kosovës për zbatueshmëri.

Gjithashtu, Këshilli profesional për kontrollin e duhanit ka bërë vlerësimin e zbatueshmërisë së Ligjit për duhanin dhe këto vlerësime i ka ranguar në vlerësime të përparësive, në vlerësimet e dobësive, në vlerësimet e mangësive të implementimit të Ligjit dhe në vlerësimet e rreziqeve. Unë tash do të cek vetëm vlerësimet e rreziqeve, të cilat janë: zvarritja e sundimit të ligjit, interesi financiar i kompanive vendore dhe ndërkombëtare që të prodhojnë dhe të shesin duhan.

Tani kalojmë në këtë projektligj, të cilin e kemi përpara për plotësim dhe ndryshim. Projektligji për ndryshim dhe plotësim paraqet standardizim dhe harmonizim ligjor dhe është mirë i strukturuar. Qëllimi i Projektligjit është të mbështesë përpjekjet e shoqërisë për të zbutur dhe reaguar ndaj një problemi të madh të shëndetësisë publike, që është problem global botëror.

Risitë dhe avancimet e Projektligjit për ndryshim dhe plotësim të Ligjit për duhanin kanë për qëllim që të rregullojnë dhe kufizojnë konsumimin e prodhimeve të duhanit përmes normave ligjore dhe në bazë të evidencave dhe të fakteve bashkëkohore shkencore, nëpërmes të kontrollit efektiv të kualitetit të prodhimeve të duhanit të mbrojtë shëndetin e popullatës dhe të zvogëlojë sëmundjet dhe vdekshmërinë e ndërlidhur në mënyrë direkte apo indirekte me konsumimin e prodhimeve të duhanit.

Projektligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për duhanin Nr. 02-L/36 paraqet memorandum shpjegues, si dhe vlerësimin e ndikimit buxhetor që do të ketë një kosto shtesë në buxhetin e Ministrisë së Shëndetësisë dhe të Qeverisë me një shumë prej 880.000 për periudhën 2009-2012 dhe kjo kosto shtesë nuk është paraparë në Kornizën afatmesme 2010-2012. Prandaj, këto duhet të trajtohen brenda ndarjeve aktuale buxhetore që do të bënte ligjin të zbatueshëm.

Ndryshimet dhe plotësimet janë bërë në nenet e ligjit ekzistues, si vijon:

Në nenin 3.2, nenin 4.5, 6.2, 6.4, 6.5 dhe në nenin 14.1. Por, ky neni që është në Ligjin për ndryshim dhe plotësim, me nenin bazik të Ligjit 14.1, do të thotë neni 7 i Ligjit të ri, vjen në kundërshtim me këtë nen, ose është gabim teknik, por ne në komisionin funksional do të japim kontributin tonë dhe do ta rregullojmë këtë çështje.

Arsyeshmëria për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit për duhanin:

1. Tanimë zbatueshmëria e Ligjit sigurohet me Kushtetutë të Republikës së Kosovës, neni 94 pika 3 dhe neni 92 pika 3.
2. Vlerësimi i ndikimit buxhetor, që më parë nuk e ka pasur ligji ekzistues bazik, prandaj edhe janë paraqitur vështirësi në zbatueshmëri të ligjit.
3. Afati kohor dhe jopërputhshmëria me Rregulloren e UNMIK-ut 1/2007.
4. Këshillat e përgjithshme për mbrojtje të shëndetit në pakon e cigareve, do të thotë tash me Ligjin e ri do të jetë ballina e parë, me 30% mbulesë për këshilla për shëndetin dhe ballina e pasme me 40% të këshillave për shëndetin do të mbulohet dhe këto do të konkretizohen me këtë projektligj për ndryshim dhe plotësim.
5. Përcaktimi i sasisë së katranit, jo më shumë se 10 miligramë katran në një cigare, nikotina jo më shumë se 1 miligram në një cigare dhe monoksidi i karbonit jo më shumë se 10 miligramë në një cigare.

Këto kritere në paketime të duhanit duhet të verifikohen me ISO – standardin 8243 domethënë Organizata institucionale për standardizim, pra është rrjet i institucioneve kombëtare standardizuese nga 148 vende me qendër në Gjenevë, Zvicër, prandaj për të qenë ligji i zbatueshëm dhe për ta sfiduar këtë, Ministria e Shëndetësisë duhet të bëjë kërkesë Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë për të siguruar ISO standardet, do të thotë në mënyrë laboratorike për t'i përcaktuar kriteret e cekura. Për këtë kërkohet buxhet shtesë nga Qeveria e Republikës së Kosovës, por edhe të ndihmojnë në këtë drejtim edhe ministritë tjera në Qeverinë e Kosovës.

Ne e përkrahim dhe ju faleminderit për vëmendje!

KRYESUESI: Faleminderit! Në emër të komisioneve të përhershme s'e ka kërkuar askush fjalën. Tani, në emër të grupeve parlamentare, në emër të Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike të Kosovës, deputetja Mimoza Ahmetaj.

MIMOZA AHMETAJ: Faleminderit, zoti kryesues!

Të nderuar ministra,

Të nderuar deputetë,

Pa dashur të zgjatem me atë që e tha anëtarja nga Komisioni për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale, dua të them se Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës e ka analizuar dhe shqyrtuar ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për duhanin dhe duke shpresuar se ky ligj më në fund do të gjejë zbatueshmëri dhe do të respektohet dhe nuk do të ndodhë ajo që ka ndodhur deri më tani.

Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike i përkrah të gjitha këto ndryshime dhe sidomos respektimin e ISO standardit 8243, që përshkruan saktësinë e përmbajtjes së sasisë së katranit, të nikotinës dhe monoksid-karbonit.

Ligji në esencë nuk ka pësuar ndryshime, mbetet ai i vjetri dhe do të dëshiroja që si i tillë të respektohet dhe zbatohet.

Duke u nisur nga hapësirat tona, nga Parlamenti, i cili vetë e ka votuar këtë ligj më herët dhe, po të dilet tani në holl, të gjithë këta deputetë të cilët mungojnë sot në sallë, janë duke pirë duhan.

E pranojmë dhe ju ftojme që të votoni “për”. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Në emër të Grupit Parlamentar të Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës, deputetja Gjylnaze Syla.

GJYLNAZE SYLA: Faleminderit!

I nderuar zoti kryesues,

E nderuar ministre,

Të nderuar ministra,

Deputetë të nderuar,

Më lejoni të shpreh së pari shqetësimin për dëmin që shkakton përdorimi i duhanit, për një produkt kaq të popullarizuar në botë dhe, pa mëdyshje, në Kosovë dhe, njëkohësisht, kaq të rrezikshëm për shëndetin.

Prandaj, Grupi Parlamentar i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës e ka shqyrtuar me shumë seriozitet Projektligjin për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit për duhanin Nr. 02-L/36.

Me fjalë të tjera, për duhanin dhe produktet e tij nuk duhet të harrojmë efektet e dëmshme të pakontestueshme në shëndetin e popullatës, meqenëse është një problem i madh prandaj edhe pritjet tona kanë qenë që ndryshimet dhe plotësimet e propozuara do të jenë në efekt të zbatimit të ligjit dhe të fuqizimit të masave, sidomos të masave të monitorimit dhe të mbikëqyrjes së ligjit, e cila do ta bënte edhe ligjin më efikas.

Megjithatë, vërejtjet tona janë të përgjithshme në vetë mënyrën e hartimit të këtyre plotësimeve dhe ndryshimeve për arsye se nuk ka asnjë sqarim se çka në praktikë nuk është zbatuar. Do të përmend disa nga nenet shumë të rëndësishme të ligjit që nuk janë zbatuar në praktikë, veçanërisht shpreh shqetësimin për përdorimin e duhanit nga fëmijët dhe të rinjtë, por edhe moszbatimin e nenit 8.5 të Ligjit, i cili ndalon shitjen apo ofrimin e prodhimeve të duhanit nga personat nën moshën 18 vjeçare. Në praktikë ky ligj nuk është zbatuar, sepse jemi dëshmitarë se fëmijët edhe shesin duhanin, edhe përdorin duhanin deri në orët e vona të natës. Sa janë gjobitur dhe sa është shuma e këtyre gjobave, a ka punuar inspektorati në terren, nuk kemi të dhëna, edhe pse sipas ligjit gjobat janë prej 20 euro e deri në 10.000 euro.

Çka propozojnë këto ndryshime. Ndryshimet e propozuara kanë një rëndësi sepse me to propozohet zbatimi i standardeve ndërkombëtare, sidomos ato të cilat kanë të bëjnë me testimin e përbërësve të dëmshëm, të katranit, të nikotinës dhe të monoksid-karbonit, e që përfshin edhe formimin e laboratorëve. Pastaj, kontrollin e prodhuesve dhe përcaktimin e kushteve të marketingut të duhanit, ndryshimi i propozuar në nenin 14 pikë 1 të ligjit nuk ndërlihet fare me përmbajtjen e Ligjit dhe, në fund, është se ky hyn në fuqi më 1 janar 2010, sidomos pjesa e cila ka të bëjë me prodhimin dhe qarkullimin e duhanit në treg.

Prandaj, mangësitë e këtij projektligji janë, si vijon:

1. Qëllimi i Projektligjit, gjegjësisht i ndryshimeve dhe plotësimeve të propozuara është i paqartë, meqenëse nuk ka përshkrim të dispozitave të Projektligjit se çka është ndryshuar.
2. Mungon fuqizimi i dispozitave të caktuara ligjore, të cilat do të ndalonin sidomos përdorimin apo shitjen e duhanit nga fëmijët nën moshën 18 vjeç.
3. Mungon fuqizimi i masave mbikëqyrëse dhe të atyre ndëshkuese të zbatimit të ligjit, sidomos ku ka të bëjë me një mekanizëm i cili do të siguronte bashkëpunimin dhe koordinimin në mes të Inspektoratit qendror dhe inspektorateve komunale.

Një gjë është e vërtetë se zbatimi i këtij projektligji nuk mund të bëhet vetëm nga Ministria e Shëndetësisë, është i nevojshëm edhe involvimi i pothuaj të të gjitha ministrive tjera.

Një kusht i rëndësishëm për zbatimin e këtij ligji, e që është mangësi, është sigurimi i buxhetit për zbatimin e tij prej 880.000 eurove, i cili kërkon edhe formimin e laboratorëve për analiza të prodhimit, por po ashtu edhe punësimin e stafit shtesë që është deri në 5 zyrtarë dhe ndërtimin e sistemit informativ për kontrollimin e duhanit.

Sipas buxhetit, qoftë atë të vitit 2009 të vetë Ministrisë së Shëndetësisë, apo edhe Kornizës afatmesme të shpenzimeve, kjo shumë prej 880.000 eurove nuk është paraparë.

Të nderuar deputetë, po të ishte shëndetësia prioritet për Qeverinë, ashtu siç deklarohet, atëherë do të sigurohej buxheti i nevojshëm për zbatimin e këtij ligji, sidomos duke marrë parasysh se përdorimi i duhanit jo vetëm që e dëmton shëndetin, por shkakton edhe zvogëlimin e produktivitetit në punë, rënien e ekonomisë dhe rritjen e shpenzimeve, sidomos në sektorin e shëndetësisë. Po ta kishte seriozisht, Kryeministri do ta nënshkruante letrën e përkushtimit, e cila do të mundësonte mbikëqyrjen dhe zbatimin e ligjit.

Për shkak se ligji është i paqartë dhe për shkak të mungesës së kushtit themelor për zbatimin e tij, siç është ai i buxhetit, ne në parim nuk e përkrahim, për ftojmë Qeverinë që seriozisht t'i plotësojë kushtet e përmendura. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Në emër të Grupit Parlamentar të LDD-së ose të Aleancës Kosova e Re, i cili e doni fjalën? Kartela e Ibrahim Gashit. Rita Hajzeraj e ka fjalën.

RITA HAJZERAJ: Faleminderit, zoti kryesues!

I nderuar ministër,

Të nderuar ministra,

Të nderuar deputetë,

Është Ligji për duhanin, tani kemi plotësimin e Ligjit për duhanin dhe nuk ka shumë amendamente të cilat janë rregulluar në këtë ligj. Ky ligj ekziston që sa vite, por asnjëherë nuk është zbatuar dhe unë këtu e shoh problemin. Do të thotë, nuk është problemi se si të riamendamentohet apo të plotësohet, por se si të zbatohet ky projektligj.

E dimë fare mirë që mungon buxheti për realizimin e këtij projektligji. Andaj, dua t'i drejtohem ministrit të Shëndetësisë, dua të kërkoj përgjigje nga ai se si ka paraparë që ky projektligj të zbatohet duke pasur parasysh dhe besoj se do t'i marrë parasysh ministri i Shëndetësisë që ky projektligj, së bashku me Ministrinë e Shëndetësisë të ketë raporte dhe marrëdhënie edhe me ministri të tjera dhe të ketë përkrahje edhe nga ministritë e tjera, siç është Ministria e Tregtisë, Ministria e Ambientit, cilat ekzistojnë të gjithë botën për Ligjin për parandalimin e duhanit. Andaj, unë e shoh emergjente. Ne jemi plotësisht për aprovimin e këtyre ndryshimeve për këtë projektligj,

por ne jemi që në mënyrë urgjente të merren masa parandaluese dhe të merren masa ekzekutive për realizmin e këtij ligji, në tërësi. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Në emër të Grupit parlamentar të LDD-së, Qamile Morina.

QAMILE MORINA: Faleminderit, zoti kryesues!

Ministra, deputetë të nderuar,

Ligji për duhanin është miratuar nga Kuvendi i Kosovës në vitin 2005 dhe është shpall nga PSSP-ja në vitin 2007. Fatkeqësisht, ky ligj ende nuk është duke u zbatuar fare në praktikë. Ajo që është e pakuptimtë dhe e paarsyeshme, është posaçërisht moszbatimi i këtij ligji në nenin 10 që ka të bëjë me ndalesat e pirjes së duhanit, e në veçanti në institucionet shëndetësore e arsimore, duke pasur parasysh qëllimin e këtij ligji për të mbrojtur shëndetin publik.

Projektligji për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit për duhanit nuk shpjegon fare qëllimin e hartimit të këtij projektligji, që do të thotë fare nuk sqaron vështirësitë që janë hasur në moszbatimin e këtij ligji, si dhe arsyet që kanë shtyrë në hartimin e këtij projektligji. Projektligji ka gjithsej 8 nene, që fare substancialisht nuk e ndryshojnë ligjin paraprak. Kryesisht, nenet e propozuara kanë të bëjnë me formulimet ekzistuese të rregulluara në aspektin gjuhësor. Kështu, kemi përshtypjen se ky projektligj ka për qëllim të përmbushë një vakuum që është krijuar me mos procedimin e projektligjeve shumë me rëndësi nga Ministria e Shëndetësisë, që janë paraparë në strategjinë legislative, zoti ministër.

Implikimet buxhetore për këtë projektligj parashihen për vitin 2009 - 20.000 euro, edhe pse ky ligj parashihet të hyjë në fuqi në vitin 2010. Për vitin 2010 - 600.000 euro dhe për 2011 dhe 2012 nga 130.000. Kjo kosto shtesë buxhetore që është paraparë për themelimin e Laboratorit për analizën e përbërjes së duhanit dhe shpenzimet operative fare nuk janë përfshirë në Kornizën afatmesme të buxhetit, kështu që, zoti ministër, nuk është e qartë se si do të përcaktohen burimet shtesë për përballimin e kësaj kostoje buxhetore shtesë.

Sidoqoftë, ky projektligj për duhanin, natyrisht, nëse vetëm gjen zbatim, është i rëndësishë së veçantë nëse vë bazën ligjore për rregullimin, përparimin dhe përmirësimin e gjendjes shëndetësore të qytetarëve të Kosovës. Andaj, Lidhja Demokratike e Dardanisë në parim e mbështet miratimin e këtij projektligji.

KRYESUESI: Faleminderit! Grupi Parlamentar “7+”, deputeti Sadik Idriz.

SADIK IDRIZ: Hvala, predsedavajući!

Ministri, poslanici,

Parlamentarna grupa „7+“ će podržati ove izmene i dopune Nacrta zakona o duvanu. Smatramo da su to izmene koje su neophodne da bi taj zakon bio kvalitetniji.

S druge strane, u svojstvu predsednika komisije daćemo svoje, kao komisija, kao do sada i uvijek amandmane na postojeće članove zakona, mada ih je ukupno 8, da bi kvalitetniji bio zakon koji će biti usvojen.

To je u raspravi koja je vodjena prije nego ovaj zakon dodje u proceduru, na prvo čitanje ovde u Parlamentu, Komisija za zdravstvo, rad i socijalno staranje je imala jedno zajedničko mišljenje, o tome je govorila i poslanica Nurishahe Hulaj i ostali poslanici, ostali članovi Komisije da primena ovog zakona je problematična na Kosovu u dosadašnjoj fazi, da nije samo Ministarstvo zdravlja institucija koja se brine o ovom zakonu, ovaj zakon uključuje i druga ministarstva, to je Ministarstvo za ambijent, Ministarstvo za javnu administraciju, Ministarstvo za trgovinu i tako

dalje, znači veliki broj gotovo jedan značajan deo vlade treba da bude uključen i zbog toga je bila ranije formirana u prethodnoj Vladi i međjuministarska, odnosno vladina grupa, u fazi u kojoj je taj zakon i dosta kasnio, nije bio potpisan od strane Specijalnog predstavnika, znači tu su nadjeni neki razlozi. U ovom trenutku želimo da ovaj zakon bude u primeni, da krene njegova primena i da ovaj zakon, da Kosovo normalno želeći da ide u Evropu, ne može sa starim navikama da se ide, znači. Poštovanje zakona o duanu jeste u interesu svih građana Kosova i tu treba svi da daju svoj doprinos. Hvala!

KRYESUESI: Faleminderit! Në emër të Grupit Parlamentar SLS, Mursel Halili.

MURSELJ HALJILJI: Gospodine predsedavajući,

Dame i gospodo prisutni,

Ovaj nacrt zakona je dobrodošao i Parlamentarna grupa SLS i ako je pozitivno ocenila ovaj tekst, sa posebnim osvrtnom će doprineti da se očuva i zaštiti zdravlje građana, naravno kroz laboratoriju i analizu, proizvod i ispitivanje sastava duvana, to je veoma pozitivna stvar.

Medjutim, ja sam obratio pažnju na predmet Nacrta zakona u delu objašnjenja memoranduma i tako dalje, gde se pod 3. navodi, citiram: „zaštita dece adolescente od štetnih uticaja konzumiranja duvanskih proizvoda“. Ja bih dodao da decu ne trebamo da štitimo samo od toga, nego decu trebamo da zaštitimo od dodira sa duvanom, znači da se to ozbiljnije razmotri i jednostavno da se deca ne šalju, ovo apelujem na roditelje i da ... decu ne šalju da im kupuju cigarete i ako se to dogodi da policija ima mandat da svako takvo dete koje vidi da u rukama drži cigarete, ode do stana i da roditelje kazni zbog toga što je na indirektan način već doveo dete u vezi sa kutijom cigareta. To je ozbiljna stvar i za to vas molim da porazmislite o tome svemu. Velika je stvar da se ovaj nacrt zakona o izimenama i dopunama zakona o duvanu i sprovodi i zato Parlamentarna grupa SLS će dati pun doprinos i u funkcionalnim komisjama i naravno, gospodine ministre, da ćemo podržati ovaj nacrt zakona u načelu. Hvala!

KRYESUESI: Faleminderit! Tani vazhdojmë me diskutimet e deputetëve. Fjalën e ka deputeti Emrush Xhemajli.

EMRUSH XHEMAJLI: Faleminderit, zoti kryesues!

Përsëendetje ministër, ministra dhe deputetë!

Natyrisht që e përkrahim projekt-propozimin që është bërë. Mua, të them të drejtën, më ka habitur ardhja e plotësimit të këtij projektligji, sepse të gjithë ne kemi pritur që ai projektligj që ka qenë, të zbatohet, dhe pa i parë efektet e zbatimit, na ka ardhur në postë, me të vërtetë, unë për veti jam habitur, sepse s'ka bërë vaki prej se që jemi në Kuvend, një ligj ende pa u aprovuar të na vijë plotësimi e ndryshimi i tij. Kjo është një dhe është mirë shumë që bëhet kjo kështu, por po duket se kush është i fortë e bie edhe projekt-ndryshimin e ligjit. Bëhet fjalë për prodhuesit, bëhet fjalë për shitësit e duhanit për shkak se ata kanë pasur vërejtje, sikur që u tha edhe këtu, mirëpo vërejtjet e këtyre që po u dëmtohet shëndeti, kanë hasur në veshë të shurdhët.

E kam pas bërë një pyetje parlamentare lidhur me zbatimin e këtij ligji, po ka pasur të bëjë kryesisht me konsumimin e duhanit në vendet publike. Edhe nuk po shohim ndonjë farë efekti në ndalimin e duhanit, pirjen e tij nëpër vende publike në mënyrën qysh është paraparë në ligj, gjithashtu edhe ndalesat për përdorimin, shitjen dhe blerjen, sikur që është paraparë në ligj, të grup-moshave të caktuara nën 18 vjet e qysh është e paraparë. Prandaj, do të ishte mirë që të koncentrohemi të lëshohen udhëzimet administrative sa më shpejt që të jetë e mundur, që të duket efekti i ligjit në pjesën ku nuk ka shpenzime, se ne po e kuptojmë këtë, a po e shihni gjithë këto shpenzime po duhen për labore e për këto. E, për të lëshua urdhëresë administrative për një

lokal ose restorant ose vende publike, nuk do ndonjë farë shpenzimi ku të di sa të madh. Domethënë, pse ajo nuk po bëhet, është shumë e pakuptueshme. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Deputeti Armend Zemaj.

ARMEND ZEMAJ: Faleminderit, zoti kryesues!

Është e vërtetë që tanimë ky ligj edhe është vonuar ndoshta së zbatuari në praktikë, duke marrë parasysh që nga viti 2005 pengesat e UNMIK-ut në zbatueshmërinë, mospërkrahjen e Këshillit profesional dhe ne mendojmë që ndoshta me këto plotësim-ndryshime do të jenë më të implementueshme dhe të zbatueshme.

Unë e shoh rëndësinë që duhet të kemi një përkufizim ndoshta të pirjes së duhanit përmes anës ligjore dhe kujdes edhe në prodhimtari, por ajo çka më ka rënë në sy është nga aspekti ekonomik, ndoshta nuk do të ndalem më shumë në ruajtjen, që po flitet, të shëndetit publik se sa në atë që ka të bëjë me aspektin ekonomik dhe tregun e lirë.

Te neni 1, pika 3.2. thuhet prodhimi dhe qarkullimi i cigareve me përmbajtje nga paragrafi 1 i neni 3 është i obliguar, domethënë, nga janari 2010. Ndoshta do të ishte mirë që kjo fjali të ndryshohet dhe të jetë. do me thënë. i obliguar nga 1 korriku 2010. Edhe te neni 7, prodhuesit dhe importuesit e prodhimit të duhanit janë të obliguar që në afat prej 12 muajsh pas hyrjes në fuqi të këtij ligji, të vendosin shenjëzimet në paketime të prodhimit të duhanit të përcaktuar në bazë të këtij ligji.

U fol këtu, do me thënë, për koston që duhet ta ketë ligji, për laboratorin. Tash do ta jap arsyetimin pse e thash këtë. Sepse, afati gjashtëmujor për të filluar obligimi është i përcaktuar nga shumë kompani transnacionale që shesin produkte në Kosovë dhe që janë disa nga tatimpaguesit më të mëdhenj në buxhetin Kosovës. Kjo është sepse cigaret e tyre janë me ISO standardin dhe nuk kanë nevojë domethënë as që t'i nënshtrohen kësaj kontrole dhe këtij laborator. Dhe, domethënë, afati gjashtëmujor inkurajon shitjen e produkteve që nuk janë në përputhje me ligjin për një periudhë përafërsisht gjashtëmujore. Kjo, do me thënë, ndikon në tregun kosovar sidomos për kompanitë e huaja dhe nuk e promovon, do me thënë, nuk e promovon tregun e lirë dhe ky është një lloj kufizimi që do të ketë ndikim negativ në zhvillimin ekonomik. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti ministër dëshiron ta marrë fjalën.

MINISTRI ALUSH GASHI: Faleminderit, i nderuari kryesues!

Me sinjeritetin më të madh ju falënderoj për fokusim në këtë çështje, për të cilën dituria e kohës, në të cilën jetojmë, më nuk ka pikëpyetje a është apo s'është i dëmshëm përdorimi i duhanit. Duhani është definitivisht shumë i dëmshëm dhe do t'ju lutja që në një kohë të përshtatshme ne të zhvillojmë një debat për duhanin dhe zbatimin apo ndërtimin e një kulture për evitim të tymosjes së duhanit dhe, aq më tepër, që qytetarët që nuk kanë nevojë direkte për duhan, që mos të ekspozohen ndaj duhanit për të cilin definitivisht dihet që edhe ata që janë në prani ku tymoset duhani, diku 60 deri 70% kanë pasoja të njëjta.

Ne duhet të jemi të ndërgjegjshëm, ashtu siç tha deputeti Xhemajli, shumë prej veprimeve që mund të kryhen, nuk kanë një kosto të madhe buxhetore dhe Ministria e Shëndetësisë edhe para një viti i ka përgatitur të gjitha aktet nënligjore për ekzekutim të këtyre pjesëve të ligjit që është paraparë. Me një fjalë, këto ndryshime kanë të bëjnë me madhësinë e shkronjave dhe sipërfaqen në pjesën e përparme dhe në pjesën e pasme dhe, nën dy, kanë të bëjnë sa i përket çështjes së laboratorit dhe më vjen mirë që ju këtë e keni kuptuar dhe mu për atë edhe i dhatë mbështetje të fuqishme.

Lidhur me atë se si është vepruar në këtë fazë pa qenë ligji në fuqi 100%, Inspektorati sanitar i ka vizituar të gjitha ndërmarrjet e vendit tonë dhe ka ardhur në përfundim se ekziston një vullnet i afaristëve që t'u adaptohen rrethanave të ligjit të ri, por kjo e ka një kosto buxhetore për atë veprimtari.

Kemi rezultate initiale shumë inkurajuese sa i përket caktimit të hapësirës për përdorim të duhanit në institucione publike. E kemi ndalesën zyrtare në të gjitha institucionet e edukimit të të gjitha niveleve, si dhe në institucione shëndetësore, ndërsa në institucione publike janë të caktuara pak a shumë hapësirat. Arsyeja pse ne nuk kemi insistuar që të jenë dënime në këtë fazë, dënime të larta, se s'jemi të ndërgjegjshëm, se nën një, ligji duhet të hyjë në fuqi dhe, nën dy, ne kemi një popullatë e cila mbi 60 – 65% ka përjetuar trauma të rënda dhe ne na duhet të jemi shumë të kujdesshëm.

Një lajm i mirë është që mu edhe në këtë dhomë, një numër i kolegëve gjatë këtij viti e ka lënë apo e ka zvogëluar duhanin. Ju lus, që si figura publike, që keni mundësinë e përcjelljes së porosisë, që t'u ndihmoni njerëzve....

(Ndërhyrje)

Mua më duhet të mbaj ligjëratë, se këtë çështje e di mirë. Ju faleminderit shumë në mbështetje dhe jam i sigurt se pas votimit, në parim, dhe ndërrimeve që ju eventualisht do t'i mbështetni, ne së bashku do të ndihmojmë që ky ligj të jetë i suksesshëm, që sa më pak njerëz të vdesin. Ne jemi dëshmitarë që na kanë vdekur shumë njerëz të dashur si pasojë e helmimit me duhan. Ju faleminderit shumë!

KRYESUESI: Faleminderit! Sipas radhës, deputeti Naser Rugova.

NASER RUGOVA: Faleminderit, zoti kryesues!

Të nderuar ministra të Kabinetit qeveritar,

Të nderuar kolegë deputetë,

Po të shikohet faktografia e procedimit të këtij ligji në Parlamentin e Kosovës dhe odisejadat e mosimplementimit të tij në praktikë, edhe ky plotësim i Ligjit për duhanin më bën skeptik që me këto ndryshime kozmetike, edhe pse janë të nevojshme dhe unë personalisht do ta votoj këtë projektligj, në parim, nuk më bind shumë, zoti ministër, që do të gjejë jetësim në përqindje çfarë do të dëshironim, çfarë do të duhej edhe duke e ditur realitetin në Kosovë.

Unë do të ndalem shkurt, jo te qëllimet e projektligjit, dihet se plotësimi i ligjit është një mbështetje e përpjekjeve të shoqërisë kosovare për të zbutur dhe për të reaguar ndaj një problemi serioz që ka të bëjë me shëndetin publik të popullatës. Mirëpo, te kostoja buxhetore janë disa dilema që i ka shfaqur edhe Ministria e Ekonomisë dhe Financave, konkretisht Departamenti i buxhetit. Zbatimi i këtij projektligji, do të thotë, për duhanin do të ketë një kosto shtesë buxhetore, që kap shumën diku prej 880.000 euro në intervalin 2009-2012. Pastaj, kjo kosto shtesë nuk është paraparë në Kornizën afatmesme të shpenzimeve dhe jo një here është potencuar që projektligjet që kanë kosto shtesë buxhetore do të duhej të ishin paraparë në atë kornizë, sepse po ndikon drejtpërdrejt në zbatimin e ligjit, pastaj edhe institucioneve përkatëse që janë të thirrura me ligj ta zbatojnë ligjin në praktikë, po u pamundësohet për shkak të mungesave buxhetore.

Unë e kam edhe një dilemë tjetër. Në vitin 2009 janë paraparë vetëm përgatitjet për zbatimin e ligjit dhe pritet që ky ligj të fillojë të jetësohet prej 1 janar të vitit 2010, ku shihet edhe furnizimi me laborator dhe në vitet në vazhdim, do të thotë, zbatimi praktik i ligjit. Sipas skenarit, thotë, nëse do të kemi furnizim me laborator, do të ketë nevojë edhe për punësimin e punëtorëve shtesë, që

mendojmë se do të mjaftonin 5 zyrtarë, dhe nëse Ministria vendos të furnizohet me laborator, që nuk ishte dashur të jetë dilemë, ose duhet të vendoset dhe të mendohet cila është më pozitive për jetësimin e këtij ligji në praktikë, do të thotë pritet të kemi edhe të hyra të cilat do të trajtohen në bazë të legjislacionit në fuqi, edhe ky është një vakuum ligjor duke ndikuar në zvogëlimin e efekteve negative buxhetore. Dhe, së dyti, thotë skenari i dytë, nëse testimet për përbërjen e duhanit bëhen nga laborator i licencuar jashtë Ministrisë së Shëndetësisë, në çfarë institucione jashtë Ministrisë së Shëndetësisë apo edhe jashtë vendit, apo si është paraparë, do të duhej kjo që në mënyrë urgjente, ministër, ose të sanksionohet në këtë ligj në mënyrë direkte, ose do të duhej nxjerrë udhëzime administrative dhe akte tjera nënligjore, përndryshe frikoj që me këtë konfuzitet, në dukje, por që komplikohet pastaj në zbatimin e ligjit në praktikë do të ballafaqoheni ju me probleme direkte dhe mekanizmat përcjellës, andaj duke e mbështetur këtë ligj, qëllimin e mirë të tij dhe nevojën e plotësisht, duhet të merren masa konkrete edhe buxhetore, edhe përmes akteve nënligjore të tjera, përndryshe realiteti ka treguar se do të hasë në rezistencë të madhe në jetësimin këtij ligji. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka deputetja Flora Brovina.

FLORA BROVINA: Faleminderit!

Përsëritet zoti ministër,

Kryesues,

Ministër i Ambientit që qëndroi këtu, sepse sigurisht e ndjen që ligji i takon edhe këtij sektori.

Pajtohem me të gjitha propozimet që janë dhënë për plotësim-ndryshimin e ligjit dhe unë do të kisha thënë, pasurimin e këtij ligji, por dua të theksoj se këto mungesa nuk kanë qenë të vetmit shkas, madje këto nuk kanë qenë as shkas për mos implementimin e ligjit. Kjo dihet. Mund të jenë një nga shkaqet, por jo të vetmet.

Ligji i ka munguar neni kryesor. Neni kryesor quhet vullneti dhe ky quhet vullneti individual i të gjithë neve, por edhe institucional që ligji të aplikohet, i përcjellë sigurisht edhe me aksione konkrete, siç janë arsimimi kundër duhanit në masë, sidomos në institucionet e arsimit, të shëndetësisë, në institucionet publike, në komunikacion publik e tjera. I ka munguar anti-propaganda ose anti-marketingu, një mekanizëm i panjohur për ne që nuk përfshin vetëm shkronjat në pakon e cigares ose të dhënat për dozën e helmit, por përfshin një mekanizëm të tërë dhe shumë efikas në vendet ku ligji aplikohet me shumë sukses.

Ligji ka implikime buxhetore, por nxjerrja e disa akteve nënligjore mund të kishte filluar dhe mund të fillojë menjëherë që të implementohet ligji kundër këtij helmi masovik, që quhet nikotinë. Sidomos kjo është shumë e rëndësishme për të rinjtë dhe për gratë, sepse është mjaft i përhapur në këtë popullatë shumë të ndjeshme për nikotinën, veçmas për gratë shtatzëna, sidomos në lokalet ku ajo duhet të jetë plotësisht e ndaluar, në çerdhe, në shkolla, në lokalet publike.

Zoti ministër, ju thatë se ai është i ndaluar, por jo edhe i kontrolluar sepse duhani merret edhe në çerdhe, ai pihet edhe në shkolla, madje edhe nga moshat shumë vogla të fëmijëve, por fatkeqësisht edhe nga arsimtarët dhe edukatorët e tyre.

Unë propozoj një formë që do t'ju vjen ndoshta në ndihmë. Të lidhet një memorandum ndërministror në mes të Ministrisë së Shëndetësisë dhe ministrive gjegjëse, sidomos të Ministrisë së Arsimit, të Ministrisë së Ambientit dhe, pse jo, edhe të ministrive tjera për të marrë ato obligime që u takojnë që ligji të zbatohet sa më shpejt dhe edhe ne të mund të fillojmë ta ndjejmë implementimin e tij. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Deputeti Ibrahim Makolli!

IBRAHIM MAKOLLI: Faleminderit, zoti kryesues!

I nderuar ministër,

U tha shumëçka për këto përmirësime, janë gjithsej nga 7 a 8 nene, të cilat po që se i shikoni, e kanë të njëjtën domethënie, që ka të bëjë vetëm me shkronja. Por, unë do të shfrytëzoj rastin tash që të pyes ministrin, a ka qenë kjo pengesë për moszbatim të ligjit deri tash apo është diku tjetër. E theksuat që inspektorati ka vizituar të gjitha ndërmarrjet dhe kanë shpreh gatishmëri që kjo të bëhet.

Zoti ministër, ai ligj që e kemi, e thotë që të rinjtë nën moshën 18 vjeçare nuk mund të furnizohen, nuk lejohet dhe ne e dimë që nëse ka inspeksion pra, ato shihen, sepse janë gjithandej, madje jo vetëm që konsumojnë duhan ose u jepet, por shumicën në rrugë i keni fëmijët e moshës 5 deri në 12 – 13 vjeç, të cilët shesin duhan dhe unë nuk e besoj dhe askush nuk e beson që këto mangësi që i ka pasur ligji, e kanë bërë të pazbatueshëm atë ligj.

Gjithësesi, shtrohet nevoja tashmë që të ndërmerret diçka në këtë drejtim, por ajo që shihet këtu, janë dy çështje të cilat unë konsideroj... E para dhe shumë më e rëndësishmja, nëse shikoni këtu mirë, si duket, ka dikush gati një laborator për t'i dhënë një licencë, sikur në shumë fusha të tjera që janë dhënë licenca dhe njerëzit pastaj janë bërë milionerë sepse kanë pasur vetëm një të drejtë të kenë licencën. Dhe, e dyta, është zotëri ministër i Shëndetësisë dhe të gjithë të tjerët që involvohen në këtë çështje, është mungesa e veprimit të inspektorëve tuaj që janë nën kompetencat tuaja, të cilët nuk kujdesen për zbatim të ligjit. Nëse e shihni gjithandej, ju keni shumicën e duhanit që shitet në Kosovë, i kanë këto shenja me 30% përpara në ballinë dhe 30 mbrapa, kryesisht ato që importohen, përpos këto që këtu prodhohen, shumica prej tyre. Por, problemi është që nuk janë krijuar mekanizima për të implementuar këto ligje. Dikujt i konvenon të shkojë kështu dhe natyrisht iu konvenon atyre që në Kosovë fusin cigare edhe jashtë rregullave, jashtë normave, jashtë doganave e tjera e tjera, prandaj nuk ka pasur interesim. Por, do të ishte mirë, zoti ministër, që Ministria juaj të bëjë një raport dhe t'ia ofrojë këtij Kuvendi se pse nuk po zbatohet ky ligj dhe, po ashtu, të ndërmerren masa ndaj atyre të cilët nuk e zbatojnë ligjin ose janë të autorizuar që të përkujdesen për zbatim të drejtpërdrejtë të ligjit. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Radhën e ka deputeti Riza Smaka.

RIZA SMAKA: I nderuari kryesues,

Ministra,

Deputetë të respektuar,

Disa vërejtje parimore. Natyrisht, ky është një dokument që duhet të përkrahet dhe e mbështesim ministrin me ekipin që e ka bërë këtë punë. Do të kishim qenë shumë të lumtur sikundër të implementohej me konsekuencë ligji tepër i dobishëm. Këtu mund të flitet me orë të tëra, natyrisht, folën deputetët e nderuar.

Bie fjala, një sugjerim te paragrafi 3.2 i nenit 1. Thuhet – prodhimi dhe qarkullimi i cigareve me përmbajtje nga paragrafi 1 i nenit 3 është i obliguar të zbatohet. Natyrisht një shprehje, një formulim jo i qëlluar, ajo – është i obliguar nuk duhet, sepse mjafton kur thuhet zbatohet nga 1 janari, do të thotë është obligim.

Në memorandumën shpjegues thuhet, pletohet se me këtë dokument synohet për t'u mbrojtur duhanxhinjtë pasivë, mirëpo nuk ka dispozita për këtë. Më të dëmtuarit janë duhanxhinjtë pasivë, ju lutem, se duhanxhiu aktiv vetë e do, e bën dhe është i vetëdijshëm me siguri se është i dëmshëm. Mirëpo dëmtohet ai/ajo që nuk e pi duhanin, padrejtësisht dënohet. Dënohet, do të thotë, pa

aktgjykim të formës së prerë, edhe atë për çdo ditë në çdo vend. Prandaj, kjo pikë është neuralgjike dhe me të vërtetë, zotëri ministër, do të duhej të bëni atë që mund ta bëni në funksion të mbrojtjes së atij/asaj që nuk e pi duhanin. Ama e pi, sepse ia imponojnë të tjerët, që janë të papërgjegjshëm dhe të pandërgjegjshëm.

Te paragrafi 2, ku thuhet, bie fjala, se kjo është një vërejtje CV-faktive. Thotë, saktësia e paraqitjes së sasisë së katranit, nikotinës dhe monoksidit të karbonit në paketim verifikohet përmes ISO – standardi 8243. Nuk duhet kësisoj të thuhet, po vetëm sipas standardit. Ja pse, sepse ky standard 8243 mund të ndryshojë, të plotësohet, prandaj do të duhej më pastaj që edhe ligji ynë, por kur thuhet standardi, “s” e vogël, e nënkupton standardin në fuqi. Është fjala për teknikë juridike që ka rëndësi.

Dhe, te neni 14, paragrafi 1, do të isha angazhuar që të mos jetë 6 muaj ditë, por 3 muaj ditë të jetë, bile-bile është gjatë, por jo 6 muaj, se është fjala për një udhëzim që mund të bëhet brenda 7 ditëve, e mos të them brenda 3 ditëve, se sa më parë, aq më mirë, këtu është fjala.

Edhe te neni 8, jo ky ligj, se nuk është fjala për ligj, por duhet të thuhet – Ligji për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit për duhanin, hyn në fuqi. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, në radhë është deputeti Fatmir Rexhepi.

FATMIR REXHEPI: Faleminderit, zoti kryesues!

Unë, personalisht s’pata për ta marrë fjalën, po gjatë debatit u entuziazmovë shumë nga paraqitja e ministrit dhe ftesat që na i bëri si doktor i mjekësisë, deputetëve që ta lëmë duhanin. Unë po e pranoj zotëri doktor, po është mirë, e kam një kërkesë tash, në funksion të asaj që ju e shtruat që me një nen të veçantë ta propozoni ju dhe komisioni të... të gjithë doktorave që ta pinë duhanin ose ta lënë profesionin. Vetëm për një arsye, jo pse po them unë si deputet, po është mirë, do të thotë, për të forcuar besimin dhe në profesionin e juaj dhe në shembullin juaj dhe në rekomandimet mjekësore që na i jepni neve si pacienta, se pirja e duhanit vërtet e rrezikon shëndetin. Faleminderit!

KRYESUESI: Fjalën e ka deputeti Ardian Gjini.

ARDIAN GJINI: Faleminderit, zoti kryesues!

Zoti ministër, respekt!

Dola këtu për shkak se u bë njëfarë kohe dhe ka filluar të bie ritmi i Kuvendit. E kam një pjesë të historisë me këtë ligj qysh se është aprovuar herën e parë. Është, ish-kolegu im këtu Sadik Idriz dhe e di që unë e kam heq një dy herë prej procedurës ligjin kur kam pas mundësi ta heq atëherë, jo pse unë atëherë kam qenë duhanxhi ose jo vetëm për atë arsye, por se edhe atëherë kam biseduar se ligji është totalisht i pazbatueshëm, domethënë në vitin 2005, në fillim të vitit 2005 dhe më vonë kur nuk kam pas mundësi ta tërheq, ligji është aprovuar, kam qenë kundër, do të thotë, atëherë në Qeveri, kam qenë kundër në Parlament dhe jam kundër edhe tash dhe do të shpjegoj pse.

Fillimisht, prapë është sensi i njëjtë. Ne po bëjmë ndryshime të një ligji, pa e pasur një raport të zbatimit të ligjit ekzistues, domethënë sa po zbatohet – është pyetje e thjeshtë, krejt e thjeshtë, krejt triviale, po pse nuk po zbatohet, është pyetje tepër interesante, se nëse kemi përgjigje pse nuk po zbatohet, kemi mundësi ndryshimet e ligjit t’i bëjmë asisoj që ligji të paktën në masë më të madhe të zbatohet. Çështja tjetër është Kuvendi i Kosovës duhet të ketë kujdes a po kalojmë në fazë tjetër të punës së Kuvendit, apo kemi ngelë të ngujuar në sistemin e punës të vitit 2001 dhe 2002, kur realisht gati sa vetëm kemi ushtruar për të qenë kuvend. Do të thotë, e dimë të gjithë të cilat janë të

metat e një ligji, e dimë të gjithë pse vjen ndryshimi i ligjit dhe, në fund të fundit, votojmë diqysh për çudë të gjithë dhe kalon ligji.

Pse kam qenë kundër atëherë? Atëherë kam qenë kundër se Projektligji për duhanin tenton t'i rregullojë 3 fusha të ndryshme të duhanit dhe nuk e rregullon asnjërën. Fillimisht flet për konsumin, ku mund të konsumohet, ku mund të konsumohet, në cilat institucione bën, në cilat nuk bën, do të thotë, tenton ta rregullojë edhe çështjen e konsumit dhe ne e dimë se nuk e ka rregulluar. Në holl të Kuvendit të Kosovës pihet duhan, do të thotë, nuk ka mbërri ta rregullojë këtë çështje, nëpër spitale pihet duhan, nëpër shkolla pihet duhan, kështu që nuk e ka rregulluar.

Aspekti i dytë, të cilin tenton ta rregullojë është distribuimi i ligjit. Bile-bile, e keni një nen i cili thotë, nuk bën të shiten cigaret nëpër automate, makina. Ju të gjithë e dini, kushdo që shkon në cilindro restorant të Prishtinës për drekë, në hyrje të cilitdo restorant ka makina për shitje të duhanit. Do të thotë, as çështja e distribuimit nuk është rregulluar.

Aspekti tjetër, është çështja e prodhimit të duhanit, tenton ta rregullojë, i keni nenet të cilat thonë, nuk bën të ketë më shumë 10 miligramë nikotinë e tjera, e tjera, i dini, nuk po i përsëris dhe, shihni ju se sa është rregulluar në atë aspekt. Do të thotë, tri aspekte totalisht të ndryshme që duhet të jenë të ndara, janë grumbulluar në një ligj, i cili absolutisht fare nuk respektohet.

Tani, çështja tjetër është pse, domethënë është pyetje tepër serioze, pse po e ndryshojmë ligjin. E është sensi për të cilin fola për një ligj paraprak – pse po e ndryshojmë ligjin? Ministri i Shëndetësisë, me gjithë respektin, nuk na tregoi qartë pse po e ndryshojmë, çka po ndryshojmë, çka ndodhë në momentin kur ky ligj hyn në fuqi, cilat do të jenë ndryshimet që ne i shohim qoftë në holl të Kuvendit, qoftë në spitale, qoftë te duhanxhinjtë, nuk kemi shpjegim. A dini çka ndryshon, ka krejt karakter komercial, është lobuar prej kompanive që distribuojnë, prej disa kompanive që distribuojnë cigare, është lobuar që të bëhet ky ndryshim i ligjit. Bile, para një viti ka pas ide që të jetë rregullore administrative. Ministër, nuk është luftë e juaja kjo. Kjo është temë komerciale, nuk ka të bëjë me pirjen e duhanit. Ka të bëjë vetëm me lobet e fuqishme të distribuimit të duhanit dhe tani neve si deputetë na servohet si ndryshim i ligjit për duhanin, se dikush e ka pa se ka për të qenë tepër kontraverze të aprovohet rregullore administrative për t'iu lejuar disa njerëzve të distribuojnë në mënyrën qysh donë të distribuojnë. Kjo është esenca. Po pse nuk po mundet dikush të dalë në Kuvend dhe të na tregojë ne se kjo është arsyeja pse ne po e ndryshojmë ligjin. Nuk ka të bëjë me fëmijët që pinë duhan, nuk ka me fëmijët që sheshin duhan, nuk ka të bëjë me spitalet, nuk ka të bëjë me Kuvendin. Ka të bëjë me shitësit.

Kjo është, domethënë, një temë për të cilën duhet të flasim, ju thashë edhe një herë, gjithmonë mendoni çka ndodhë nesër mbasi të aprovohet ligji.

Çështje tjetër është, çka është mesazhi që Kuvendi e dërgon në këtë rast. Është mesazh tejet jo korrekt, është tejet jo korrekt. Unë po ju them, ish-kolegëve të mi, duhanxhinj – mos keni dert se nuk ju tradhtoj, e di çka është të pihet duhanin, se e kam pi 20 vjet, që 1 vit e kam lënë, është shumë më mirë për ta lënë. Pajtohem me ministrin! Është tepër më mirë. Ama, ne këtu po flasim për jo korrektësi. Nuk po zbatohet ligji, në hallë të Kuvendit pihet duhan. A pihet duhan? A e dini ju të gjithë se pihet duhan në holl të Kuvendit? Ne e kemi aprovuar ligjin, për shembull.

Çështje tjetër tepër me rëndësi, që duhet të përmendet, është pse prapë, e kam përmendur disa herë përpara, po e përmendi për herë të fundit sot – pse Agjencioni Antikorrupsion nuk kërkohet të japë mendimin e vet për projektligjet të cilat na vinë përpara neve. Unë nuk po them që dikush në Ministrinë e Shëndetësisë po synon të krijojë hapësirë për korrupsion me këtë ligj. Po, ajo që po them është që çdo vendim i Kuvendit ose krijon hapësirë për korrupsion, ose mbyll hapësirë për

korupsion dhe ne na duhet ta kemi një vlerësim të paktën të Agjencisë Antikorupsion çka ndodhë në momentin kur ky ligj aprovohet në aspektin e krijimit të hapësirës për korupsion. E kemi marrë, shembull të marrim, mendimin e Agjencisë për Integritet Evropian, është krejt në rregull. Gjithmonë vlerësimet janë pa lidhje se nuk dinë çka vlerësojnë ata, por është në rregull t'i marrim. Tani po na duhet, se korupsioni është temë tepër serioze në Kosovë. E kemi një agjencion i cili nuk duhet të shërbejë vetëm si agjencion që i mbledhë deklaratat tona të pasurisë, që në shumicën e rasteve nuk janë të vërteta, por të mendojë në aspektin struktural a po aprovojme ne diçka që krijon rrethana për veprime korruptive në Kosovë dhe, unë po ju them juve, që ky ligj që po e ndryshojmë ne tash, nuk ka për të ndryshuar absolutisht asgjë që ka të bëjë me konsumin e duhanit as me distriubimin, por e kam njëfarë ndjenje dhe ne e kemi njëfarë ndjenje që krijon hapësirë për veprime korruptive. Duke i pasur parasysh të gjitha këto dhe duke pasur parasysh se kjo nuk është tema realisht e Ministrisë së Shëndetësisë, kjo ka qenë dashur që të jetë temë e Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë dhe Ministrisë së Ekonomisë e të Financave, ne mendojmë se nuk duhet të kalojë dhe përgjigjet e sakta duhet të jepen për këtë ligj dhe, në fund të fundit, për kryesuesin e seancës edhe për kryetarin nëse më dëgjon, le të krijohet një dhomë dinjitoze për duhanxhinjtë e Kuvendit, për shkak se është një dhomë tepër jo dinjitoze, dhe kjo është një prej arsye pse pihet duhan në holl të Kuvendit. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! I fundit, deputeti Gani Buçinca.

GANI BUÇINCA: Të nderuar kolegë deputetë,

Ju kisha lutur për vëmendje për atë sa do të jetë diskutimi përmbajtësor, kurse ju zotëri kryesues, ju falënderoj për fjalën që ma dhatë!

Përshëndes edhe ministrat që janë këtu prezantë!

Problemi i duhanpirjes është një problem që e shqetëson tërë komunitetin botëror, jo vetëm Kosovën, është një problem që ekziston si problem që nga ekzistimi i njeriut dhe ne nuk duhet të pretendojmë këtu që këtë problematikë shumë shqetësuese edhe për botën demokratike, edhe ekonomisht të konsoliduar do ta zgjedhim as me këto ndryshime që i ka paraqitur ministri, as në të ardhmen e afërt. Mirëpo, ne nuk duhet të dyshojmë me qëllimin e mirë të ministrit dhe të projektligjit, i cili kërkon disa ndryshime që në këtë fazë pak a shumë të bëhen përpjekje që ky fenomen, kjo dukuri shqetësuese në shoqëri pak a shumë të minimizohet, të kufizohet dhe të jetë më pak e dëmshme.

Unë jam i prirur që këto ndryshime t'i mbështes, duke ju tërhequr vëmendjen për një çështje e cila më ka preokupuar gjatë – pse në Kosovën e pas luftës vetëm dy artikuj, dy artikuj nuk kanë pësuar ngritje të çmimit dhe në mesin e këtyre dy artikujve është duhani dhe alkooli. Dy artikuj shumë të dëmshëm e kanë një çmim standard, e kanë një shkallë të tatimit shumë të ulët dhe njëfarë mënyre këto e stimulojnë dhe duhanpirjen, e stimulojnë këtë çështje.

Kur po flitet këtu se mungojnë paratë për ta zbatuar këtë ligj, po më duket krejtësisht absurde. Në një produkt ku mund të fitohen shumë para, tepër para mund të fitohen, mund të përfitojë edhe buxheti i Kosovës, ne e shtrojmë problemin e 800.000 eurove për zbatimin e këtij ligji. Unë, zoti ministër, ju kisha lutur që ju në bashkëpunim me Ministrinë e Tregtisë dhe Industrisë, në bashkëpunim me Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë t'i bëni me analizë të thukhtë dhe t'i përdorni ato standarde të cilat përdoren për duhanin në rajon dhe më gjerë në Evropë. Unë jam vetë konsumues i duhanit dhe mund t'ju them dhe ju kërkoj falje të gjithë atyre që e pinë duhanin, mirëpo nuk mundet të konsumohet duhani, të lejohet çmimi kaq i ulët i duhanit në Kosovë, se është një prej faktorëve më stimulues për duhanpirësit. Në këtë kategori bie edhe vet. Domethënë, është e patolerueshme. Mirëpo, duhani si një fenomen, padyshim, i prek disa kategori, është një kategori psikologjike që i prek duhanpirësit dhe duhet të merren masa adekuate që njerëzit t'i eliminojnë këto shprehje të këqija qysh janë dhe duhet dhënë edhe para, duhet investuar edhe para

që në njëfarë mënyre njerëzit të cilët dëshirojnë të vetë dëmtojnë shëndetin e vet edhe kanë probleme, duhet t'u krijohej mundësia që ata të konsumojnë dhe të krijojnë ambiente të posaçme. Kjo kërkon investime të të gjitha subjekteve, qofshin ato publike, qofshin ato private dhe këtu duhet të jemi më të ndërgjegjshëm që t'i japim kohës kohë, që të përgatiten edhe institucionet publike, edhe institucionet private që kjo masë ligjore të zbatohet në praktikë.

Pastaj, është një problem tjetër, një problem shumë i madh që duhet ta trajtojmë, ta trajtojmë në mënyrë të përgjegjshme – të ngrehim akcizën e duhanit dhe pikërisht me ato mjete të cilat grumbullohen nga ngritja e akcizës, të krijohej mundësia për luftimin e duhanpirjes si dukuri, që ato para të shkojnë në Ministrinë e Shëndetësisë, siç u cek edhe këtu, që pastaj të bëjë propagandë për parandalimin e kësaj dukurie dhe të këtij fenomeni.

Tjetër, unë ju kërkoj falje të gjithë atyre që janë duhanpirës, jam edhe vet, po duhet të ndërgjegjësohemi të gjithë se duhani e dëmton shëndetin, jo vetëm të atij që e pi, po edhe të tjerëve, kështu që ne duhet të bëjmë përpjekje të gjithë që t'i heqim këto shprehje.

Një problem tjetër që desha ta shtroj. Nuk mundet në lokalet ku pihet duhani të jetë çmimi i njëjtë i pijeve, qofshin ato pije alkoolike ose joalkoolike. Ne duhet të licencojmë edhe lokalet ku pihet duhani, mirëpo aty duhet të jenë çmimet 100% më të shtrenjta se në lokalet ku nuk pihet duhani dhe krejt ato para duhet të shkojnë në buxhet të Kosovës, përkatësisht në Ministrinë e Shëndetësisë. Në luftë kundër duhanit ne duhet t'i bëjmë këto klasifikime, t'u tregojmë njerëzve që në rast se pinë, në rast se dëmtojnë shëndetin e vet personal dhe shëndetin e të tjerëve, duhet të paguajnë, duhet të paguajnë për këtë dhe kjo është një masë që e zbatojnë edhe në perëndim, duhet ta zbatojmë edhe ne. Mua ma merr mendja se mos aprovimi i këtyre ndryshimeve vjen vetëm nga ato qarqe të cilat dëshirojnë të tolerojnë edhe më tutje kontrabandën e duhanit ose janë të lidhura në njëfarë mënyre me ato qarqe të caktuara.

Mirëpo, në fund krejt, desha të theksoj se duhani trajtohet edhe si kategori ekonomike. Ju duhet të dini se në botë shumë njerëz jetojnë prej duhanit. Kultivimi i duhanit sjell edhe leverdi ekonomike, sjell edhe vende të punës dhe në këtë kontekst nuk e ka të lehtë as kjo Qeveri, e më së paku ministri i Shëndetësisë, që këtë fenomen, këtë dukuri, këtë problem në shoqëri tonë ta zgjedhim shpejt. Mirëpo, unë e përshëndes përkushtimin e Qeverisë dhe të ministrit që t'i bëjmë hapat e parë në këtë aspekt. Ju ftoj që ta votojmë, t'i votojmë këto ndryshime.

KRYESUESI: Faleminderit! Konstatoj se diskutues tjerë nuk ka. Pak më parë kuorumi ishte, tani nuk e di si është. Në sallë janë 62 deputetë, që do të thotë se ka kuorum për të votuar. Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim, votojmë tani:

Konstatoj se me 46 vota “për”, 6 abstenime dhe 7 “kundër”, Kuvendi miratoi në parim Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 02-L/36 për duhanin.

Në bazë të Rregullores së Punës, Kuvendi i ngarkon këto komisione:

- Komisionin për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale, si komision funksional,
- Komisionin për Legjislacion dhe Gjyqësi,
- Komisionin për Buxhet dhe Financa,
- Komisionin për Komunitete, dhe
- Komisionin për Integritet Evropian.

Komisionet duhet që brenda dy muajve nga shqyrtimi i parë, Kuvendit t'i paraqesin raportet me rekomandimet.

Vazhdojmë me pikën e tetë të rendit të ditës.

(Reagime nga salla)

Kush është lodhur, tash nuk e di. Por ne duhet ta realizojmë programin që e kemi. Mos t'u ndejt Ardian, natën e mirë! Ne do t'i diskutojmë, pra në qoftë se nuk ka kuorum, do t'i diskutojmë ligjet, për nesër mbetet vetëm votimi. Nesër nuk ka diskutim për debat për ligjet që diskutohen sot.

(Ndërhyrje nga salla)

Kush nuk mundet të rrijë, le të shkojë. Ne duam ta realizojmë programin që e kemi. Çka kam të bëj unë, ne duam të punojmë, s'kemi orar të punës ne. Paguhemi për t'i miratuar ligjet. Ju lus, nesër askush nuk ka për ta marrë fjalën për Ligjin kundër korrupsionit, ata që nuk janë këtu. Keni të drejtë vetëm të votoni.

- **Shqyrtimi i parë i Projektligjit kundër korrupsionit**

Në bazë të Rregullës 35.1 të Rregullores së Punës, janë përmbushur kushtet për shqyrtim dhe miratim në parim të këtij projektligji.

Ftoj ministren e Drejtësisë, zonjën Nekibe Kelmendi që në emër të Qeverisë së Republikës së Kosovës para deputetëve të Kuvendit ta prezantojë projektligjin. E keni fjalën, zonja ministre.

MINISTRJA NEKIBE KELMENDI: I nderuari kryesues i seancës plenare,

Të nderuar deputetë,

Të nderuar ministra,

Në emër të Ministrisë së Drejtësisë, sipas Strategjisë së hartimit të ligjeve për vitin 2009, pas miratimit në Qeveri, sot para jush paraqes Projektligjin e ri kundër korrupsionit, për të cilin jap sqarimet, si në vijim.

Hartimi i Projektligjit në fjalë është nevojë imanente për ndryshimin e Ligjit antikorrupsion në fuqi, në mënyrë që me projektligjin i cili është objekt shqyrtimi në lexim të parë, të mënjanohej zbrazësitë e ligjit në fuqi, të bëhet rregullimi i kësaj fushe sipas nevojave të kohës, të bëhet përshtatja me rrethanat e krijuara pas zgjidhjes së statusit të Kosovës dhe hyrjes në fuqi të Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe të bëhet...

KRYESUESI: Më falni, kuorum ka të mjaftueshëm për debat. Faleminderit!

MINISTRJA NEKIBE KELMENDI:... harmonizimi me standardet ndërkombëtare për luftimin e korrupsionit në shtetin tonë.

Qëllimi i këtij projektligji është marrja e masave kundër korrupsionit brenda fushës së veprimit të strategjisë kundër korrupsionit, përcaktimi i përgjegjësisë së Agjencisë Kundër Korrupsionit, si institucion i pavarur dhe i specializuar, por edhe përgjegjës për zbatimin e politikave shtetërore, për luftimin dhe parandalimin dhe raportimin e rasteve të korrupsionit dhe për t'i bërë dispozitat e këtij ligji të përshtatshme dhe më efikase me përpjekjet për parandalimin dhe luftimin e korrupsionit, i cili tanimë nuk është vetëm fenomen, por është shndërruar edhe në dukuri në disa institucione të rëndësishme publike. Pos kësaj, hartimi i Ligjit të ri kundër korrupsionit mundëson

eliminimin e vërejtjeve të identifikuara me Raportin e progresit për Kosovën në fushën e sundimit të ligjit.

KRYESUESI: Deputetët e koalicionit të mos dalin prej sallës, jeni në seancë!

MINISTRJA NEKIBE KELMENDI: Me këtë projektligj fuqizohet dhe bashkëpunimi midis agjencisë dhe Qeverisë së Kosovës dhe organizatave qeveritare e joqeveritare në hartimin e Strategjisë kundër korrupsionit, dokument ky me të cilin ndërtohen politikat kundër korrupsionit, të cilat duhet t'i zbatojnë institucionet përgjegjëse të Republikës së Kosovës.

Me miratimin e këtij projektligji do të rritet efikasiteti i punës së prokurorive në zbulimin dhe ndjekjen penale të kryerësve të veprave penale të korrupsionit.

Këto do të ishin vetëm disa sqarime të përgjithshme përkitazi me këtë projektligj. Tani do të kalojë në disa sqarime më konkrete.

Ky projektligj dhe Projektligji për deklarimin, prejardhjen dhe kontrollin e pasurisë, dhe ai për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për parandalimin e konfliktit të interesit përbëjnë tërësinë e ligjeve komplementare, si instrumente të përshtatshme për parandalimin dhe luftimin e korrupsionit.

Projektligji ka gjithsej 28 nene, përkatësisht 8 kapituj. Është përvjedhur një gabim teknik në numërimin e kapitujve, sepse dy herë është shkruar Kreu IV, kështu që numri IV romak duhet të shndërrohet në V, V-shi në VI dhe më tej ligji është krejtësisht në rregull. Prandaj, kjo duhet të kihet parasysh kur të miratohet ky projektligj në lexim të parë dhe të eliminohet ky gabim.

Me Kreun I – Dispozitat e përgjithshme, rregullohet qëllimi i ligjit dhe përkufizimet e nocioneve që përdoren në tekstin e projektligjit.

Kreu II- përcakton statusin dhe përgjegjësinë e Agjencisë Kundër Korrupsionit në kuadër të të cilave vend të veçantë zë zbatimi i politikave shtetërore për luftimin dhe parandalimin e korrupsionit në Kosovë, autonominë për menaxhimin e buxhetit, kompetencat e agjencisë, pagat dhe kompensimet, organin udhëheqës, drejtorin e agjencisë dhe procedurat për emërimin e tij. Rregullon edhe pagën e drejtorit, shkarkimin e tij, përgjegjësitë dhe kompetencat e drejtorit, kompetencat dhe detyrimin e tij për t'i raportuar agjencisë përkatësisht organit – komisionit që do të caktohet.

Me Kreun III- parashihet themelimi i një komisioni të veçantë parlamentar, mbikëqyrës i agjencisë, i cili do të drejtohet nga opozita, për të cilin janë paraparë kompetencat e komisionit për ta shqyrtuar dhe miratuar raportin e agjencisë në seancë parlamentare.

Me Kreun IV- rregullohet detyrimi për hartimin e strategjisë kundër korrupsionit dhe i planit të veprimit.

Me Kreun V- rregullohet mënyra e zhvillimit të hetimeve paraprake, raportimi i rasteve të korrupsionit, qasja në dokumentacionin e autoriteteve publike dhe të personave privatë, pavarësia e zyrtarëve të agjencisë gjatë ushtrimit të detyrës së tyre.

Me Kreun VI- është rregulluar çështja e pranimit të dhuratave nga personat zyrtarë, kufizimet e marrjes së dhuratave, regjistrimi i dhuratave dhe i vlerave të tyre.

Ç'është e vërteta, kjo materie është sugjeruar nga faktorët ndërkombëtarë që kanë marrë pjesë, sidomos nga Komisioni Evropian, në hartimin e Ligjit, kanë sugjeruar që kjo çështje të bartet në Ligjin për deklarin dhe prejardhjen e pasurisë, prandaj meqë kemi të bëjmë me një pako ligjesh të cilat dua të shpresoj se do të qiten në rend dite për një seancë të njëjtë plenare, gjatë shqyrtimit nëpër komisione, sidomos në Komisionin për Legjislacion, Gjyqësi dhe Çështje Kushtetuese të vlerësohet nëse duhet të mbetet ky kapitull këtu apo të bartet në ligjin që e përmenda.

Me Kreun VII- është rregulluar mbrojtja e të dhënave, ruajtja e shënimeve dhe fshehja e informatave.

Dhe, me Kreun VIII, ku bëhet fjalë për dispozitat kalimtare dhe përfundimtare, me të cilin sanksionohet lënia jashtë fuqie e ligjit të mëparshëm, por kur jemi këtu, unë e bëj një përmirësim, sepse nga diskutimi i sotëm e pranova se është bërë edhe këtu një gabim, duhet të ceket dhe të konkretizohet cili ligj shfuqizohet. Me këtë rast, më lejoni ta bëj një përmirësim dhe të them se në dispozitat kalimtare në nenin 7, se me hyrje në fuqi të këtij ligji shfuqizohet Ligji Numër 2004/34 kundër korrupsionit. S'ka dyshim se ky ligj është në harmoni edhe me Konventën Evropiane Antikorrupsion, e po ashtu edhe me ligjet tjera dhe standardet ndërkombëtare.

Në fund, deputetë të nderuar, ju lus që këtë ligj ta miratojmë në lexim të parë, duke qenë e vetëdijshme se ky nuk është i përsosur dhe ka hapësirë që të përmirësohen të gjitha ato zbrazëtira apo gabime që janë përvjedhur gjatë hartimit të tij. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Unë dua t'ju kërkoj falje për shkak se shumica e deputetëve e kanë lëshuar seancën, zoti Hamiti e ka kërkuar fjalën për procedurë, do t'ia jap fjalën në qoftë se mendon se duhet të thotë diçka dhe jemi të detyruar ta ndërpresim.

SABRI HAMITI: Zoti kryesues,

Ju e keni listën sa njerëz janë brenda dhe sigurisht edhe Rregulloren e dini. Pa numrin e caktuar, nuk duhet të bëhet as debati...

KRYESUESI: 37 kanë mbetur në sallë, ishin 42.

SABRI HAMITI: Urdhëro! Po, po, tash po e kuptoj. Pra, nuk mund të votohet pa qenë një më shumë se gjysma e të gjithë deputetëve, por debati nëse janë 40 mund të bëhet, kështu që dihen rregullat.

Po, unë desha të them diçka që e kam përsëritur edhe në legjislatura tjera, se u përkas atyre njerëzve që janë në tri legjislaturat, ku janë krijuar shumica edhe të mëdha, edhe shumica të vogla dhe nuk po bëj asgjë tjetër, pos po e përsëris, sepse jam i detyruar ta përsëris.

Deputetët janë të lirë të kenë mendimin e vet, por deputetët nuk janë kaq të lirë që ta lëshojnë Kuvendin kur tu teket. Aq më tepër, deputetët e shumicës nuk guxojnë të mbeten pakicë. Le të vlen kjo për PDK-në që është këtu, le të numërohen kush janë dhe pse janë, LDK-në dhe të tjerët që janë në koalicion. Puna e opozitës dihet, po qe se iu teket, dalin dhe bën vaki, një muaj nuk vinë në Kuvend. Nuk është mirë të ndodhë kjo, por ndodhë nëpër parlamente. Është punë e tyre.

Besoj se nuk është mirë as për ta që të lëshohet Parlamenti kur ka të bëjë me ligje të rëndësishme, por prapë është problem i tyre. Ajo që krijon shumicë, ajo ka përgjegjësi. Dhe, unë tjetër më shumë, zoti kryesues, nuk kisha ç'të them, por është e sata herë që duhet të përsëritet kjo, sepse këta njerëz, si duket, ende nuk e kuptojnë rëndësinë që e kanë, edhe pse ju e dini, cili ta hapë

gojën, thotë jam përfaqësues i popullit sa që gati kam filluar të mos e përdor më dhe të gërditem prej asaj mënyre të identifikimit.

Shumica e ka detyrim të jetë në sallë kur votohet në gjithë dynjanë e mirë ose të keqe, sepse ajo duhet t'i kalojë, ta ketë forumin të votojë “për” dhe “kundër”. Çdokush është i lirë dhe të votojë edhe “për” edhe “kundër”, por është e detyruar të krijohet shumica. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Shpresoj se RTK-ja do ta zgjasë transmetimin më shumë kur kemi seanca dhe rrimë më gjatë. Kaq, përfundoi seanca. Nuk kemi kuorum. Nesër vazhdojmë në orën 10.

E mërkurë, 10 korrik 2009, ora 10:22

Drejton seancën: Kryetari i Kuvendit të Republikës së Kosovës, zoti Jakup Krasniqi,

KRYETARI: Të nderuar deputetë,

Sipas orarit, seanca ka qenë dashur të fillojë në orën 10.00, tani është 10:22 minuta.

Jemi duke e shqyrtuar Projektligjin kundër korrupsionit, do të thotë, shqyrtimi i parë. Dje ministria e Drejtësisë, zonja Nekibe Kelmendi e ka paraqitur fjalën hyrëse. Radha është e kryetarit të Komisionit për Legjislacion dhe Gjyqësi. Fjalën e ka deputeti Bahri Hyseni.

BAHRI HYSENI: Ju faleminderit, zoti Kryetar!

Përshëndetje të nderuar ministra,

Kolegë deputetë,

Do të flas edhe në emër të Komisionit për Legjislacion, por edhe në emër të Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike të Kosovës.

Projektligjin kundër korrupsionit e kemi shqyrtuar në komision dhe në grup parlamentar dhe gjatë shqyrtimit kemi konstatuar se është një projektligj i cili i plotëson të gjitha kriteret që sot të lexohet në parim, dhe natyrisht që, si deputet, kemi vendosur ta përkrahim, në parim.

Projektligji kundër korrupsionit ka një rëndësi të veçantë, mirëpo nuk është projektligj për herë të parë, sepse institucionet e Kosovës kanë pasur një projektligj të cilin e kanë zbatuar deri më tani, mirëpo për shkaqe të ndryshme, në kohën kur është aprovuar dhe për shkak të rrethanave tani që i kemi të reja në Kosovë, ky projektligj i ka pasur edhe mangësitë e veta, prandaj sponzorizuesi apo Qeveria e Kosovës e ka parë të arsyeshme që të krijojë apo të krijoj një projektligj komplet të ri. Ne e respektojmë sponzorizuesin, gjegjësisht Qeverinë e Kosovës, që brenda afatit të paraparë edhe në agjendën legjislative, ka prurë të gjitha projektligjet të cilat flasin kundër korrupsionit dhe, natyrisht, në Komision, në bashkëpunim edhe me Zyrën ndërlidhëse të Komisionit Evropian, përfaqësuesit ndërkombëtarë, përfaqësuesit e Zyrës së EULEX-it jemi duke biseduar që komplet si projektligje t'i kalojmë dhe mundësisht t'i amendantojmë duke i bartur nganjëherë edhe amendamentet nga një projektligj në projektligjin tjetër, duke i konsoliduar më mirë.

Unë do të prek vetëm disa çështje, për të cilat do të kemi dilemë dhe do të kisha dashur që deputetët e Parlamentit sot të na ndihmojnë.

Çështja e parë, është çështja e përbërjes së komisionit. Ne e dimë që aktualisht Agjencia kundër Korrupsionit e ka një këshill, një këshill i cili ka pasur përbërje hetoregjene dhe ka pasur

përfaqësues nga shumë institucione, duke filluar nga Kuvendi i Kosovës, nga Prokuroria, nga institucionet tjera, të cilat realisht nuk kanë treguar efikasitet duke marrë parasysh se ka qenë një përbërje hetoregjene dhe në shumtën e rasteve ndoshta edhe për shkak të Projektligjit apo të amendamenteve, të neneve që i ka pasur projektligji, kanë hasur në kundërtënie në mes veti dhe ka ndikuar në punën e Agjencionit. Tani nga Qeveria e kemi pothuaj të njëjtin propozim, mirëpo për dallim shkruhet se do të formohet një komision nga Kuvendi i Kosovës, shumë etnik, shumë partiak, do të udhëhiqet nga opozita, mirëpo nuk përcaktohet shumë qartë se a do të jetë vetëm nga deputetët e Parlamentit të Kosovës, apo do të jetë një komision qysh ka qenë edhe paraprakisht, një këshill qysh ka qenë. Edhe Zyra ndërlidhëse e Komisionit Evropian, por edhe ne si komision, mendojmë se komisioni duhet të jetë nga deputetët e Kuvendit të Kosovës, sepse ky këshill që ka ekzistuar deri tash, ju thashë se ka pasur probleme dhe për shkak të përfaqësimit shumë institucional, mandej edhe çështja e sigurisë së të dhënave, çështja e debateve të mëdha ka ndikuar në efikasitetin.

Çështje tjetër që vlen të përmendet dhe që është vërejtje edhe e Komisionit ndërlidhës, Komisionit Evropian, është çështja e drejtorit, mënyra e emërimit të drejtorit dhe mënyra e shkarkimit të drejtorit, për çështjet për të cilën edhe ne si komision pajtohemi. Në rend të parë, në çdo projektligj po rregullohet paga e menaxherëve, kjo është një dukuri që nuk duhet ekzistuar në të ardhmen. Ne jemi duke përgatitur Ligjin për pagat e funksionarëve të lartë publikë dhe nuk ka nevojë çdo ligj tash ta rregullojë pagën e menaxherëve, secili ligj po e parasheh pagën për vete. Kjo është një dukuri që nuk duhet të ekzistojë, prandaj këto mendoj që duhet ta kemi të qartë që ne do të shikojmë ta amendamentojmë, sepse edhe pagën si e kanë kërkuar, thotë të kryetarit të një komisionit parlamentar, mendoj që nuk mund të zbatohet zbatohet. Dhe, çështja tjetër, thotë, rreth shkarkimit, drejtori do të shkarkohet nëse bie në kundërshtim me funksionin e tij kundër ligjit. Është diçka e paqartë, duhet të qartësohet, është një përkufizim që e keni bërë, që nuk dimë çka të veprojmë në këtë mënyrë. Mirëpo, ne shpresojmë se do ta eliminojmë me amendamente.

Dhe, krejt në fund, është një kapitull komplet në Ligjin kundër korrupsionit për dhuratat dhe ne jemi të mendimit, si komision, por edhe në bashkëpunim me faktorin ndërkombëtar, që këtë kapitull ta bartim në Ligjin për deklarimin e pasurisë, sepse nuk e ka vendin te Ligji kundër korrupsionit. Prandaj, jemi të mendimit, besoj që edhe deputetët do të na përkrahin, që ky kapitull i dhuratave të kalojë te deklarimi i pasurisë, sepse nuk e ka vendin këtu. Dhe, një shqetësim është edhe rreth mbrojtjes së informacioneve të besueshme, do me thënë është kërkuar në Ligjin e Agjencisë kundër korrupsionit që të ruhen ato fshehtësitë nga stafi i Agjencisë, mirëpo nuk është kërkuar dhe nga anëtarët e Këshillit që do të jenë. Prandaj, këtu është pak një dilemë e madhe. Nëse janë deputetë të Parlamentit, ne e kemi një rregullore ku të gjitha punët i bëjmë në mënyrë transparente, me dyer të hapura. Mirëpo, ndoshta në të ardhmen, për shkak të rëndësisë që ka Agjencioni Antikorrupsion dhe lëndët të cilat shqyrtohen në antikorrupsion, ndoshta do ta kemi parasysh që në rastin e shqyrtimit të raporteve të tilla, të mendojmë mënyrën se si do ta organizojmë takimin me dyer të mbyllura apo do t'ju lejojmë qasje vetëm atje ku nuk preket interesi i qytetarëve të Kosovës.

Prandaj, në parim, Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike dhe komisioni e mbështesin ligjin. Ju faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit!

Në emër të Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike, fjalën e ka kërkuar deputeti Armend Zemaj.

ARMEND ZEMAJ: Ju faleminderit, zoti Kryetar!

I nderuar zëvendëskryeministër, ministra

Të nderuar kolegë deputetë,

Grupi Parlamentar i LDK-së e ka shqyrtuar me kujdes të veçantë Projektligjin kundër korrupsionit, duke marrë parasysh se po plotësohet infrastruktura ligjore që ka të bëjë me parandalimin dhe luftimin e korrupsionit, si në sektorin publik dhe në të gjitha lëmit e jetës.

Përcaktimi i masave që adresohen në këtë Projektligj, përmirësojnë dhe avancojnë veprimet, si dhe mbikëqyrjen e drejtpërdrejtë të Agjencisë kundër Korrupsion për zbulimin dhe hetimin e korrupsioneve brenda fushës së veprimit të Agjencisë dhe rritjen e bashkëpunimit edhe me Prokurorinë Publike.

Risite në këtë projektligj janë, sidomos mbikëqyrja e drejtpërdrejtë e Agjencionit, Agjencisë Kundër Korrupsionit nga Kuvendi i Kosovës përmes një komisioni të veçantë, që tani me këtë ligj do të udhëhiqet nga opozita. Ne mendojmë që ngritë besimin dhe shton transparencën dhe efikasitetin në luftimin e korrupsionit, si nga agjencia, ashtu edhe nga institucionet tjera.

Vërejtjet tona që janë parimore, edhe pse do ta mbajmë mbështetjen në parim, janë te pagat dhe kompensimet e stafit të Agjencionit dhe te neni 9, paga e drejtorit, ku është e përshkruar që të jetë në lartësinë e kryetarit të komisionit parlamentar të Kuvendit të Kosovës, që ne mendojmë që nuk është mirë e sqaruar dhe e definuar, sepse kryetari i komisionit parlamentar të Kuvendit të Kosovës duhet të jetë deputet dhe mund ta ketë pagën, për shembull, të thuhet të një deputeti, mos të shkojë mbas funksioneve, se ka edhe funksioneve tjera dhe kjo mund të keqkuptohet. Sigurisht, e tha edhe kryetari i Komisionit, që ne jemi në hartim e sipër te ligjeve tjera që rregullojnë pagat e zyrtarëve të lartë publikë.

Grupi parlamentar e vlerëson dhe jep mbështetjen, në parim, duke dhënë kontributin edhe në komisionet tjera, edhe në komisionin funksional. Ju faleminderit!

KRYETARI: Ju faleminderit!

Në emër të Grupit Parlamentar të Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës, Ardian Gjini e ka kërkuar fjalën, apo Donika Kadaj. Ju, kush e keni fjalën në emër të Grupit?

DONIKA KADAJ-BUJUPI: Ju faleminderit!

I nderuar kryetar,

Të nderuar kolegë deputetë,

Sigurisht, të gjithëve na kujtohet që pak më shumë se një vit, kur kjo Qeveri erdhi në pushtet, ne e kishin një slogan - zero tolerancë kundër korrupsionit. Mirëpo, ne po thuaj se gati dy vite nga ajo kohë, ne kemi një - zero transparencë dhe zero llogaridhënie me një sistem komplet të korruptuar. Këtë e thonë të gjitha raportet vendore dhe ndërkombëtare. Nuk është ajo për çka alarmon pozita, pothuajse që dy vite, por është diçka që thuhet në të gjitha raportet, e së fundi, edhe në raportin e fundit.

Pasojat për Kosovën, apo ku e çon kjo Kosovën, është drejt degradimit, mungesës së investimeve, zhvillimit ekonomik, më pak vende pune, më pak liberalizim apo fare liberalizim të vizave dhe një geto të përgjithshme, në të cilin gjendet rinia e Kosovës. Gjithashtu, një zvarritje të procesit të integritimeve, kjo prapë bazohet në të gjitha raportet ndërkombëtare.

Qytetarët e Kosovës, partnerët tanë ndërkombëtar, të gjithë...

KRYETARI: Deputete, Ligji antikorrupsion...

DONIKA KADAJ-BUJUPI: ... dhe të gjithë njerëzit që presin që kjo Qeveri dhe këto institucione të reja ta luftojnë korrupsionin, presin që kjo të bëhet në dy mënyra. E para, që të kemi ligje të mira, në të cilat do të bazohet kjo luftë kundër korrupsione, ligje të cilat duhet të prodhohen nga Qeveria e Kosovës dhe, e dyta, që lufta kundër korrupsionit të mos bëhet vetëm me retorikë, por të bëhet me hapa konkretë, duke u bazuar në ligje. Ajo çka keni sjellë ju sot këtu para nesh, e nderuar Qeveri, zëvendëskryeministër, është më tepër një konkurs, e shihni, paragrafi 3.2 përshkruan që drejtori i Agjencisë kundër Korrupsionit duhet të ketë diplomë universitare. Paramendoni me çka është ngarkuar ky ligj edhe çka është substanca e këtij ligji, në bazë të cilit duhet të luftohet korrupsioni. Do të thotë, thuhet që drejtori duhet të mos ketë qenë i dënuar për vepër penale, të ketë integritet të lartë moral, të ketë së paku 5 vite përvojë pune profesionale edhe na po e bazojmë Ligjin kundër korrupsionit në një fazë kur Kosova po alarmohet prej korrupsionit, kur të gjitha raportet vendore, ndërkombëtare flasin për një shkallë të lartë të korrupsionit, në një ligj, i cili flet që drejtori i Agjencionit Kundër Korrupsionit, duhet të ketë diplomë universitare. Prandaj, kjo flet se ku jemi, se si po e luftojmë luftën kundër korrupsionit, që nuk kemi më së pari aftësi për t'i bërë ligjet dhe unë këtu do të ftoja Qeverinë e Kosovës dhe të gjithë kolegët e mi deputetë, jo sot ta kthejmë, por të kërkojmë që të rishkruhet ky ligj, sepse është ligj që do të bëjë që në Kosovë me të vërtetë duhet të fillojë lufta kundër korrupsionit dhe, nëse Qeveria dhe, do të thotë, ministria përkatëse nuk e denjë, nuk është e aftë, nuk ka profesionalizëm që ta bëjë një ligj të mirëfilltë në një sektor themelor dhe bazik për Kosovën, mund të kërkojnë edhe prej opozitës t'ju ndihmojë dhe t'i përkrahë.

Ne, si grup parlamentar, jo që nuk do ta përkrahim, por kërkojmë rishkrimin e tij. Edhe njëherë i ftoj kolegët deputetë mos ta kalojmë sot, e keni shumicën e votave, por nuk është mirë ta kaloni se nuk ka kurrëgjë në te, shumë thjeshtë, s'ka kurrëgjë.

KRYETARI: Kërkoj nga deputetët në vijim që të flasin për Projektligjin kundër korrupsionit, por le ta dinë edhe partitë e opozitës që nuk janë bash krejt të liruar nga korrupsioni. Në sallë kemi 79 deputetë. Fjalën në emër të Grupit Parlamentar të AKR-së e ka Ibrahim Gashi.

IBRAHIM GASHI: Ju faleminderit, zoti Kryetar!

Përshëndetje zëvendëskryeministër,

Ministra prezentë,

Të nderuar deputetë,

Është e vërtetë që po bisedojmë për një ligj me rëndësi të veçantë për shtetin e Kosovës në proceset e shtetndërtimit dhe sikundër edhe të gjitha ligjet që në këtë instancë vijnë në fazën e parë, do me thënë në leximin e parë vijnë me mangësi dhe ne jemi të thirrur që të japim kontributin tonë për t'i korrigjuar. Mendoj që edhe ligji që e kemi tash në shqyrtim, është një prej atyre ligjeve që ka mundur të jetë, ka disa paqartësi, që në faza, do me thënë, të leximit të parë dhe të dytë të amendamentimit, mund të korrigjohet dhe, duke pasur parasysh këtë se mund të intervenohet, nëse ka disponim që të bëhet një ligj i mirë, Grupi Parlamentar i AKR-së, në parim e mbështet, por do të provojmë që edhe gjatë leximit të parë dhe gjatë amendamentimit të japim kontributin konkret.

Më së pari, te emërtimi i ligjit ka një dilemë. Ligji, thuhet Projektligji kundër korrupsionit dhe pastaj menjëherë neni i parë, qëllimi i ligjit, ligji i adresohet, i dedikohet vetëm Agjencionit Kundër Korrupsion dhe komisionit parlamentar.

Mendoj që ky ligj duhet të vlej edhe për Qeverinë, duhet të vlejë edhe për mekanizmat tjerë që e luftojnë korrupsionin dhe ndoshta nuk ishte dashur me u definuar bash kaq ngushtë, e para. Pastaj, kjo shihet, do me thënë, kjo përzierje e kompetencave në luftën, në këtë fushë të veprimit të institucioneve në mënyrë të përbashkët, vërehet te neni i parë, do me thënë pika 4 dhe 5, bën

monitorimin, thotë, dhe mbikëqyrë zbatimin e strategjisë kundër korrupsionit. Cilës strategji? E kujt është kjo strategji, dhe menjëherë më poshtë, neni 1.5, thotë: “Në bashkëpunim me komisionin, Qeverinë dhe institucionet tjera kompetente harton, monitoron dhe zbaton planin e veprimit kundër korrupsionit”. Harton dhe monitoron prapë është një formulim që nuk shkon bash mirë, do të thotë, cilën strategji e harton, çka është plani i veprimit, çka është strategjia, do të thotë edhe këtu, në këto dy pika do të duhej të korrigjohet.

Pastaj, është pika 1.10, që për mua nuk është prapë shumë e qëndrueshme, përfaqësohet në takime ndërkombëtare që kanë të bëjnë me korrupsionin, si dhe merr pjesë në procesin e negociatave për lidhjen e marrëveshjes bilaterale dhe multilaterale, apo miratimin e instrumenteve ligjore ndërkombëtare kundër korrupsionit. Mendoj që Agjencioni nuk është instancë aq kredibile dhe me kompetencë vendimmarrëse në shtet, sa që ta përfaqësojë shtetin e Kosovës në takimet të tilla, ku bisedojnë qeveritë për luftën kundër korrupsionit ose mekanizma të Komisionit Evropian. Edhe këtu i është dhënë një kompetencë, për mendimin tim, shumë e madhe komisionit dhe është mbetur Qeveria që në njëfarë mënyre ka për të qenë ajo që ka mekanizëm zbatues të luftës kundër korrupsionit.

Pika 6, prapë do të thotë jemi te një moment, jemi te pika e zgjedhjes së drejtorit, pika e gjashtë, drejtori zgjidhet për mandat 5 vjeçar, për drejtorin e Agjencionit është fjala, për mandat pesë vjeçar, dhe mund të rizgjidhet vetëm edhe për një mandat. Mendoj që edhe këtë rizgjedhjen duhet rishikuar. Një post kaq me përgjegjësi, nuk duhet, mendoj unë, lënë të drejtën e rizgjedhjes në një mandat të dytë. Duhet rishikuar praktikatat e vendeve se si e bëjnë këtë për arsye se është një post tepër delikat.

Pastaj, është neni 21, pavarësia në ushtrimin e kompetencave. Mendoj që thuhet këtu çka thuhet, mirëpo nuk është asnjë mekanizëm që i mbron këto, do me thënë që e mbron antikorrupsionin. Pavarësia nënkupton edhe një mekanizëm mbrojtës. Ai nuk mund të ketë pavarësi në ushtrimin e funksionit të vet dhe të misionit të vet për çka e thërret ky ligj, nëse nuk ka edhe një mekanizëm që e mbron. Ne e kemi, aktualisht e kemi atë agjencion pa asnjë mbrojtje. Njerëzit kanë hyrë dhe me kërcënim ia marrin dosjen dhe i kërcënojnë të gjithë ata dhe dalin pa therë në këmbë, që thotë populli. Do me thënë, ne po bëjmë ligj për një agjencion dhe nuk po e kemi një mekanizëm që e merr në mbrojtje atë agjencion.

Sigurisht që kolegët nga grupi im parlamentar kanë, si të them, edhe vërejtje tjera, kanë edhe kontribut tjetër në nenet tjera, thashë në parim e përkrahim, por duhet të punohet shumë në këtë ligj. E përkrahim për arsyen e vetme se Kosovës i duhet ky ligj. Por, natyrisht, duhet të zgjerohet pak, ky ligj të shërbejë, si të them, edhe për instancat tjera që janë të thirrura se disi po mbesin anash dhe krejt lufta kundër korrupsionit po koncentrohet, sipas këtij ligji, të një agjencioni vetëm. Ju faleminderit!

KRYETARI: Ju faleminderit!

Tani është radha e Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike të Dardanisë. Fjalën e ka deputeti Lulzim Zeneli.

LULZIM ZENELI: Ju faleminderit, zoti Kryetar!

Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike të Dardanisë konsideron se si dokument i cili ofron një bazë edhe për strategjinë e veprimit, edhe për planin e veprimit, duhet të reflektojë pozitivisht nga deputetët e Kuvendit të Kosovës, me vullnetin më të mirë që, të paktën në aspektin e legjislacionit, të bëjë një hap pozitiv në këtë drejtim, e para, dhe, e dyta, edhe pse pretendohet të luftojë korrupsionit përmes këtij ligji, konsiderojmë se ky ligj, nga emërtimi i këtij ligji është

shumë megaloman. Arsyeja qëndron në faktin se kjo materie përfshin vetëm organogramin apo strukturën e brendshme të agjencioni, duke përfshirë edhe rolin e komisionit parlamentar.

Pjesa tjetër që ka të bëjë me hartimin e strategjisë dhe planin e veprimit kundër korrupsionit, këtu preket si çështje që i adreson përgjegjësitë në Agjencionin Antikorrupsion dhe organet qeveritare, por me involvim edhe të mekanizmave joqeveritarë. Ajo çka do të duhej të reflektonte pozitivisht në këtë ligj, se fillimisht duhet që përmes këtij ligji të adresojmë edhe përgjegjësitë tjera që kanë të bëjnë me ruajtjen e pavarësisë së institucionit të pavarur, siç është Agjencioni Antikorrupsion, në mënyrë që të garantohet nga refleksionet e ndryshme politike dhe jopolitike, në mënyrë që ta kemi një institucion i cili me të vërtetë, me përkushtimin më të madh do të krijonte transparencë sa i përket këtij fenomeni.

Të flitet për korrupsion sot, nuk është tema e ditës. Ato më së miri reflektohen prej raporteve ndërkombëtare. Mirëpo, si Grup Parlamentar i Lidhjes Demokratike të Dardanisë, ne e mbështesim në parim, duke shprehur nevojën e domosdoshme që ky ligj të pasojë edhe me ligjet përcjellëse. Ju faleminderit!

KRYETARI: Ju faleminderit, deputet!

Në emër të Grupit Parlamentar “7+”, fjalën e ka deputeti Enis Kervan

ENIS KRVAN: Ju faleminderit, zoti Kryetar!

Sayın başkan, başbakan yardımcısı, bakanlar ve değerli milletvekilleri

Kosova Cumhuriyeti'nin yeni yapılanmasında Kosova Hükümeti olası rüşvetleri engellemeye yönelik yeni bir yasa tasarısı düzenlemeyi uygun görmüştür. Dolayısıyla Parlamento Komisyonu'nda Tasarıya yeşil ışık yakmasıyla birlikte, birinci okunuşu genel kurulda gündeme gelmiştir. Tasarıda elbetteki kimi açıklamalar eksiktir ve kimi değişikliklere ihtiyaç mevcuttur. Kosova Meclisi'nde çok etnikli bir komisyonun kurulacağı belirtilmektedir. Ancak bu komisyonda kimlerin üye olacağı belirtilmemiştir. 7+ Parlamento Grubu, kurulacak olana bu komisyonda milletvekillerinin yer almasının daha mantıklı olacağı düşüncesindedir. Aynı zamanda, Yasa Tasarısının 6. maddesinde müdürün yeniden süresi dolduktan sonra bir tekrar seçilme imkanının verilmesinin de mantığa karşı olduğu düşüncesindedir. Bu konunun da görüşülüp araştırılması gerekmektedir. 7+ Parlamenro Grubuna göre hediyeler bölümü de bu Taslaktan çıkartılarak var olan konuyla ilgili diğer yasalara aktarılmalıdır.

Kosova Cumhuriyetinin resmi kurumlarında ve tabi ki diğer özel kurumlarda da rüşvetin önlenmesini amaçlayan bu Yasa Tasarısını destekliyoruz, önergelerimizi mevcut komisyonlara sunacağız.

Faliminderit!

KRYETARI: Ju faleminderit, deputet!

Në emër të Grupit Parlamentar të SLS-së, fjalën e ka kërkuar deputetja Kosara Nikoliq

KOSARA NIKOLIĆ: Hvala, gospodine predsjedniče!

Pozdrav Vladinom kabinetu,

Pozdrav svima kolegama poslanicima i poslanicima,

Poslanička grupa SLS je razmatrala Nacrt zakona protiv korupcije i mi ga u načelu podržavamo, jer smatramo da se radi o jednom veoma važnom zakonu. Svoj doprinos u vezi nekih dopuna,

daçemo kroz učešće u funkcionalnim komisijama. Apelujemo da se on u praksi primenjuje, da li je bio ovakav ili izmenjen, smatramo da može dopunjavati kosovski budžet. Hvala!

KRYETARI: Ju falemidnerit, deputete!

Do të thotë, grupet parlamentare e kryen. Kemi të lajmëruar edhe 10 deputetë deri më tani për fjalë. Fjalën e ka kërkuar deputeti Ardian Gjini, le të përgatiet Sanije Alijaj.

ARDIAN GJINI: Ju faleminderit, zoti Kryetar!

Të nderuar deputetë,

Zëvendëskryeministër, ministra,

Disa çështje prapë pak a shumë të njëjta me formatin e sjelljes së ligjeve. Çështja e parë është kjo, kur e kemi marrë planin legjislativ, na dalin disa elemente të cilat i kemi përmendur atëherë edhe sot i shohim. Ky ligj nuk ka qenë dashur që të vijë nga Ministria e Drejtësisë, fillimisht. Duhet të them se ky ligj ka qenë dashur që të vijë te ne nga Zyra e Kryeministrit, se në atë rast, atëherë formati i rrjedhjes së ligjit kishte për të qenë krejt ndryshe.

Lufta kundër korrupsionit, Agjencioni Antikorrupsion nuk tangojnë me Ministrinë e Drejtësisë, por drejtpërdrejtë me Zyrën e Kryeministrit të Kosovës dhe mendoj se ky është një prej gabimeve. Çështje tjetër është se kur kemi këso ligjesh të rëndësishme, kemi mundësi të reflektojmë edhe në procedura, për të cilat folëm dje, cilat janë procedurat, në çfarë mënyre po debatojmë për ligjet ne.

Seriozisht, të nderuar kolegë, unë mendoj se ministrat duhet t'i mbrojnë ligjet dhe kur një ministër e sjell një ligj në Kuvend, është totalisht absurde që të thuhet - bëni amendamente sa të mundeni, por vetëm kalon ligjin. Nëse një ligj është funksional, nëse për një ligj njerëzit kanë menduar shumë, ndryshimi i vetëm ose vetëm një amendament mund t'ia ndërrojë kuptimin ligjit. Në Kuvend e marrim një projektligj, për të cilin thuhet se do të bëjmë amendamente, do ta ndryshojmë, atëherë ne kuptojmë se ligji ka ardhur në Parlament pa u studiuar, pa u menduar mirë, pa u përpunuar si duhet, fillimisht, para se të vijë tek ne dhe dikush thotë, po kalon ligjin njëherë, kalon ligjin qysh të mundeni, e mbasandaj ndërroni çka të doni. Nëse një ligj është tepër i rëndësishëm, nuk guxon të sillet këtu dhe të thuhet - bëni amendamente.

Ju kujtohet juve në të kaluarën, ka pasur raste kur një ministër i çuditshëm ka dal dhe e ka mbrojtur ligjin amendament për amendament, se e ka ditur që ai ligj, nëse i ndryshohet një amendament, ndryshohet koncepti politik për cilën e ka sjellë ministri këtu ligjin, fillimisht, kjo është një çështje. Çështja tjetër është se, nëse ligji shpreh vullnet politik dhe duhet të shprehë vullnet politik për shkak se partitë në pushtet që e kanë shumicën, i bëjnë ligjet, kjo është normale në çdo vend të botës. Atëherë, ai vullnet politik nuk mund të ndryshohet me 100 amendamente të ligjit. Ministri duhet të vijë dhe ta mbrojë pikë për pikë, fjalë për fjalë ligjin ashtu si e ka sjellë dhe t'ju shpjegojë deputetëve pse e ka sjellë ashtu si e ka sjellë, e jo të vjen ligji dhe thotë - bëni amendamente sa të mundeni, çka doni bëni, vetëm kalone ligjin. Këto janë çështje, fillimisht, sa për të ndërtuar një kontekst për ligjin.

Tani, shikoni, e keni nenin 1 të Ligjit kundër korrupsionit, i cili thotë, po citoj: "Ky ligj përcakton statusin dhe përgjegjësitë e Agjencisë kundër Korrupsionit dhe Komisionit parlamentar mbikëqyrës të Agjencisë", do të thotë, ky nuk është Ligj kundër korrupsionit, ky ligj rregullon diçka tjetër dhe ka qenë dashur të paktën emri t'i vihet se çka rregullon ligji. Ligji nuk merret me luftë kundër korrupsionit, por i rregullon dy institucione të cilat duhen të merren, do të thotë, është indirekt i lidhur me këtë çka po flasim.

Çështje tjetër është, për shembull, pse nuk kemi mendim të bashkëngjitur, është diçka që po e përsëris disa herë dhe mendoj që dikush po dëgjon, pse nuk kemi të bashkëngjitur mendim të

Agjencionit Antikorrupsion për Ligjin. Agjencioni Antikorrupsion, nuk mund të merret, vetëm t'i grumbullojë të dhënat tona për pasurinë tonë, ju lutem, jam duke e përsëritur disa herë. Ata duhet të japin mendim se janë Agjencion, nuk janë zyrë. Agjencioni jep mendim për ligjet, mendim të shkoqitur dhe na tregon, a na ndihmon ky ligj a jo, është agjencion profesional.

Çështje tjetër, Ligji nuk lejon që Agjencioni Antikorrupsion të shndërrojë sistem për luftë kundër korrupsionit, nuk e shndërron luftën e korrupsionit në çështje sistemore, por merret me çështje krejt detaje, me radhitje tepër mekanike, të cilat në fund të fundit, realisht, as nuk na bëjnë shumë nder. Që po i lexoj disa, thotë kështu, shembull ta marrim, i keni dy ose tri çështje, dhuratat. Me ligj, do të thotë, ngarkohet Agjencioni Antikorrupsion që të mbikëqyrë marrjen e dhuratave. Shikoni, ne e dimë që duhet të mbikëqyret marrja e dhuratave, po a duhet të jetë objekt i këtij ligji, do me thënë, kjo radhitje kësisoj, mendoni vetë ju lutem, mendoni vet, janë çështje të cilat ka qenë dashur të mendohet shumë më herët, e jo të vihet këtu në Kuvend dhe të na thuhet prapë, - po bëni amendamente, hiqni se diçka kemi shti, diçka nuk kemi shti, hiqni çka të mundeni.

Me këtë ligj po i pamundësohet sistemit, që quhet shtet, ta kontrollojë vetveten. Sistemi duhet ndërtuar asi soji që të ketë mekanizma mbrojtës, të mos varet prej vullnetit politik. Sa më i varur që të jetë sistemi prej vullnetit politik, aq më shumë ka korrupsion. Kjo është formulë dhe a po i shkon dikujt ndërmend, të paktën Agjencisë kundër Korrupsionit, që të ndërtojë mekanizma të sistemit, që vetvetiu të mbrohen prej korrupsionit, e jo të bëhet sistemi totalisht të varur prej vullnetit politik. Edhe një herë po e përsëris, varësia prej vullnetit politik të kujt do qoftë në pushtet, e rritë korrupsionin, nuk e ulë korrupsionin. Atëherë, ne duhet të mendojmë se a është i mirë ai njeri që është në pushtet, a është njeri i keq. Jo, sistemet nuk duhet të varen nga ajo se a është njeri i mirë apo është njeri i keq. Duhet të ndërtohet sistemi, kurse ky ligj ekzakt e bën të kundërtën. Nuk lejon ndërtim të sistemit që e mbron vetveten kundër korrupsionit, edhe unë tash po supozoj për një minutë që nuk jam në opozitë, duhet menduar a po do dikush me të vërtetë ta luftojë korrupsionin a nuk po do ta luftojë korrupsionin. Do me thënë, është pyetje esenciale.

E përmenda, te neni 5, për shembull, i keni çështjet që kanë të bëjnë me përshkrimin e dhuratave e tjera, e tjera. Tani po kthehem, në fund, edhe një herë të Agjencioni për Integritet Evropian. Shikoni, prapë Agjencioni për Integritet Evropian, sikur më përpara, na ka sjellë pjesën dërmuese të raportit të vet, e ka përmirësimin e përkthimit prej gjuhës shqipe në gjuhën angleze. Shikoni, është tepër me rëndësi Ligji të jetë në rregull në gjuhën angleze, e kuptojmë ne të gjithë këtë, por Ligji zyrtarisht është në gjuhën shqipe, është zyrtarisht edhe në gjuhën serbokroate dhe pasi të aprovohet ligji, përkthehet. Nuk mund të përkthehet ligji para se të aprovohet e të bëhen një mori e vërejtjeve para se të aprovohet ligji. Do me thënë, Agjencioni për Integritet Evropian po shndërrohet në Agjencion të përkthimit, e kam thënë edhe një herë. Përderisa pjesa shpjeguese, memorandumit shpjegues është tepër i cekët, thotë, nuk merret acquis, nuk merret specifik, unioni nuk merret specifik, por shtetet merren specifik. Okej. Është krejt në rregull që shtetet të merren me këtë luftë. Nëse shtetet me këtë luftë, sa kohë i ishte dashur këtij agjencioni të na i sjellë 5, 6 ose 7 shembuj të shteteve anëtare të Unionit, të cilat janë, shembull ta marrim, të suksesshme në luftë kundër korrupsionit. Ne shumë na kishte ndihmuar, na kishte ndihmuar edhe gjatë hartimit të ligjit, por ju kishte ndihmuar edhe deputetëve. Mirëpo, kur shkruhet një paragraf në atë farë rutinë e famshme që e kemi aty dhe thotë, nuk rregullohet ose rregullohet, ose është në pajtueshmëri, ose nuk është në pajtueshmëri, realisht nuk po na ndihmon dhe prapë është në agjencion, sikur Agjencioni Antikorrupsion që nuk po na ndihmon ta kryejmë punën tonë si duhet, e duhet të na ndihmojë, se ai është institucion profesional, na nuk jemi profesional, na jemi politik. Ne përfaqësojmë vullnet politik, i kemi agjencitë profesionale dhe ato duhet të na ndihmojnë, nuk po na ndihmojnë. Edhe çështja tjetër, për shembull prapë e kemi, vetëm për t'ju treguar për profesionalizmin, Ministria e Financave, zakonisht, shikoni i keni nëpër të gjitha ligjet, kur e përfundon memorandumit e vet shpjegues, thotë, ju faleminderit për vëmendje, me shkrim.

Mendoj se janë disa çështje të cilat realisht nuk donë shumë koment, e po e përfundoj duke thënë që ky Kuvend duhet të shkoet prej të kaluarës. Ka ardhur koha, ka ardhur koha për të qenë krejt ndryshe, jo si në vitin 2001, kur e kemi ushtruar demokracinë, kemi bërë prova se si shkon. Tash duhet esencialisht të jemi tepër serioz për gjithçka. Edhe ne nuk po e shohim seriozitetin qysh duhet ta ketë ky Kuvend deri sot. Po ju them edhe një herë, me të vërtetë është hije tepër e keqe në Kuvend të Kosovës, kur për çdo ligj ne themi, po kaloje njëherë se bëjmë mandej amendamente sa të mundemi.

E kam njëfarë ndjenje që po humb besimi i njerëzve në institucionin dhe ne nuk po dimë se çka jemi duke bërë, nuk po dimë çka janë ato ligje, qysh guxojmë të mos kemi kurrfarë vullneti politik brenda ligjit që të bëjmë amendamente sa të mundemi për çdo ligj. Ju faleminderit!

KRYETARI: Ju faleminderit!

Fjalën e ka Sanije Alijaj le të përgatitet deputetja Suzan Novobrdaliu.

SANIJE ALIJAJ: Ju faleminderit, zoti Kryetar!

I nderuar zëvendëskryeministër, ministra,

Të nderuar deputetë,

Duke u nisur nga fakti se korrupsioni është veprimtari e keqpërdorimit të resurseve publike për interesa individuale, se korrupsioni është sinonim i pandershmërisë, rregullimi i veprimtarisë së parandalimit dhe luftimit të korrupsionit me ligj, mundëson evitimin e kësaj dukurie në sistem edhe ndaj individëve.

Në Projektligj, Projektligjin kundër korrupsionit mundësohet reformimi i ligjit të mëparshëm në pajtueshmëri me ligjet e Bashkimit Evropian. Rregullimi i kësaj veprimtarie me ligj, si dhe angazhimi i serioz i Agjencisë kundër Korrupsionit për zbatimin e këtij projektligji mundëson funksionimin transparent të institucioneve të Republikës së Kosovës për luftimin e korrupsionit që është i ndërlidhur me shumë dukuri tjera negative që e dëmtojnë synimin e Kosovës për t'u anëtarësuar në institucionet ndërkombëtare.

Vlerësoj se Projektligji kundër korrupsionit, si ligj bazik, deri diku plotëson standardet bashkëkohore, sepse rregullon statusin dhe përcakton kompetencat e Agjencisë kundër korrupsionit si dhe kompetencat e Komisionit parlamentar mbikëqyrës të Agjencisë kundër Korrupsionit. Në realitet, do të ishte më mirë dhe më e drejtë që projektligji të emërtohej Projektligji i Agjencionit Kundër Korrupsionit, sepse fillim e mbarim projektligji rregullon mënyrën e organizimit dhe të funksionit të Agjencisë kundër Korrupsionit si organ, si mekanizëm i pavarur për zbatimin e politikave shtetërore për parandalimin dhe luftimin e korrupsionit.

Me këtë Projektligj, ndër të tjera, Agjencioni ushtron këto kompetenca: zhvillon procedurën e hetimit dhe zbulimit të korrupsionit, mundëson bashkëpunimin e institucioneve vendore, ndërkombëtare që për mision kanë luftimin e korrupsionit, mbikëqyrë dhe kontrollon pasuritë e zyrtarëve të lartë publikë, si dhe të personave të tjerë.

Me këtë rast propozoj që me një nen agjencisë t'i mundësohet të bllokojë llogaritë bankare personave publik të dyshuar si dhe ngrirjen e aseteve kompanive të dyshuara deri në ndriçimin e plotë të rasteve si dhe sekuestrimin e dokumenteve të udhëtimit të keqvepruesve.

Kapitulli i katërt i projektligjit rregullon mënyrën e bashkëpunimit të Agjencisë kundër Korrupsionit me Qeverinë për hartimin e strategjisë kundër korrupsionit që duhet ta zbatojnë institucionet qendrore dhe lokale. Agjencioni Kundër Korrupsionit, për ta zbatuar strategjinë

kundër korrupsionit, harton planin e veprimit së bashku me institucionet përgjegjëse të Republikës së Kosovës, dokument që përmban masat dhe metodologjinë e veprimit për luftimin e kësaj dukurie.

Me këtë rast, vlerësoj se neni 17, pika 1, 2 dhe 3, duhet më shumë të definohet se cilat janë institucionet përgjegjëse, me të cilat Agjencioni harton dhe ndryshon planin e veprimit, si dhe kush i ofron informacione dhe kush kujt i raporton.

Në nenin 8 definohet apo rregullohet mënyra e zgjedhjes së drejtorit të Agjencisë kundër Korrupsionit. Mandati 5 vjeçar, me mundësi të rizgjedhjes, ju lutem, jo vetëm që krijon rrethana dhe kushte për të mos luftuar korrupsionin, por ndoshta të vijë deri te rrethanat që vetë drejtori edhe vetë korruptohet.

Muaj më parë, Agjencioni Kundër Korrupsionit paraqiti një raport në Kuvendin e Republikës së Kosovës, të dhënat të cilat edhe pse ishin simbolike, ishin për t'u shqetësuar. Me këtë projektligj krijohen mundësitë që të hetohen dhe të zbulohen individët që me veprimet e tyre i dëmtojnë institucionet.

Projektligji trajton materiet që korrupsioni si dukuri duhet luftuar nga politika dhe politikanët, apo personat zyrtarë, por duke e ditur që korrupsioni shkatërron vlerat shoqërore dhe vlerat e qytetarit, propozoj që neni 17 t'i shtohen disa pika që korrupsioni të luftohet edhe nga radhët e atyre që ju mundësojnë personave zyrtar për t'u korruptuar. Kryesisht materia, kapituj të tërë i kushtohen çështjeve të cilat nuk janë të rëndësishme për luftimin e korrupsionit, e me asnjë nen, me as një pikë të neni nuk rregullohet luftimi i korrupsionit me rastin e shpalljes së tenderëve, që është një dukuri që i shqetëson të gjitha institucionet, edhe në nivelin qendror, dhe në atë lokal.

Në fund, Projektligjin e përkrah në parim, sepse risitë në këtë projektligj i mundësojnë Kuvendit të Republikës së Kosovës të mbikëqyrë punën e Agjencionit përmes Komisionit parlamentar Mbikëqyrës për ta zbatuar strategjinë kundër korrupsionit dhe planin e veprimit dhe mbës me shpresë se ky projektligj, gjatë procedimit të mëtejshëm do të amendamentohet dhe do të bëhet një ligj funksional për të luftuar këtë dukuri nga radhët tona. Ju faleminderit, shumë!

KRYETARI: Jo, desha të them ndoshta bash nga radhët tona nuk është. Fjalën e ka deputetja Suzan Novobrdaliu, le të përgatitet Gjylnaze Sylja.

SUZAN NOLVBRDALIU: Ju faleminderit, Kryetar!

I nderuar Kabinet qeveritar,

Të nderuar deputetë,

E mira e së mirës kishte për të qenë që institucionet kryesore të Kosovës për luftimin e korrupsionit, Policia, Prokuroria, Gjyqësia të funksionojnë si duhet dhe ta luftojnë korrupsionin. Mirëpo, për fat të keq, vetë këto institucione po bëhen objekt korrupsioni, atëherë ne duhet të fokusohemi në bërje të një ligji që seriozisht do t'ia priste gjithë kanalet e mundshme korrupsionit, çfarëdo lloji qoftë.

Unë do ta përkrah këtë ligj, sepse është rëndësisë së veçantë. Vërejtjet e mia në këtë projektligj janë këto: Në nenin 5, pika 1.18, thuhet se Agjencioni i raporton një herë në vit Kuvendit dhe në çdo 6 muaj komisionit, ndërsa në nenin 12, thuhet se Agjencia pas miratimit nga Këshilli, i paraqet raport vjetor Kuvendit, andaj është e paqartë se a është në pyetje komisioni apo këshilli. Me siguri është gabim teknik, por edhe këto dy nene nuk përputhen sa u përket kompetencave, sepse në nenin 5 nuk thuhet se raportin një vjeçar e miraton Kuvendi, pas miratimit të tij nga komisioni.

Neni 9, ka të bëjë me pagën e drejtorit të Agjencionit. Duhet të shikohet se kjo çështje a është në mënyrë të njëjtë e rregulluar edhe për agjencione tjera. Qysh nga përkufizimi i termave, më vonë edhe në nenet e këtij projektligji parashikohet formimi i një Komisioni parlamentar Mbikëqyrës, e kjo do të thotë shuarje e Këshillit, me çka unë nuk pajtohem. Arsytet e mospajtimit janë: formimi i një komisioni të ri parlamentar nënkupton shpenzime më të mëdha se sa shpenzimet e Këshillit të tanishëm, si dhe duke marrë parasysh faktin se Komisioni për Punë të Brendshme dhe Siguri edhe ashtu ka të drejtën që sipas nevojës të kërkojë informata nga Agjencioni, si dhe se agjencione tjera të pavarura kanë këshilla apo borde.

Mendoj se Këshilli duhet të ekzistojë me 5 deri në 7 anëtarë, me përbërje, kompetenca të njëjta të përcaktuara në nenin 13 dhe 14 të këtij projektligji, të cilat tani janë paraparë për komision, por të njëjtat të parashihen jo për komision por për këshill. Ju faleminderit!

KRYETARI: Ju faleminderit, deputete!
Fjalën e ka deputetja Gjylnaze Syla.

GJYLNAZE SYLA: Ju faleminderit, i nderuari zoti Kryetar!

I nderuari zoti zëvendëskryeministër,

E nderuara ministre,

I nderuar ministër,

Të nderuar deputetë,

Projektligji kundër korrupsionit në të vërtetë është ndryshimi dhe plotësimi i Ligjit aktual kundër korrupsionit, Numër 2004/34, por të shohim se sa do të jetë efikas ky projektligj që na është sjellë, a është më i fuqishëm se ligji që është në fuqi. Nuk kemi të dhëna se cilat janë me të vërtetë pengesat ose pse sillen këto ndryshime. E para që është dashur të bëhet, është të na tregohet se cilat janë këto zbrazësi juridike të cilat nuk janë plotësuar me ligjin aktual.

E dyta, dua t'ua të sjell një përvojë dhe t'ju përkujtoj deputetëve se ne e kemi pasur strategjinë kundër korrupsionit, pikërisht të hartuar nga ky agjencion dhe e kemi kthyer për arsye se nuk ishte strategji e mirë. Tani me këtë projektligj a fuqizohet aq shumë Agjencioni Antikorrupsion që të jetë në gjendje të hartojë strategjinë dhe pastaj planin e veprimit, apo a janë dispozitat e paraqitura të tilla që do të rrisin pavarësinë e Agjencionit. Në të gjitha nga këto, përgjigja është jo, as nuk fuqizohet me shumë agjencioni dhe as nuk do të jetë me kapacitete më të mëdha ose më i pavarur se sa që është tani ose siç i ka të përcaktuara sipas ligjit aktual.

Tjetra, sa i përket titullit dhe përmbajtjes, nuk përputhen. Pjesa më e madhe e projektligjit, kryesisht ka të bëjë me statusin dhe përgjegjësitë e vetë Agjencionit dhe një pjesë pastaj me ndryshimin, që në vend të kompetencave që i ka pasur deri me tash Këshilli, tani i përshkruhen Komisionit Mbikëqyrës parlamentar. Disa ndryshime tjera janë, për shembull, në formën e raportimit, që në ligjin aktual nuk ka pasur raporte finale, qoftë nga Prokuroria, të cilat ju kanë kthyer ose kanë informuar Agjencionin, apo edhe organi kompetent administrativ, kurse me Projektligjin e ri këto sigurohen, do të thotë edhe raportet finale nga Prokuroria edhe nga organi administrativ. Por, a e ndihmon kjo luftën kundër korrupsionit? Sigurisht se jo. Tjetra, është shumë i kufizuar në segmentin e vet, vetëm në atë publik. Çka do të thotë kjo, a është korrupsioni i kufizuar vetëm në segmentin publik apo është edhe në atë privat, formal dhe joformal? Çka do të thotë se edhe pse Projektligji i ri nuk i cenon parimet themelore të acquis, megjithatë nuk i rregullon shumë çështje që parashihen me aktet juridike të acquis dhe ato ndërkombëtare. Së paku është dashur të adaptohet te definicioni i korrupsionit, të cilin e kanë Kombet e Bashkuara. Unë po thirrrem në disa akte juridike të acquis, të cilat ka mundur ligji t'i përfshijë. Ky është vendimi kuadër i Këshillit të Bashkimit Evropian mbi luftimin e korrupsionit në sektorin privat, pastaj

komunikata e Komisionit Evropian mbi një politikë gjithëpërfshirëse kundër korrupsionit. Me fjalë të tjera, duke marrë parasysh në fund se Qeveria nuk ka ndonjë politikë efektive, ka deklarata pompoze, siç është - zero tolerancë kundër korrupsionit, mund të dyshojmë shumë në fuqizimin e këtij agjencioni, meqenëse agjencioni ka gjithashtu rol të vetin pikërisht zbatimin e këtyre politikave.

Po ashtu, ky projektligj nuk siguron jo vetëm luftimin dhe parandalimin e korrupsionit, por edhe më pak luftën e tij dhe prioritetin të cilin e kemi, realizimin e prioritetit në partneritetin Evropian për Kosovën.

Po ju kujtoj se çka përmban Raporti i progresit i Komisionit Evropian për vitin 2008, i cili thotë: “Raporti i Auditorit të Përgjithshëm ka treguar humbjen e pasqaruar të Buxhetit të Kosovës prej 05 deri në 5 milionë euro çdo vit në Ministri”.

Të nderuar deputetë,

Ju ftoj që të mendoni mirë se sa ky ligj mund ta luftojë me të vërtetë antikorrupsionin. Shpresoj se do të jeni serioz në vendimet e juaja dhe se nuk do ta votoni këtë projektligj. Ju faleminderit!

KRYETARI: E respektojmë edhe opozitën për këtë. Fjalën e ka deputeti Hydajet Hyseni.

HYDAJET HYSENI: Zoti kryetar,

I nderuari zëvendëskryeministër,

Të nderuar ministra,

Zonja e zotërinj deputetë,

Dua t’u bashkëngjitëm atyre që e përshëndesin nismën për ta avancuar legjislacionin tonë në fushën e luftës kundër korrupsionit. Konsideroj se ligji që na është sjellë, është një ndihmesë në këtë drejtim. Konsideroj se është një ligj solid, por i mirëpres dhe i mbështes edhe vërejtjet që bëhen, sidomos kur janë qëllimmira, kur janë të motivuara vërtet për të ngushtuar hapësirën korrupsionit dhe jo për të bërë politikë me një çështje aq të rëndësishme.

Kam përshtypjen edhe unë se ligji është konceptuar pak në mënyrë të pazakonshme. Ka pretenduar në titull që të jetë një ligj kundër korrupsionit dhe do të ishte mirë të jetë i tillë, por është e vërtetë se ligji pastaj ngushtohet vetëm në Agjencionin Kundër Korrupsionit dhe Komisionin Mbikëqyrës, që është vetëm një segment që duhej rregulluar me këtë ligj, së paku ashtu siç thuhet në titull. Mendoj që ky defekt do të duhej rregulluar, qoftë duke e kthyer në Ligj për Agjencinë Antikorrupsion, ajo nënkupton pastaj edhe Komisionin Mbikëqyrës ose, nëse bëhet Ligj kundër korrupsionit, atëherë të përfshijë edhe pjesët që i mungojnë, i mungojnë madje gjithë legjislacionit tonë, që do të sqaronin më qartë se çka është korrupsioni dhe çka nënkuptohet me korrupsion.

Në Ligjin që ne e kemi përpara, praktikisht është specifikuar vetëm çështja e dhuratave dhe ne të gjithë e dimë se ndoshta më së paku ne kemi telashe me korrupsion me dhuratat. Ka disa forma tjera që, disi po vazhdojnë të mbetën të paprekura, sidomos çështja e tenderëve, na mbytnë tenderët, provizionet dhe, për më tepër, është krijuar përshtypja sikur është legalizuar ajo që quhet përqindja, 10%, 20%, 30% pothuaj se në çdo tender, në çdo transaksion që bëhet. Ka qenë kështu edhe përpara, për fat të keq, vazhdon të jetë. Unë, natyrisht, i mbështes përpjekjet e Qeverisë për ta luftuar korrupsionin dhe është për ta përshëndetur, por mendoj se do të duhej të gjente bazë ligjore edhe në ligjin që e kemi përpara dhe duheshin krijuar dispozita që e avancojnë luftën kundër fenomeneve që po e ngulfatin shoqërinë kosovare, po e pengojnë progresin e saj, po e ulin edhe reputacionin e Republikës së re.

Gjithkund është, po thotë dikush, po gjithkund është ilegale dhe mendoj që në Kosovë duhet të jetë më së paku. Lufta kundër korrupsionit nuk mund të reduktohet vetëm në luftën e agjencionit dhe mendoj se nuk janë sqaruar sa e si duhet fushëveprimi dhe kompetencat e agjencionit, as raporti me komisionin, as me segmentet tjera shoqërore dhe sidomos jo me drejtësinë. Nuk mund ta kuptoj si është e mundur që, ta zëmë, në një nen ku flitet për statusin e agjencionit, thuhet zbaton strategjinë kundër veprimit, kurse në nenet atje për kompetencat, flitet pastaj se agjencioni harton legjislacionin dhe strategjinë, planin e veprimit bashkë me Qeverinë, e prezanton në Kuvend nëpërmjet Qeverisë dhe në njëfarë mënyre kjo imponohet sipas një substituti mbi Qeverinë, kurse në ligjet tjera është instrument i qeverisjes, e tjera. Zor të funksionojë kjo në mënyrë të rregullt. Mendoj se duan sqaruar këto çështje duke siguruar edhe llogaridhënien.

Unë, natyrisht nuk mund ta kontestoj nevojën që agjencioneve të pavarura të kenë pavarësinë financiare, por dua të jem i lirë ta them se nuk jam i bindur se vetëm kjo pavarësia financiare, sidomos me linjë të veçantë buxhetore dhe njëfarë pavarësie të bëjnë që të duan agjencioneve të pavarura me financat, atëherë siguron pavarësinë e tyre. Nuk është dëshmuar askund si e suksesshme. Përkundrazi, mendoj se vetëm krijon mjegullnajë. Kjo nuk duhet ta përjashtojë llogaridhënien dhe transparencën. E mbështes edhe instrumentin që është krijuar, që Komisioni Mbikëqyrës të ketë edhe mundësinë për të parë në retroaktive çka po ndodhë pastaj edhe me menaxhimin e financave të agjencioneve të pavarura.

Mendoj se do të duhej sqaruar pak më shumë edhe çështja e mitos, ryshfetit e tjera, se po ashtu janë kategori që nuk janë sqaruar dhe nuk janë përfshirë sa e si duhet. Që agjencioni të jetë i suksesshëm, ne do të duhej t'i bënim edhe një analizë të përvojës së deritashme. Keni pasur në agjencion dhe ka pasur një bazë edhe normative, por objektivisht nuk mund të jemi të kënaqur me efektet e atij agjencionit.

Personalisht, kam krijuar përshtypjen se po na ndodhë ajo që e ka tërhequr vërejtjen Çerçili dikur moti. Sa herë që dua të mos kryhet një punë, dua të krijoj një grup punues dhe pastaj krijohet përshtypja sikur po bëhet diçka, në të vërtetë nuk është as përafërsisht ajo që pritet.

Vërejtja ime tjetër ka të bëjë me atë që e thashë edhe dje. Në Agjencionin Kundër Korrupsionit dhe në komision përsëri na shfaqet ajo formula e famshme “nuk mund të jenë ata që kanë pasur një vepër penale, kanë qenë të dënuar për vepër penale”, pa e specifikuar për çfarë veprash penale. Apeloj përsëri që në çdo ligj, ku theksohet kjo nevojë e qartë për një digë, për t'i vënë një digë atyre që kanë vepra penale në të kaluarën e tyre, duke përjashtuar veprat politike, sepse në fakt edhe në praktikë ka ndodhur që të diskriminohen dhe të përjashtohen ata që janë edhe më të motivuarit dhe më të përkushtuarit për të luftuar korrupsionin edhe konform përcaktimit të tyre jetësor.

Po ashtu në nenin 27, thuhet: “Pas hyrjes në fuqi të këtij ligji, shfuqizohen dispozitat që vijnë në kundërshtim me këtë ligj”. Është edhe kjo një klishe që po na përsëritet nëpër ligjet tona. Është në rregull që të shfuqizohen dispozitat që janë në kundërshtim me këtë ligj, sipas asaj ligji më i..., pastaj e derogon ligjin e mëparshëm, por çka me ligjet që kanë qenë të përparshme dhe nuk janë në kundërshtim, çka me rregulloret, me aktet tjera. Pres që gjatë amendamentimit të korrigjohet edhe kjo çështje. Me këto vërejtje, unë mendoj që ligji do mbështetur dhe besoj do të kontribuojë në përpjekjet e përgjithshme të cilat i mbështes dhe në këtë drejtim mbështes edhe angazhimin e Qeverisë dhe sukseset e saj për hapa përpara efektiv në luftën kundër korrupsionit. Ju faleminderit!

KRYETARI: Ju faleminderit, Hydajet!
Fjalën e ka deputetja Njomza Emini

NJOMZA EMINI: Ju faleminderit, Kryetar!

I nderuari zëvendëskryeministër,

Kabinet qeveritar dhe

Kolegë deputetë,

Duke e ditur që Kosova është njëra ndër vendet në tranzicion, që kuptohet se korrupsioni është në rritje dhe është më i dukshëm, unë konsideroj që ky projektligj kundër korrupsionit është i një rëndësie të veçantë, duke e ditur që ne jemi shtet një vit e gjysmë dhe deri tek krijimi i institucioneve, ashtu se si do të duhej në vendet demokratike të parandalohet korrupsioni, unë mendoj se në këtë projektligj nuk ka edhe aq, do të thotë, mangësi se sa që ka edhe të mira në këtë projektligj, sepse duke e ditur që nëpër institucione ka korrupsion dhe nuk është vetëm Kosova që renditet në vendet e korrupsionit, unë mendoj që sipas analizave që janë bërë nga disa organizata dhe që është dalë në Raportin e progresit të Komisionit Evropian, është njëra ndër shtyllat kryesore për një shtet, të cilin do të duhej ta ndërtonim dhe të japim edhe shembull të mirë, jo vetëm për vendet tjera, por edhe për qytetarët tanë, sepse vijnë edhe gjenerata tjera dhe të gjithë i kanë sytë tek institucionet tona dhe përcillet ajo se çka është e mira e vendit tonë.

Në këtë projektligj mendoj që kanë punuar ekspertët të cilët kanë qenë të profilizuar në këtë drejtim dhe kuptohet që ka të meta, sepse unë i pash edhe tek disa nene, te neni 5, pika 1. 17, janë disa përkufizime që unë mendoj në komisionin përkatës, që me amendamente të ndryshohet. Për shembull, thotë që duhet të ofron këshilla ky projektligj, ligji përcakton dhe parandalon, nuk është që ofron këshilla, sepse nuk kemi këtu të bëjmë me rekomandime që del një dokument. Është deklaruar po ashtu edhe prej Qeverisë, që do të thotë korrupsioni është në zvogëlim, pra nuk është në rritje, por është në zvogëlim. Unë mendoj se është e kundërta. Ne pavarësisht që jemi në dijeni, edhe qytetarët të thjeshtë e shohin se ka korrupsion, mirëpo se sa jemi në gjendje ne dhe sa kemi vullnet politik ta parandalojmë korrupsionin, ajo është kryesorja, do të thotë vullneti politik që do të duhej dhe të gjithë, unë i ftoj dhe që të gjithë, aty ku shohin që ka korrupsion, ta lajmërojnë, jo vetëm të flasim që ka korrupsion dhe ta heshtim. Ne jemi ata të cilët e parandalojmë korrupsionin nëse dëshirojmë që të mos ketë korrupsion. Ju faleminderit!

KRYETARI: Ju faleminderit, deputete!

Deputetja e radhës është Myrvete Pantina.

MYRVETE PANTINA: Ju faleminderit, zoti Kryetar!

Projektligji kundër korrupsionit, të cilin po e shqyrtojmë sot, ndryshon dhe plotëson Ligjin kundër korrupsionit 2004/34, të shpallur me Rregulloren e UNMIK-ut 2005/26. Po ashtu, ky projektligj përcakton statusin dhe përgjegjësitë e Agjencisë kundër Korrupsionit dhe të Komisionit Mbikëqyrës të Agjencisë në fushën e luftimit dhe të parandalimit të korrupsionit, veçanërisht në fushën e raportimit, të zbulimit dhe të hetimit të korrupsionit, po ashtu të zbatimit të strategjisë dhe të planit të veprimit kundër korrupsionit.

Në këtë projektligj janë bërë edhe disa ndryshime pozitive. Risia kryesore në këtë projektligj ka të bëjë me mbikëqyrjen që do të bëhet në mënyrë të drejtpërdrejtë të Agjencisë kundër Korrupsionit nga ana e Kuvendit të Kosovës dhe kjo parashihet të bëhet përmes një komisioni të veçantë që do të themelohet për këtë qëllim, komision i cili do të udhëhiqet nga opozita. Për mendimin tim, kjo për mua paraqet një hap pozitiv, por në Projektligj duhet të definohet në mënyrë të qartë, konkretisht në nenin 14, duhet të definohet përbërja e këtij komisioni, se a do të jenë anëtarë të komisionit nga radhët e deputetëve apo do të ketë një shtrirje më të gjerë.

Natyrisht që puna e drejtorit të Agjencisë kundër Korrupsionit, nuk është punë e lehtë, është punë me përgjegjësi të lartë, por mendoj se nuk është dashur që në këtë projektligj të

përcaktohet paga e tij, po mendoj, në këtë projektligj propozohet që niveli i pagës të jetë në nivel të kryetarit të komisionit parlamentar.

Për zbatimin e strategjisë kundër korrupsionit, Agjencia kundër Korrupsionit parashihet që të hartojë edhe planin e veprimit kundër korrupsionit. Në projektligj nuk definohet qartë afati brenda të cilit duhet të hartohet plani i veprimit, prandaj mendoj që në nenin 17 duhet të përcaktohet në mënyrë të qartë, po ashtu të definohet pra afati i paraqitur ose i përgatitjes së planit të veprimit.

Plani i veprimit kundër korrupsionit duhet të hartohet në bashkëpunim me institucionet përgjegjëse të Republikës së Kosovës, një dokument që duhet të përmbajë masat konkrete me të cilat do të luftohet korrupsioni e që duhet të zbatohen nga institucionet në nivel qendror dhe lokal. Pra, parashihet që në luftën kundër korrupsionit të angazhohen të gjitha institucionet shtetërore në nivel qendror dhe lokal. Por mendoj se kjo në këtë rast bie në kundërshtim me qëllimin e ligjit që është dhënë në nenin 1.

Për këtë arsye mendoj se kjo lidhet edhe me titullin e projektligjit, i cili do të duhet, pra të përshtatet. Meqenëse ligji kryesisht përqendrohet në punën e Agjencionit Kundër Korrupsionit, mendoj se edhe titulli do të duhej të ishte Projektligji ose Ligji për punën e Agjencisë Kundër Korrupsionit.

Për të luftuar korrupsionin Agjencioni duhet të merret me zbulimin e rasteve dhe jo të bazohet vetëm në raportime. Mendoj se kjo është një çështje shumë e rëndësishme- zbulimi i rasteve, do të thotë, hulumtimi që duhet të bëhet nga ana e Agjencionit, për arsye se ka raste kur pala nuk e ka guximin të raportojë për arsyet që dihen deri më tani, prandaj Agjencioni duhet të merret me zbulimin e rasteve të tilla.

Dhe, në fund do të theksoj se lufta kundër korrupsionit, të gjithë e dimë se nuk është e lehtë, por është më se e nevojshme që të merremi me këtë problem për të cilin te ne flitet mjaft, por për fat të keq nuk kemi tregues të matshëm që tregojnë për nivelin e korrupsionit në mesin tonë. Pra, edhe më tutje sikurse në ligjet e tjera për ne mbetet një pikëpyetje e madhe sa do të zbatohet ky ligj, sepse ligjet mund të jenë të shkruara në mënyrë të përsosur, por nëse nuk zbatohen, nuk do të kemi efekte nga ato ligje.

Ju faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Për t'i ndihmuar deputetët që presin në radhë të diskutojnë, unë kërkoj një sqarim nga ministrja dhe nga kryetari i Komisionit për Legjislacion: A është ligj i ri apo është plotësim i ligjit ekzistues dhe çka është? Megjithatë, në nenin 1, te qëllimi i ligjit thuhet: "Ky ligj përcakton statusin dhe përgjegjësitë e Agjencisë Kundër Korrupsionit dhe të komisioneve parlamentare të mbikëqyrjes të Agjencisë në fushën e luftimit dhe parandalimit të korrupsionit, veçanërisht në fushën e raportimit, zbatimit dhe hetimit të korrupsionit, zbatimit të strategjisë dhe planit të veprimit kundër korrupsionit", thotë në nenin 1 – qëllimi i ligjit. Nuk thotë kurrkund që ky ligj e zëvendëson ligjin ekzistues, prandaj këtu është ngatërruar deri tash, dikush e ka trajtuar si ligj që e zëvendëson një ligj e në fakt kurrkund nuk thuhet as në memorandum shpjegues e as në ligj. Më tepër po merret me dy çështje, me Agjencionin Antikorrupsion dhe me formimin e Komisionit, komisioni nuk e di, për Komisionin parlamentar është Parlamenti, nuk kemi çka e vëmë në dyshim, sepse edhe kjo u vë në dyshim nga disa deputetë. Komisionet parlamentare përbëhen prej deputetëve, përndryshe s'mund të quhen komisione parlamentare. Prandaj, do të ishte mirë për ta saktësuar, nëse është ligj që përcakton vetëm fushë veprimtarinë e Agjencionit dhe të Komisionit, atëherë mendoj që edhe titulli i ligjit duhet të ndryshojë.

Urdhëro, ministre, pastaj Bahri Hyseni do të na japë një sqarim para deputetëve se vërtet është bërë një konfuzion.

MINISTRJA NEKIBE KELMENDI: Faleminderit, zoti Kryetar!

Unë me vëmendje i dëgjova të gjitha komentet dhe vlerësimet që u dhanë lidhur me këtë ligj. Ka diçka që unë dje e kam shpjeguar dhe arsyetuar pjesën e arsyetimit me shkrim të këtij ligji. Shumica prej deputetëve nuk kanë qenë të pranishëm në sallë dhe nuk kanë qenë në gjendje t'i përcjellin arsyetimet që i kam dhënë lidhur me këtë ligj.

Sikur që e tha edhe Kryetari i Parlamentit, Komisioni vetvetiu nënkuptohet se është parlamentar, sepse thuhet se atë e drejton opozita, prandaj kjo nuk do koment.

Gjithashtu, kryetari i Komisionit për Legjislacion dhe Gjyqësi tha se Kreu VI duhet të bartet në Ligjin për deklarimin e pasurisë. Kjo qëndron dhe unë pajtohem, mirëpo meqë Ligji për deklarimin e pasurisë ka kaluar në lexim të parë, unë nuk kam mund ta mbuloj ndryshe atë vakum përpos edhe vetë dje jam pajtuar që Kreu VI tërësisht të transferohet apo të bartet në atë ligj në fazën e amendamentimit.

Për paga, pajtohem që të rregullohet me ligj, por në njëfarë mënyre ne kemi dashur edhe t'ia forcojmë pavarësinë e drejtorit të Agjencionit, por kjo lë për të menduar a ka vend këtu të thuhet apo të rregullohet me ligj tjetër?

U tha këtu se ky ligj është punuar me jo profesionalizëm. Unë do ta shoh profesionalizmin tjetër, ndryshe, nëpërmjet të amendamentimit nga ata që e vunë në dyshim profesionalizmin gjatë hartimit të këtij ligji.

Pastaj, u përmend dhe u përfol shumë neni 1 dhe Kryetari me të drejtë kërkon sqarim nga sponsoruesi i ligjit nëse ky ligj është plotësim dhe ndryshim i ligjit të mëparshëm apo është ligj tërësisht i ri.

Edhe dje, në fjalën time të arsyetimit, unë thashë se e përmirësoj Kreun VII dhe them se me këtë ligj shfuqizohet tërësisht, domethënë, jo pjesërisht, Ligji numër 2004/34 kundër korrupsionit, që do të thotë se ky ligj është ligj tërësisht i ri.

Pastaj, u tha se këtu më tepër bëhet fjalë për agjencionin, kompetencat, drejtorin, mënyrën e zgjedhjes së drejtorit e tjera. Duhet t'ju them se Agjencioni është themeluar një herë, është themeluar me Ligjin 2004/34 dhe nuk kemi nevojë ta rithemelojmë atë organ, por kemi nevojë ta përforcojmë, ta sigurojmë në punën e tij të pavarur.

U tha se nuk është dashur që ky ligj të hartohet nga Ministria e Drejtësisë, por me strategjinë legjislative Ministria e Drejtësisë është ngarkuar me hartimin e këtij ligji dhe Ministria e Drejtësisë nuk ka pasur se si të veprojë ndryshe pos ta zbatojë strategjinë që është miratuar edhe nga Qeveria.

Pastaj u tha se titulli nuk i përshtatet përmbajtjes, sepse titulli thotë: Ligji kundër korrupsionit, kurse përmbajtja del se ceken kompetencat. Po është shumë e qartë e cekur në nenin 1 se qëllimi i këtij ligji dhe fushëveprimi i vet Agjencionit është: zbulimi, hetimi i korrupsionit, raportimi e tjera. Nuk është Agjencioni i vetmi organ që duhet ta luftojë krimin. Agjencioni i ka këto disa veprimeve që duhet t'i ndërmarrë si shoqëri e organizuar në luftimin e korrupsionit. Dhe, çka ka të keqe nëse Agjencioni: heton, zbulon, raporton, jep informata. Agjencioni nuk mund të jetë operativ sikur që janë: organet e ndjekjes, policia, prokuroria, pastaj edhe organet e gjyqësisë të cilat i shqyrtojnë të gjitha këto.

Ka edhe shumë gjëra që u cekën këtu e që janë të natyrës teknike apo që më tepër çojnë në atë drejtim se duhet një koment për ta bërë këtë ligj sa më të kuptueshëm dhe sa më të zbatueshëm. Nuk mund të japim komente me ligj, komentimi bëhet duke u zbatuar ligji.

Kjo është e tëra që desha të them këtu. Pra, zoti Kryetar, kemi të bëjmë me një ligj krejtësisht të ri, prandaj edhe në Kreun VII thuhet se shfuqizohet ligji i mëparshëm numër 34/2004, këtë përmirësim e kam bërë dhe në arsyetim, sikur që e kam bërë përmirësimin në Kreun VII, por ja që ka qenë një arsye tjetër që sot u ngrit kjo çështje e jo arsyeja se nuk e kam arsyetuar ndryshimin dhe përmirësuar ligjin. Faleminderit!

KRYESUESI XHAVIT HALITI: Faleminderit! Fjalën e ka Bahri Hyseni.

BAHRI HYSENI: Faleminderit, zoti kryesues!

Unë mendoj që në fillim është sqaruar, por ndoshta për shkak që deputetët ose s'kanë pasur vëmendje, ose ndoshta edhe është çështje pak konfuze, mirëpo bëhet fjalë për një projektligj të ri. Domethënë, ligji është i ri dhe më që nuk po shkruan për ndryshim dhe plotësim, është fjala për ligj të ri. Kjo është çështja e parë.

Çështja e dytë është, e nderuara ministre, por edhe Qeveria është mirë t'i përmirësoni ligjet pa i prurë këtu në Parlament, sepse tash s'e keni atë mundësi dhe nuk keni mundësi të propozoni plotësim-ndryshime. Tash është në duar të Parlamentit dhe natyrisht që ne i kemi ngritur disa shqetësime. Kapitullin e dhuratave ju e keni në këtë projektligj, por ne si komision po mendojmë që kapitulli i dhuratave nuk duhet fare të jetë në këtë ligj, sepse s'ka të bëjë me ligjin.

Çështje tjetër, nuk është e qartësuar, thashë në fillim, janë tri çështje me dilema të mëdha. Çështja e Komisionit, e thashë në fillim, po e përsëris – Kuvendi i Kosovës në bazë të këtij ligji dhe Rregullores së Punës themelon Komisionin Mbikëqyrës të Agjencisë. Domethënë, një komision i cili tash është këshill themelohet, mirëpo nuk qartësohet.

Paragrafi 2, thotë kështu: “Komisioni është multietnik dhe shumë partiakë dhe udhëhiqet nga një përfaqësues i partisë më të madhe opozitare. Kuvendi cakton numrin e anëtarëve të Komisionit”. Mirëpo, është dilemë a do të jenë deputetë, sepse Kuvendi e ka të drejtën të formojë edhe komisione me anëtarë që s'janë deputetë, pikërisht këshillin e ka formuar. Këshillin e Agjencionit Antikorrupsion e ka formuar ky Kuvend, por në përbërje të tij ka njerëz nga prokuroria, nga avokatura, nga Kuvendi i Kosovës. Është dilemë a ka menduar Qeveria, në këtë rast, Ministria e Drejtësisë, që Komisioni të jetë komplet nga deputetët e Parlamentit, që ashtu do të duhej, dhe ne të gjitha përpjekjet do t'i bëjmë që Komisioni të jetë parlamentar, qoftë një komision i cili do të formohet pikërisht vetëm për mbikëqyrje të Agjencisë Kundër Korrupsionit dhe të mos ketë në përbërje, siç ka ndodhur deri tash përfaqësues të institucioneve të tjera, sepse e kemi parë që nuk mund të jetë efikas, për shkak të interesave e rekomandimeve të ndryshme.

Çështja është shumë diskutabile edhe rreth emrit. Unë nuk desha ta përmend në fillim, sepse ne e përkrahëm në parim dhe nuk është mirë tash të thuhet të gjitha vërejtjet. Mirëpo, çështja është shumë diskutabile, sepse ne kemi agjencionin. Agjencioni është themeluar dhe është themeluar jo me këtë ligj, por me ligjin që ka qenë deri më tani. Ju po përmendni që kapitulli VII e shfuqizon. Jo, te shfuqizimi unë e thashë, është një problem, sepse neni që e keni paraparë për shfuqizim thotë kështu, neni 27: “Me hyrje në fuqi të këtij ligji, shfuqizohen të gjitha dispozitat ligjore që janë në kundërshtim me të”.

Nuk mund të ekzistojë kështu. Me hyrjen në fuqi të këtij ligji do të shfuqizohet ligji që ekziston, jo dispozitat ligjore, sepse ne tani do ta kemi një dilemë, institucionet që do të punojnë në të ardhmen do ta kenë dilemën me cilin ligj të punojnë. Mirëpo, ne si komision nuk e kemi këtë dilemë. Ne do ta përmirësojmë, do ta bëjmë amendament dhe ky ligj e shfuqizon ligin e mëparshëm, sepse ky ligj po duket jo vëllimor, por nga ky ligj do të kalojë konflikti i interesit që veç e kemi amenamentuar. Ju e dini që ka pasur një pjesë të madhe ku është bërë fjalë për konfliktin e interesit, do ta heqim edhe çështjen e dhuratave, komplet një kapitull. Do t'i heqim kompetencat e Këshillit që kanë qenë shumë, sepse po pretendojmë, ju s'e keni sqaruar, por ne do ta sqarojmë – Komision parlamentar dhe konsideroj që ligji nëse përmirësohet me këto vërejtje që u përmendën, do të jetë shumë i mirë. Nuk do të jetë ligj i pakuptueshëm, sepse, fundi i fundit, ky flet për parimet dhe natyrisht se nuk do të jetë Agjencia që mund ta luftojë korrupsionin vetë, korrupsionin duhet ta luftojnë të gjithë, të gjitha institucionet, por flet për parimet, mënyrën e organizimit. Dhe, tash u ngrit çështja a duhet drejtorit t'i parashihen kushtet, po edhe nëse i parashihen kushtet e konkursit nuk është diçka shkelje e jashtëzakonshme se po flasim për një institucion specifik. Pra, s'po flasim për drejtorë të departamenteve, s'po flasim as për drejtorë të kuvendeve komunale, por po flasim për një drejtor të një agjencie që është specifike në Kosovë dhe pikërisht me ligj, prandaj edhe të parashihen kushtet nuk është tragjedi. Mendoj se me këto qartësime tash do ta kemi më të kuptueshëm, nuk ka të bëjë me ligjin paraprak, por është komplet një ligj i ri. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit!

Fjalën e ka deputetja Vezira Emrush.

VEZIRA EMRUSH: Hvala lepa na datu reč!

Pozdravljam predsedništvo i vladin kabinet i sve kolege poslanike. Smatram da treba i ja kao poslanica da dam svoj doprinos kada je u pitanju Nacrt zakona o sprećavanju korupcije.

Ovaj nacrt zakona znamo da je proizašao iz člana 26. Zakona o menadžiranju javnim finansijama, na ime obaveze vlade, poslovnika vlade broj 01/2007. Pre ovog zakona znamo da je ova oblast, dobili smo informaciju od strane gospodje ministarke, da je ovo bila regulisana na ime zakona 2004/34 na ime koga je istog zakona bila i formirana Agencija protiv korupcije.

Ovaj zakon vidimo da ima godišnju budžetsku liniju od 504 hiljade evra, da ima 35 zapošljena i sada bi se malo više zadržala... Znamo da je ovo na osnovu izveštaja Evropske komisije i domaćih institucija, više puta se Kosovo upozorava i proziva na veliki stepen korupcije i nacrt zakona dolazi u pravo vreme. Ali smatram da je nekoristan ako nije u paketu sa ostalim zakonima koji prate ovu oblast. Ako vlada ima strategiju za sprećavanje korupcije, vlada je mogla, morala i ministarstvo da prepozna zakone koje prate ovu oblast i da ovaj zakon dodje u paketu a ne pojedinačno kao što se desilo danas.

Ja ću da dam do znanja koji su sve to zakoni: Nacrt zakona protiv korupcije mora da bude u paketu sa Nacrtom zakona o prijavi imovine zvaničnika ili o deklarisanju zvaničnika, Nacrt zakona, jako bitan Nacrt zakona o oduzimanju imovine stećene na nezakonit način, kao i Nacrt zakona o platama javnih službenika i jako potreban Nacrt zakona o javnim fondovima. To su sve polja gde se najviše vrši korupcija i ako ovi zakoni nisu u jednom sistemu, onda oni sami za sebe ne znače ništa. Mi moramo ovo kao poslanici da znamo i sada se vraćam na ciljeve i definiciju zakona.

U zakonu je definisana agencija, definisana je komisija i definisana je namena. Moram da kažem da imamo po drugi put, ne po drugi put nego stalno se ponavlja udvostručivanje institucija. Komisija je za mene dvostruka paralelna agencija, agencija treba u svom sastavu da ima to što treba da ima komisija multietničnost, balans i da se napravi sistematizacija ili nivelizacija, da se

definiše u zakonu kada je u pitanju agencija a ne da se agencija bavi jako, jako puno samo sa izborom direktora i u načelu sa prestankom vršenja funkcije sa svim ostalim namenama samo kada je u pitanju direktor. Ovaj zakon bi trebao da se pozabavi o svim zapošljenim i o infrastrukturi agencije. Tako da za mene komisija nije potrebna, ona je nadzorni organ i smatram da agencija sa komisijom izgubila bi svoj smisao.

Jako važno u ovom zakonu, moramo da kažemo kada je u pitanju način delovanja agencije. Agencija, kaže, monitoriše i nadgleda sprovođenje strategije protiv korupcije. U zakonu nije opisana strategija. Kaže da radi plan, isto tako zakon ne definiše niti ima akcioni plan, koji je jako potreban danas kosovskom društvu, zakon je prepisan sa hrvatskog jezika, nije prilagodjen kosovskim potrebama i nema akcioni plan, koji, u kom polju, gde, koja svera, to sve treba u zakonu da se konačno definiše ako imamo nameru i političku volju da rešavamo slučaj korupcije na Kosovu.

Jako važan član, 1.15, kaže – Agencija prikuplja i analizira i objavljuje statističke podatke ili druge podatke u vezi korupcije na Kosovu. Znači, prikuplja i analizira a delovanje agencije dalje, da li agencija ima izvršnu moć, to smo čuli od gospodje Keljmendi, da je agencija sa ovim zakonom samo posmatrač. A dali nam je ta agencija potrebna kao posmatrač, to treba mi danas da vidimo.

Jako važno poglavlje IV, kaže koje su sve potrebne istrage kada je u pitanju agencija. Agenciji je sa ovim zakonom praktično oduzeta operativna agencije, operativna joj je oduzeta. U zakonu dobro stoji da kada prati slučajeve na osnovu primljenih informacija od strane fizičkih ili pravnih lica, ona zahteva informaciju od lica koji su uključeni u slučaju, ima pravo da nadgleda celokupnu dokumentaciju a jako, jako bitno je da direktor agencije ima neograničenu ulogu u otkrivanju slučajeva i vođenja slučajeva gde je data jako monopolska moć samom direktoru i jako je bitno ovo da ako je potrebno, kaže agencija može tražiti pomoć od tužilaštva o obezbeđenju potrebnih informacija u vezi konkretnog slučaja, kao jedan. Dalje, agencija kaže da prenosi slučaj nadležnom tužilaštvu na dalje procesuiranje i nadležno javno tužilaštvo informiše agenciju za dalje procesuiranje i konačnu odluku u vezi slučaja.

Član 8. kaže – ako se ne sumnja o krivičnom delu, nije definisano zakonom polje krivičnog dela. Mi moramo danas da imamo pred sobom koja su polja krivičnog dela, koja su krivična dela, mi kao poslanici da znamo od kog polja treba sami sa svojim imunitetom da pazimo i da ne dolazimo u situaciju sukoba interesa.

Dalje kaže da o krivičnom delu i o administrativnom kršenju, agencija prenosi slučaj kod nadležnog administrativnog organa. Kog organa, koji organ? Gore se daje da je to tužilaštvo, da informiše tužilaštvo, dalje se ne definiše i nadležni administrativni organ dalje se daje, opet nije definisan nadležni administrativni organ. Znači, ova agencija zajedno na ime nacrtu zakona sa kojim se formira, ona ne sprečava, praktično ovaj zakon ne sprečava korupciju, samo posmatra korupciju na Kosovu. Evo, to je bitno jako za nas poslanike da znamo, to je samo mali doprinos moj. Hvala na pažnji!

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka deputeti Gani Koci.

GANI KOCI: Faleminderit, zoti kryesues!

E nderuara ministre,

Të nderuar deputetë,

Ne para veti kemi Ligjin kundër korrupsionit, pra që të mos i përsëris ato që i thanë të tjerët, vërtet, do të duhej të ishim pak më të saktë në këtë drejtim. Pra, titulli i projektligjit duhet, madje në një formë ose në një tjetër të përcaktojë edhe përmbytjen. Dhe, po të shihet përmbytja e

projektligjit, vërtet, nuk e arsyeton këtë titull, mirëpo si do të duhej të ishte titulli unë nuk e di. Fenomeni i korrupsionit ose lufta kundër korrupsionit nuk mendoj se bëhet veç nga një mekanizëm, por nga shumë mekanizma dhe nga përkufizimet del se vërtet ky projektligj duhet të na sillte ose të përcaktonte me dispozita format e veprimit, format e hulumtimit, jo vetëm të Agjencionit Kundër Korrupsionit, por të gjithë mekanizmave të tjerë në luftën kundër korrupsionit, prandaj shtrohet pyetja me këtë ligj se cilat janë autorizimet që do t'i nxjerrin institucionet e tjera në luftën kundër korrupsionit apo autorizimi i vetëm i bie Agjencionit Kundër Korrupsionit, që nuk mendoj se është institucion ose mekanizëm i vetëm në këtë luftë kundër korrupsionit? Ne kemi edhe mekanizma të tjerë që në fund të fundit janë në funksion të kësaj lufte të korrupsionit siç është Zyra e Revizorit Gjeneral, pastaj kemi Ligjin për auditimin e brendshëm ose zyrat e auditorëve të brendshëm, prokurorinë si segment i luftimit të korrupsionit, pastaj edhe shumë segmente të tjera. Dhe, shtrohet pyetja cilat janë autorizimet që këta mekanizma do të duhej t'i nxirrnim nga ky ligj, sepse titulli i ligjit thotë- luftë kundër korrupsionit dhe këta të gjithë duhet të merren me këtë çështje. Do të thotë kjo duhet të përcaktohet.

Unë mendoj se ligji paraprak përpos disa zbrazësive, disa dilemave që gjatë zbatimit të tij ka shkakuar në Agjencion, që në njëfarë mënyre janë zgjidhur, të gjitha të tjerat kanë qenë më mirë në atë ligj të përcaktuar se sa në këtë ligj që sot na ofrohet këtu.

Dilemat e zbatimit të atij ligji kanë qenë vetëm rreth një kompetence të Këshillit të Agjencionit, me agjencionin dhe moskuptimi i përgjegjësisë nga ana e Këshillit dhe detyrave të Këshillit në raport me agjencionin dhe një tendencë, një përpjekje që shpeshherë Këshilli ndoshta të ndërmarrë edhe veprime që nuk kanë qenë veprime të tij, po veprime kryekëput të Agjencionit dhe për këtë dilemë Këshilli disa herë ka bërë edhe kërkesë në komisionin përkatës të Kuvendit që të sqarohet dhe mirë që është sqaruar.

Arsye tjetër ndoshta e Këshillit ka qenë, sepse në njëfarë mënyre ndikimi i Qeverisë në këtë agjencion duke pasur një përfaqësues të vetin në Këshillin e Agjencionit dhe po ashtu edhe i Presidencës në këtë agjencion, duke e pasur një përfaqësues, po them në Këshillin e Agjencionit, duke e pasur një përfaqësues në atë këshill dhe natyrisht këto segmente kanë pasur ndoshta interesa të caktuara, qëllime të caktuara që shpeshherë janë bërë pengesë e vetë punës të Agjencionit. Pra, kjo çështje do të duhej të zgjidhej mirë dhe të jetë ndoshta e drejtë ekskluzive e Kuvendit të Kosovës, qoftë nëpërmjet një komisioni të përhershëm ose komisioneve të rastit ose për çështje të caktuara.

Një çështje tjetër që mua më intereson shumë dhe që nuk ka zgjidhje këtu, vërtet ne si Kuvend po kemi problem rreth buxhetimit të agjencioneve të pavarura dhe vetë mënyrat e përcaktimit që këtij ose atij agjencionit, Kuvendi ia miraton ndaras buxhetin, në emër të një pavarësie të këtyre agjencioneve, mendoj se kjo është e padrejtë dhe është ngarkesë për vetë Kuvendin, sepse buxheti i të gjitha agjencioneve do të duhej të trajtohej me buxhetin e përgjithshëm të Republikës së Kosovës dhe jo si buxhete ndaras dhe si buxhete të miratuara ndaras nga buxheti i përgjithshëm i Republikës së Kosovës. Kjo çështje duhet të rregullohet, neni 4 absolutisht duhet të ndryshohet.

Te pagat dhe kompensimet. Ju lutem, ne kemi bërë kërkesë disa herë, agjencionet do të duhej në mënyrë të njëjtë, në mënyrë uniforme rreth kompensimit të tyre dhe të ketë një ligj të veçantë, një rregullore të veçantë, qoftë të miratuar nga Kuvendi, qoftë nga Qeveria duke pas parasysh edhe specifikat ose veçantitë e këtyre agjencioneve. Vetë mënyra e përcaktimit të pagave në këtë formë sigurisht krijon një pakënaqësi tjetër ose krijon precedent pastaj të veprimit edhe të agjencioneve të tjera që unë si kryetar i Komisionit për Buxhet dhe anëtarët e Komisionit për Buxhet e dinë me çfarë vështirësish jemi përballur në këtë çështje. Prandaj, kjo çështje, ju lutem, të rregullohet, sepse

ideja e shumë propozuesve të ligjit nuk është ndoshta që të bëjnë një materie, një ligj që të rregullojë çështjen, por më tepër përqendrohet si do të paguhet dhe si do të trajtohen ata, që mendoj nuk do të duhej të ishte qëllim i parë dhe i vetëm i projektligjit dhe as i këtij projektligji në këtë rast.

Një çështje tjetër, çështja e fshehtësisë së veprimit të këtij agjencioni. Thuhet se ka të drejtë të qaset në dokumentacion. Në dokumentacion të kujt? Të gjitha institucionet që mendohet se ka veprime korruptive, po cila është ana tjetër? Ne jemi përballur me një fenomen shumë të madh kohëve të fundit? Shumë organizata joqeveritare kanë kërkuar mbi bazë të ligjit qasjet në dokumentet zyrtare të futen në dokumentacione të Agjencionit Antikorrupsion. Kjo çështje nuk është e rregulluar dhe s'ka qenë e rregulluar as atëherë mirë, por nuk është e rregulluar as sot se cila është qasja e opinionit ose e të interesuarve mbi bazën e ligjit për qasje në dokumente zyrtare në qasje të dokumenteve të Agjencionit? Flitet vetëm për anën tjetër të agjencionit ku mund të qaset, por edhe kush mund të qaset në këtë agjencion?

Pastaj te ruajtja e dokumentacionit. Ligji paraprak ka pasur të paraparë edhe anëtarët e Komisionit, të Këshillit të agjencionit dhe ata që punojnë brenda agjencionit, fshehtësinë është dashur ta ruajnë deri në 15 vjet dhe kjo nuk është e përcaktuar. Mendoj, duke pasur parasysh se është e ndjeshme puna dhe veprimi i këtij agjencioni, ne s'na kanë ndodhur as 5 minuta të ruhem, madje ka pasur tendenca për t'u futur edhe në pjesët që janë nën hetim, edhe ato që kanë përfunduar, në emër të asaj se mos po gjendem unë kund ose mos po gjendet miku im kund ose ai tjetri dhe kjo, vërtet, ka pamundësuar punën e Agjencionit. Këto çështje do të duhej të rregulloheshin, do të duhej të rregullohej qasja e të tjerëve në dokumentacionin e agjencionit.

Dhe, ajo që u tha në fund, sinqerisht më mirë do të duhej të ishte të quhej Ligji për Agjencionin Antikorrupsion dhe në fund detyrat e këtij agjencioni sepse në bazë të ligjit kundër korrupsionit e kanë për detyrë të veprojnë të gjithë. Prandaj, prapë shtrohet dilema- cilat janë autorizimet e institucioneve të tjera që do t'i nxjerrin nga ky projektligj? Nuk ka autorizime, s'mund t'i nxjerrë, sepse nuk është vetëm ligji antikorrupsion që lufton, që parandalon korrupsionin, kemi edhe një mori ligjesh të tjera. Kjo është një nga ato ligjet por të definohet – Ligji për agjencionin kundër korrupsionit. Kështu më mirë ndahen ato dilema. Nuk po futem te strategjia, këtu po flitet për ta luftuar korrupsionin. Ne s'e kemi miratuar strategjinë, ky Kuvend s'e ka miratuar, të mirë ose të keqe, do të thotë, kemi qenë kundër asaj lufte, me veprimin tonë me vetëdije ose pa vetëdije kemi qenë kundër asaj lufte, në emër të asaj se nuk ka plan të veprimit. Ju lutem, planin e veprimit kundër korrupsionit nuk mund ta bëjë agjencionin antikorrupsion, ai e bën planin e veprimit për fushën, për agjencionin e vet, për institucionin e vet, nuk mund të bëjë plan të veprimit për këtë ministri, atë ministri, për Qeverinë, për prokurorinë, për doganat e tjera. Ata i bëjnë vetë planet e tyre kundër korrupsionit, nuk mund agjencionin t'i bëjë, prandaj edhe ky segment që trajtohet në këtë projektligj, do të duhej shikuar mirë dhe të zgjidhet në mënyrën më të mirë. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka Zafir Berisha me kartelën e Adem Grabovcit.

ZAFIR BERISHA: Faleminderit, zoti kryesues!

Të nderuar kolegë deputetë,

Realisht, pas kërkesës që bëri kryetari i Parlamentit për një sqarim nga kryetari i Komisionit funksional dhe ministrja, vazhdon të jetë e paqartë çështja e këtij ligji. Fillimisht dua të them e paqartë për atë se ministrja thotë se është plotësim i ligjit, e kryetari i Komisionit thotë është ligj i ri. Unë pajtohem edhe me parafolësin për të dal deri te një kolege deputete që foli rreth Komisionit të ri parlamentar për kontrollin demokratik për Agjencionin Antikorrupsion. Ligji faktikisht nuk ka të bëjë me luftën kundër korrupsionit, por ka të bëjë me një mekanizëm, i cili bën strategji dhe në njëfarë forme luftën korrupsionin. Për ndryshe, unë kam një mendim shumë personal që ky ligj

megjithatë, jo që dua t'i bashkëngjitëm dikujt, por ky ligj, kështu nuk duhet të kalojë në Parlament dhe duhet të rikthehet, sepse në faktikisht për çdo ditë flasim kundër korrupsionit, por me këtë projektligj, domethënë, nuk mund të krijojmë baza dhe mekanizma për një luftë të mirëfilltë kundër korrupsionit.

Përndryshe, realisht edhe institucionet shtetërore edhe mekanizmat joqeveritarë flasin për gjyqësinë si institucioni më i korruptuar dhe tash agjencioni faktikisht të gjitha të dhënat do t'i çojë në gjyqësi. Pra, kush do ta luftojë korrupsionin, ai që është vetë i korruptuar? Thjesht unë do të jap edhe një mendim rreth asaj se faktikisht përmes një ligji duhet të rregullohet edhe një çështje, sepse faktikisht ai që jep dhe ai që merr janë të barabartë para ligjit dhe derisa janë të barabartë para ligjit faktikisht korrupsioni nuk mund të luftohet.

Duke u rikthyer te deputetja Novobrdaliu, unë e mbroj mendimin se s'ka nevojë të formohet komision i posaçëm, pasi që një komision i Parlamentit merret me këtë çështje, thjesht është një ngarkesë ose në njëfarë forme vetëm jemi duke u marrë me vetveten, por jo edhe me një strategji të mirëfilltë për ta luftuar këtë dukuri negative të shoqërisë tonë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka deputeti Riza Smaka, le të përgatitet deputeti Naser Rugova.

RIZA SMAKA: I nderuar, zotëri kryesues!

Zonja ministre,

Zotëri ministër,

Kolegë të nderuar deputetë,

Nuk ka dilemë se titulli i ligjit gjithmonë duhet ta shprehë korrektësisht përmbajtjen dhe anasjelltas, e në këtë rast nuk është bërë kjo, prandaj medoemos duhet të bëhet rishikimi dhe adaptimi.

Te definicioni, është çështje me rëndësi definicioni se varësisht nga definicioni i nocionit, më pastaj bëhet edhe interpretimi i rastit dhe nga atje mund të bëhet edhe kvazi apo pseudo interpretimi korruptiv dhe do të duhej të jepej në dy nivele, në esencën e ngushtë dhe të gjerë, dhe, madje e theksoj këtë se ekziston një Konventë e OKB-ës Antikorrupsion. Më pastaj ekziston edhe Deklarata e Limës për Antikorrupsion. Nuk shihet se janë konsultuar këto dy dokumente relevante, juridike, politike ndërkombëtare, valide aplikative sot për sot, së paku flas me gjuhën e memorandumit ku jepen shpjegimet se nuk shihen, këto dokumente nuk figurojnë a do të duhej të ishin. Më pastaj do të duhej të merren shumë ligje, së paku të vendeve fqinje që kanë ligje, unë i kam lexuar nga kureshtja, janë ligje të mira, akte ligjore të mira. Më pastaj SHBA-të kanë Ligjin antikorrupsion, afër 100 vjet dhe është dashur të merren, sepse këtu dalin shumë defekte të formulimet.

Te neni 5, gjithnjë është fjala për çështje parimore. Do të duhej të autorizohet agjencioni që, jo vetëm të kryejë punë, t'i quajmë kështu teknike administrative, por t'i ketë disa ingerenca, t'i ketë disa kompetenca, ta ketë një juridiksion më serioz, se ndryshe do të dilte si një zyrë administrative që bën grumbullimin e deklaratave, i përcjell më tutje dhe asgjë askujt, e kjo ndodh sot aktualisht dhe praktikisht. Bie fjala Agjencioni ia procedon çështjen Prokurorisë Publike dhe atje mbeten adakta, pluhurosen me centimetra letra, domethënë, ato t'i quajmë dokumente dhe s'ka përgjigje. Do të duhej të ketë sanksion, të ketë ingerencë Agjencioni të kërkojë çfarë ndodhi me shkresën numër kaq e kaq, po e zëmë, e jo vetëm të ketë autorizim se atë mund ta kërkojë edhe unë si qytetar e mos të marrë përgjigje kurrë, por të ketë sanksion juridik që nëse nuk përgjigjet, do të thotë, do të duhej të kishte sanksion, që do ta bënte një shtrëngim dhe një obligim.

Te neni 6, përfundimisht duhet të hiqet kjo intencë krejtësisht e paqëlluar që pagat të rregullohen me disa akte kësisoj kalimthi apo jo, të favorizohen pikat e caktuara e kështu. Ne duhet ta bëjmë ligjin për pagat, ju lutem, të ketë kritere, të ketë standarde, të ketë normativa dhe në bazë të tyre të bëhet klasifikimi, kategorizimi, kur emërohet, emërohet në pozicionin që e meriton dhe çështja është e kryer, bie fjala?

Me nenin 13 nuk është dhënë definimi i saktë i strategjisë i planit dhe i programit. Këto janë tri dokumente që njihen fare, që mos flitet gjerë e gjatë, po gjithsesi duhet të jepet definicioni ç'është strategjia, çka përmban ajo, kush e miraton, çfarë? Më pastaj plani, a mund të jetë afatgjatë a afatmesëm apo afatshkurtër dhe programi, ju lutem, që vihet në funksion të planit. Kjo është konfuze në këtë dokument.

Në nenin 16 bie fjala, definim i paqëndrueshëm. Thotë- Agjencia me Qeverinë, do të thotë, e ngrit vetveten, jo agjencioni po ky dokument nëse do të miratohej me Qeverinë e bën partner që nuk do të duhej apo jo dhe me institucionet e tjera. Edhe aty, tjera, domethënë, cilat janë ato? Atëherë del dhe çfarëdo institucioni do të ishte i rangut me Qeverinë dhe Agjencioni i rangut me Qeverinë, që nuk është formulim as i nevojshëm as oportun, as i pranueshëm.

Neni 18 paragrafi 10, thotë, Agjencioni, ndër të tjera, merr vendim me mbyll çështjen. Kurrësi, merr vendim. Vendimi është akt që e miraton organi kolegjial. Tash është çështja juridike, pragmatike. Kundër vendimit në parim nuk ka të drejtë ankese. Dhe, tash çështja është me rëndësi që duhet të ketë të drejtë, a duhet të jetë aktvendim, bile aktvendimi është i përcaktuar me Ligjin për procedurën e përgjithshme administrative edhe nocioni dhe elementet se çfarë përmban, e është akt juridik i administratës që mund të atakohet e do të duhej të ketë bazë për atakim dhe të ketë mundësi. Bie fjala, shembull, qytetari i caktuar e ngrit çështjen, sot është kurajë qytetare për ta ngritur se ka plot rreziqe, e ngrit çështjen, mirëpo është konsekuent dhe tash po e zëmë mund të ndodhë që nëpunësi, oficeri apo funksionari i Agjencionit të jetë i korruptuar që nuk përjashtohet mundësia se mund të jetë edhe kryetari i Gjykatës, bie fjala, i korruptuar, e korruptuar dhe kushdo tjetër mund, pra, mund, e tash, e mbyll çështjen, atëherë qytetari që e ka ngritur çështjen është i rrezikuar dhe nuk është i satisfikuar dhe s'ka mundësi juridike, s'do të kishte sipas këtij formulimi për ta grahur çështjen më tutje, a do të duhej ta merrte aktvendimin me udhëzimin juridik, në mënyrë që eventualisht të marrë nga arsytimi të bindej se do ka vend apo s'ka vend për ta proceduar çështjen në instanca vijuese, deri në Gjykatën Supreme, bie fjala në konflikt administrativ.

Me nenin 19 është dhënë një formulim që është në kundërshtim, po e zëmë me institutin juridik penal të përgjegjësisë. Këtu thotë, ndër të tjera, kështu, kur një person dyshon e tjera, e tjera se ekziston korrupsioni, akti korruptiv mund ta ngre çështjen. Jo mund, e ka obligim. Ai është jus imperativus – obligim i secilit qytetar për ta luftua në kuadrin e kapaciteteve që i ka, të ingerencave që i ka, domethënë është obligim dhe duhet të jetë obligim e nuk duhet të jetë zgjidhje fakultative. Bie fjala, e sheh aktin, e din aktin korruptiv edhe, domethënë e vlerëson pse unë nuk jam për këto punë, s'po dua të rrezikoj unë, ka kush të merret me këto punë. Se nëse nuk e lufton secili qytetar i Kosovës korrupsionin, ne me dhjetëra-mijëra agjenci mund t'i konstituojmë dhe nuk do të ketë kurrfarë efekti. E formulimet e këtilla janë problematike ju lutem, se japin bazë për indolencë, për pasivë.

Te neni 22 paragrafi 3, vlerat e dhuratave. Ju lutem, në këtë kontekst të tregoj vetëm një ngjarje, rast korruptiv: Brezhnjevi – Niksoni. Ia ka falë Niksoni Brezhnjevit auto veturën e 500.000 dollarëve, ky ka thënë – s'mund ta marr, sepse mbi 5 dollarë e merr shteti e ia ka faturuar vlerën 4 dollarë e 990 centë. Dy akte korruptive, edhe dhuruesi edhe marrësi. Dua të them se këtu duhet të riformulohet me kujdesin më të madh çështja e dhuratave dhe medoemos dhuratat duhet të

evidencohen, të valorizohen, jo nga dhuruesi, porse nga organi kompetent edhe ato duhet të jenë pronë shtetërore, ju lutem. E në qoftë se primusi është, bie fjala faktor, përfaqësues i shtetit, i institucionit, nuk e merr dhuratën si emër, po e merr, si bie fjala, ministër, kryeministër apo kryetar, apo president e tjera. Ato duhet të evidencohen dhe të mbeten pronë- res-publika- e popullit, nëpërmjet shtetit.

Përfundimisht do të duhej të inkorporoheshin dispozitat ndëshkimore, se bie fjala primusi e ngrit çështjen, nëpunësi i caktuar e evidencon dhe nuk e procedon çështjen. Çka? Kurrigjë kurrkujt. Prandaj, duhet të ketë sanksione reciproke.

Medoemos duhet nëpërmjet amendimeve tona që të pasurohet dhe të sigurohet kontrollimi reciprok. Agjencioni të jetë i kontrolluar, të ketë autorizime për të kontrolluar dhe të ketë dikush autorizime për ta kontrolluar. Dhe, duhet të përpunohet sekreti zyrtar në këtë dokument se është tepër i nevojshëm, është një ndër parakushtet për funksionimin efikas të agjencionit. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka deputeti Naser Rugova, të përgatitet deputeti Mark Krasniqi.

NASER RUGOVA: Faleminderit, zoti kryesues!

Të nderuar kolegë deputetë,

Po e diskutojmë një projektligj tejet të rëndësishëm për të cilin në njëfarë forme është folur shumë dhe imazhi i vendit tonë dhe i institucioneve të Republikës së Kosovës tani shpeshherë është paraqitur edhe në opinionin vendor edhe në atë ndërkombëtar i lidhur me një nocion- korrupsionin dhe luftën kundër korrupsionit.

Unë do të ndalem shkurt në disa çështje që kanë të bëjnë me substancën e këtij projektligji.

Te memorandumit shpjegues i Projektligjit kundër korrupsionit pika 2 – fushëveprimi i Projektligjit thuhet: ” Ky projektligj përcakton statusin, përgjegjësitë e Agjencisë Kundër Korrupsionit dhe Komisionit parlamentar mbikëqyrës të Agjencisë në fushën e luftimit dhe parandalimit të korrupsionit, veçanërisht në fushën e raportimit të zbulimit dhe hetimit të korrupsionit dhe zbatimit të strategjisë dhe të planit të veprimit kundër korrupsionit.”

Ende nuk e kemi as strategjinë e luftës kundër korrupsionit, si institucione, si Qeveri dhe si Parlament dhe nuk e kemi një plan të veprimit me agjendë strikte. Ardhja e ligjit tani në procedim në lexim të parë në Kuvendin e Republikës së Kosovës, pa kaluar procedurat këto dy dokumente të rëndësishme, konsideroj që është një zbrastësi dhe një vakum i madh, andaj ky ligj duhet të jetë në harmoni të plotë me këto dy dokumente të rëndësishme.

Te risitë dhe avancimet e Projektligjit, kishte edhe dilema dhe konfuzione a është plotësim. Ky është një ligj i ri, mirëpo në substancë dhe cilësi ndryshon vetëm në disa elemente të avancuara, më tepër të karakterit formal dhe administrativ.

Risitë e këtij projektligji, po citoj- janë: “Mbikëqyrja e drejtpërdrejtë e Agjencisë Kundër Korrupsionit nga ana e Kuvendit të Kosovës përmes një komisioni të veçantë, i cili do të udhëhiqet nga opozita.”

Do të duhej të kishte risi të tjera strikte, jo vetëm në avancimet administrative të Agjencionit, sepse ky ligj nuk mund të vijë çdo dy muaj në rishqyrtim apo amendim apo plotësim dhe duhet të kemi kujdes dhe konform vërejtjeve që i ka dhënë Komisioni Evropian në këtë fushë të luftës kundër korrupsionit, të rendit dhe sundimit të ligjit.

Një çështje tjetër e rëndësishme, është edhe te definicioni i korrupsionit. Zonja ministre, duhet të shikohet me kujdes të definohet qart definicioni i korrupsionit sipas kornizës standarde të vendeve anëtare të Bashkimit Evropian dhe kërkesës së Komisionit Evropian, sepse një nga sfidat e adresuara apo kritikën e raportit të fundit të progresit evropian ka qenë definimi jo i saktë i definicionit të korrupsionit në ligjin ekzistues që ka qenë.

Pastaj, te neni 13 – te Komisioni, mjaft kolegë deputetë këtu e potencuan çështjen e Komisionit, ekzistencën, mos ekzistencën, ekzistenca e këshillit të tij, cili është më kompetent? Pa diskutim që është komisioni parlamentar dhe mbikëqyrja parlamentare e agjencionit, sepse agjencioni dhe drejtori i Agjencionit është themeluar dhe zgjedhur nga Kuvendi i Republikës së Kosovës.

Te Komisioni, po citoj: “ Kuvendi i Kosovës në bazë të këtij ligji dhe Rregullores së Punës së tij themelon Komisionin mbikëqyrës të Agjencisë. Komisioni është multietnik dhe shumë partiak dhe udhëhiqet nga një përfaqësues i partisë më të madhe opozitare.”

Kjo është e drejtë, qëndron, përkon edhe me vendet me demokraci shumë të avancuara dhe me praktikën demokratike të mbikëqyrjes parlamentare të institucioneve.

Kuvendi, po citoj: “cakton numrin e anëtarëve të Komisionit”. E tani, praktika e Këshillit ka qenë një praktikë jo frytdhënëse dhe e gabuar, sepse ka pasur edhe anëtarë nga institucionet e tjera që haptas ka pasur konflikt interesi. Edhe kjo ka qenë një nga adresimet dhe vërejtjet serioze nga ana e raportit të fundit të progresit të Komisionit Evropian. Dhe, konsideroj që është mirë që ky këshill po evitohet tani dhe po formohet një komision parlamentar, i cili e bën mbikëqyrjen, monitorimin dhe kontrollin parlamentar të jetësimit të këtij ligji. Komisioni duhet të jetë ekskluzivisht komision parlamentar dhe kjo duhet të qartësohet në ligj, zonja ministre, sepse po krijon konfuzion edhe te deputetët, por edhe te institucionet e tjera relevante që në zbatimin praktik të këtij ligji, pastaj do të duhet thjeshtë ta japin ndihmesën e vet, qoftë edhe eksperiencën edhe profesionale edhe institucionale. Në këtë kuptim unë e mbështes këtë ligj në praktikë, mirëpo në shumë kapituj dhe nënë duhet të jepen ato orientime dhe adresime të qarta edhe të përgjegjësive institucionale dhe të lehtësimit të këtyre neneve dhe amendamenteve për zbatimin në praktikë të këtij projektligji. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka deputeti Mark Krasniqi, le të përgatitet deputeti Ibrahim Makolli, diskutuesi i fundit.

MARK KRASNIQI: I nderuari, kryesues!

Të nderuar ministra dhe deputetë,

Në këtu po analizojmë, po propozojmë dhe miratojmë ligje të ndryshme të nevojshme për të krijuar dhe për të udhëhequr shtetin ligjor. Është përgjegjësi e madhe e Kuvendit dhe e Qeverisë për cilësinë e çdo ligji që miratohet në Kuvendin e Republikës së Kosovës, sepse me ligje garantohen të drejtat e qytetarëve, por edhe obligimet e tyre ndaj shtetit.

Ligji për korrupsionin ka rëndësi të posaçme sidomos në fazën e tranzicionit në të cilin jemi ne. Madje, lufta kundër korrupsionit është edhe një kusht i yni për inkuadrimin e shtetit tonë në strukturën të ndryshme të rëndësishme ndërkombëtare. Mirëpo, nuk është korrupsion vetëm monedha – paratë të përvetësuar jo ligjërisht. Korrupsion është edhe: familjarizimi, nepotizmi, proteksioni, partitizmi dhe veprimet e tjera të ndryshme me çka përfiton individ apo grupi partiak pa të drejtë me ç’rast dëmtohen të tjerët të cilëve ligji u jep përparësi, sepse kanë kualitete më të mira se ai që ka fituar. Por çfarëdo të jetë ligji kundër korrupsionit, ai mbetet vetëm në letër nëse nuk zbatohet. Janë organet e caktuara që duhet t’i zbulojnë rastet konkrete të korrupsionit, siç:

policia, Agjencia Kundër Korrupsionit, Institucioni i Inteligjencës e tjera. Por, nëse këto organe nuk kanë përkrahjen e publikut dhe të mjeteve të informimit, suksemi nuk do të jetë ai që duhet të jetë.

Deri tash për korrupsion vetëm po flitet, nuk publikohen rastet konkrete, sepse korrupsioni me sa duket paska rrënjë të thella në Kosovë, kështu që të korrumpuarit e luftojnë korrupsionin vetëm me fjalë boshe dhe kështu lufta kundër korrupsionit nuk mund të jetë e suksesshme, por edhe dëmtohet shoqëria dhe dëmtohet edhe shteti i cili është në formim. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka deputeti Ibrahim Makolli.

IBRAHIM MAKOLLI: Faleminderit, zoti kryesues!

Të nderuar kolegë,

Shumica e çështjeve që do të duhej të thuheshin për këtë projektligj, u thanë nga shumë parafolës, por unë do të shtroj një çështje të cilën besoj se ministrja do të duhej ta ketë parasysht.

Ne kemi pasur një ligj të tillë dhe prandaj do të pyes se çka ndryshon nga ai i kaluari ky projektligj që kemi tash dhe pse mendohet se ky ligj garanton një sukses në luftën kundër kësaj dukurie? Në vendet ku funksionojnë hallkat e sistemit nuk ka nevojë për agjencione të tilla, përpos në këto vendet post-komuniste. Si duket, në vend që të marrin praktika pozitive, po marrim praktika të vendeve që kanë dështuar dhe po dështojnë për çdo ditë, sepse në vend që të fuqizohen mekanizmat, institucionet të cilat do të duhej të merreshin drejtpërdrejt me këtë çështje që janë: policia, prokuroria dhe sistemi tjetër i drejtësisë, në vend që të investohet aty, ne kemi krijuar agjencione të ndryshme të cilat pastaj kanë edhe përplasje në mes veti sikurse që është Agjencioni Kundër Korrupsionit me institucionet e tjera. Nuk mund të quhet ky projektligj – ligji kundër korrupsionit, sepse po të ishte i tillë brenda do të duhej të përfshinte gjithë mekanizmat e tjerë të shtetit të cilët luftojnë korrupsionin. Dhe, pajtohem që, nëse duhet të kemi një diçka të tillë, atëherë ky ligj të quhet Ligji për Agjencionin Kundër Korrupsionit, sepse përndryshe në mbështetje të kësaj atëherë luftëtar i vetëm i korrupsionit në këtë vend do të duhej të ishte dhe është vetëm Agjencioni Kundër korrupsionit. Ligji ka mangësi të shumta, këto mangësi vërehen në sipërfaqe të cilat e defunksionalizojnë këtë institucion.

Po ashtu, meqë u thanë shumë çështje, do të përqendrohem vetëm edhe në një çështje shumë të rëndësishme. Ju keni parë, kolegë, që shumë të dhëna janë zbuluar nga Agjencioni Antikorrupsion, pa e dhënë fjalën e vet drejtësia dhe shumë njerëz janë përfolur që janë të korrumpuar, pa u vendos paraprakisht nga një institucion i drejtësisë, i cili vërteton nëse dikush është ose jo i përfshirë në korrupsion. Dhe, prandaj, për të garantuar mbrojtje edhe të drejtave të qytetarëve do të duhej që paralelisht me këtë ligj të jetë edhe Ligji për mbrojtjen e të dhënave si një prej dokumenteve më të rëndësishme që garanton mbrojtjen e të dhënave të qytetarëve.

Zonja ministre, nuk e besoj se korrupsioni luftohet duke krijuar letra të mira, përkundrazi, duke qenë në krye të Ministrisë së Drejtësisë, konsideroj se pikërisht korrupsioni do të mund të luftohet nëse fuqizohen institucionet e drejtpërdrejta, në këtë rast Prokuroria, por edhe në fushën tjetër, policia, sepse ne kemi njësitë për Krime brenda policisë të cilat do të duhej të merreshin drejtpërdrejt dhe merren me këtë çështje dhe jo të krijohen institucione paralele të cilat në vend që ta ndihmojnë njëra-tjetrën në Kosovë për fat të keq praktika ka treguar që janë penguese të njëra-tjetrës.

Do të jetë shumë e vështirë që nga ky projektligj të ndërtohet një ligj efikas për zbatim në praktikë, rezultati i së cilës do të duhej të ishte pikërisht lufta kundër korrupsionit dhe jo vetëm krijimi i mekanizmave fiktivë të cilët para syve të qytetarëve dhe para opinionit do të thuhej se ne

kemi infrastrukturë të mjaftueshme ligjore për të luftuar këto dukuri, po me të vërtetë në praktikë këto për çdo ditë marrin përmasa më shqetësuese sesa që kanë qenë.
Faleminderit, zoti kryesues!

KRYESUESI: Faleminderit! Konstatoj se diskutues të tjerë nuk ka. Kërkoj që të dimë numrin e deputetëve të pranishëm në sallë. Nuk ka kuorum! Vazhdojmë. Ministria e ka fjalën edhe njëherë. Mendova se e keni përfunduar që në herën e parë. Më falni!

MINISTRJA NEKIBE KELMENDI: Duhet ta kuptomë të gjithë ne se ky nuk është ligj bazik dhe ky ligj nuk shërben si burim ligjor për hartimin e ligjeve të tjera. Ky ligj i ka specifikat e veta dhe kompetencat e Agjencionit dhe aq mund të rregullojë, prandaj atë që duhet ta përfshijë e kemi përfshirë. Kemi harmonizuar edhe definicionin e korrupsionit, ashtu siç është kërkuar në harmoni me Kodin Penal të Republikës së Kosovës.

Këshilli Mbikëqyrës është risia më e madhe që është bërë në këtë ligj, sepse Këshilli Mbikëqyrës ka qenë i përbërë prej vetë pjesëtarëve të atyre organeve që janë gjithashtu të involvuar në ndjekje apo të përfshirë në ndjekjen e veprave penale të korrupsionit.

Dhe, në fund, deputetë të nderuar, ju lus që t'i lexoni dokumentet zyrtare për kompetencat e Ministrisë së Drejtësisë, çfarë kompetencash ka, e jo t'ia adresoni Ministrisë së Drejtësisë etiketimet dhe të gjitha ato që kanë të bëjnë me gjyqësorin apo prokurorinë. Nëse doni ta denigroni ministren, mos i lexoni ato dokumente. Nëse doni ta dini të vërtetën, Ministria e Drejtësisë nuk i administron, nuk i menaxhon as gjykatat, as prokuroritë, sepse edhe ato duhet ta kenë pavarësinë e tyre dhe mendoj se është siguruar pavarësia e tyre me ndërtimin e organeve tjera, siç janë Këshilli gjyqësor dhe Këshilli prokuroria.

KRYESUESI: Faleminderit, zonja Kelmendi! Unë ju kisha lutur që vërtet ta gjejmë një mënyrë të votimit të ligjeve, të paktën ta bëjmë në fund të seancës ose diku ta caktojmë parimisht në orën 17, sepse kështu me vrap, një herë janë e një herë s'janë, nuk është në rregull. Atëherë, kemi kuorum, janë 69 deputetë në sallë dhe vazhdojmë me votimin e ligjit, në parim.

Lus regjinë dhe deputetët që të përgatiten për votim. Votojmë tani:

Ju lus, merrni kartelat me veti, jeni të obliguar. Unë po ju them, jeni të obliguar t'i merrni kartelat dhe nuk jemi dordolecë këtu ne tash t'ju këqyrim sa herë i keni e sa herë s'i keni.

Sa janë pa kartelë që votojnë “për”? Pra, janë 54 vota “për”, 11 “kundër” dhe 1 abstenim.

Konstatoj se u miratua ligji në parim – Projektligji kundër korrupsionit. Faleminderit!

Në bazë të Rregullores së Punës, Kuvendi ngarkon këto komisione:

1. Komisionin për Legjislacion dhe Gjyqësi, si komision funksional,
2. Komisionin për Buxhet dhe Financa,
3. Komisionin për Komunitete dhe
4. Komisionin për Integritet Evropian.

Komisionet duhet që brenda dy muajve nga shqyrtimi i parë, Kuvendit t'i paraqesin raportet me rekomandimet.

Edhe një këshillë për ju që nuk keni kartela, paraqituni për mëditje, se kur s'i keni kartelat, nuk ua japin as mëditjet.

Po vazhdojmë me pikën e nëntë të rendit të ditës:

- **Shqyrtimi i parë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për prokurimin publik në Kosovë**

Në bazë të Rregullës 35 pika 1 të Rregullores së Punës, janë përmbushur kushtet për shqyrtim dhe miratim në parim të këtij projektligji.

Komisioni për Buxhet dhe Financa, si komisioni funksional, e ka shqyrtuar projektligjin dhe Kuvendit i ka rekomanduar për miratim, në parim.

Ftoj ministrin Ahmet Shala, përfaqësuesin e caktuar nga Kryeministri që në emër të Qeverisë së Republikës së Kosovës, para deputetëve të Kuvendit, ta prezantojë Projektligjin. Zoti ministër, e keni fjalën.

MINISTRI AHMET SHALA: I nderuar kryesues,

Të nderuar anëtarë të Kabinetit,

Të nderuar deputetë,

Kam nderin dhe kënaqësinë që të paraqes para jush sot Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Numër 2003/17 për prokurimin publik në Kosovë.

Pas shpalljes së pavarësisë së Kosovës dhe pas hyrjes në fuqi të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, shteti i ri i Kosovës është ballafaquar me vështirësi të mëdha, sidomos në përmbylljen e misioneve të veta diplomatike e posaçërisht duke pasur parasysh specifikat e secilit vend, që ka legjislacione të ndryshme sa i përket çështjeve të prokurimit dhe çështjeve të tjera urbanistike dhe të planifikimit urban për blerjen e ambasadave si dhe furnizimit të rregullt të ambasadave.

Një grup punues i kryesuar nga Ministria e Punëve të Jashtme dhe në përbërje të ministrive dhe institucioneve të tjera të rëndësishme ka shqyrtuar mundësitë e ndryshimit dhe plotësimit të këtij ligji, i cili do të mundësojë tejkalimin e të gjitha problemeve, që paraqiten në blerjen e ambasadave, në furnizimin e ambasadave me kohë, qofshin me inventarë, qofshin me nevoja të përditshme, qoftë për pagimin e qirasë apo pagesat e tjera.

Andaj, Komisioni ka ardhur me një projektligj të ri, i cili i ka 7 nene, reflekton nevojat dhe specifikat në mënyrë që shteti i Kosovës të ketë mundësi që sa më shpejt që është e mundur t'i ketë ambasadat e veta dhe të ketë një furnizim të rregullt konform ligjeve specifike të vendeve të ndryshme.

Ne besojmë që ky ligj i ka përmbushur kërkesat dhe shqetësimet që i kanë paraqitur ambasadorët tanë dhe Ministria e Punëve të Jashtme, andaj e paraqes para jush për mbështetje, në mënyrë që ne të ecim pastaj përpara me procedurat që janë të nevojshme. Faleminderit për mirëkuptim dhe kërkojmë mbështetjen tuaj.

KRYESUESI: Faleminderit! A e dëshiron fjalën kryetari i Komisionit funksional për Buxhet, zoti Gani Koci?

GANI KOCI: Faleminderit, zoti kryesues!

Ne, si komision, paraprakisht para leximit këtu, në parim, të këtij projektligji për ndryshimin e ligjit në fjalë, e kemi shqyrtuar dhe e kemi parë të nevojshme që vërtet kjo çështje të rregullohet në mënyrë që t'i lehtësohet veprimi i përfaqësive tona diplomatike dhe akomodimi sa më i mirë i tyre, sepse, megjithatë, kanë vështirësi dhe pengesa në këtë drejtim.

Unë dua të ripërsëris një fakt që po themi është çështje e ngutshme, kjo çështje ka qenë e ngutshme tash e një vit, do të thotë, nga korriku i vitit të kaluar është shtruar nevoja që këtë çështje do të duhej ta ndryshojë ligji. Dhe, dua t'ju përkujtoj se në mars të këtij viti Komisioni për Buxhet dhe Financa kur e ka shqyrtuar raportin e Komisionit Rregullativ të Prokurimit Publik i ka paraqitur këtij Kuvendi disa rekomandime lidhur me Ligjin e prokurimit publik. Pra, dua të rikujtoj vetëm një gjë dhe këtë me arsye, sepse nuk është respektuar deri në fund ky rekomandim dhe unë po e lexoj duke u bazuar në analizën e bërë të raportit lidhur me mënyrën e implementimit të Ligjit për prokurimin publik.

Duke pasur parasysh pengesat e shfaqura në procedurat e prokurimit publik në praktikë, Komisioni për Buxhet dhe Financa i propozon Kuvendit të Republikës së Kosovës që të kërkojë nga Qeveria formimin e grupit punues për hartimin e ligjit të ri për prokurimin publik, i cili, ndër të tjera, duhet të përfshijë edhe dy çështje, njërin që sot po e diskutojmë, çështjen e prokurimit lidhur me misionet diplomatike të Kosovës në vende të ndryshme të botës dhe rregullativën e cila do t'i rregullojë aktivitetet e prokurimit publik në sektorin e ndërmarrjeve publike.

Ne kemi shpresuar se do ta kemi një ligj të ri që do të ketë këta dy kapituj të rinj në këtë ligj, por nuk e kemi dhe meqë është nevoja urgjente, ne si Komision kemi marrë një qëndrim që duhet të miratohet ky propozim i ndryshimit të ligjit dhe njëkohësisht këtë qëndrim e mban edhe Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës.

KRYESUESI: Faleminderit! Domethënë, edhe në emër të Grupit Parlamentar e kreve diskutimin lidhur me këtë. Kryetarët e komisioneve të përhershme a do ta kërkojnë fjalën? Jo. Kryetarët ose përfaqësuesit e grupeve parlamentare, sipas radhës. PDK-ja e ka ngarkuar Gani Kocin dhe e kreu. Në emër të LDK-së, kush e kërkon fjalën? Deputeti Armend Zemaj e ka fjalën.

ARMEND ZEMAJ: Faleminderit, zoti kryesues!

Zëvendëskryeministra,

Të nderuar ministra,

Projektligji për ndryshimin e Ligjit numër 02/L-99 të Ligjit të prokurimit publik në Kosovë numër 2003/17 do t'i plotësojë dhe eliminojë zbrazëtirat që duhet të rregullohen për përcaktimin e rregullave të prokurimit që kanë të bëjnë me përfaqësitë tona diplomatike dhe konsullore.

Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike të Kosovës i ka shqyrtuar me kujdes edhe këto 7 nene të paraqitura, më të cilat do të rregullohet procedura e prokurimit dhe aktivitetet e prokurimit, ku mendojmë se do të lehtësohet puna për plotësimin e kushteve të punës dhe aktivitetit për misionet tona diplomatike të cilat janë më se të nevojshme.

Është shumë e qartë, e tha këtë edhe kryetari i Komisionit se nevoja për ndryshim e plotësim të këtij ligji ka të bëjë edhe me disa fusha të tjera. Ne mendojmë se duhet ta shfrytëzojmë rastin, sepse ka shumë probleme në përditshmëri që hasin shkaku i procedurave dhe aktiviteteve të prokurimit.

Grupi Parlamentar i LDK-së mendon, përpos atë që e tha kryetari i Komisionit që duhet të bëhet ndryshimi në sektorin e ndërmarrjeve publike, ne kemi problemet edhe në sektorin e shëndetësisë, sidomos të procedurave të prokurimit me furnizim me barna që në këtë ligj të prokurimit ka shumë

probleme dhe mendojmë që ato duhet të eliminohen se shkaktojnë në vazhdimësi probleme të cilat janë të njohura edhe për Ministrinë edhe për publikun.

Grupi Parlamentar i LDK-së i jep mbështetje në parim dhe do të kontribuojë maksimalisht që me ndryshimin e këtyre 7 neneve po edhe të neneve të tjera që Ligji i prokurimit publik të ndryshohet dhe të plotësohet edhe në lëmenjtë tjerë dhe të jetë sa më funksional dhe më i zbatueshëm. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Në emër të Grupit Parlamentar të Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës, deputeti Haki Shatri.

HAKI SHATRI: Faleminderit, zoti kryesues!

Të nderuar deputetë,

Edhe për Grupin tonë parlamentar shqetësimi është në atë që rekomandimet e Kuvendit lidhur me çështjet e prokurimit dhe të ligjit për prokurimin publik kanë qenë që të hartohet një ligj i ri, i cili do të eliminonte disa të meta të Ligjit në fuqi të cilat i ka verifikuar praktika e deritanishme dhe kemi akceptuar nevojën urgjente për përfshirjen edhe të kësaj pjese, pra të prokurimit në misionet diplomatike konsullore, sepse është urgjente, por rekomandimi dhe kërkesa edhe e Komisionit Rregullativ ka qenë që në një ligj të përfshihen edhe pjesët tjera që rregullojnë prokurimin edhe në ndërmarrjet publike. Qeveria e ka prurë parcialisht ligjin, pjesën vetëm për prokurimin në përfaqësitë konsullore dhe kjo është vërejtja jonë, pra që nuk është respektuar rekomandimi i Kuvendit. Megjithatë, në ligjin që na ka ardhur kemi edhe vërejtje në përmbajtje. Në veçanti kërkojmë që të respektohen dispozitat parimore të Ligjit për prokurimin dhe të bëhen përjashtime për përfaqësitë konsullore në pjesët që duhet të bëhen, sepse nuk mund të respektohet e njëjta procedurë sikurse në organizatat buxhetore në vend. Por, kërkesa për përjashtim të rregullave nuk duhet të bëhet në vetë Ministrinë e Punëve të Jashtme, por duhet të bëhet në Agjencionin e Prokurimit Publik. Këtu në ligjin e propozuar kjo ose ka dalë gabim ose duhet të ndryshohet.

Pastaj në nenin e fundit të pika 35.17 ku kërkohet pëlqimi prej vetë Ministrisë, prapë për përjashtim, kur është fjala për blerje të veturës, mendoj që nuk ka nevojë të bëhet përjashtim nëse kërkesa vjen në Ministrinë e Jashtme pse mos të shkojë në Agjencionin e Prokurimit, që është rregull, dhe vonesa nuk do të ketë. E kam parasysh nevojën e kohës, domethënë, urgjencën por sipas rregullave agjencioni është i obliguar që përgjigjen ta japë brenda 3 ditësh që do të thotë nuk shkakton kurrfarë pengesa në kohë dhe në funksionim. Këto janë vërejtjet tona të cilat po të plotësohen ne do ta përkrahim sepse ka nevojë kjo pjesë në veçanti të plotësohet. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Në emër të Grupit Parlamentar të AKR-së, e ka fjalën deputeti Riza Smaka.

RIZA SMAKA: Në parim e mbështesim miratimin e këtij dokumenti, me ndryshime dhe plotësime të paevitueshme. Bie fjala, neni 3, formulimi i këtillë do të krijonte bazë juridike për interpretime arbitrare, prej rasti në rast, qysh kujt i teket. Bie fjala, nënshkrimi i kontratave për vlera minimale dhe të vogla. Cilat janë vlerat minimale, cilat janë të vogla?

(Ndërhyrje)

Të lutem, nuk është ashtu! Se ky është ligji dhe unë po flas konkretisht 100% me precizitet, me koncizitet. Po flas për nenin 3, për paragrafin 25. Dhe, duhet medoemos të jepen plafonët, prej - deri, vlera minimale e tjera.

Po kësisoj, rrjedhimisht te neni 4, - të gjitha aktivitetet e prokurimit të vlerave të mesme dhe të mëdha, kjo disi i përngjanë raportit, referatit politik, partiak disi, jo tekstit ligjor. Cilat janë ato? Duhet të definohen qartë se ligji dhe gjuha e ligjit është sui generis, do të duhej të ishte shumë precize se nëse do të ishte e tillë më pastaj do ta kishim ligjin çfarë duhet ta kishim dhe duhet ta kemi.

Ju lutem, neni 5, te 34.11 që i referohet, thotë: “Shefi i misionit diplomatik, konsullor, pasi që identifikon pronën e përshtatshme të mundshme udhëheq negociatat për oferta dhe kushtet për marrjen me qira të objekteve”. Nuk do të duhej të ishte kësisoj, se do të krijohej bazë solide për spekulime abuzive. Ju lutem, ne e dimë fare mirë, qiratë sidomos në vende të jashtme janë shumë të larta, janë edhe këtu shumë të larta dhe do të krijohej, domethënë, bazamenti juridik solid, ja ligji, ja kjo, e tjera.

Manipulimet janë të mundshme dhe të paevitueshme, bile, së paku ne mos të kontribuojmë në atë drejtim.

34.13. Shefi i misionit diplomati konsullor mund ta angazhojë një kompani vendore në shtetin pranues për ndërmjetësim. Pse një kompani? Po me shpallje për tender, procedurat janë të përgjithshme, janë të mirënjohura se domethënë kjo është një formë vetëm formë legale për ta legalizuar ilegalen në transaksione.

34.19.” Për blerjen e objekteve për misione diplomatike konsullore të Republikës së Kosovës përdoren procedurat e negociuara pa publikim të njoftimit të kontratës”. Po kjo nuk mund të pranohet kurrësi në kushtet normale, absolutisht, formulim me të vërtetë imitues dhe i dëmshëm do të ishte për interesin publik. Pse, qysh nuk mund të lejohet ajo?

Te 34.2: “Ministria e Punëve të Jashtme mban evidencën e të gjithë pasurisë së luajtshme dhe të paluajtshme të misioneve diplomatike”. Duhet të meditojmë pak më thellë, ndoshta, do të ishte më mirë që evidencat e aseteve shtetërore t’i mbante Ministria për Ekonomi e Financa, te të gjitha, ju lutem. A mund të jetë dhe evidencat e veta t’i ketë edhe Ministria për Punë të Jashtme?

Do të duhej me një ligj çështja e prokurimit të absolvohej krejtësisht, e me dispozita të caktuara specifikat që do t’i referoheshin po e zëmë blerjes së aseteve nga përfaqësitë diplomatike-konsullore, do të ishte zgjidhje më e mirë se sa kjo që është ofruar. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka deputetja Besa Gaxherri, në emër të LDD-së

BESA GAXHERRI: Faleminderit, zoti kryesues!

Të nderuar kolegë deputetë,

Është e vërtetë se Ligji për prokurimin publik, së paku nga Komisioni i Buxhetit është kërkuar shumë më herët para se të paraqitet problemi për funksionimin e ambasadave të Kosovës, që të ndërhyhet në këtë ligj, sepse është parë nga praktika se vërtet ka nevojë, sidomos kur është fjala për aktivitetin e prokurimit publik për ndërmarrjet publike.

Një gjë e tillë nuk ka ndodhur dhe realisht ka ndodhur që të na vijë sot ky ligj në shqyrtim në Kuvendin e Kosovës kur gati Kosova po i mbush dy vjet të pavarësisë së saj dhe ambasadat tona nuk mund të funksionojnë pa këtë ligj.

Lidhja Demokratike e Dardanisë, ka theksuar dhe ka kërkuar me muaj të tëra më herët që ky ligj të vijë në ndryshim që vërtet ambasadat tona të funksionojnë ashtu si duhet që vërtet ambasadat tona të japin imazhin e një shteti serioz, që vërtet nuk ka ndodhur dhe ne deri në momentin sot që po

bisedojmë apo deri sa ky ligj të hyjë në fuqi, ambasadat tona janë në një nivel shumë të ulët të përfaqësimit, sepse u mungon logjistika komplet.

Kjo vërtet tregon një mosseriozitet të kësaj qeverie dhe kjo vërtet tregon se nuk përgatitet asgjë me kohë në këtë qeveri, por gjithçka vendoset ad-hoc për momentin. Me vetë ligjin i cili na ka ardhur jo ndryshimet tjera përveç për funksionimin e ambasadave, të jap të kuptosh së prapë duhet të ndërhyhet në këtë ligj dhe nuk jemi në gjendje apo nuk jemi të gatshëm që vërtetë kur të hyjmë ta ndryshojmë një ligj apo kompletojmë ashtu si është e nevojshme?

Natyrisht se këtë ligj e kem shqyrtuar dhe jemi shumë të gatshëm t'i japim mbështetjen për arsye se po e rritet, vërtetë ambasadat tona duhet të kenë legjislacion, duhet të kompletohen me legjislacion, me logjistikë dhe ato duhet të funksionojnë ashtu si i ka hije një shteti, sepse jemi në fillim dhe duhet ta fitojmë imazhin në radhë të parë e lere më pastaj procedurat ligjore të cilat fatkeqësisht shkelen shpesh dhe atje ka mundësi të ndodhin edhe keqpërdorime të ndryshme.

Unë kisha pas me u ndal vetëm te një letër që na ka ardhur para ligjit që realisht përshkruhet – vlerësimi i ndikimit buxhetor që është mirë e theksuar sa kemi ndarë për vitin 2009 dhe çka parashihet tash në 2010-2011, është paqartësi, domethënë, rrezik financiar dhe sigurimi i mjeteve buxhetore.

Domethënë, isha ndalur tek paqartësia, ky rreziku financiar që atje diku në nenin 5, nëse nuk gabo, këtu thotë – vlerësohet si rrezik financiar fakti se sipas këtij projektligji Qeveria e Republikës së Kosovës cakton një komision profesional për zhvillimin e negociatave me subjektin që e shet pronën, objektin. Pra, përbërja, kompetenca dhe funksionimi i Komisionit rregullohen me akt nënligjor të Qeverisë.

Natyrisht, unë mendoj se dy komisione, apo komisioni funksional për këtë ligj duhet të ulet dhe ta rregullojë mirë këtë nen, sepse ky është tash një risi prej neve, domethënë është një prokurim njëburimor dhe vërtet në këtë komision duhen të jenë njerëzit me përgjegjësi, ndoshta edhe vetë ministrat ose realisht duhet në përbërje të këtij Komisioni të ketë edhe nga opozita sepse ne jemi dëshmitarë tashmë çka ndodhë edhe me tenderë që janë shumë burimore e lere më me një blerje një burimor që vërtet ka hapësirë për korrupsion.

Megjithatë, pa u lëshua shumë në detaje, Lidhja Demokratike e Dardanisë e përkrah këtë ligj në parim dhe do ta jap kontributin e vet në komisionet funksionale. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Sipas radhës, ne emër të Grupit Parlamentar ” 7+”, fjalën e ka Shpresa Murati.

ŠPRESA MURATI: Hvala! Pozdravljam sve prisutne!

I Parlamentarna grupa „7+“ je razmatrala Nacrt zakona o izmenama i dopunama Zakona o javnoj nabavci i smatra da će predložene izmene i dopune eliminisati praznine koje se odnose na redovnu delatnost, funkcionisanje i odgovornost diplomatsko-konzularnih misija. Trebalo bi možda obratiti pažnju na član 34. u celini, posebno na tačku odnosno paragraf 21 i 22, prema kojima Vlada treba da formira jednu stručnu komisiju za pregovaranje sa subjektima koji prodaju imovinu, dok sastav nadležnost i funkcija komisije uređuju se podzakonskim aktom.

Samatramo da bi bilo bolje i preciznije da se to zakonski uredi. Na kraju, Parlamentarna grupa „7+“, podržava u načelu ovaj nacrt zakona i daće svoj doprinos u toku njegove dalje procedure. Hvala!

KRYESUESI: Ju falemidnerit!
Në emër të Grupit Parlamentar SLS, Kosara Nikoli.

KOSARA NIKOLIĆ: Hvala, gospodine predsedniče!
Parlamentarna grupa SLS je razmatrala nacrt zakona, i sobzirom da se radi o hitnosti koja mora da se sprovede, jer bez toga samatramo da nema funkcionisanja države, samo imamo jednu dilemu, ministar je malo pre rekao da se radi o Zakonu 2003/17, a u dokumentima nam stoji da se radi o Zakonu 02L-99. Mi podržavamo u suštini nacrt zakona.

KRYESUESI: Ju faleminderit!
Konstatoj që grupet parlamentare e kanë kryer prononcimin e tyre. Tani, sipas radhës, deputetët e paraqitur. Fjalën e ka deputetja Vlora Çitaku.

VLORA ÇITAKU: Ju faleminderit shumë, zoti kryesues!
Do të doja që në cilësinë e deputetes, por edhe duke qenë zëvendësministre e Punëve të Jashtme, ndiej nevojë që t'i jap disa sqarime para deputetëve.

E para që dua të them, është që Ligji i prokurimit, me të cilin operojmë ne sot, është miratuar jashtë kontekstit të shtetësisë dhe, si i tillë, nuk trajton fare çështjen e ambasadave dhe të misioneve diplomatike. Do të duhej të evitojmë situatat, kur sa herë që miratojmë një ligj apo diskutojmë për një projektligj, gjithmonë e trajtojmë atë nga një kontekst apo nga një perspektivë e keqpërdorimeve apo keqmenaxhimeve. Ne ambasadorëve të Republikës së Kosovës u kemi besuar shumë më shumë se sa një buxhet, u kemi besuar që ata ta përfaqësojnë Republikën e Kosovës, në shtetet përkatëse ata janë edhe president, edhe kryeministër edhe ministër, ata janë përfaqësues të shtetit të Kosovës dhe ne kemi obligim që t'ju ofrojmë një dinjitet minimal. Kjo është e para.

E dyta, bazuar në Ligjin mbi menaxhimin e financave publike, të vetmit persona të autorizuar për të nënshkruar kontrata janë menaxherët e prokurimit, menaxherët e certifikuar të prokurimit. Qeveria e Kosovës, me buxhetin që ka sot, dhe jo vetëm Qeveria e Kosovës, por ne kemi bërë edhe kemi hulumtuar edhe si e kanë të rregulluar këtë çështje vendet e rajonit, ne nuk mund të përballojmë që në ambasadat e Republikës së Kosovës, të dërgojmë menaxher prokurimi, të cilët do të merreshin ekskluzivisht me këtë çështje. Andaj, çështja e lidhjes së kontratave dhe e prokurimit është një e drejtë e cila duhet bartur tek pjesëtarët e stafit diplomatik. Normalisht që edhe ata do t'ju nënshtrohen proceseve të auditimit dhe padyshim që ne do të përkujdesemi që t'i evitojmë situatat e keqpërdorimit.

Tek çështja e blerjes së ambasadave u fol se nuk do të hapet tender. Çështja e blerjes së ambasadave nuk është uniforme me të gjitha shtetet ku ne synojmë të blejmë ambasada. Kjo është çështje e cila lidhet me protokollin e shtetit dhe mund të krahasohet edhe me një lloj eksterritorialiteti dhe nuk është çështje e cila rregullohet, do të ishte shumë e vështirë të rregullohet përmes procedurave të hapura të tenderimit. Shtetet e veçanta këtë e kanë të rregulluar në disa mënyra. Në disa shtete ekzistojnë hapësirat e ndara për misionet diplomatike dhe ne do ta kemi pak a shumë të parapërcaktuar vendin se ku do të blejmë ambasadën ose do të duhej të negociojmë me agjencitë e specializuara në shtetet përkatëse, të cilat merren ekskluzivisht me patundshmëri të misioneve diplomatike, sepse përveç elementit të protokollit, këtu është edhe elementi i sigurisë.

Unë dua t'ju njoftoj se ne as me qira nuk kemi mundur të marrin objektet aty ku kemi dashur, pa u konsultuar paraprakisht me protokollin e shtetit përkatës. Duke pasur parasysh gjithë këto implikime, unë do të kërkoja nga deputetët e Kuvendit të Kosovës që ta trajtojnë me urgjencë këtë

çështje, në mënyrë që misionet tona diplomatike, posaçërisht tani kur synojmë të hapim edhe misionet tona konsullore, në mënyrë që bashkatdhetarëve tanë më në fund të jemi në gjendje t'ju ofrojmë shërbime, ta trajtojnë këtë çështje me urgjencë dhe ta kalojmë këtë ligj edhe në leximin e dytë, gjatë këtij sezoni, brenda muajit korrik. Ju faleminderit, shumë!

KRYESUESI: Ju faleminderit!
Fjalën e ka deputeti Sabri Hamiti.

SABRI HAMITI: Ju faleminderit, zoti kryesues Haliti!

Unë po flas edhe si deputetë, në këtë rast edhe si kryetar i Komisionit për Politikë të Jashtme. Është mirë që, më në fund, ky ligj po vjen në Parlament. Mendoj që deputetët e të gjitha orientimeve dhe të gjitha përvojave kanë të drejtë të flasin për këtë ligj në tërësinë e tij. Mirëpo, sot ma merr mendja që nuk është mirë që të thellohemi në te, sepse dihet saktësisht që ky ligj po ndryshohet për shkak të një qëllimi të ngutshëm. Prandaj, unë e përkrah plotësisht zëvendësministren e Jashtme, zonjushën Çitaku. Mendoj se duhet të përdoren të gjitha dinamikat ligjore të Parlamentit që do të mund ta arrinin, do me thënë, sipas procedurave ekzistuese që ky ligj të aprovohet brenda këtij muaji, që do të thotë para pushimit veror të Parlamentit.

Nuk dua të flas këtu sot, sepse kam folur edhe me ministrin e Financave, disa herë për këto probleme, ministrin e Jashtëm, për nevojën që ky ligj të kalohet shpejt, por të gjithë ne që kemi pasur rastin të kemi kontakte me përfaqësitë tona, e dimë në çfarë gjendje janë ata momentalisht. Ne po flasim për imixhe, por ata, zonja e zotërinj, tavolinat i kanë qua nga shtëpitë e tyre, sepse ligji në fuqi nuk u lejon, nuk u jep mundësi të kenë kushte elementare pune dhe mendoj se edhe vetë nuk do të bëjë më tutje fjalim, do ta ndërpresë këtu se më duket i padobishëm në këtë rast, veç se t'i thërras edhe njëherë komisionet që do të ngarkohen për ta lexuar Ligjin deri në leximin e dytë në Parlament, ju lus që ta kryeni punën sa më shpejt, natyrisht, në bazë të procedurave të Parlamentit. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit!
Fjalën e ka deputeti Bahri Hyseni, le të përgatitet Myzejene Selmani.

BAHRI HYSENI: Ju faleminderit shumë, zoti kryesues!

Ne e përkrahim Projektligjin, në parim, duke pasur parasysh që është projektligj me një rëndësi të veçantë dhe natyrisht që e bën çështjen e funksionimit të institucioneve diplomatike efikase. Mirëpo, unë konsideroj se Ligji i prokurimit publik ka pasur nevojë edhe për disa ndryshime dhe është mirë t'i jepet autoritet, Kuvendi t'i jep autoritet Komisionit për Buxhet dhe Financa që për disa çështje të cilat donë domosdo të ndërrojnë Ligjin e prokurimit publik, sepse janë të paimplementueshme në praktikë disa nene. Me rastin e amendamentimit, Komisioni për Buxhet dhe Financa dhe në komisionet tjera, të mos i lëshojnë.

Sipas rregullave procedurale, nuk e kemi këtë të drejtë, nëse nuk e ngrehim çështjen në lexim të parë. Prandaj, me qëllim po e ngreh në lexim të parë, me qëllim që të jepet mundësia t'i amendamentojmë së paku një dy-tre nene që janë pengesë e funksionimit të Ligjit të prokurimit publik.

Dhe, çështja tjetër, është çështja e rregullimit ndoshta të këtyre neneve. Ne e kuptojmë se ndoshta nuk kanë pasur mundësi, por është mirë të rregullohen, se nëse i lëshojmë kështu, to ta kemi problem ta bëjmë funksional këtë projektligj.

Neni 34.11 i jep autoritet shefit të misionit diplomatik të negociojë për të marrë objekte me qira. Krejt është në rregull. Mirëpo, neni 34.13 tash i jep autoritet të njëjtit shef për të autorizuar një

kompani për të bërë një kohë të gjatë a të marrë objekte me qira, që tash është e panevojshme, njëra ose tjetra. Më pastaj, shkon neni 34.19, që e bënë tash më të paqartë, thotë: për blerjen e objekteve për Misionin diplomatik të Republikës së Kosovës, përdoren procedurat e negociuara pa publikimin e njoftimit të kontratës. Kjo veç në fillim u tha, mendoj me nenin 34.11, nuk ka nevojë.

Më pastaj, 34.20 thotë: “Për blerjen e objekteve për misionet diplomatike, paraprakisht merret vendimi i Qeverisë”. Neni 34.21 thotë: Qeveria formon komision, do me thënë, nga neni 34.11, ku thotë - shefit të misionit diplomatik i jepet e drejta të negociojë për të marrë objektin me qira, mandej thotë, e cakton një kompani neni tjetër, më pastaj thotë, Qeveria duhet të marrë vendim, e më pastaj thotë, Qeveria formon një komision, faktikisht nuk dihet cili autoritet. Prandaj, është mirë që komisioni funksional të ketë pasur parasysh që shefit të misionit diplomatik t’i jepet autoritet, sepse krejt qëllimi i këtij ligji është mos të pengojë aktivitetin e institucioneve diplomatike që veprojnë jashtë. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit!
Deputetja Selmani e ka fjalën.

MYZEJENE SELMANI: Projektligji për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit nr. 02L-69 për Prokurim publik në Kosovë, sipas të gjitha gjasave, po shihet se kërkesa e Ministrisë së Punëve të Jashtme ka ndodhur që ky plotësim-ndryshim të bëhet për rregullimin e procedurave për misionet diplomatike të Republikës së Kosovës. Mirëpo, edhe duke i përkrahur mendimet dhe vendimet e Komisionit për Buxhet dhe Financa që ky Projektligj nuk është në harmoni dhe me Projektligjin për ndërmarrjet publike, atëherë, zoti ministër, është dashur së paku të rishkruhet një ligj i ri, komplet, i cili do t’i përkrahte edhe konsullatat, njëkohësisht edhe do t’i përkrahte rekomandimet e Komisionit për Buxhet dhe Financa.

U tha se, në parim, edhe Grupi Parlamentar i AKR-së e përkrah këtë Projektligj për arsye që të plotësohen konditat për misionet diplomatike të Kosovës, kështu që kërkojmë ndryshimet dhe plotësimet të mos të bëhen vetëm për nga një dikaster, por të bëhen në përgjithësi në krejt Projektligjin. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit!

Konstatoj se nuk ka të tjerë të paraqitur për diskutim. Në vazhdim, kërkoj deklarinimin me votim të deputetëve lidhur me Projektligjin. Së pari të konstatojmë kuorumin. Nuk ka kuorum. Pauzë një orë.

Vazhdimi i seancës pas pauze

KRYESUESI XHAVIT HALITI: Pra, po presim edhe pesë minuta, në qoftë se nuk ka kuorum, do ta shtyjmë seancën për javën e ardhshme.

Regjia, ju lutem, paraqiteni gjendjen në sallë para medieve. Pra, hiqni kartelat e atyre që s’ janë në sallë.

KRYETARI: Të nderuar deputetë, a po e shtyjmë edhe për gjysmë ore apo për...?

(Reagime nga salla)

KRYETARI: Mirë ju faleminderit! Regjia, le t'i evidentojë kush është në këtë moment në sallë. Këtë ta keni parasysh, do t'u hiqet nga një mëditje e plotë të gjithë atyre që mungojnë me këtë rast.

Ju njoftoj juve edhe përmes jush, nëse është edhe në televizion, që deputetët që nuk janë në këtë seancë, në këtë moment, do të thotë, mëditjet do t'i kenë të humbura. Pra, do ta bëjmë që në fund të seancave të nënshkruhen deputetët që e kryejnë seancën. Regjistrimi i deputetëve do të ndodhë në fund të seancës dhe ai do të jetë bazë që t'u paguhet kompensimi për mëditjen në seancë plenare.

KRYESUESI XHAVIT HALITI: Të nderuar deputetë, vazhdojmë seancën. Në sallë janë 62 deputetë, kështu që mund të vazhdojmë me procedurën e votimit për shqyrtimin e parë të Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për prokurim publik.

Diskutimet janë kryer. Fillojmë votimin. Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim. Votojmë tani.

Me 5 vota "për", 2 abstenime dhe 2 "kundër", Kuvendi miratoi në parim Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për prokurimin publik në Kosovë. Ju faleminderit!

Në bazë të Rregullores së Punës, Kuvendi ngarkon këto komisione:

- Komisionin për Buxhet dhe Financa, si komision funksional,
- Komisionin për Legjislacion dhe Gjyqësi,
- Komisionin për Komunitete, dhe
- Komisionin për Integritet Evropian.

Komisionet duhet që për seancën e radhës, Kuvendit t'ia paraqesin raportet me rekomandime.

Vazhdojmë me pikën e dhjetë të rendit të ditës:

- Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për rezervat shtetërore të mallrave

Konstatime hyrëse:

Komisioni për Ekonomi, Tregti, Industri, Energjetikë, Transport dhe Telekomunikacion, ka shqyrtuar Projektligjin për rezervat shtetërore të mallrave dhe Kuvendit i ka rekomanduar që ky projektligj t'i kthehet sponsorizuesit, Qeverisë për ri hartim.

Rekomandimi i Komisionit i u është shpërndarë deputetëve. Para se ta procedojmë me votimin e rekomandimit, ftoj kryetaren e Komisionit për Ekonomi, Tregti, Industri, Energjetikë, Transport dhe Telekomunikacion, deputeten Myzejene Selmani, apo raportuesin e Komisionit që para deputetëve ta arsyetojë rekomandimin e Komisionit.

MYZEJENE SELMANI: Zotëri, kryesues! A ka të drejtë të flasë raportuesja e këtij projektligji që është kthyer, a të flasë në emër të Komisionit komplet? Okej. Ju faleminderit!

Në bazë të rregullave numër 37 dhe 47 të Rregullores së Punës së Kuvendit të Kosovës, Komisioni për Ekonomi, Tregti, Industri, Energjetikë, Transport dhe Telekomunikacion, më 9.6. 2009, e shqyrtoi Projektligjin për rezervat shtetërore të mallrave dhe përfundoi se Projektligji ka implikime të mëdha buxhetore, që e venë në dyshim zbatimin e tij, si dhe ka mangësi të mëdha

përmbajtjesore- juridike. Projektligji ka nevojë të pësojë ndryshime më shumë se në 50% të materies e që është në kundërshtim me procedurat përkatëse.

Bazuar në këtë vlerësim, Komisioni përfundoi se projektligji duhet t'i kthehet sponsorizuesit duke e nxjerrë këtë rekomandim: I rekomandohet Kryesisë që t'i procedojë Kuvendit të Republikës së Kosovës, për shqyrtim përfundim e Komisionit që Projektligji t'i kthehet sponsorizuesit me kërkesë që të ri miratohet duke plotësuar standardet themelore të legjislacionit dhe nevojat përmbajtjesore, specifike të Republikës së Kosovës. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit! Qeveria nuk është dakord me propozuesin, nuk kanë opsion tjetër. Atëherë, në qoftë se keni për të thënë diçka, mund ta thoni. Okej. Ministri e ka fjalën.

MINISTRI LUTFI ZHARKU: I nderuar kryesues,

Të nderuar deputetë,

Unë kisha dashur vetëm dy çështje t'i përmend. Sa i përket implikimeve buxhetore, besoj se ligji mund të aplikohet parçalisht sipas alokimeve buxhetore me ndryshim të një neni, kurse sa i përket asaj që ligji duhet të amendamentohet më shumë se 50%, ne si pjesë e Qeverisë nuk kemi pasur deri tash kurrfarë kërkesë apo rekomandimi nga ana e Komisionit, se ligji duhet të rekomandohet. Unë mendoj se duhet të kthehet, por veç dua t'ju përkujtoj se në leximin e parë ligji ka qenë i lavdëruar dhe është mirëpritur nga të gjithë deputetët, kështu që besoj se ky ligj është mirë ose të votohet siç është, është propozimi im, apo të na jepet një kohë që të merremi vesh me Komisionin, që si Ministri që ta ripunojmë. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit!

Sipas Rregullores dhe vendimit paraprak të Kryesisë së Kuvendit, nuk ka debat për këtë çështje. Ministri e tha arsyetimin dhe qëndrimin e Qeverisë dhe të Ministrisë përkatëse. Komisioni ka dhënë rekomandimet, tani lus regjinë dhe deputetët, le të përgatiten për votim. Votojmë tani.

(Reagime nga salla)

Rekomandimet e Komisionit, nuk ka debat. Konstatoj se më 31 vota "për", 3 abstenime, 4 vota "kundër", Kuvendi miratoi rekomandimin e Komisionit për Ekonomi, Tregti, Industri, Energjetikë, Transport dhe Telekomunikacion, që Projektligji dhe rezervat shtetërore të mallrave t'i kthehet sponsorizuesit, Qeverisë për rihartim.

Vazhdojmë me pikën 11 të rendit të ditës:

- Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për menaxhimin e pasurisë së sekuestruar apo të konfiskuar

Konstatime hyrëse:

Komisionet parlamentare kanë shqyrtuar Projektligjin për menaxhimin e pasurisë së sekuestruar apo të konfiskuar dhe Kuvendit i kanë rekomanduar miratimin e tij me amendamentet e propozuara. Raportet me rekomandimet e komisioneve iu janë shpërndarë deputetëve. Para se të procedojmë me votimin e amendamenteve, ftoj kryetarin e Komisionit për Legjislacion dhe Gjyqësi, deputetin Bahri Hyseni apo raportuesin e Komisionit, që para deputetëve ta arsyetojë raportin me rekomandime.

Ju lutem, ju keni pasur mundësinë që të informoni Kryesinë me kohë, që të ankoheni me kohë. Unë nuk mund ta rikthej rendin e ditës në Kryesi, unë e kam rendin e ditës, kam zbatuar Rregulloren. Pakënaqësitë tuaja mundeni t' i shprehni më tutje. Zoti Hyseni, e keni fjalën.

BAHRI HYSENI: Ju faleminderit, zoti kryesues!
Mirëpo, para se të flas për ...

KRYESUESI: Vetëm sipas Rregullores, zoti Rexhepi. Më fal zoti Rexhepi, unë jam duke e zbatuar Rregulloren e Kuvendit dhe nuk kam të drejtë që të fus diçka në proces, debatin, i cili nuk është i paraparë në rend dite. Ju nuk keni kërkuar debat dhe ju lutem, ky është rregull si për mua, si për ju, si për të gjithë deputetët. Mirë, unë nuk e kam me shkrim, prandaj nuk lodhem hiq çka po thua ti, në emër të cilit grup. Grupi Parlamentar i LKD-së, mund të flasë. I ke dy anëtarë të Lidhjes Demokratike të Kosovës në Kryesi dhe e ke një kryetar të Grupit Parlamentar. Asnjëri nga këta nuk kanë kërkuar diçka, nuk kanë kërkuar një procedurë tjetër, nuk kanë kërkuar që të mbështetet propozimi i Qeverisë, nuk kanë informuar që nuk ka marrë vendim Komisioni. Dhe, as ju, si anëtarë të Komisionit, nuk e keni nënshkruar në letër që t'ia dërgoni Kryesisë së Kuvendit, t'i thoni se kjo çështje nuk është shqyrtuar në Komision. Tani, unë e kalova me votim dhe nuk dua më që të debatoj për këtë çështje.

Fjalën e ka zoti Hyseni.

BAHRI HYSENI: Ju faleminderit, zoti kryesues!

Komisioni për Legjislacion dhe Gjyqësi në afatin e përcaktuar me Rregulloren e Punës së Kuvendit, e ka shqyrtuar Projektligjin për menaxhimin e pasurisë së sekuestruar ose të konfiskuar dhe ka konstatuar se në përmbajtjen e disa neneve ekzistuese të projektligjit, me qëllim të rregullimit të neneve përkatëse, të bëjë amendamente dhe amendamentet kanë qenë me qëllim që këto nene të projektligjit në fjalë të jenë të zbatueshme në praktikë.

Komisioni ka hartuar amendamente që kanë të bëjnë me titullin e Projektligjit, me emrin e Agjencisë, me titullin e kreut 2, me nenet 3.2, 6.1, 6.3, 6.4, 7.6 e të tjerë. Prandaj, meqë bëhet fjalë për një ligj me interes të veçantë dhe për një ligj, i cili për herë të parë po e rregullon një çështje shumë me interes, kërkoj nga deputetët e Parlamentit të Kosovës, që t'i mbështesin amendamentet e propozuara dhe Projektligjin në fjalë ta aprovojmë. Faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit, zoti Hyseni!

Vazhdojmë me votimin e amendamenteve një nga një. Lus regjinë dhe deputetët që të përgatiten për votim. Votojmë amendamentin e parë tani.

Amendamenti 1

Me 51 vota “për”, 4 abstenime, 4 vota “kundër”, miratohet amendamenti 1.

Amendamenti 2

Konstatohet se në sallë janë 70 deputetë. Votojmë, tani.

Me 37 vota “për”, 4 abstenime, 1 “kundër”, miratohet amendamenti 2.

Amendamenti 3

Votojmë, tani.

Me 39 vota “për”, 4 abstenime, 1 “kundër”, miratohet amendamenti 3.

Amendamenti 4

Votojmë, tani.

Me 45 vota “për”, 4 “kundër”, 3 abstenime, miratohet amendamenti 4.

Amendamenti 5

Votojmë, tani.

Me 53 vota “për”, 1 “kundër”, 5 abstenime, miratohet amendamenti 5

Amendamenti 6

Votojmë, tani.

Me 48 vota “për”, 3 “kundër”, 2 abstenime, miratohet amendamenti 6.

Amendamenti 7

Votojmë, tani.

Me 47 vota “për”, 2 “kundër”, 4 abstenime, miratohet amendamenti 7.

Amendamenti 8

Votojmë, tani. Në sallë janë 71 deputetë.

Me 54 vota “për”, 3 “kundër”, 4 abstenime, miratohet amendamenti 8.

Amendamenti 9

Votojmë, tani.

Me 50 vota “për”, 2 “kundër”, 5 abstenime, miratohet amendamenti 9

Amendamenti 10

Votojmë, tani.

Me 53 vota “për”, 3 “kundër”, 5 abstenime, miratohet amendamenti 10.

Tani të nderuar deputetë, e votojmë tekstin në tërësi me amendamentet e miratuara. Votojmë, tani.

Siç e thashë, në sallë janë 71 deputetë.

Me 57 vota 2 “për”, 4 abstenime dhe 3 “kundër”, konstatoj se Kuvendi miratoi Ligjin për administrimin e pasurisë së sekuestruar ose të konfiskuar.

Vazhdojmë me pikën 12 të rendit të ditës:

- Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për punësimin e shtetasve të huaj në Republikën e Kosovës

Konstatime hyrëse:

Komisionet parlamentare kanë shqyrtuar Projektligjin për punësimin e shtetasve të huaj në Republikën e Kosovës dhe Kuvendit i kanë rekomanduar miratimin e tij me amendamentet e propozuara. Raportet me rekomandimet e komisioneve u janë shpërndarë deputetëve. Pra se të procedojmë me votimin e amendamenteve, ftoj kryetarin e Komisionit për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale, zoti Sadik Idriz apo raportuesin e Komisionit, që para deputetëve ta arsyetojë raportin me rekomandime.

Zoti, Sadik Idriz, urdhëroni e keni fjalën!

SADIK KDRIZ: Hvala, predsedavajući!

Komisija za zdravstvo, rad i socijalno staranje je radila na ovom zakonu i dostavlja izveštaj na ovaj nacrt zakona, Komisija je dala 23 amandmana, od kojih 5 amandmana su amandmani poslanika Rize Smake, 4, 16, 18, 21 i 24. ali uz podršku funkcionalne komisije, znači predlažemo da i ti amandmani prodju, znači Komisija predlaže. Takodje, kada budu drugi amandmani, imam jednu inatervenciju, ima greške odredjene, ali kada bude drugi amandman, da dobijem reč... Komisija znači predlaže da zakon, odnosno nacrt zakona sa amandmanima Parlament usvoji. Huvala!

KRYESUESI: Ju faleminderit!

Ju lus që ta konstatojmë kuorumin. Konstatoj se në sallë janë 72 deputetë. Kemi kuorum për të vazhduar me votimin e amendamenteve. Pra, vazhdojmë me votimin amendamenteve të propozuara sipas radhës së paraqitur në raport.

Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim. Votojmë amendamentin 1.

Me 52 vota “për”, 4 abstenime, 4 “kundër” Kuvendi miratoi amendamentin nr. 1.

Për amendamentin e dytë, është lajmëruar Sadik Idriz.

SADIK IDRIZ: Hvala!

U tekstu koji je ovde prikazan, došao je do jednog tehničkog propusta, iza reči „za rad“ ili na albanskom „per punë“ da se doda reč: „dhe punësim“ jer nije u skladu sa naslovom zakona, znači samo jedna reč da se doda posle reči „punë dhe punësim“, znači „rad i zapošljavanje“.

KRYESUESI: Atëherë, a jeni dakord me propozimin? Okej. Konstatoj që propozimi i kryetarit të Komisionit është i arsyeshëm dhe deputetët janë “për”.

Atëherë, vazhdojmë votimin për amendamentin e dytë sipas propozimeve të kryetarit të Komisionit që dha tani, zotit Sadik Idriz. Regjia dhe deputetët të bëhen gati për votim dhe votojmë, tani:

Amendamenti 2

Me 55 vota “për”, 3 abstenime, 7 “kundër”, miratohet amendamenti 2.

Amendamenti 3

Votojmë tani.

Me 50 vota “për”, 5 “kundër”, 2 abstenime, miratohet amendamenti 3.

Amendamenti 4

Votojmë, tani.

Me 49 vota “për”, 5 “kundër”, 2 abstenime, miratohet amendamenti 4.

Amendamenti 5

Votojmë, tani.

Me 43 vota “për”, 6 “kundër”, asnjë abstenime, miratohet amendamenti 5.

Amendamenti 6

Votojmë, tani.

Me 50 vota “për”, 6 “kundër”, 1 abstenime, miratohet amendamenti 6.

Amendamenti 7

Votojmë, tani.

Me 49 vota “për”, 4 “kundër”, 4 abstenime, miratohet amendamenti 7.

Amendamenti 8

Votojmë, tani.

Me 51 vota “për”, 6 “kundër”, 3 abstenime, miratohet amendamenti 8.

Amendamenti 9

Votojmë, tani.

Me 45 vota “për”, 4 “kundër”, 3 abstenime, miratohet amendamenti 9.

Amendamenti 10

Votojmë, tani.

Me 47 vota “për”, 4 “kundër”, 3 abstenime, miratohet amendamenti 10.

Amendamenti 11

Votojmë, tani.

Me 53 vota “për”, 6 “kundër”, 3 abstenime, miratohet amendamenti 11

Amendamenti 12

Votojmë, tani.

Me 53 vota “për”, 5 “kundër”, 4 abstenime, miratohet amendamenti 12.

Amendamenti 13

Votojmë, tani.

Me 49 vota “për”, 5 “kundër”, 1 abstenime, miratohet amendamenti 13.

Amendamenti 14

Votojmë, tani. Ju lus që të votoni “për” ose “kundër”, mos harroni. Ju faleminderit!

Me 50 vota “për”, 5 “kundër”, 3 abstenime, miratohet amendamenti 14

Amendamenti 15

Votojmë, tani. Ju faleminderit

Me 52 vota “për”, 6 “kundër” dhe 3 abstenime, miratohet amendamenti 15.

Amendamenti 16

Votojmë, tani. Ju faleminderit!

Me 52 vota “për”, 5 “kundër” dhe 3 abstenime, miratohet amendamenti 16.

Amendamenti 17

Votojmë, tani. Ju lus që të votoni. Ju faleminderit!

Me 46 vota “për”, 6 “kundër” dhe 3 abstenime, miratohet amendamenti 17.

Amendamenti 18

Votojmë, tani. Kuorumin, ju lutem.

Me 46 vota “për”, 4 “kundër” dhe 3 abstenime, miratohet amendamenti 18

Amendamenti 19

Votojmë, tani. Vazhdojnë të jenë 72 deputetë në sallë, nuk po votojnë të gjithë. Ju faleminderit!

Me 43 vota “për”, 5 “kundër” dhe 3 abstenime, miratohet amendamenti 19.

Amendamenti 20

Votojmë, tani. Ju faleminderit!

Me 49 vota “për”, 5 “kundër” dhe 4 abstenime, miratohet amendamenti 20.

Amendamenti 21

Votojmë, tani. Ju faleminderit!

Me 49 vota “për”, 5 “kundër” dhe 2 abstenime, miratohet amendamenti 21.

Amendamenti 22

Votojmë, tani. Ju faleminderit!

Me 53 vota “për”, 6 “kundër” dhe 2 abstenime, miratohet amendamenti 22.

Amendamenti 23

Votojmë, tani. Ju faleminderit!

Me 50 vota “për”, 7 “kundër” dhe 2 abstenime, miratohet amendamenti 23.

Konstatohet që u votuan të gjitha amendamentet. Vazhdojmë me votimin. Votojmë tani për tekstin e Ligjit në tërësi me amendamentet e miratuara.

Në sallë janë prezentë 72 deputetë.

Me 53 vota “për”, 5 “kundër”, 2 abstenime, konstatohet se Kuvendi e miratoi Ligjin për dhënien e lejes për punë dhe punësim të shtetasve të huaj në Republikën e Kosovës. Ju faleminderit!

Vazhdojmë me pikën e 13-të të rendit të ditës, që është:

- Shqyrtimi i Raportit të Komisionit për Ekonomi, Tregti, Industri, Energjetikë, Transport dhe Telekomunikacion lidhur me mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për rrugët

Konstatime hyrëse:

Komisioni për Ekonomi, Tregti, Industri, Energjetikë, Transport dhe Telekomunikacion, në pajtim me dispozitat e Rregullores së Punës, ka bërë mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për rrugët dhe Kuvendit i ka paraqitur raportin me rekomandime.

Raporti me rekomandime iu është shpërndarë deputetëve. Sipas radhës, lus që ta marrë fjalën kryetarja e Komisionit funksional, zonja Myzejene Selmani.

MYZEJENE SELMANI: Ju faleminderit, zoti kryesues!

Përshëndetje për ministren dhe ministrin që janë prezent.

Përshëndetje për të gjithë deputetët,

Duke u bazuar në Rregullën 53 të Rregullores së Punës së Kuvendit të Kosovës, Komisioni për Ekonomi, Tregti, Industri, Energjetikë, Transport dhe Telekomunikacion, ka autoritetin ta mbikëqyrë zbatimin e ligjeve në fushat të cilat i mbulon.

Për ta ushtruar këtë autoritet, Komisioni kontrollon dhe studion efektivitetin e ligjeve në fuqi, paraqet propozimet për masat konkrete që duhet të ndërmerren, ushtron kontroll të punës së Ministrisë përkatëse rreth zbatimit të ligjeve dhe i raporton Kuvendit për shkallën e zbatimit të ligjeve.

Në kuadër të mbikëqyrjes së zbatimit të Ligjit, Komisioni për Ekonomi, Tregti, Industri, Energjetikë, Transport dhe Telekomunikacion, në mbledhjen e datës 11 korrik 2008, vendosi ta mbikëqyrë zbatimin e Ligjit për rrugët.

Komisioni, duke u mbështetur në autorizimet që ka, arriti t’i përmbyllë aktivitetet e planifikuara për mbikëqyrjen e zbatimit të ligjit. Gjatë kësaj periudhe, Komisioni bëri katër vizita në terren. Janë mbajtur edhe takime të Grupit, qëllimi i të cilave ishte koordinimi dhe planifikimi i aktiviteteve. Vizitat e Komisionit në terren u përqendruan në shkallën e institucioneve si: institucione lokale, komuna e Prishtinës, komuna e Mitrovicës, komuna e Gjakovës. Institucionet qendrore, Ministria e Transportit dhe Telekomunikacionit -dy takime dhe vizita në terren, rruga e Dushkajës në komunën e Gjakovës, për verifikimin e kategorizimit të rrugës. Në të gjitha fazat e mbikëqyrjes së zbatimit të ligjit, Komisioni është mbështetur nga Instituti Demokratik Kombëtar NDI dhe stafi mbështetës i Komisionit.

Mbështetja e NDI dhe e stafit mbështetës të Komisionit ishte profesionale dhe teknike. Atëherë do të kaloj vetëm te takimet e Komisionit dhe vizitat të cilat janë bërë, që të gjithë deputetët i keni përpara.

Vizita në terren. Komisioni për mbikëqyrje të zbatimit të Ligjit për rrugë, i realizojë 5 vizita në terren, në tabelë janë të dhëna të gjitha institucionet të cilat janë vizituar. Pikë së pari është Ministria e Transportit dhe Postë-Telekomunikacionit, takimi me zëvendësministrin, Adem Grabovci dhe sekretarin permanent, Skënder Gashi.

Kuvendi Komunal i Gjakovës, takim me kryetarin e Komunës, zotëri Palë Lekaj.

Vend punimet në rrugën e Dushkajës, për vizitë në terren ishte edhe zëvendësministri Adem Grabovci me Komisionin.

Kuvendi Komunal i Prishtinës, ku kishim takim me zotëri Halim Halimin, drejtor i Administratës, Agim Salihun, shef i Zyrës Ligjore, zotëri Habib Çorri, shef i Shërbimeve Publike, zotëri Ahmet Gashin, drejtor për Çështje Juridike, zotëri Refik Sadikun, shef i Drejtorisë për infrastrukturë lokale, zotëri Shyqyri Spahiun, drejtor i Urbanizmit, zotëri Ejup Krasniqin, drejtor i Drejtorisë së Pronës, zotëri Rasim...

Tash do të them edhe në Kuvendin Komunal të Mitrovicës, takimi me zotëri Rasim Veselin, drejtor i Urbanizmit dhe zotëri Mehdi Balën, drejtor i Administratës.

Në Komision ka raportuar edhe ministri i Transportit, zoti Fatmir Limaj. Atëherë problemet e identifikuar gjatë monitorimit të ligjit, do t'i cek: mungesa e disa akteve nënligjore dhe moszbatimi i akteve ekzistuese. Komisioni për Ekonomi, Tregti, Industri, Energjetikë, Transport dhe Telekomunikacion, gjatë mbikëqyrjes së Ligjit për rrugët, vërejti se mungojnë disa udhëzime administrative, pa të cilat vështirësohet puna e Ministrisë dhe e komunave në zbatimin e ligjit.

Në vizita, në disa komuna, Komisioni vërejti se mungesa e disa udhëzimeve administrative, ndikon shumë në moszbatimin të plotë të ligjit- mungesa e planeve vjetore komunale për mirëmbajtjen dimërore dhe verore. Gjatë mbikëqyrjes së zbatimit të ligjit, u identifikuan mungesat e planeve vjetore për mirëmbajtjen e rrugëve. Ligji për rrugët, neni 12, e detyron ministrin, përkatësisht Kuvendin Komunal t'i hartojë planet e mirëmbajtjes së rrugëve sipas kompetencave.

Ministria ka plan vjetor për mirëmbajtjen e rrugëve, përderisa komunat jo. Planifikimi i rrugëve të kategorizuara nga Ministria dhe komunat.

Komisioni në takim dhe në vizitat në terren, identifikoi mungesën e regjistrave në shkallën e komunave të rrugëve, si dhe mungesën e kategorizimeve të reja të rrugëve, qofshin ato magjistrale, rajonale ose lokale.

Neni 4 dhe 7 i Ligjit 2003/11, parasheh rregullimin e kategorizimit të rrugëve me një rregullore të veçantë që e nxori ministri. Edhe pse është akti nënligjor numër 2006/18 për caktimin e kriterëve dhe procedurave për kategorizimin e rrugëve, në vizita në terren, është konstatuar se nuk janë bërë kategorizimet përkatëse. Ky problem është identifikuar në vizitë në komunën e Gjakovës, në komunën e Mitrovicës dhe në komunën e Prishtinës.

Nën 4, nxjerrja e rregulloreve për peshat dhe përmasat e automjeteve në rrugë. Komisioni konstatoi se nuk po zbatohet neni 24 i ligjit, i cili e detyron ministrin e Transportit dhe Telekomunikacionit, të nxjerrë rregulla të veçanta lidhur me adaptimin e standardeve për peshat dhe përmasat e automjeteve, të cilat i shfrytëzojnë rrugët publike.

Numër 5, moszbatimi i kritereve ligjore për ruajtjen e brezit rrugor dhe të brezit mbrojtës. Komisioni konstatoi mos zbatim të nenit 31 të ligjit.

Ministri nxori qarkore me të cilën e njofton nivelin komunal përgjegjës për masat që duhet të merren për ruajtjen e brezit rrugor, në pajtim me ligjin. Komisioni vërtetoi se brezi i të gjitha rrugëve është cenuar dhe rreziku nga punimet e ndryshme përreth rrugëve, të cilat i bëjnë personat fizik e juridikë të papërgjegjshëm, inspektorati kompetent nuk mund t'i parandalojë këto shkelje drastike dhe nuk kishte të dhëna për masat që merreshin kundër tyre.

Pika 5- mirëmbajtja e shenjave të trafikut, neni 13.1, detyron ministrin, përkatësisht komunat për mirëmbajtjen e shenjave të trafikut në auto-udhë, rrugë magjistrale, rrugë regjionale dhe rrugë lokale. Në bazë të vizitave në terren, Komisioni ka vërejtur mungesë të madhe të shenjave të trafikut, sidomos mirëmbajtja e tyre ishte e keqe.

Funksionimi i Inspektoratit të rrugëve:

Në vizitat në terren, Komisioni ka vërejtur se Inspektorati përkatës i të dy niveleve, nuk e kryen detyrën si duhet ngase nuk ka njohuri as evidencë zyrtare për gjendjen e zbatimit dhe respektimit të Ligjit për rrugët. Nuk ka të dhëna statistikore për masat e ndërmarra dhe shqiptimin e gjobave për shkelje dhe mosrespektim të dispozitave përkatëse.

Komisioni ka vërejtur se faktorët e tjerë me ndikim në moszbatim dhe mosrespektim të detyrimeve që dalin nga legjislacioni, është edhe numri i pamjaftueshëm i inspektorëve komunal për shkak të kufizimeve buxhetore.

Bashkëpunimi i institucioneve qendrore dhe lokale:

Në bazë të vizitave nëpër komuna, Komisioni konstatoi se mungon bashkëpunimi ndërmjet Ministrisë dhe institucioneve komunale që reflektohet në zbatim të ligjit. Në komuna nuk ka njohuri të mjaftueshme për akte nënligjore, për këshilla të tjera praktike dhe për ndryshime në legjislacion.

Mungonin edhe rregulloret komunale dhe aktet e tjera juridike. Komisioni vlerësoj se edhe shkalla e bashkëpunimit ndërmjet inspektoratit, organeve të sigurisë dhe të drejtësisë në zbatimin e ligjit, ishte e ulët.

Vakuumi juridik:

Komisioni vlerësoj se Ligji 2003/11, kishte shumë vakuum juridik dhe dispozita të pazbatueshme të evidentuara gjatë shqyrtimit të zbatimit të Ligjit që janë amendamentuar nga Komisioni gjatë shqyrtimit të Projektligjit për ndryshim dhe plotësim të Ligjit për rrugët, që është shpallur në janar të vitit 2009, numër 02L-135.

Bazuar në mangësitë dhe pengesat e evidentuara gjatë mbikëqyrjes së zbatimit të Ligjit, Komisioni nxori këto

R E K O M A N D I M E:

1. Për të zbatuar Ligjin për rrugët, Ministria, në afat më të shkurtër duhet të kompletojë Ligjin me akte nënligjore që dalin nga Ligji për rrugët, nr. 2003/11 dhe Ligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për rrugët nr. 02L-135. Komunat po ashtu duhet t'i nxjerrin aktet e nevojshme për zbatim të dispozitave të Ligjit për rrugët.

2. Ministria e Transportit dhe Telekomunikacionit duhet të punojë më shumë në bashkëpunim me organet komunale dhe të përpilojë planin vjetor për mirëmbajtje të rrugëve në sezonin dimëror dhe në atë veror.

3. Ministria e Transportit dhe Telekomunikacionit duhet të punojë më shumë në kategorizimin përkatës të rrugëve që janë në përgjegjësi të saj dhe komunat t'i përmbushin kriteret e kërkuara me Udhëzimin Administrativ 2006/16 për kategorizimin e rrugëve, që janë në përgjegjësi të komunave.

4. Ministria e Transportit dhe Telekomunikacionit duhet ta plotësojë infrastrukturën e nevojshme rregullative për adaptimin e standardeve të nevojshme për peshat dhe përmasat e automjeteve në rrugët publike.

5. Ministria e Transportit dhe Telekomunikacionit duhet të zbatojë në përpikëri nenin 31.2 të Ligjit për ruajtjen e brezit rrugor dhe atij mbrojtës, si dhe të ndërmarrë masa përkatëse ndaj të gjithë uzurpuesve të brezit rrugor.

6. Ministria e Transportit dhe Telekomunikacionit t'i inspektojë rregullisht rrugët që janë në përgjegjësi të saj dhe të verifikojë se ato janë të pajisura me shenjat e trafikut, t'i mbrojnë dhe t'i plotësojnë aty ku mungojnë.

7. Ministria e Transportit dhe Telekomunikacionit të forcojë dhe të mbështesë punën e Inspektoratit ..., por edhe të kërkojë zhuritë më të madh nga Inspektorati, të punojë për ngritjen e vetëdijes së publikut për rëndësinë e ruajtjes së rrugëve nga dëmtimi. Inspektorati duhet të incizojë masa përkatëse ku është e nevojshme.

Komisioni për Ekonomi, Tregti, Industri, Energjetikë, Transport dhe Telekomunikacion, kërkon nga ministri i Transportit të paraqesë raport të veçantë për punën e Inspektoratit me të dhëna konkrete për inspektime, dhe

8. Ministria e Transportit të marrë nisma të ngutshme për çështjen e bashkëpunimit me organet e sigurisë dhe të përpilohet Memorandumi i bashkëpunimit me Ministrinë e Punëve të Brendshme dhe Policinë e Kosovës për çështjet të caktuara, të rritet bashkëpunimi me organet komunale dhe të koordinohet inspektimi në të dy nivelet, dhe

9. Ministria e Transportit dhe Telekomunikacionin, në pajtim me Rregullën 53, paragrafi 2 të Rregullores së Punës së Kuvendit të Kosovës t'i raportojë Komisionit për shkallën e zbatimit të ligjit. Ju faleminderit!

KRYESUESI NAIM MALOKU: Ju faleminderit, zonja deputete!

Fjalën e ka ministri i Transportit dhe i Postë-Telekomunikacionit, zoti Fatmir Limaj.

MINISTRI FATMIR LIMAJ: Ju faleminderit, zoti kryesues!

Të nderuar deputetë,

Para se t'i them disa fjalë, unë dua ta falënderoj Komisionin për punën që e ka bërë. Ju siguroj që vërejtjet, rekomandimet të cilat janë paraqitur nga Komisioni përkatës, Ministria e Transportit do t'i marrë shumë seriozisht dhe do të angazhohet në përmirësimin e gjithë atyre që u thanë. Ne jemi munduar që, siç e tha edhe kryetarja e Komisionit, jemi shumë kooperativ me Komisionin. Stafi i Ministrisë së Transportit, unë personalisht në çdo rast kemi qenë në dispozicion të komisioneve dhe jemi munduar që t'i japim të gjitha ato sqarime të nevojshme ose shpjegime që është kërkuar nga Komisioni.

Edhe një herë përsëri po them, falënderoj për gjithë punën që është bërë nga ky komision. Megjithatë, unë dua t'i them disa fjalë rreth kësaj çështjeje. Së pari dua të them se politikat e Ministrisë së Transportit, që janë krahas vullit të ndërtimit të gjitha rrugëve të reja në tërë territorin e Republikës së Kosovës, rëndësi të madhe është duke i dhënë, funksionin që e ka, i ka kushtuar edhe mbrojtjes së brezit rrugor, duke e zbatuar ligjin në fuqi.

Për këtë ne kemi aktivizuar Inspektoratin e Ministrisë si mekanizëm ligjor për mbikëqyrjen e mbrojtjes së brezit rrugor në të gjitha rrugët që janë në përgjegjësinë e Ministrisë së Transportit, është fjala për rrugët nacionale dhe regjionale.

Dua t'i them dy-tri fjalë për Inspektoratin.

Gjatë vitit 2008-2009, Inspektorati ka iniciuar dhe realizuar 243 inspektime, ka hartuar procese dhe të gjitha këto, kanë qenë në mbrojtje të brezit rrugor, nga ndërtimet e paligjshme dhe që cenojnë brezin rrugor.

Ka iniciuar 25 lëndë në Gjykatën Komunale, 44 aktvendime për ndërprerje të punimeve dhe eliminimin e parregullsive të operatorëve në punishte. 12 lëndë na janë kthyer në realitet me përgjigje negative nga ana e gjykatave deri më tani.

Ne si Ministri, besoj të gjithë edhe ju, jemi të vetëdijshëm me gjendjen aktuale rreth brezit rrugor, është një gjendje e trashëguar, fatkeqësisht për vite të tëra, duke mohuar mungesa e kujdesit dhe kujdesit ligjor, e respektimit të ligjeve për shkak të kaluarës dhe të gjitha ato që kanë ndodhur dhe jemi gjetur në një situatë të tillë. Dhe, këtë gjendje siç e kemi gjetur jemi duke bërë të gjitha përpjekjet që ta sanojmë, duke mbrojtur interesin publik dhe duke krijuar hapësira për të rritur nivelin e sigurisë në rrugët tona. Mendoj që, nëse shikojmë nga ky një vit e gjysmë, ju mund të shihni përmirësime në këtë drejtim dhe mund të shihni këmbënguljen tonë në ruajtjen e brezit rrugor, në njërën anë dhe në anën tjetër, rikthimin e brezit rrugor që ka qenë i uzurpuar në të kaluarën.

Ne si Ministri po ashtu jemi të vetëdijshëm me gjendjen aktuale nëpër komuna dhe infrastrukturën komunale, besoj edhe ju e dini saktë gjendjen nëpër komunat tona, mundësitë e komunave tona, problemet me të cilat janë ballafaquar komunat e Kosovës, ashtu siç janë ballafaquar edhe organet qendrore. Po ashtu, dua të them që ne në koordinim me komunat, ne si Ministri, në fillim të vitit 2008, siç u tha edhe në raport, ju kemi dërguar të gjitha komunave të Kosovës një letër qarkore dhe ndërmarrjeve publike qendrore dhe komunale, që të mos ndërtojnë rreth brezit rrugor, pa pëlqimin e Ministrisë së Transportit, ashtu siç parashihet me Ligj.

Infrastruktura rrugore është duke u ndërtuar në përputhje me Ligjin për rrugët. Mund të ketë shmangie në këto, mund të ketë tendenca për t'u shmangur, mirëpo ju siguroj që Ministria është duke qëndruar afër të gjithë atyre të cilët tentojnë të bëjnë shmangie të tilla, prandaj ne kemi një mbikëqyrje të vazhdueshme që të zbatohet në përpikëri Ligji për rrugët.

Gjithashtu jemi duke u ballafaquar me ndërtimet në brezin rrugor dhe në raste të tilla Inspektorati i Ministrisë i ka ndërmarrë të gjitha veprimet ligjore, duke ngritur procedura ligjore ndaj të gjithë punë kryerësve të cilët cenojnë brezin rrugor. Për njoftimin tuaj, Ministria e Transportit e lëshon ose e refuzon pëlqimin e kërkuar nga personi fizik apo juridik dhe pa pëlqimin e Ministrisë, komunat nuk duhet dhënë leje ndërtimi dhe të gjitha ndërtimet pa leje, duhet t'i pengojë inspektoratet komunale. Është fjala në komuna, i komunës përkatëse dhe është përgjegjësi e tyre, që ata të pengojnë çfarëdo ndërtimi pa leje në komunat e tyre.

Vlen për të përmendur se ka pasur raste ku fatkeqësisht komunat kanë lëshuar leje me gjithë kundërshtime ose mosdhënien e pëlqimit nga Ministria, por unë jam i bindur që kjo gjë është duke u përmirësuar, duke i falënderuar bashkëpunimit që ne po e ndërtojmë me komunat.

Ligji për rrugët implementohet përmes Drejtorisë së Rrugëve, ndërsa mbikëqyrret nga Departamenti i Infrastrukturës Rrugor dhe nga Inspektorati.

Dua t'i them edhe dy fjalë rreth disa çështjeve, shqetësimeve nga Komisioni përkatës, është fjala për shembull për kategorizimin e rrugëve. Dua të them që Ministria e Transportit është duke punuar në konsultim me Bankën Botërore, ka ndërtuar Komisionin për kategorizimin e rrugëve. Mund të them, deri me tani janë në pyetje të kategorizimit të rrugëve rreth 1500 kilometra dhe besoj që deri në fund të vitit ne do të kemi kategorizimin e rrugëve në Kosovë.

Sa i përket konstatimit të Komisionit se nuk po zbatohet neni 24 i Ligjit, që e drejton Ministrinë për adaptimin e standardit për peshat dhe përmasat automjetet, të cilat i shfrytëzojnë rrugët publike, unë dua të them se këtë materie, këtë çështje e rregullon Ligji për sigurinë në komunikacion rrugor, përkatësisht nenet: 171, 172, 173, 174, 175, 176, 177 dhe neni 178 të këtij ligji.

Te çështja e sinjalistikës. Vërtet ka qenë një gjendje shumë e pakëndshme, e keqe e trashëguar edhe pse ka pasur përpjekje vazhdimisht të përmirësohet dhe ne po e bëjmë një gjë të tillë. Në mesin e asaj, është futur edhe pastrimi i të gjitha shenjave të komunikacionit. Por, unë e kam përmendur shpeshherë në këtë foltore, dua ta them edhe një herë, po ballafaqohemi edhe me probleme të tjera. Vetëm në vit ndodh 200 deri 300 tabela sinjalistike që vidhen anekënd Kosovës. Ne vazhdomë t'i vëmë të reja, përsëri vidhen dhe do të dëshiroja që edhe një herë t'iu bëj apel qytetarëve që ta lajmërojnë policinë, organet e rendit për çfarëdo rasti që mund të shohin nga njerëzit e tillë, të cilët drejtpërdrejtë ndikojnë në sigurinë e qytetarëve. Kjo ka ndodhur edhe në rrugë, ka ndodhur edhe në hekurudha, që në një mënyrë apo tjetrën e kanë rrezikuar jetën e qytetarëve tanë. Mund t'ju siguroj që bashkëpunimi me policinë është jashtëzakonisht i mirë. Ne vazhdojmë të bashkëpunojmë edhe më tutje me organet policore. Jam i bindur që do të vazhdojmë ta rrisim bashkëpunimin me komunat, me inspektoratet komunale, sepse fatkeqësisht këtu ka çaluar dhe pajtohem me rekomandimet që janë dhënë nga Komisioni përkatës.

Edhe një here duke e përfunduar fjalimin tim, e falënderoj Komisionin përkatës, ju siguroj që të gjitha rekomandimet, të cilat janë dhënë dhe me këtë elaborim serioz që është bërë, na ka ndihmuar si Ministri në punën tonë dhe ju siguroj se do t'i marrim të gjitha masat për të përmirësuar të gjitha shqetësimet që janë ngritur nga Komisioni përkatës. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit, zoti ministër!

Fjalën e kanë kryetarët ose përfaqësuesit e grupeve parlamentare. Nga Grupi parlamentar i PDK-së, është paraqitur deputetja Kaqusha Jashari.

KAQUSHA JASHARI: Jo, unë për diskutim jam lajmëruar.

KRYESUESI: Atëherë, më vonë. Nuk ka të paraqitur të tjerë.

Nga Grupi Parlamentar i LDK-së, janë dy. Deputeti Zef Morina e ka fjalën.

ZEF MORINA: Ju faleminderit, zoti kryesues!

I duruar ministër,

Të nderuar kolegë deputetë,

Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike të Kosovës, ka shqyrtuar me vëmendje raportin për mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për rrugët, dhe ka konstatuar që Ligji në përgjithësi është duke

u implementuar. Ka nevojë që për shkak të vështirësive që u cekën edhe janë në raport edhe nga vetë ministri, që ato të tejkalohen, por lypet një kohë. Natyrisht, vështirësitë kanë qenë pikërisht për shkak se ligji i cili ka qenë i aprovuar në vitin 2003 është dashur të amendamentohet dhe është dashur një kohë e cila, sigurisht që e ka penguar që vërtet ligji të jetë më lehtë i aplikueshëm. Ajo që ne, si Lidhje Demokratike e Kosovës kërkojmë nga Ministria dhe nga kuvendet komunale që rekomandimet t'i marrin në shqyrtim dhe t'i marrin shumë seriozisht, sidomos tek brezi rrugor dhe tek mbingarkesat në rrugë. Ato janë vërtet obligim që të jenë pothuaj se në çdo kohë në përcjellje, në kontroll në mënyrë që mos të vijë deri tek dëmtimi i rrugëve, si dhe tek sinjalistika, është plotësisht e vërtetë ajo çka e tha edhe ministri, ato po keqpërdoren, por është Komisioni dhe Inspektorati ai i cili duhet të punojë me policinë dhe policia të marrë masa ndaj atyre të cilët bëjnë veprime të tilla.

Në përgjithësi, raporti është korrekt dhe në rregull dhe ne si Grup Parlamentar e përkrahim dhe kërkojmë nga Ministria dhe komunat që t'i respektojnë dhe t'i zbatojnë këto rekomandime, në mënyrë që ligji të jetë vërtet i aplikueshëm qind për qind.

KRYESUESI XHAVIT HALITI: Ju faleminderit!

Në emër të Grupit Parlamentar të Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës, deputeti Ardian Gjini.

ARDIAN GJINI: Ju faleminderit, zoti kryesues!

Ne e kemi marrë raportin dhe e kemi shqyrtuar, me siguri se do të ketë prapë diskutime, mirëpo, që në fillim dua ta them atë që do të dalë si konkludim, mendojmë se raporti nuk duhet të miratohet sot. Ka shumë arsye, e unë do t'i përmend disa.

Çështje kryesore është, përpos atyre që u përmendën, për shembull, diçka që nuk është përmendur që janë kyçjet ilegale në rrugë për shembull. Pothuajse Kosova nuk merret me këtë çështje më, e kyçjet ilegale në rrugë shkaktojnë dëmet më të mëdha edhe në trafik. Pra, askush s'është marrë me këtë çështje seriozisht.

Kemi çështje të tjera, të cilat përmenden këtu dhe si aspekt, për shembull është koha e monitorimit, afati i monitorimit dhe çka ka ndodhur ndërkohë? Shihni në tabelë, për shembull, në faqen 6, e keni vendpunimet në rrugën e Dushkajës janë shikuar më datën 24. 7.2008, që do të thotë, para më pak se një viti. Kjo do të thotë se në atë kohë janë shikuar punimet e rrugës dhe nëse dikush shkon dhe e sheh rrugën sot, ajo rrugë është dekompozuar. Dhe, sikur Komisioni ta kishte shikuar rrugën tash, me siguri rekomandimet do të ishin ndryshe, do të thotë ka shpërputhje mes asaj që ka ndodhur në atë kohë dhe kësaj që po ndodhë sot.

Sinjalizimi horizontal gati sa nuk ekziston dhe kushdo që udhëton për çdo ditë në Kosovë e sheh se përkundër faktit se për çdo vit vendosen vijat e bardha të asfaltit, ato prapë dekompozohen brenda vitit dhe, nëse rastësisht dikush udhëton në orët e darkës, sidomos kur ka shi, rrezikon ta humbë jetën në trafik.

Çështje tjetër është, shembull ta marrim emërtimet dhe shenjat të cilat u përmendën këtu. Kush që udhëton e sheh se gjuha që përdoret në emërtimet e vendbanimeve është skandaloze, mund të them se 80% e emrave të vendbanimeve, të fshatrave, të rrugëve, janë të shkruara gabimisht në gjuhën shqipe. Janë më mirë të shkruara në gjuhën serbokroate ose serbe se në gjuhën shqipe, kushdo që udhëton i sheh, janë disa ë të pazëna të vendosura gabimisht, diku janë tepër, diku janë mangut edhe askush nuk merret me këtë çështje. Prapë, për mos shkruar më tutje, po them kështu, ka shumë askete që nuk janë përendur në këtë raport, e që janë tepër serioze në zbatimin e Ligjit për rrugët, dhe koha në mes kohës kur ka filluar të bëhet raporti dhe tash në momentin kur ne po e shqyrtojmë këtë raport, është në s'përputhje të madhe me gjendjen e cila sot figuron në

rrugë dhe çështja tjetër është që duhet të përmendet për shkak se është përmendur pa dashur që të them se, një gjë e tillë ka ndikuar në përpilimin e raportit, deputeti Zef Morina ka qenë kryesues në hartimin e këtij raporti dhe pjesa dërmuese e raportit është përpiluar përderisa ai ka qenë kryesues i këtij grupi dhe, me qenë se, zoti Zef Morina ka dhënë dorëheqje prej kryesimit të këtij grupi për arsye të konfliktit të mundshëm të interesit, atëherë është e udhës që ne të kërkojmë që ky Komision të na sjellë një raport tjetër të monitorimit për shkak se do të kishte qenë çështje tepër qesharake nëse sot Kuvendi e miraton këtë raport, duke e pasur parasysh që vendimet janë marr për ta evituar këtë konflikt të interesit. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit,

Në emër të Grupit Parlamentar të AKR-së, është paraqitur deputeti Heset Cakolli.

HESET CAKOLLI: Fillimisht, dëshiroj ta përshëndes punën dhe aktivitetin...

KRYESUESI: Zoti Heset, më fal, ia ka përmendur emrin deputetit Morina. Ai do replikë- dy minuta i ka. Më fal, se nuk të pash!

ZEF MORINA: Ju faleminderit, zoti kryesues!

Sigurisht që nuk desha që të replikoj, por dëshiroj t'i them kolegut Gjini që raporti nuk është përpiluar në kohën kur unë kam qenë kryesues, por është përpiluar më vonë dhe raportin e ka përpiluar Komisioni e jo Zef Morina. Por dëshiroj një gjë tjetër t'i them, që absolutisht nuk ka të bëjë me kurrfarë konflikt interesi. Në qoftë se keni lexuar edhe Ligjin për rrugët, Ligjin për antikorrupsion, shikoni mirë a është apo s' është konflikt interesi, por për shkak të veprimeve mediatike që janë bërë nga disa kolegë tonë, të cilët kanë qenë në Komision dhe janë munduar ta keqtrajtojnë këtë çështje, unë jam tërhequr nga Grupi. Në grup janë zgjedhur nga Komisioni, pikërisht për shkak që ishte lëmi më e afërt, kam qenë ministër dhe kam dashur që vërtetë ky raport të jetë sa më i mirë. Meqë, është kërkuar që unë të tërhiqem nga kryesimi i grupit, unë jam tërhequr dhe Komisioni e ka bërë raportin e jo Zef Morina, kështu që nuk kam të bëjë me atë çka thotë zoti Gjini, por në qoftë se ka mangësi të tjera të cilat i thotë, ajo është çështje tjetër, përndryshe raporti bëhet njëherë në vit.

Pra, raporti është bërë në kohën e caktuar. Me Rregulloren e Punës së Kuvendit, Komisioni brenda vitit e bën raportimin ose parqet mbikëqyrjen e një ligji për të cilin është caktuar.

KRYESUESI: Ju faleminderit!

Për kundër replikë është paraqitur prapë Ardian Gjini.

ARDIAN GJINI: Ju faleminderit, zoti kryesues!

Shumë shkurt. Unë nuk ju referova fjalës së sotme të zoti Morina. Nuk citova asgjë nga fjala e tij, ju referova raportit dhe mendoj se nuk ka pasur nevojë për replikë nga ana e tij ndaj meje, mirëpo, me qenë se e shfrytëzoj atë të drejtë të replikojë, unë prapë dua të them pa kurrfarë paragjykimi se a ka pasur apo jo esencialisht konflikt interesi ... Është perceptuar se mund të ketë konflikt interesi dhe zoti Morina ka dhënë dorëheqje prej atij grupi punues. Nëse nuk ka pasur kurrfarë konflikti interesi, pse ka dhënë dorëheqje prej atij grupit punues? Vetë fakti se ka pasur dorëheqje na bënë të besojmë se është perceptuar konflikti i interesit dhe perceptimi për atë konflikt interesi na bënë të besojmë se ky raport nuk duhet të aprovohet. Kështu e thashë unë. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Fjalën e ka deputeti Heset Cakolli, në emër të AKR-së.

HESET CAKOLLI. Ju faleminderit, zoti kryesues!

Të nderuar ministra,
Të respektuar kolegë deputetë,
Fillimisht, dëshiroj ta përshëndes punën dhe aktivitetin e Komisionit për Ekonomi, Tregti, Industri, Energjetikë, Transport dhe Telekomunikacion për hartimin e Raportit për mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për rrugët, numër 2008/11.

Ligji për rrugët rregullon : pozitën juridike, ndërtimin, mirëmbajtjen, masat mbrojtëse, financimin dhe mbikëqyrjen e rrugëve publike, por, ky ligj nuk është zbatuar në nivelin e dëshiruar për shumë arsye. Me këtë rast po përmendi disa arsye që janë dhënë edhe në raport. Ka mundur, thotë bashkëpunimi në mes të nivelit qendror dhe lokal, si dhe autoriteteve të tjera kompetente për zbatim të këtij ligji.

Të nderuar deputetë,
Komisioni pas shumë vizitave në terren, ka konstatuar se ka pasur raste në disa komuna që nuk kanë pasur njohuri të mjaftueshme për ligjin, si dhe kanë identifikuar probleme të natyrave të ndryshme dhe për këtë arsye, Komisioni ka propozuar 9 rekomandim, me qëllim të ndryshimit të gjendjes në terren.

Këto rekomandime, Grupi Parlamentar i Aleancës Kosova e Re i mbështet, por me këtë rast, dëshiroj të theksoj se pika 4 e këtyre rekomandimeve, sipas mendimit tonë, është mjaft mirë e rregulluar edhe me Ligjin për sigurinë në komunikacion, siç i ceku edhe ministri nënet përkatëse.

Unë, me këtë rast dua të them se, me këtë ligj është e paraparë që ngarkesa... në ura ngasëse, respektivisht rrotat e dyfishta mund të lejohet deri në 11.5 tonë për rrugët regjionale dhe magjistrale, ndërsa për rrugët lokale me këtë ligj është e paraparë ngarkesa boshtore deri në 6 tonë.

Viteve të fundit në Kosovë po ndërtohen shumë rrugë të të gjitha kategorive me standarde mjaft të larta, por nëpër këto rrugë qarkullojnë automjete me masa të përgjithshme shumë më të mëdha se sa masat e përgjithshme që lejohen edhe në shtete anëtare të Bashkimit Evropian. Nëpër rrugët e Kosovës ka raste kur lëvizin automjete me masa të përgjithshme edhe mbi 60 tonë dhe këto mbingarkesa po i dëmtojnë shumë rrugët e Kosovës, për këtë jemi dëshmitarë të gjithë ne sepse nëpër këto rrugë kudo vërehen kanale gjatësore si rezultat i deformimeve të rrugëve.

Inspektorët e Ministrisë së Transportit dhe Posttelekomunikacionit të Kosovës kanë bërë një punë të mirë në këtë drejtim dhe kanë shqiptuar edhe gjopa të shumta për personat fizikë dhe juridikë me qëllim të pengimit të lëvizjes së automjeteve me mbingarkesa, që është e paraparë sipas nenit 35 pika a, b, dhe c, të Ligjit për rrugët. Por, fatkeqësisht, gjendja në terren ka ndryshuar pak, pastaj shtrohet pyetja, a janë zbatuar deri më sot neni 15 dhe 25 pika 3 e Ligjit për rrugët, si dhe udhëzimet administrative 2007/2, 2005/13. Unë kujtoj se janë zbatuar pak deri më tash, por në fund, ne mendojmë se është mirë që të zbatohen ligjet dhe aktet tjera nënligjore ekzistuese që kanë të bëjnë me rrugën dhe sigurinë në komunikacion rrugor me qëllim që në të ardhmen t'i mbrojmë dhe t'i menaxhojmë rrugët sipas standarde ve të Bashkimit Evropian. Ju faleminderit, zoti kryesues!

KRYESUESI: Faleminderit!
Në emër të LDD-së, Naser Rugova.

NASER RUGOVA: Faleminderit, zoti kryesues!
Edhe Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike të Dardanisë e ka shqyrtuar me vëmendje raportin e Komisionit funksional për Ekonomi, Tregti, Industri, Energjetikë, Transport dhe

Telekomunikacion për monitorimin se si po zbatohet Ligji për rrugët. Është një praktikë e mirë e disa komisioneve funksionale të Kuvendit të Republikës së Kosovës, të cilat kanë filluar monitorimin e zbatimit në praktikë të ligjeve që janë miratuar nga ky Parlament dhe në këtë kontekst duhet përshëndetur puna e komisionit.

Vërejtjet e Grupit Parlamentar të LDD-së janë në disa aspekte. Së pari, te diskrepanca kohore e raportimit të monitorimit të ligjit dhe kohës kur raporti ka ardhur për shqyrtim në seancën plenare të Kuvendit.

Së dyti, nuk është bërë asnjë monitorim në aspektin e kontrollit të cilësisë së ndërtimit të rrugëve. Kjo do të duhej të ishte një vërejtje kolegjiale për punën e komisionit në të ardhmen. Pastaj, te raporti i komisionit shihen edhe qasje jo të plota, por të pjesshme pasi që ky Ligj nuk i ka trajtuar disa pjesë të rëndësishme që dalin nga neni 15, për shembull, Ministria nxjerr rregulla dhe kriteret teknike për ndërtimin dhe rikonstruimin e rrugëve publike.

Te neni 18, që ka të bëjë me rrugët magjistrale, regjionale, ndërsa në nivelin komunal për rrugët lokale dhe caktimin e rregullave sipas standardeve për ndërtim dhe rikonstruim të këtyre rrugëve publike.

Te neni 19 pastaj, që rregullon ndikimin në ambient, do të thotë, çfarë ndikimi ka ndërtimi i rrugëve në zonat e caktuara dhe ndikimi negativ në ambientin.

Kurse, sa iu takon vërejtjeve dhe rekomandimeve të komisionit, Grupi Parlamentar i LDD-së i mbështet, në parim, pasi që edhe anëtarët e Grupit tonë kanë marrë pjesë në monitorimin dhe në hartimin e këtij raporti. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit!

Grupi Parlamentar “7+”, nuk ka të paraqitur. Grupi Parlamentar SLS, nuk ka të paraqitur. Vazhdojmë me diskutimet. Sipas radhës, deputeti Adem Grabovci.

ADEM GRABOVCI: Faleminderit, zoti kryesues!

Është me të vërtetë për të përshëndetur puna e këtij komisioni, se shihet qartë se ka pasur një angazhim konkret dhe daljen në terren dhe vizitat që i ka bërë, konstatimin e gjendjes reale nëpër rrugët e Kosovës. ndikimin e saj edhe në rritjen e shkallës së sigurisë.

Mirëpo, unë kisha disa vërejtje, mendoj se duhet të jenë shumë më të qartë, komisioni, te rasti i rekomandimeve dhe të qartësohet se çka është në përgjegjësi të komunës dhe çka është në përgjegjësi të Ministrisë.

Është fjala në pikën, në rekomandimin e dytë, ku thuhet te plani vjetor, hartimi i planit vjetor, bien në kundërshtim me vetveten komisioni, se paraprakisht e thotë se Ministria, do të thotë, konstaton se ka plan vjetor, ndërsa në rekomandim del se Ministria nuk ka plan vjetor. Prandaj, këtu duhet të precizohet shumë qartë, ka apo nuk ka Ministria plan vjetor. Nëse nuk ka komuna plan vjetor, atëherë duhet t'i rekomandohet komunës që ta hartojë planin vjetor për mirëmbajtjen verore.

Pastaj kemi, te mungesa e shenjave në komunikacion. Mendoj se komisioni duhet të konstatojë dhe të vlerësojë punën dhe pengesat që ka organi përkatës në zbatimin e ligjit. Jo vetëm të konstatojë gjendjen, si rrjedhojë e kujt ka ardhur mungesa e këtyre shenjave në komunikacion dhe të konstatohen dhe të kërkohet apo t'i ndihmohet organi përkatës për zbatimin e ligjit në mënyrë adekuate.

Është fjala te udhëzimet administrative, po ashtu. Duhet të jetë shumë i qartë komisioni se sa udhëzime administrative duhet të nxjerrë Ministria e Transportit, sa prej këtyre udhëzimeve administrative i ka nxjerrë dhe sa nuk i ka nxjerrë. Do të thotë, këto paqartësi duhet të jenë shumë më të precizuara dhe të bëhet një ndarje mes organeve përkatëse, jo të flitet në mënyrë të përgjithësuar për Ministrinë apo për komunat që janë në një bashkëpunim në mes të këtyre dy niveleve. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Fjalën e ka deputeti Armend Zemaj.

ARMEND ZEMAJ: Faleminderit, zoti kryesues!

Të nderuar kolegë deputetë,

Ministra,

Është shumë e qartë dhe më se e nevojshme se edhe ashtu është e rregulluar me rregullore monitorimi i ligjeve, por për të pasur një pasqyrë ndoshta më të qartë rreth këtij monitorimi, unë mendoj që këtu mungojnë materialet përcjellëse, edhe pse është thënë që ato janë në kapitullin e fundit. Këtë e them sepse nuk mund ta japim një mendim konkret, për shembull, ajo që thuhet nuk ka bashkëpunim të duhur të nivelit qendror dhe në atë komunal dhe nuk e dimë në çka të bazohemi se ku është ai bashkëpunim apo ku është ajo ngecje dhe sidomos te kompetencat edhe të Ministrisë, edhe kompetencat komunale.

E dyta, çka dua të them është se këtu mungonin rregulloret komunale dhe akte të tjera juridike. Ndërsa, në takimin të cilën thuhet që ministri ka qenë prezentë, deklarohet që Ministria ka nxjerrë të gjitha aktet apo 8 aktet për zbatueshmërinë e këtij ligji, ndërsa te rekomandimet prapë përsëriten, ta nxjerrë këtë akt administrativ, do me thënë, ose ta zbatojë këtë.

Unë mendoj që ndoshta po t'i kishim pasur materialet përcjellëse dhe ta kishim ditur në cilat komuna mungojnë rregulloret, në cilat komuna mungojnë planet edhe pse ashtu këto vizita ishin 4 vizita gjithsej, gjithnjë ju them duke respektuar punën e këtij komisioni, edhe pse është i përbërë nga të gjitha partitë politike.

Ajo çka ndoshta një vërejtje që duhet t'i kushtohet këtu, thuhet që mungojnë shenjëzimet. Unë mendoj që ndoshta edhe më herët është për t'u çuditur se ndoshta si ju ka rënë anëtarëve të komisionit, rrugës a mungojnë të gjitha këto shenjëzime edhe pse kemi pasur deklarata publike se çdo ditë i vjedhin këto shenjëzime. Unë mendoj që duhet të përkrahet ajo që u tha më herët, deformimi i emërtimeve. Në emërtime duhet të ketë kujdes, të nxirret një rekomandim i veçantë edhe të dimë ku janë kufijtë, sepse ne e kemi Ligjin mbi kufijtë komunalë dhe shumë herë, për shembull, unë e pash këtu që është bërë një monitorim në Mitrovicë, është tabela ku thuhet në fshatin Kçiq është "Mirë se vini në Mitrovicë", ndërsa kufiri dihet ku është Mitrovica, është atje më poshtë, po kështu ndodh edhe në anën tjetër të kundërt, do me thënë duhet të ketë kujdes t'i respektojmë kufijtë komunalë.

E thashë unë, gjithnjë duke respektuar punën e komisionit hartues, mendoj që ka shumë mangësi, mendoj që ka shumë mangësi edhe në këto rekomandime që i drejtohen Ministrisë, Qeverisë përkatëse, nuk janë konkrete, se nëse themi ne - Ministria e Transportit dhe Posttelekomunikacionit të punojë më shumë. Ministria është e obligueshme dhe punon çdo ditë, duhet në bashkëpunim me organet komunale dhe jo t'i drejtohet të punojë më shumë, sepse e obligon ligji dhe kushtetuta që të punojë. Prandaj, nëse thuhet që më 5.5. janë nxjerrë të gjitha udhëzimet administrative, ne nuk e dimë për shembull se si do të japim rekomandim për nenin 31 pika 2 për ruajtjen e brezit, do me thënë të brezit rrugor dhe të atij mbrojtës nëse ekziston udhëzimi administrativ. Ndoshta unë kisha kërkuar një sqarim prej ministrit për këto 8 udhëzime, a i plotësojnë të gjithë aktet nënligjore të kërkuar për zbatueshmërinë e këtij ligji. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit!
Fjalën e ka deputetja Kaqusha Jashari.

KAQUSHA JASHARI: Faleminderit, zoti kryesues!

Të nderuar të gjithë prezentë,

I nderuar ministër,

Ligji për rrugë, sikur që dëgjuam, është aprovuar në vitin 2003 dhe ndërkohë është bërë edhe plotësimi dhe ndryshimi i ligjit sivjet, në fillim të vitit. Prandaj, kjo vonesë për monitorimin e ligjit është edhe për shkak të asaj se ndërkohë është punuar edhe plotësimi edhe ndryshimi i ligjit, e askush atë nuk e përmend. Mjaft kohë është kushtuar bash në këtë drejtim se ligji bazë ka pas shumë mungesa, sidomos për përgjegjësinë e Inspektoratit dhe ajo është plotësuar në atë masë sa ka qenë e mundur.

Unë nuk kisha fol shumë në lidhje me këtë raport se kam marrë pjesë vetë në përpunimin e tij edhe është e vërtetë që zoti Grabovci që përmendi, nuk e di pse është bërë ai gabim, se edhe vetë kam propozuar ndarjen, se mirëmbajtja verore dhe dimërore ekziston në nivelin e Ministrisë dhe ajo është bërë si një praktikë bile edhe kohore kur të bëhet programi, kur të shpallet. Prandaj, ajo vlen vetëm për nivelin lokal. Ato çka unë e kam kështu si brengë edhe që mua më brengos shumë është se çdo ligj, jo vetëm ky ligji për rrugët, ka mundësi dhe ka nevojë për shumë akte nënligjore dhe në këtë monitorim kemi shkuar vetëm sa po zbatohet ligji dhe ndërkohë sa janë bërë aktet nënligjore, sa janë aprovuar, por jo edhe në përbërjen e tyre. Ajo nuk ka qenë detyra dhe nuk mundet Kuvendi të hyjë në atë vlerësim, por është një problem shumë serioz se me shumë akte nënligjore mund të bëhen edhe gabime, e në fakt dëshira e Kuvendit ka qenë që më lehtë të bëhen ndryshime, se një procedurë për plotësimin e Ligjit është shumë më e gjatë se një ndryshim i aktit nënligjor. Prandaj, kjo është për funksionimin e mirë efikas, por në qoftë se nuk respektohen do rregulla të tjera, mund të bëhen edhe gabime të cilat mund edhe të jenë serioze. Pse e përmenda këtë. Në nenin 8 pikë 3 të këtij ligji, shkruan që duhet me akte nënligjore t'i jepet përgjegjësia Departamentit të Rrugëve dhe Drejtorisë së Rrugëve. Në vendet tjera gjithashtu kërkohet për kategorizimin e rrugëve, kërkohet për inspektoratin, kërkohet shumë çka, por në qoftë se nuk bëhet një harmonizim i përgjegjësisë, atëherë mundet të vijë edhe ngatërresa e përgjegjësisë edhe të lehen disa punë pa definuar.

Pse po mendoj kështu? Departamenti i rrugëve prioritet e ka krijimin e politikave, Drejtoria e Rrugëve e ka implementimin të programeve dhe të projekteve, Inspektorati e ka inspektimin, në qoftë se këto tri udhëzime nuk janë të harmonizuara si duhet, atëherë aty mund të vijë deri te përzierja e kompetencave, mos të them edhe deri te konflikti të interesave.

Prandaj, unë e mora fjalën për t'i sugjeruar Ministrisë së Transportit që t'i marrë parasysh rekomandimet nga Agjencioni Evropian, gjithashtu rekomandimet edhe nga Banka Botërore për ndarjen e përgjegjësisë dhe për krijimin e administrimit rrugor. Sa është me rëndësi sa rrugë po i ndërtojmë, kualiteti i ndërtimit, aq është me rëndësi të krijohet edhe një administratë stabile, e cila mund të vazhdojë edhe me ndërrimin e njerëzve të cilët udhëheqin këtë. Unë këtë nuk e parashoh në të ardhmen, por unë mendoj se ka ndodhur prej vitit 2003 një udhëzim administrativ prej një ministrie, mandej ka ndodhur tjetra për të ndryshuar diçka për një departament edhe një drejtori, a kanë qenë edhe mendime tjera për riorganizim të brendshëm. Prandaj, sugjerimi është që t'i marrim normat edhe ndërkombëtare se gjithkund ekziston administrimi në këtë lëmi.

Lidhur me peshore është përmendur këtu, zoti ministri tha që është ky Ligji për siguri, i cili e përfshinë atë pjesë. Kur është puna e peshoreve dhe lidhur me përgjegjësinë të cilën e ka Ministria, është e lidhur me respektimin e ngarkesës me standarde në rrugë, jo të sigurisë, me ngarkesën, se

çdo rrugë projektohet me ngarkesën e caktuar. Në një kohë kanë qenë standarde tjera, tash janë standarde tjera. Prandaj, edhe ngarkesa është ajo e cila mund t'i dëmtojë.

Unë po përfundoj me këtë, me një sugjerim që në rekomandime të futet edhe respektimi i rekomandimeve të Agjencionit Evropian dhe të Bankës Botërore lidhur me administrimin rrugor, se kemi më në fund edhe obligim.

KRYESUESI: Faleminderit!

Fjalën e ka deputetja Gjylnaze Syla.

GJYLNAZE SYLA: Faleminderit!

I nderuari zoti kryesues,

E nderuara ministre,

I nderuar ministër,

Deputetë të nderuar,

Mbikëqyrja e këtij ligji ka qenë më se e rëndësishme duke marrë parasysh faktin se pjesa më e madhe e buxhetit, ose pjesën më të madhe të buxhetit të Kosovës e shfrytëzon Ministria e Transportit. Prandaj, është dashur të përmbushet përgjegjësia që e ka, që në këtë rast ka qenë e dyfishtë, dhe të shihet se sa po shkojnë mirë, sa po e shfrytëzojnë mirë për të mirën publike parane publike, por edhe çka është produkti i shfrytëzimit të atyre parave, natyrisht, duke mbikëqyrur nenet kyçe të ligjit.

Raporti, sipas mendimit tim, është i shkurtër, i pamjaftueshëm dhe është i pjesërisht, realisht nuk pasqyron ose nuk kemi një pasqyrë të mirë, të plotë se sa zbatohet ligji në praktikë ose cili është niveli i zbatimit të këtij ligji.

Mangësitë e mbikëqyrjes ose monitorimi i pjesërisht natyrisht që rezulton edhe me rekomandime të pjesërishtme. Nuk janë mbikëqyrur nenet kryesore të ligjit mbi rrugët, që janë neni 5, 15, 18, 19, 24, 26 dhe unë do ta argumentoj një nga një secilin nga nenet.

Po filloj nga neni 5. Në raport thuhet se Komisioni ka dalë në terren dhe ka vizituar rrugën e Dushkajës, në Gjakovë, e cila në të vërtetë është rrugë e rikonstruktuar, së paku sipas dokumenteve. Do të thotë, është dashur Komisioni të përqendrohet në nenin 5.1 dhe nenin 5.2, sipas të cilit rrugët si auto-udhë, rrugët rajonale, nacionale dhe rrugët lidhëse janë përgjegjësi të Ministrisë, kurse rrugët lokale janë përgjegjësi e komunës. Tash, çka ka ngjarë? Besoj që edhe pa dalë në terren, vetëm të lexohet raporti, gjegjësisht në qoftë se lexojmë më 12 qershor, kur kemi pasur debatin lidhur me shpenzimet e buxhetit për vitin 2008 dhe po të përcjellim vetëm fjalët e Kryeministrit Thaçi, i cili gjerë e gjatë na i ka lexua të gjitha rrugët, mund të shohim se Ministria e ka shkel ligjin sepse ka ndërtuar rrugë të cilat ligji nuk ia lejon, ka ndërtuar rrugë lokale që janë pjesë e përgjegjësisë së Ministrisë në lagje bile edhe trotuare.

Sa i përket nenit 15 të ligjit, është dashur Komisioni të monitorojë se a ka nxjerrë Ministria rregulla mbi kriteret teknike për ndërtimin dhe rikonstruktimin e rrugëve publike.

Sa i përket nenit 18, është dashur të monitorojë se Ministria për auto-udhë dhe rrugë regjionale dhe komuna për rrugë lokale a ka caktuar rregulla sipas standardeve për ndërtim dhe rikonstruktim të rrugëve publike.

Gjithashtu, nuk kemi informata lidhur me zbatimin e nenit 19, sipas të cilit bëhet vlerësimi mbi ndikimin në ambient për ndërtimin e auto-udhëve, të rrugëve regjionale në bashkëpunim me

Ministrinë e Ambientit, por po ashtu edhe në komuna në bashkëpunim, rrugë komunale në bashkëpunim me Ministrinë e Ambientit.

Nuk ka të dhëna me zbatimin e nenit 24, sipas të cilit Ministra nxjerr rregulla të veçanta lidhur me peshat dhe dimensionet e automjeteve të cilat shfrytëzojnë rrugët publike.

Sa i përket nenit 26, kam pritur që do të ketë së paku informata se sa po zbatohet neni 26. 1 dhe neni 26.2 lidhur me ndërtimin ose mosndërtimin e fabrikave, instalimeve e tjera, ashtu siç përcaktohet me nenin 26.1 e që ligji thotë se hapësira e brezit mbrojtës rrugor duhet të jetë do me thënë 100 metra nga auto-udha, 40 metra nga ajo regjionale dhe 30 metra nga ajo lokale. Apo neni 26.2, me të cilën Komisioni do të na informonte se a po ndërtohen objekte të ndryshme, rezidenca, puse, objekte, gropa septike e të tjera në largësinë siç e ka përcaktuar ligji.

Në raport thuhet se ministri Limaj mungesën e një libri kadastror për rrugët e paraqet si problem të veçantë.

Të nderuar kolegë,

Ju jeni për mbikëqyrjen e Ligjit, që nënkupton natyrisht edhe udhëheqësit e kësaj ministrie. Kjo nuk thotë asgjë, e është dashur të thuhet që ministri nuk e ka përmbushur obligimin ose se këto mungojnë, do me thënë, nuk jep kurrfarë arsytimi, çka do të thotë që mungon libri kadastror.

Prandaj, në fund konsideroj se me qenë se ky raport është i pjesërishëm, Komisioni duhet të formojë edhe një grup punues, duke marrë parasysh rëndësinë e këtij ligji dhe të mbikëqyrë ligjin dhe edhe njëherë t'i paraqet raportin Kuvendit lidhur me zbatimin e këtij ligji, natyrisht, me një mbikëqyrje shumë më të shprehur të Ministrisë, sepse përshtypja ime është se më shumë keni mbikëqyrur nivelin lokal se nivelin qendror. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit!

Fjalën e ka deputetja Sala Berisha – Shala, me kartelën e Gani Buçincës.

SALA BERISHA - SHALA: Faleminderit, zoti kryesues!

Përsëritet ministër i Transportit dhe Posttelekomunikacionit, zoti Limaj!

Përsëritet për të gjithë deputetë!

Praktika e monitorimit të ligjeve është një praktikë e mirë që është dhënë në detyrën e deputetëve, përveç amendamentimit të ligjeve.

Së pari, unë dëshiroj ta përsëritet përkrahjen e NDI-të që na ka dhënë një përkrahje të fuqishme për monitorimin e këtij ligji.

Së dyti, përsëritet edhe Ministrinë e Transportit, e cila ka qenë mjaft bashkëpunuese me komisionin. Ajo që dua të them, është se koha prej fillimit të monitorimit të ligjit e deri të përfundimi i këtij raporti është një kohë mjaft e gjatë, brenda të cilit afat kohor kanë ndodhur shumë ndryshime. Njërin prej ndryshimeve e përmendi edhe kolegja ime. Ne kemi filluar monitorimin e këtij ligji, në Kuvend ka ardhur plotësimi dhe ndryshimi i Ligjit për rrugët, prandaj, me plotë të drejtë mund të konstatojmë se raporti apo rekomandimet e Komisionit, që nuk do të thotë se është faj i Komisionit, nuk përputhen plotësisht me situatën edhe në teren, por edhe me obligimet që dalin nga ligji.

Ne kemi bërë monitorimin e Ligjit për rrugët, do me thënë, të Ligjit 2003/11, e jo monitorimin e Ligjit që është miratuar në Kuvend në vitin kalendarik që shkojë. Prandaj, këtu unë i përcolla

diskutimet e kolegëve të mi dhe nuk munda ta kuptoj se cilit ligj iu referuan, a iu referuan Ligjit 2003/11 apo Ligjit për plotësimet dhe ndryshimet, që ka kalua në Kuvend.

Ajo që më bëri shumë përshtypje, është shumë interesant se disa prej deputetëve janë plotësisht nën ndikimin e qasjeve që i kanë disa OJQ, që na kanë prurë një letër në si deputet. Për mua është shqetësuese dhe çuditëse pak për disa deputetë që pretendojnë që e njohin shumë mirë zbatimin e ligjeve, e njohin legjislacionin, thjeshtë i njohin rregullat, thirren në atë se nuk janë zbatuar nenet e rëndësishme në ligj. Së paku prej ne deputetëve nuk duhet të dalë ky mendim, sepse ligji i ka të gjitha nenet e rëndësishme, nuk është njëri më pak i rëndësishëm e tjetri më shumë i rëndësishëm, të gjitha e kanë rëndësinë e vet. Pati të drejtë ministri që nuk u pajtua me rekomandimin numër 4, që ai rekomandim nuk i qaset materies së këtij ligji, sepse Ligji për sigurinë në komunikacion e rregullon atë materie. Këtu pati diskutime prej deputetëve se nuk janë përfillë rregullat teknike, cilësia e asfalteve e kështu me radhë. Duhet ta kuptojmë vetëm një gjë, se monitorimi i ligjeve bëhet me një qëllim të vetëm që të shihet se sa po gjen zbatim ligji në praktikë. Në qoftë se nuk gjen zbatim, ne duhet ta bëjmë iniciimin për plotësimin dhe ndryshimin e atij ligjit duke i analizuar njëherë shkaqet e mos zbatimit të atij ligji, a janë shkaqet që nuk e respektojnë ata që duhet të zbatojnë ligjin, apo vetë ligji është pengesë për mos zbatimin e tij.

Gjatë monitorimit të këtij ligji, ne si komision parlamentar kemi ardhur në përfundim se nuk janë arsyeja apo shkaqet tek zbatuesit e ligjit, por vetë ligji është një pengesë për zbatimin e tij, prandaj me të drejtë është inicuar nga Qeveria plotësimi dhe ndryshimi i këtij ligji.

Pajtohem me disa deputetë që thanë për monitorimin e rrugës në Dushkajë. Personalisht edhe unë nuk jam pajtuar me vizitën e asaj rruge, sepse qëllimi i Komisionit nuk është që të shkojë t'i shoh se me çfarë cilësie po shtrohen rrugët sepse kompetencë e dikujt tjetër janë cilësia e rrugëve, a po zbatohen standardet kriteret teknike, më the, e thashë e të gjitha ato. Qëllimi i monitorimit është të shihet se a po zbatohen, pse s'po zbatohen dhe nëse nuk zbatohen, ne duhet të iniciojmë plotësim dhe ndryshim ose duhet t'u tërheqim vërejtjen kompetentëve që janë për zbatimin e rrugëve.

Në 3 – 4 komuna janë bërë vizita në terren. Mua më vjen keq se në shumicën e komunave nuk i kanë kryer obligimet e veta që i obligon ligji. Përveç në komunën e Mitrovicës, ku kemi pasur rastin dhe kemi pasur kënaqësinë të kuptojmë se ata kanë edhe plane për mirëmbajtje verore dhe dimërore të rrugëve të tyre që janë brenda kompetencave të tyre dhe i kanë përfillur të gjitha obligimet që dalin nga ligji. Në komuna tjera, ku kam qenë së paku vetë prezent, sidomos në komunën e Prishtinës, jemi ndarë shumë të shënjuar. Prandaj, unë mendoj që secili le ta marrë përgjegjësinë e vet, niveli qendror përgjegjësinë e tij, niveli lokal përgjegjësinë e tij.

Kështu që, unë e kam edhe një kërkesë, që të mos bien shumë nën ndikimin e të tjerëve dhe ta lexojnë mirë ligjin. Nuk po dua të përmend emra këtu për të mos e zgjatur diskutimin, por më befaso, nuk e di as cilin ligj e lexoi njëri prej deputetëve, a lexoi atë 2003 a Ligjin 2008, që është miratuar në Kuvend dhe nuk kisha mundësi as t'i qasem, apo e lexoi komplet një letër që na ka ardhur në kutia tona.

Unë kërkoj që të miratohet ky raport me ndryshimin e disa rekomandimeve, duke i hequr ato që nuk i rregullon materia e këtij ligji. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Për replikë deputetja Gjylnaze Syla. I është përmendur emri më herët.

GJYLNAZE SYLA: Faleminderit, zoti kryesues!

Dëshiroj t'i them deputetes dhe koleges sime Sala Berisha se asnjëherë nuk jam subjektive, shpresoj që nuk do të jetë subjektive po ajo. Qëllimi im gjithnjë është në interes të qytetarëve të

Kosovës dhe ligjet janë lexuar, ato janë të metat të cilat i thashë, për më shumë, unë jam informuar nga vetë ministri, se ia kam bërë një pyetje me shkrim dhe janë përgjigjet të cilat i kam marrë nga vetë ministri. Prandaj, pjesë e debatit tim ishte ajo pikërisht çka është përgjigjur vetë ministri. Dhe, në qoftë se deputetja është e interesuar, unë do t'ia jap letrën. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit!

Prapë zonja Berisha, kërkon kundër replikë, një minutë.

SALA BERISHA - SHALA: Nuk kisha dashur të merret kjo replikë si diçka personale në mes meje dhe koleges time, por unë desha vetëm të përkujtoj një fjalë të popullit, “mos e vet, se të kallëzon vetë”. Dihet kush është nën ndikimin e OJQ-ve, thjeshtë mund të them, ato që nuk i analizojnë mirë procedurat se qysh shkon monitorimi i ligjit, bërja e amendamentimit e të tjera.

KRYESUESI: Fjalën e ka deputeti Riza Smaka.

RIZA SMAKA: I nderuari zotëri kryesues,

Mua më inspiroi raporti, që sipas vlerësimit tim është bërë mirë në përgjithësi, në një anë, si dhe referimi i ministrit, i cili nuk ishte në kolizion po ishte komplementar me konkludimet e Komisionit dhe në këtë kontest do të isha angazhuar që të gjitha komisionet në sferat e veta të bëjnë më shumë në monitorimin e zbatimit të akteve ligjore, se ajo është një ndër pikat më neuralgjike. Kemi shumë ligje të cilat mjerisht nuk përfillen sa e si duhet, nuk implementohen, nuk zbatohen dhe të konstatohet e të jepen propozime, rekomandime, e më pastaj ekzekutivi do të jetë më vigjilent.

Në raport thuhet ndër të tjera që mungon bashkëpunimi ministri – komuna. Unë do të isha angazhuar që nëpërmjet amendimit të Ligjit për rrugët, Ministrisë t'i jepen më shumë ingerenca edhe kompetenca sepse është fjala për ekzekutivin, ju lutem, për zbatimin e ligjit, e më tepër ka vend për hierarki e funksionale se sa për konsultime, korespondime, harmonizime të pikëpamje e tjera e tjera, se është fjala për ligjin, për zbatimin e ligjit, prandaj kur është ligji në pyetje, vlen hierarkia.

Jemi dëshmitarë të uzurpimeve të shumta, të uzurpimeve arbitrare, të dëmtimeve të pronave shoqërore apo shtetërore në mënyrë të pamëshirshme, e tha edhe zotëri ministri, po kësaj do të isha angazhuar që me ndryshime dhe plotësime të Ligjit për rrugët të precizohen sanksionet dhe autorizimet e inspektorëve, në këtë rast, në procedurë të shkurtuar, jo nëpërmjet gjykatave, që të kenë autorizime për të ndërmarrë masa se kalimtarë i rëndomtë, nëse e bënë një rrugë, po e zëmë, 100 kilometra nëpër Kosovë, është e pamundur që mos t'i vërej 2 a 3 dëmtime, aty për aty është fjala, se lëre më që natën a ditën, e çka po di unë.

Do të isha angazhuar për mirëkuptim, do të kisha apeluar ministrit që në kuadër të autorizimeve që i ka, po edhe të autoritetit që mund ta ketë mbi autoritetet publike komunale, të bëjë më shumë sa u përket tabelave, të cilat përmbajnë, do të duheshin të përmbanin emërtimet e vendbanimeve dhe të jenë ato emërtime më të vërtetë autoktone, kështu, ato oronime, hidronime, toponime në përgjithësi, se si të tilla çfarë janë, që u tha edhe në raport, edhe nga disa diskutues, me të vërtetë irritojnë me gabimet drejtshkrimore, me emërtimet që nuk janë adapte me rrethanat.

Unë, përfundimisht do ta kisha përkrahur raportin edhe fjalimin e ministrit që ishte, ta nënvizoj edhe një herë, komplementar me raportin që premtonte se është fjala për mirëkuptim reciprok dhe për angazhim për zbatim të rekomandimeve të konstatuara. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit!

Deputeti Ibrahim Makolli, e ka fjalën.

IBRAHIM MAKOLLI: Faleminderit, zoti kryesues!

Zoti, ministër,

Para vetes kemi një raport të një komisioni dhe konsideroj se praktikat e monitorimit të zbatimit të ligjeve nga komisionet e Kuvendit është një praktikë e mirë që do të duhej të vazhdojë edhe më tutje. Ligji ose raporti për të cilën po bëjmë fjalë, obligon dy nivelet, nivelin qendror dhe nivelin lokal dhe unë do të përpiqem shkurt të paraqes disa pikëpamje sa i përket këtij raporti.

Raporti i komisionit do të duhej të ishte më gjithëpërfshirës edhe më i qartë në rekomandimet që ka. Nuk është gjithëpërfshirës, nuk ka rekomandime të qarta përmes të cilave qoftë ministria, qoftë niveli lokal do të mund të jepnin një kontribut më të madh. Është për t'i përshëndetur veprimet, edhe të nivelit qendror, edhe të nivelit lokal për të përmirësuar infrastrukturën rrugore, por fatkeqësisht edhe më tutje gjendja praktike në rrugët tona nuk është e kënaqshme.

Do të filloj t'i përmend disa prej tyre. E vlen, nuk e besoj që do të duhej të jemi shumë të mençur, por e vlen që të udhëtojmë nëpër rrugët magjistrale të Kosovës dhe të shohim se sa është mungesa, sa ndihet mungesa e sinjaleve treguese në rrugë, të cilat natyrisht janë shndërruar në pengesa ose në faktorë për aksidente të rënda të komunikacionit.

Në disa vende, po ashtu, janë të vendosura mbrapsht këto shenja, unë e di që Ministria nuk vendos shenja, por janë kompanitë të cilat vendosin shenja dhe që jo gjithherë këto shenja janë treguese, përkundrazi e pengojnë qarkullimin e lirë të komunikacionit. Mungesa e shiritave ndarës nëpër rrugët, u tha edhe këtu edhe prej disa kolegëve, të cilat janë një faktor shumë i rëndësishëm për sigurinë në komunikacion.

Përfundimisht, gjendja e rrugëve tona në përgjithësi është një faktor shumë i rëndësishëm, që ne për çdo ditë kemi aksidente, madje me pasoja fatale dhe ju e dini se sa është numri i këtyre aksidenteve që ndodhin në Kosovë.

Arnimet, kemi arnime jo adekuate të rrugëve, që në vend që të jenë në shërbim të ngritjes së cilësisë, ato janë shndërruar në pengesa. Në shumë vende ku zhvillohen, e keni po qe se i viziton për çdo ditë, sepse ne të gjithë udhëtojmë, në shumë vende ku zhvillohen punimet, nuk ka shenja mbrojtëse dhe ne kemi pasur mjaft aksidente për shkak të mungesës së shenjave mbrojtëse gjatë zhvillimit të punimeve nëpër rrugë. Se sa janë të sigurta rrugët tona, unë vetëm po përmend një fakt se sa janë të rrezikuara fëmijët, fëmijët tanë, fëmija sidomos në kalimin e këmbësorëve afër shkollave, përkundër përpjekjeve të Ministrisë në dy vitet e fundit që të ndërtojë nënkalime për të pasur një siguri më të madhe. Megjithatë, ne kemi vende ose rrugë në të cilat është rrezik permanent i kalimtarëve. Po përmend vetëm dy raste, që konsideroj më eklatante, e që janë tash e tri vjet, të cilat kanë qenë vendi ku ka pasur mjaft aksidente ose gati, më mirë të them, për çdo ditë aksidente. E keni te rrethi i madh, i cili e lidh rrugën për Veternik, në dalje të Prishtinës, lidhje me magjistralen e Mitrovicës dhe keni, po ashtu, rrethin në Çagllavicë, në të cilin brenda dy muajsh kemi pasur tri aksidente me pasoja fatale.

Po ashtu, edhe hyrjet dhe daljet e shpeshta, lidhjet me këto rrugë janë një faktor i rëndësishëm. Ne kemi vetëm në rrugën për Fushë Kosovë diku më tepër se 10 hyrje dhe dalje dhe kemi pasur disa aksidente fatale. Ministër, do të duhej të mendohej se çka të veprohet në drejtim të garantimit të një sigurie më të madhe në atë pjesë.

Kemi, po ashtu, mungesa të ndalesave për kalim aty ku rruga kalon mbi hekurudhë. Kemi disa prej aksidenteve të cilat kanë ndodhur për shkak të mungesës së rampave ose të sigurisë në kalimin e hekurudhave.

Kemi në kundërshtim, që është në kundërshtim me nenin 26 të ligjit, po flas gjithmonë për Ligjin 2003/11, ndërtimi i objekteve statike në kundërshtim me nenin 26 që ... dhe, po ashtu, për ta përmbyllur këtë, janë automjetet me peshë të rëndë, në kundërshtim me nenin 24. Ne na bie të shohim për çdo ditë automjete të tilla. Sikurse edhe mirëmbajtja, që gjatë kohës së dimrit, për fat të mirë, këtë dimër kemi pasur një mirëmbajtje të mirë, dimrin e kaluar në rrugët magjistrale, por që kjo nuk mund të thuhet për rrugët lokale, në veçanti për rrugët e Prishtinës. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit!
I fundit, deputeti Gani Buçinca.

GANI BUÇINCA: Faleminderit, zoti kryesues!

Të nderuar kolegë deputetë,

I nderuari zoti ministër Limaj,

E mora fjalën për të vetmin qëllim që t'ua tërheq vëmendjen, vërejtjen disa diskutuesve, që të mos flasim për Shkup e për Shkodër, por të përqendrohen te ligji, është fjala për Ligjin për rrugët, nuk është fjala për Ligjin për sigurinë në komunikacion, nuk është fjala për caktimin e ditës së votimit për fushatë parazgjedhore, jemi akoma larg asaj.

I nderuari zoti ministër,

Për mua, si deputet i Kuvendit të Kosovës, ishte shumë inkurajuese dhe shumë premtuese zotimi juaj dhe premtimi juaj që të gjitha vërejtjet e komisionit do t'i merrni me seriozitet dhe do t'i trajtoni me prioritet. Kjo ishte një praktikë e re e komunikimit të Qeverisë me Kuvendin, përkatësisht me një komision, i cili, ma merr mendja, në kuadër të aftësive profesionale, kompetencave e ka bërë një punë të mirë dhe i ka dhënë disa vërejtje, disa rekomandime, disa sugjerime që megjithatë të përmirësohet gjendja në rrugët e gjithë territorit të Kosovës.

Unë, pavarësisht vërejtjeve që u dhanë këtu, unë mendoj që komisioni kishte qëllim të mirë dhe kishte bërë një punë të mirë, pavarësisht se në disa raste i bënte disa vërejtje Ministrisë që nuk është kompetente, por megjithatë nuk vërejta se komisioni kishte tendencë, ishte tendencioz ose kishte qëllime të këqija.

Gjendja e sigurisë në Kosovës, gjendja në rrugët e Kosovës dihet, nuk është në nivelin e kënaqshëm. Mirëpo, të thuhet se në Kosovë ka aksidente për shkak të papërgjegjësisë në punë të Qeverisë ose për shkak të gjendjes së rrugëve, është krejt absurde. Aksidente, fatkeqësisht, ka në Kosovë, por ka edhe në vende më të përparuara, ka edhe në Evropë, ka edhe gjithandej botës së qytetëruar. Për sigurinë në komunikacion nuk është përgjegjëse vetëm Qeveria, por janë të gjithë aktet të cilët marrin pjesë në komunikacion. Dhe, pa dyshim, ka vend për përmirësime, mirëpo duke u bazuar edhe në rrethanat ekonomiko-sociale, të cilat janë që shpesh njerëzit detyrohen të marrin një sinjalizim, nuk mund të pretendojmë që ne të krijojmë roje te çdo sinjal dhe t'i ruajmë sinjalet 24 orë çdo ditë, kur mungon nga rruga. Besoj se në ngritjen, në vetëdijesimin e përgjithshëm të popullatës, edhe këto dobësi, edhe këto mangësi që ekzistojnë sot në rrugë, një ditë do të hiqen nga rendi i ditës dhe nuk do të ketë interes dikush që të heq një mbishkrim ose një sinjalizim për aq pak para.

Unë mund t'ju them, zoti ministër, se disa vërejtje të Komisionit me të vërtetë të janë shqetësuese, sidomos mbingarkesa e kamionëve të cilat qarkullojnë nëpër rrugët e Kosovës. Ne nuk mund t'i tolerojmë vetit që të ndërtojmë, në njërin anë, dhe të shkatërrojmë, në anën tjetër. Nuk është vetëm

Ministria e Transportit përgjegjëse për këto që në Kosovë nuk ndërtohen vetëm rrugë, kolegë të nderuar, por në Kosovë ndërtohen edhe në sektorin privat, ndërtohen ndërtesa edhe Kosova sot është një kantier i madh i ndërtimit dhe askush nuk mund të mohojë këtë. Me të vërtetë, në një proces kaq intensiv të ndërtimeve që bëhen në Kosovë, ka edhe vështirësi në mbikëqyrjen, kontrollin dhe zbatimin e ligjeve në Kosovë.

Këtu, në këtë problem të cilin po e diskutojmë sot, janë të involvuara edhe Ministria e Rendit, edhe pushteti lokal, kështu që unë besoj që në të ardhmen me angazhime të përbashkëta edhe të pushtetit lokal, edhe të atij qendror dhe duke i pasur parasysh edhe vërejtjet që u dhanë këtu dhe duke pasur parasysh përkushtimin dhe entuziazmin e Qeverisë që të kemi në Kosovë rrugë moderne dhe t'i mirëmbajmë ato, do të përmirësohet gjendja.

Kurse, sa iu përket rrugëve magjistrale dhe rrugëve nacionale, mund t'ju them se asnjëherë në histori të Kosovës nuk ka qenë gjendja më e mirë, sidomos në kohën e dimrit, asnjëherë nuk ka qenë kjo, duhet të pranoni të gjithë, nuk ka pasur vështirësi në mirëmbajtje dhe në qarkullim në komunikacion prej kur ekziston Kosova.

Pushteti lokal, u dhanë vërejtje për pushtetin lokal. Vërejtjet janë të arsyeshme, mirëpo pushteti lokal ballafaqohet me mungesa të mëdha të mjeteve materiale për mirëmbajtjen e rrugëve. Këtë duhet ta kemi parasysh. Ndoshta nuk mungon përkushtimi, mirëpo të thuash se në Prishtinë nuk është gjendja në nivel të duhur, është e vërtetë që nuk është, mirëpo Prishtina është zhvilluar aq shpejtë sa që asnjë qeveri komunale nuk mund të përcjellë zhvillimin aq të madh me rrugë moderne në Prishtinë, kështu që arsyet më shumë janë të natyrës objektive se sa subjektive. Ne duhet të jemi të gjithë të vetëdijshëm që në Kosovë ka zhvillim, ka përparim dhe, normalisht, çdo zhvillim i paraqet edhe vështirësitë, përcillet edhe me vështirësi edhe me dobësi anësore të këtij zhvillimi.

Unë e përkrah raportin dhe i uroj Ministrisë punë të mbarë.

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Ibrahim Makolli, një minutë e ka.

IBRAHIM MAKOLLI: Faleminderit!

Seriozisht, unë pajtohem që dikush këtu flet për Shkup e Shkodër, sepse ndoshta më shumë rri në Shkup e në Shkodër, por unë dhe shumica prej nesh rrimë në Prishtinë dhe në Kosovë dhe po flasim për Prishtinë dhe për Kosovë.

Zoti Buçinca, po flasim për ligjin, jo, po ia përmend emrin, 2003/11, sepse nuk flas pa emra, s'e gjuaj gurin e ta fsheh dorën. Neni 20 thotë: Ministria është përgjegjëse për vendosjen e shenjave të trafikut mbi rrugë të ndërtuara magjistrale dhe regjionale dhe për shkak të mungesës së këtyre shenjave, ne kemi aksidente të komunikacionit. Nuk janë faktorë kryesor por kemi. Komuna është përgjegjëse për vendosjen e shenjave të trafikut mbi rrugët e ndërtuara dhe lokale, do të thotë këto janë në përgjegjësi të Ministrisë, unë e di që ministri as zëvendësministri nuk vendos shenja, por shenjat janë nën kompetencë ...

KRYESUESI: Uroj që të debatoni në ndonjë vend tjetër. Mendoj që s'ka nevojë, zoti Buçinca, një minutë dhe e përfundojmë debatin.

GANI BUÇINCA: Zoti Makolli, nga ana ime je shumë i respektuar dhe i nderuar. Janë dy qytete që unë i kam shumë për zemër, edhe Shkupin, edhe Shkodrën. Pas Prishtinës janë dy qytete që unë më së shumti i dua. Unë besoj që ju nuk keni dëshirë ta shihni ministrin Limaj duke i ruajtur sinjalet nëpër rrugët e Kosovës dhe unë besoj që ju nuk keni ekspertizë aq të madhe sa që të

konstatoni se të gjitha fatkeqësitë në Kosovë vinë për shkak të sinjalizimeve. Do të shkojmë në kafe sot dhe do të bisedojmë së bashku, kam shumë respekt për ty.

KRYESUESI: Vazhdoni pas seancës. Fjalën e ka ministri Fatmir Limaj.

MINISTRI FATMIR LIMAJ: Faleminderit, zoti kryesues!

Përsëri ne dëgjuam debatet, diskutimet e shumë deputetëve dhe i falënderoj për sugjerimet që kanë dhënë shumica, të drejta. Njëri nga deputetët tha, ne jetojmë këtu dhe e dimë qysh e kemi gjendjen, që është e vërtetë. Prandaj, kisha ftuar që realisht të bisedojmë dhe t'i shfrytëzojmë minutat tonë për ta analizuar gjendjen reale dhe ku jemi.

Në Kosovë asnjë rrugë nuk ka pasur sinjalistikë për të treguar qyteti me qytet ku është, jo sot, por kurrë, sidomos pas luftës. Asnjë tabelë nuk ka qenë për të treguar se sa ka prej Gjakovës në Pejë, prej Pejës në Prishtinë, prej Prishtinës në Gjilan, me kilometër po flas, të tregojë me kilometër, të thotë se ju jeni në Komoran, i keni edhe kaq kilometra deri në Pejë. Gjithkund në Kosovë, gjithkund në Kosovë ka qenë kështu dhe ne e dimë gjendjen si është. Shenjat e bardha ose trakat, që flasim ne, për dallim në të kaluarën, që s'kanë qëndruar as dy javë, ne jemi duke ndryshuar kualitetin. Shumica e ish ministrave, deputetëve që jeni ju këtu edhe nga përbërja e kaluar, keni kaluar nëpër to dhe e dini si ka qenë ajo gjendje. E dini mirë si ka qenë mirëmbajtja verore, ku me muaj kanë mbetur gropat e hapura të punuara dhe të mos asfaltuara, mos mirëmbajtja e atyre. Ju e dini se si ka qenë mirëmbajtja verore viteve të tjera, ju e dini si ka qenë mirëmbajtja dimërore viteve të tjera. Unë ju kërkoj që duke i cilësuar gabimet ku i kemi, telashet me të cilat po ballafaqohemi, dobësitë nga e kaluara, t'i punojmë bashkë dhe ne i marrim këto sugjerime për t'i përmirësuar, por ju kisha kërkuar gjithashtu që të vlerësoni edhe punën që është duke u bërë. Asnjëherë rrugët e Kosovës nuk kanë pasur mirëmbajtje më të mirë sa tani, edhe verore edhe dimërore.

Gjendja në komunikacion, më lejoni t'ju them me shifra zyrtare. Fatkeqësitë në komunikacion fatalitetet kanë rënë sipas të dhënave, shifrave zyrtare të policisë, 12 deri në 17%, varësisht nga lloji i aksidentit. A e dini pse ka ndodhur kjo? Pse në të kaluarën asnjë automjet në Kosovë nuk ka hyrë në kontroll teknik dhe unë e di që ju shumica e deputetëve i keni regjistruar automjetet pa i çuar në kontroll teknik. askush s'ju ka kërkuar, kështu ka ndodhur, 99% e automjeteve të Kosovës nuk janë futur në kontroll teknik, kjo është një e vërtetë dhe sot është ndryshe gjendja. Vlerësoni përpjekjet që po i bëjmë, sikur ne që do t'i marrim sugjerimet, në të cilat besoj që ka shumë gjëra që duhet të përmirësohen, ka shumë gjëra që duhet të rregullohen.

Dalloni rrugët lokale dhe rrugët regjionale. Në qoftë se komuna thërret për të bashkë investuar Ministria, Ministria shkon, me komunën bashkë investon edhe në rrugë lokale, kur është ftesë, është marrëveshje në mes Ministrisë, Qeverisë edhe komunës, që quhet bashkëfinancim, është me ligj.

Dalloni rrugët regjionale, për shembull, dikush Dushkajën e quajti si rrugë lokale. Nuk është Dushkaja rrugë lokale. Dushkaja është rrugë regjionale. Shkoni, shikoni atë rrugë edhe e vlerësoni se çfarë kategorie e rrugës është.

Edhe një gjë tjetër po ju them. Ne jemi të gatshëm për debat për çdo gjë, por mos e përziëni Ligjin për rrugët, Ligjin për sigurinë në rrugë, me cilësinë, kontrollin. Urdhëroni, hulumtoni, dilni, vizitoni të gjitha, po t'i përmbahemi secili obligimeve dhe kompetencave të cilat i kemi.

Unë nuk desha të futem shumë në rekomandimet e komisionit, i paraqitëm disa vërejte unë edhe zëvendësi im, por ne morëm për sipër që ato të cilat ne mendojmë se duhet të rishikohen, e që neve

na ndihmojmë për të përmirësuar, ju siguroj që do të përmirësojmë. Po, dua të ju them që rrugët, edhe sinjalistika, edhe mirëmbajtja janë shumë, shumë më të mira, sikur që dua t'ju them që për herë të parë ne po e kthejmë pronën publike, është uzurpuar në të kaluarën. Prona publike, projekti rrugor në Kosovë është uzurpuar fuqishëm pas luftës, sidomos mbas luftës në Kosovë dhe ne po e kthejmë, që ka ndodhur dikur e kundërta, është dhënë leja për t'u zënë pronë publike, është dhënë leje për të zënë brezin rrugor, ne po e bëjmë të kundërtën, po e kthejmë. Kyçjet në rrugë, nuk e di kush e përmendi njëri nga deputetët, është e vërtetë se ka pasur kyçje në rrugë ose pëlqim për kyçje në rrugë në mënyrë të pashpjegueshme, kushdo që është afruar, pa e analizuar a duhet të jepet kyçje apo jo. Urdhëroni, këqyrni vendimet e një vitit e tutje dhe ju do ta shihni edhe sa kyçje ka të lejuara nga Ministria e Transportit, pastaj mund të shohim se ku kemi qenë vitet e kaluara, ku jemi sot.

Komunat, unë e di që ka vullnet të shumica e komunave, ballafaqohen me të njëjtin problem që ballafaqohemi ne, po këtë alarmim të opinionit duhet ta bëjmë të gjithë së bashku për të na ndihmuar që ligjet të zbatohen. Ne do të jemi të vendosur për zbatimin e të gjitha ligjeve që ne i kemi obligim t'i implementojmë në vendin tonë, në sektorët që i drejtojmë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zoti ministër!

Për fund, deputetja Myzejene Selamani, si kryetare e Komisionit. I keni 5 minuta.

MYZEJENE SELMANI: Faleminderit, zoti kryesues!

Në fund, mund t'i përshëndes të gjithë deputetët për kontributin e vet që e dhanë për rekomandimet e Komisionit për Ekonomi, Tregti, Industri, Energjetikë dhe Telekomunikacion, për monitorimin e Ligjit të rrugëve. Dhe, njëkohësisht apeloj si ligjvënës brenda këtij Kuvendi që në mënyrën më strikte të bëhet zbatimi i ligjeve, jo vetëm të nxirren ligjet dhe të aprovohen brenda këtij Kuvendi, por edhe të zbatohen në terren. Kam qenë dëshmitare që shumë pak zbatohet ligji në terren dhe kërkoj në mënyrën më sinqertë prej ministrit dhe prej gjithë deputetëve këtu të shihet zbatueshmëria e ligjeve, vetëm me zbatueshmërinë e ligjeve mund të arrihet sukses i Kosovës në përgjithësi.

Kërkoj nga ju që të përkrahet, në parim, ky raport dhe të kalojë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit!

Të nderuar deputetë, vazhdojmë sipas Rregullores me votimin e Raportit me rekomandimet e Komisionit për Ekonomi, Tregti, Industri, Energjetikë dhe Telekomunikacion për mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për rrugët.

Ju njoftoj që në sallë janë 72 deputetë.

Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim, votojmë tani:

Konstatoj që Raporti së bashku me vërejtjet që janë dhënë u miratua nga deputetët, 50 vota "për" janë me kartelë, 4 vota pa kartelë, që do të thotë se 54 vota janë "për", 14 vota "kundër" dhe 3 abstenime. Konstatoj që Kuvendi miratoi Raportin me rekomandimet e Komisionit për Ekonomi, Tregti, Industri, Energjetikë, Transport dhe Telekomunikacion për mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit 2003/11 për rrugët.

Sipas radhës, pika e katërmëdhjetë e rendit të ditës:

- **Shqyrtimi i Raportit të Komisionit parlamentar ad-hoc për përzgjedhjen e kandidatëve për anëtarë të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës të Kosovës**

Komisioni parlamentar ad-hoc për përzgjedhjen e kandidatëve për anëtarë të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës të Kosovës, në pajtim me Rregulloren nr. 2008/2 për ndryshimin e Rregullores nr. 2001/36 për shërbimin civil ka intervistuar kandidatët për anëtarë të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës të Shërbimit Civil të Kosovës dhe Kuvendit i ka paraqitur Raportin me rekomandime.

Raporti i Komisionit së bashku me dokumentacionin u është shpërndarë deputetëve.

Ftoj kryetarin e Komisionit ad-hoc, zotin Hydajet Hysenin, që para deputetëve të Kuvendit ta arsyetojë raportin me rekomandime. Zoti Hyseni e ka fjalën.

HYDAJET HYSENI: Faleminderit, zoti kryesues!

Zonja e zotërinj deputetë,

Të nderuar ministra,

Komisionit parlamentar ad-hoc për përzgjedhjen e kandidatëve për anëtarë të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës të Kosovës, i zgjedhur dhe i autorizuar nga ky Kuvend, pas përfundimit të procedurës së përzgjedhjes në pajtim me procedurat e miratuara nga Kuvendi, duke pasur në dispozicion një numër të madh të kandidatëve, vërtet cilësorë, rekomandon si kandidatë për pozitën - anëtarë të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës të Kosovës, kandidatët vijues:

- Sabile Avdylin, me 96.2 pikë, dhe
- Ali Dragushën, me 95.5 pikë.

Dëshiroj, me lejen tuaj, vetëm të theksoj faktin se me këtë proces krijohet mundësia e kompletimit të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës, zgjidhet anëtari i gjashtë i tij sipas mandateve që kanë pasur dhe përmbushet njëra nga vërejtjet që iu janë bërë institucioneve tona në Raportin e progresit.

Në procedurë është edhe kandidati vijues dhe me këtë përmbushet obligimi ynë, duke respektuar edhe përbërjen etnike dhe atë gjinore. Ju ftoj, prandaj, që ta përmbushim me sukses edhe këtë obligim institucional. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit!

Në vazhdim, mund të kërkohet deklarimi i grupeve parlamentare në qoftë se kanë diçka në emër të grupeve parlamentare.

Grupi Parlamentar i PDK-së, ka diçka për të thënë? Nuk ka.

Grupi Parlamentar i LDK-së, nuk ka.

Grupi Parlamentar i AAK-së, nuk ka.

Grupi Parlamentar i AKR-së, nuk ka.

Grupi Parlamentar i LDD-së, nuk ka.

Grupi Parlamentar “7+”, nuk ka.

Grupi Parlamentar i SLS, nuk ka.

Ju njoftoj se në pajtim me nenin 8 pika 5 të Rregullores, pas ndryshimit të Rregullores nr. 2001/36 për Shërbimin Civil të Kosovës, Kuvendi i Kosovës emëron njërin prej dy kandidatëve të rekomanduar me shumicën e votave të deputetëve të pranishëm dhe që votojnë.

Meqë janë dy kandidatë për një pozitë, atëherë do të mbahet votimi i fshehtë. Për zbatim të procedurës së votimit, ftoj shefat e grupeve parlamentare që të propozojnë nga një anëtar të Komisionit votues.

Komisioni votues do të mbështetet prej dy zyrtarëve të administratës së Kuvendit.

Në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së, zoti Buja, kënd e keni caktuar në Komision?

RAMË BUJA: Unë propozoj Gani Kocin.

KRYESUESI: Zoti Gani Koci, në emër të PDK-së.
Në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, zoti Haziri.

LUTFI HAZIRI: Ne propozojmë zotin Armend Zemaj.

KRYESUESI: Zoti Armend Zemaj.
Grupi Parlamentar i AAK-së?

ARDIAN GJINI: Ne propozojmë zotin Ibrahim Selmanaj.

KRYESUESI: Zoti Ibrahim Selmanaj, në emër të AAK-së.
Grupi Parlamentar i AKR-së?

MYZEJENE SELMANI: Faleminderit, zoti kryesues!
Ne propozojmë Suzan Novobrdaliun.

KRYESUESI: Grupi Parlamentar i AKR-së, Suzan Novobrdali.
Grupi Parlamentar i LDD-së?.

ADEM SALIHAIJ: LDD propozon deputetin Naser Rugova.

KRYESUESI: LDD-ja, deputetin Naser Rugova.
Grupi Parlamentar “7+”, Xhezair Murati.

DŽEZAIR MURATI: Parlamentarna grupa “7+”, predlaže Enisa Kervana.

KRYESUESI: Grupi Parlamentar “7+”, zotin Kervan.
Grupi Parlamentar SLS, kënd e propozoni?
Vaša parlamentarna grupa koga predlažete, molim vas!

KOSARA NIKOLIQ: Dimić Dragan.

KRYESUESI: Dimić Dragan.
Ftoj deputetët që sipas ftesës, të marrin fletëvotimet.
Komisioni le të zë vendin e vet.

(Ndërprerje e incizimit)

Deputetët, a keni zënë vend, a janë gati të gjithë?

Ju lus, Komisioni, a jeni gati për votim? Zoti Koci, a jeni gati për votim, a i keni fletëvotimet? Më trego, për t’i thirr deputetët me radhë.

Sipas radhës, deputeti Adem Grabovci, nuk është, deputeti Adem Hajdaraj, deputeti Adem Salihaj, deputeti Agim Veliu, deputeti Ahmet Isufi, deputeti Ali Lajçi, deputeti Alush Gashi, deputetja Anita Morina, deputeti Ardian Gjini, deputeti Armend Zemaj, deputeti Arsim Rexhepi, deputeti Bahri Hyseni, deputeti Bajram Kosumi, deputeti Behxhet Pacolli, deputeti Berat Luzha, deputeti Berim Ramosaj, deputetja Besa Gaxherri, deputeti Bojan Stojanoviq, nuk është, deputeti Branislav Grbiq, deputeti Bujar Bukoshi, deputeti Danush Ademi, deputetja Donika Kadaj, deputeti Dragisha Miriq, nuk është, deputetja Drita Kadriu, nuk është, Drita Maliqi, deputeti Driton Tali, deputeti Xhezair Murati, deputetja Edita Tahiri, deputetja Elheme Hetemi, deputeti Emrush Xhemajli,

deputeti Enis Kervan, deputeti Enver Hoxhaj, deputeti Eqrem Kryeziu, mungon, deputeti Esat Brajshori, deputeti Etem Arifi, deputeti Et'hem Çeku, deputeti Fatmir Limaj, deputeti Fatmir Rexhepi, deputetja Fatmire Berisha, deputeti Fehmi Mujota, mungon, deputetja Flora Brovina, deputeti Gani Buçinca, deputeti Gani Geci, deputeti Gani Koci, deputetja Gjylnaze Sylja, deputetja Hafize Hajdini, deputeti Hajdin Abazi, deputeti Hajredin Hyseni, mungojnë të dytë, Hyseni është këtu, deputeti Hajredin Kuçi, deputeti Haki Shatri, deputeti Hashim Thaçi, deputeti Heset Cakolli, deputeti Hydajet Hyseni – Kaloshi, deputeti Ibrahim Gashi, deputeti Ibrahim Makolli, deputeti Ibrahim Selmanaj, deputeti Ismet Beqiri, deputetja Kaqusha Jashari, deputeti Kolë Berisha, deputetja Kosara Nikoliq, deputeti Dragan Dimiq, deputetja Luljeta Shehu, deputeti Lulzim Zeneli, deputeti Lutfi Haziri, deputeti Mahir Yagcilar, s'është, deputeti Mark Krasniqi, deputetja Melihate Tërmkolli, deputeti Memli Krasniqi, deputeti Mihajlo Shqepanoviq, nuk është, deputetja Mimoza Ahmetaj, deputetja Myfera Shinik, deputeti Mursel Halili, deputetja Myrvete Pantina, deputetja Myzejene Selmani, deputeti Naim Maloku, deputeti Naim Rustemi, deputeti Nait Hasani, deputeti Naser Osmani, deputet Naser Rugova, deputetja Nekibe Kelmendi, deputetja Nerxhivane Dauti, Naser Rugova, a të thirra? Po. Deputeti Nexhat Daci, mungon, deputetja Njomza Emini, deputeti Numan Baliq, deputetja Nurishahe Hulaj, deputetja Qamile Morina, s'është. Deputetja Radmilla Vujoviq, deputeti Ramadan Avdiu, deputeti Ramadan Gashi, deputeti Ramë Buja, deputeti Ramë Manaj, mungon, deputeti Rasim Selmanaj, mungon, deputetja Rita Hazeraj, deputeti Riza Smaka, deputeti Rustem Mustafa, deputeti Sabri Hamiti, deputeti Sadik Idriz, deputetja Safete Hadërgjonaj, deputetja Sala Berisha-Shala, deputetja Sanije Aliaj, deputetja Selviqe Halimi, deputeti Shkumbin Demaliaj, deputeti Skender Hyseni, Deputeti Slavisha Petkoviq, s'është, deputeti Slobodan Petrovich, deputetja Shpresa Murati, deputetja Suzan Novobërdaliu, deputetja Synavere Rusha, deputetja Teuta Hadri, deputetja Vezira Emrush, deputeti Vlladimir Todoroviq, Deputeti Vlora Çitaku, deputeti Xhevdet Neziraj, deputeti Zafir Berisha, deputeti Zef Morina, deputeti Zylfi Merxha, deputetja Zylfije Hundozi, deputeti Xhavit Haliti.

Pesë minuta pauzë, nëse ka nevojë dikush për të pushuar.

(Pas pauze)

KRYESUESI XHAVIT HALITI: Faleminderit prej Komisionit! Për ta komunikuar rezultatin e votimit, fjalën e ka zoti Gani Koci, si kryesues i Komisionit.

GANI KOCI: I nderuar kryesues,

Të nderuar deputetë,

Po japim raportin mbi rezultatet e votimit për anëtarin e Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës.

Komisioni votues, më 10 korrik 2009

R a p o r t

mbi rezultatet e votimit për zgjedhjen e një anëtarit të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës të Kosovës

Në mbështetje të nenit 65 pika 1 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe të nenit 1 të Rregullores Numër 2008/12 për ndryshimin e Rregullores 2001/36 për shërbimin civil të Kosovës, Komisioni votues, në përbërje nga përfaqësuesit e grupeve parlamentare:

- Gani Koci, Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës;
- Armend Zemaj, Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike të Kosovës;
- Ibrahim Selmanaj, Grupi Parlamentar i AAK-së;
- Suzan Novobërdaliu, Grupi Parlamentar i AKR-së;

- Naser Rugova, Grupi Parlamentar i LDD-së;
- Enis Kervan, Grupi Parlamentar “7+” dhe
- Dimiq Dragan, Grupi Parlamentar SLS.

Në votim kanë marrë pjesë gjithsej 74 deputetë.

Për Sabile Abdylin kanë votuar 39 deputetë, ndërsa

Për Ali Dragushën kanë votuar 25 deputetë.

Komisioni ka konstatuar se janë 10 fletëvotime të pavlefshme dhe që të ketë një vërejtje ndoshta për në të ardhmen me rastet e votimeve, në një fletëvotim e kemi shpallur të pavlefshëm sepse është votuar në anën e djathtë të emrit dhe jo në rubrikën e përcaktuar, edhe pse në fund të fletës thuhet - votohet në kolonën ose në linjën e caktuar, por duhet të jenë në të ardhmen në katrorin eventalisht ose ndonjë formë tjetër që të kemi parasysh. Ne e kemi shpallur një votim të pavlefshëm dhe kjo ishte një vërejtje ndoshta për punën e komisioneve të tjera.

Në bazë të rezultateve të votimit, në pajtim me Rregullën 31 pika 3 të Rregullores së Punës të Kuvendit dhe të nenit 1 të Rregullores Numër 2008/12 për ndryshimin e Rregullores Numër 2001/36 për Shërbimin civil të Kosovës, konstatohet se Sabile Abdyli është zgjedhur anëtare e Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës të Republikës së Kosovës me mandat pesëvjeçar.

Raportin e kanë nënshkruar të gjithë anëtarët e Komisionit, pa asnjë kundërshtim.

KRYESUESI: Faleminderit, zoti Koci!

Pra, konstatojmë se Sabile Abdyli është zgjedhur me vota përkatëse – me 39 vota.

Ne po vazhdojmë me pikën e pesëmbëdhjetë të rendit të ditës, që është:

- Shqyrtimi i propozimit të Qeverisë së Kosovës për emërimin e drejtorit dhe të zëvendës drejtorit të Rregullatorit për Ujërat e Mbeturinat

Komisioni parlamentar për Bujqësi, Pylltari, Zhvillim Rural, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor, në pajtim me dispozitat e Rregullores së Punës ka shqyrtuar propozimin e Qeverisë së Kosovës për emërimin e drejtorit dhe të zëvendës drejtorit të Rregullatorit për Ujërat dhe Mbeturinat dhe Kuvendit i ka paraqitur propozimin për miratimin e Propozim-vendimit të Qeverisë në seancën plenare.

Rekomandimi i komisionit funksional për propozimin e Qeverisë u është shpërndarë deputetëve.

Ftoj përfaqësuesin e Qeverisë, si propozues. A ka kush që e do fjalën? Nuk dëshiron askush. Ftoj kryetarin e komisionit funksional, zotin Zeneli apo raportues kush është në emër të komisionit funksional, ta marrë fjalën. Naim Maloku. Urdhëroni!

NAIM MALOKU: Faleminderit, zoti kryesues!

Të nderuar deputetë,

Komisioni e ka shqyrtuar propozimin e Qeverisë për emërimet në këto poste dhe i kërkon Kuvendit që të procedohet me votimin e këtij rekomandimi. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Kryetarët e komisioneve të përhershme, a kanë diçka për të thënë? Jo. Tani, sipas radhës, janë kryetarët e grupeve parlamentare. Kryetari i Grupit Parlamentar të PDK-së? Nuk do. Kryetari i Grupit Parlamentar të LDK-së? Nuk dëshiron të prononcohet. Kryetari i Grupit Parlamentar të AAK-së, nuk ka. Kryetari i Grupit Parlamentar të AKR-së? Nuk do. I LDD-

së? Nuk do. “7+”? Nuk ka. SLS? Nuk ka të interesuar për fjalë. Deputetë, nuk ka të paraqitur për diskutim.

Atëherë, vazhdojmë me votimin e Propozim-vendimit të Qeverisë së Kosovës për emërimin e drejtorit dhe të zëvendës-drejtorit të Rregullatorit për Ujërat dhe Mbeturinat.

Konstatoj se në sallë janë 67 deputetë të pranishëm. Tani lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim dhe votojmë tani:

Pa kartelë? 2 “për”. Atëherë, konstatoj se me 24 vota me kartelë plus 2 pa kartelë “për”, pra 26 vota “për”, 31 vota “kundër”, 5 abstenime, nuk zgjedhen kandidatët e propozuar.

Vazhdojmë me pikën e gjashtëmbëdhjetë ë rendit të ditës:

- **Shqyrtimi i dokumentit Letra e Bardhë - Sfidat e përfshirjes sociale në Kosovë**

Komisioni për Integritet Evropian dhe Komisioni për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale, në pajtim me dispozitat e Rregullores së Punës kanë shqyrtuar dokumentin Letra e Bardhë - Sfidat e përfshirjes sociale në Kosovë dhe Kuvendit ia kanë rekomanduar, për miratim.

Dokumenti Letra e Bardhë - Sfidat e përfshirjes sociale në Kosovë dhe rekomandimet e komisioneve u janë shpërndarë deputetëve.

Ftoj përfaqësuesin e Komisionit për Integritet Evropian, zotin Naser Rugova, që ta marrë fjalën, në emër të komisionit.

NASER RUGOVA: Faleminderit, zoti kryesues!

Të nderuar anëtarë të Kabinetit qeveritar,

Të nderuar kolegë deputetë,

Letra e Bardhë e Kuvendit të Kosovës ka për qëllim të prezantojë konceptin e përfshirjes sociale dhe të theksojë fushat e përjashtimit të individëve dhe të grupeve të cenuara brenda shoqërisë kosovare. Qëllim tjetër i këtij dokumenti është intensifikimi i angazhimit të Kuvendit të Republikës së Kosovës në një diskutim më të gjerë rreth çështjeve të cilat i kontribuojnë zhvillimit të një shoqërie më përfshirëse, më kohezive dhe mirëqenie më të madhe sociale.

Çka është Letra e Bardhë? Letra e Bardhë është një dokument ose raport zakonisht i lëshuar nga institucionet shtetërore që prezanton ose adreson koncepte politike, sfida ose probleme të cilat ndihmojnë në informimin dhe edukimin më të gjerë të politikëbërjes. Letra e Bardhë nuk ka karakter obligativ dhe nuk ka implikime buxhetore. Në këtë rast, ky draft dokument që ka ardhur në seancën e rregullt të Kuvendit të Kosovës është një shprehje e vullnetit politik të organit më të lartë legjislativ të vendit.

Letra e Bardhë është një dokument i përpiluar si rezultat i një aktiviteti sistematik të deputetëve të Kuvendit të Kosovës. Ky aktivitet i deputetëve është përkrahur, jetësuar dhe koordinuar në bashkëpunim me përfaqësuesit e NDP-së, në përkrahje të Kuvendit, si dhe të ekspertëve vendorë dhe ndërkombëtarë nga ana e fushave apo lëmive specifike.

Koncepti i këtij draft-dokumenti, përfshirja sociale është një koncept që synon t'i krijojë, t'i ruaj dhe forcojë proceset në të cilat individët dhe grupet, pavarësisht nga dallimet ndërmjet tyre, mund të çojnë një jetë të mirë. Përfshirja sociale nënkupton një proces i cili mundëson që të gjithë individëve dhe grupeve t'u krijojnë mundësi të luajnë rol të plotë në të gjitha aspektet e jetës

sociale. Për të qenë të përfshirë, atyre duhet t'u krijohen ose t'u ofrohen mundësi të barabarta në fushën e edukimit, sipas nevojës dhe interesimit të tyre, punësimit të përcjellë me siguri sociale, qasje më të lehtë në shërbime publike dhe komunitare, lidhjes me familje, shokë, me punë, me interesa personale dhe me komunitete lokale, si dhe zëri i tyre të dëgjohet dhe të jenë pjesë aktive e vendimmarrjes.

Në rrethana specifike të Kosovës, përfshirja sociale paraqet në sfidë komplekse se cilës institucionet e Kosovës duhet t'i qasen me sensin e urgjencës, duke shfrytëzuar kapacitetet politike, ligjore, financiare në dispozicion, si dhe duke kërkuar përkrahjen e komunitetit dhe të organizatave ndërkombëtare për këtë qëllim.

Kuvendi, si institucion më i lartë legjislativ i vendit, në bashkëpunim me Qeverinë dhe me institucionet tjera të qeverisjes qendrore ose lokale, do të angazhohet për planifikimin e hapave më specifike që adresojnë përmirësimin e gjendjes sociale, me theks të veçantë në përfshirjen sociale duke u kundërvënë kështu përjashtimit dhe cenueshmërisë sociale.

Në adresimin e sfidave të zhvillimit njerëzor dhe përfshirjes sociale, në kontekst të zhvillimeve dhe të praktikave më të mira që marrin formë në rajon dhe në vendet e Bashkimit Evropian, Kuvendi i Republikës së Kosovës duhet të shprehë interesimin për të përfutur nga ndihmat që ofrojnë organizatat ndërkombëtare dhe ato vendore, më konkretisht ndihmën përmes së cilës ne, si institucione dhe shoqëri, më lehtësisht do të mund të qasemi në thellësi të fushave të përmendura në qëllime të këtij draft-dokumenti.

Letra e Bardhë përbën një gurthemel, në të cilin pritet të marrin formë zhvillimet e tjera lidhur me përfshirjen sociale, pasi që ne në një nga seancat e mëparshme kemi miratuar edhe objektivat e Deklaratës së mijëvjeçarit dhe konform agjendës evropiane për Kosovën, i ftoj të gjithë kolegët deputetë që në parim ta përkrahin këtë draft-dokument apo edhe me plotësimet dhe sugjerimet eventuale ta begatojnë këtë shprehje të vullnetit politik për përfshirjen sociale të të gjitha fokus grupeve shoqërore në vendin tonë. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zoti Rugova!

Në emër të Komisionit për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale, si dhe në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së, fjalën e ka Mimoza Ahmetaj.

MIMOZA AHMETAJ: Faleminderit, zoti kryesues!

I nderuari ministër dhe ministre,

Të nderuar deputetë,

Komisioni për Punë dhe Mirëqenie Sociale ka qenë pjesë aktive në përpilimin e këtij dokumenti që nga fillimi i punës. Jemi munduar që në mënyrë sa më reale të paraqesim situatën ekzistuese sociale në Kosovë. Letra e Bardhë, ashtu si u tha edhe nga parafolësi im, është një raport zyrtar i cili adreson problemet e caktuara dhe ofron zgjidhjen për to dhe nëpërmjet saj lexuesit informohen, ndërsa politikëbërësit hartojnë politikat e caktuara.

Ky raport në mënyrë të përmbledhur mundohet t'i përfshijë kategoritë, grupet dhe personat e përjashtuar dhe të cenuar brenda shoqërisë kosovare. Duke i ditur rrethanat e caktuara deri tani, Kosova nuk ka pasur mundësi të hartojë dokumente të llojit të tillë dhe nuk ka ndonjë përvojë në hartimin e letrave të tilla deri sa në shumë shtete të zhvilluara të Evropës dhe të botës raportet e tilla bëhen në mënyrë periodike ose në shumë raste u paraprijnë përpilimit të politikave të caktuara shtetërore.

Për ne, si shtet shumë i ri, besoj jemi munduar që dokumentit ë jetë sa më i qartë dhe gjithëpërfshirës.

Me këtë dokument, Kuvendi i Kosovës manifeston angazhimin në përmbushjen e kritereve të Bashkësisë Evropiane për përfshirjen sociale, si një proces i cili siguron që kategoritë e caktuara të cenuara të kenë të drejtë të jenë të përfshira në jetën ekonomike, sociale, kulturore dhe të kenë një standard të jetesës. Objektiv themelor, përveç të tjerave, i Mijëvjeçarit ka qenë edhe luftimi i varfërisë dhe vdekjeve të foshnjave.

Nëpërmjet këtij dokumenti prezantohet koncepti i përfshirjes sociale të grupeve dhe individëve të caktuar të cilët janë të përjashtuar dhe të stigmatizuar në shoqëri. Është mjaft shqetësuese të ballafaqohemi me faktet dhe të dhënat të cilat janë paraqitur në këtë dokument, si për shembull, varfëria në shkallë shumë të lartë që arrin diku, sipas disa të dhënave, deri në 44% që jetojnë me më pak se 1.25 euro në ditë, pastaj niveli i ulët i përfshirjes së fëmijëve në edukimin parashkollor dhe braktisja e shkollave nga shumë fëmijë që arrin vlerën deri në 12% e fëmijëve, niveli i ulët i arsimit të popullatës, sidomos të gratë, shkalla e lartë e papunësisë, pamundësia e ofrimit kualitativ të shërbimeve shëndetësore për gjithë popullatën, shkalla e lartë e vdekshmërisë së foshnjave dhe lehonave, gati më e larta në Evropë, që llogaritet të jetë 3 deri 7% e vdekjeve maternale, jetëgjatësia më e shkurtër po ashtu në Evropë, që llogaritet të jetë tek meshkujt deri 69 vjet, ndërsa tek femrat 71 vjet, mungesa e regjistrimit civil të popullatës. Besoj se dokumenti është hartuar me të dhënat më të sakta të mundshme që ne i kemi, duke mos harruar të them se të mangët e bën mungesa e regjistrimit të popullatës dhe të pronës, gjë e cila është cituar, është përmendur në dokument.

Duke marrë parasysh rëndësinë që kjo letër ka, në emër të Komisionit për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale dhe në emër të Partisë Demokratike të Kosovës ju ftoj që ta përkrahni këtë dokument, në mënyrë që t'i hapet rruga një mori ligjesh që presin kalimin e kësaj letre dhe hartimin e tyre si dhe investimeve dhe tërheqjes së fondeve ndërkombëtare në shumë fusha të caktuara të shoqërisë sonë, sidomos tani pas anëtarësimit në mekanizmat ndërkombëtarë.

Për fund, do të dëshiroja të citoja një nga artistët shumë të njohur dhe këngëtarët e skenës botërore, Bono Vox-in, nga grupi Ju tu, i cili në forumin ekonomik botëror pikërisht që ndërlidhet me objektivat e Mijëvjeçarit, e thotë një fjalë, po e citoj: “Nëse njerëzimi ka arritur ta dërgojë njeriun në Hënë, pse nuk mund të arrijmë ne të ndërtojmë shkolla për fëmijët tanë”. Faleminderit dhe ju ftoj që ta përkrahni këtë dokument, siç e thashë edhe më herët. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Kryetarët e komisioneve të përhershme, a dëshiron kush ta marrë fjalën. Jo. Kryetarët dhe përfaqësuesit e grupeve parlamentare, në emër të PDK-së foli Mimoza. Në emër të LDK-së janë dy të paraqitur, kush e do fjalën, deputetja Hulaj.

NURISHAHE HULAJ: Faleminderit!

I Nderuar kryesues i Kuvendit,

Të nderuar ministra dhe deputetë,

Letra e Bardhë është një draft-dokument i strukturuar mirë, gjithëpërfshirës që ngërthen në vete sfidat komplekse të cilave institucionet e Republikës së Kosovës duhet t'i qasen me dinamikë më të nxituar, duke shfrytëzuar kapacitetet politike, ligjore, financiare në dispozicion, si dhe duke kërkuar përkrahjen e komunitetit dhe të organizatave ndërkombëtare për këtë qëllim. Draft-dokumenti pra, Letra e Bardhë, brenda përbrenda koncepton përfshirjen sociale dhe analizon zhvillimet e shumë sektorëve socialë dhe të tjera. Duke e ilustruar këtë me indikatorë matës të cilët mundësojnë dhe ndihmojnë edhe më shumë intensifikimin e angazhimeve të institucioneve

qendrore dhe lokale të Republikës së Kosovës, pra në rastin konkret angazhimin e Kuvendit të Kosovës me një diskutim më të gjerë rreth çështjeve të cilat i kontribuojë zhvillimit dhe arritjes së objektivave të Mijëvjeçarit, të cilat objektiva Kuvendi i Kosovës përmes një rezolute i ka votuar dhe miratuar më 17 tetor 2008, si dhe Rezolutën për prioritetet dhe strategjitë e Kosovës për integrim në Bashkimin Evropian. Adresimi i këtyre sfidave është shumë i rëndësishëm dhe specifik për qytetarët e Kosovës. Dihet fakti se procesi i përfshirjes sociale kërkon përpjekje afatgjata, mekanizma më të profesionalizuar të planifikimit, të zbatimit dhe të mbikëqyrjes së realizimit të objektivave të Mijëvjeçarit të cilat janë tetë më të rëndësishme, dhe e para prej tyre është ulja e varfërisë. Për këtë kërkohet përkrahje ndërkombëtare, më e fuqishme për investim dhe zhvillim të vendit tonë.

Shteti i Kosovës sigurisht se do të angazhohet për zotime të reja financiare që në vazhdim do të çonin më lehtë drejt përvetësimeve dhe praktikave më të mira të përfshirjes sociale nga rajoni dhe nga shtetet anëtare të Bashkimit Evropian dhe si rrjedhojë e kësaj edhe pasurimin e monitorimit të progresit në lidhje me përfshirjen sociale dhe përmbushjen e objektivave të Mijëvjeçarit.

Unë do i prek disa segmente të Letrës së Bardhë, me sa vijon.

1. Jeta politike në Kosovë që synon në një segment të veçantë. Qasjen më të madhe të femrave në vendimmarrje dhe grupeve tjera në sektorët tjerët të marrin pjesë më tepër.
2. Informimi. Me këtë segment shtresat sociale pak të përfshira në informim.
3. Qasja në informim. Shumë pak janë të përfshira edhe shtresat sociale.
4. Mediat. Kosova ka një nga normat më të ulëta të tirazhit të gazetave.
5. Regjistrimi civil. 19.89% e posteve udhëheqëse në nivel qendror mbahen prej femrave, konsiderohet ende indikator shumë i ulët.
6. Administrata publike. Personat me aftësi të kufizuar mbeten nën nivelin e duhur të përfaqësimit.
7. Drejtësia. 1940 persona mbeten të pa gjetur. Numri total i rasteve civile ende të pazgjidhur nëpër gjykatat komunale në Kosovë, rreth 160.477 raste. Këtë e thotë edhe Raporti i progresit evropian.
8. Jeta kulturore dhe shoqërore civile. Mbetet shumë për t'u dëshiruar.
9. Shëndetësia. Në Kosovë ende nuk ka financim të mjaftueshëm dhe të qëndrueshëm për shëndetësi dhe nuk ka fond ende të sigurimeve shëndetësore.
10. Punësimi. Shkalla e papunësisë konsiderohet të jetë rreth 45%, është më e larta në Ballkanin perëndimor.
11. Arsimimi. Ende konsiderohet shkalla e ulët e regjistrimit parashkollor. 66.50% e personave me edukim universitar janë të punësuar, të tjerët me përgatitje universitare janë të pa punë.
12. Mjedisi ekonomik. Është një sektor shumë i rëndësishëm për qytetarët e Kosovës që tregon se numri i bizneseve të regjistruara në Kosovë është në rritje, ndërsa pasiguria rreth politikave rregullatore, kostos dhe qasjes në financime u krijojnë probleme bizneseve.

13. Furnizimi me energji elektrike. Edhe pse ka pak përparime në këtë drejtim, konsiderojmë se ende ngelet jo i qëndrueshëm.
14. Familja. Nënata, fëmijët ende mbeten në trajtim të dobët shëndetësor.
15. Dimensioni mjedisor. Uji, ushqimi, mbetet shumë për t'u punuar në këtë drejtim. Ngrohja globale ndikon direkt në ndryshimin e kushteve atmosferike.
16. Diaspora. Qytetarët tanë jashtë vendit hasin në vështirësi për të realizuar të drejtat e tyre të posedimit të dokumentacioneve personale.

Treguesit e Letrës së Bardhë na japin informatën se ka ngecje në përmbushjen e objektivave të Mijëvjeçarit kryesisht për shkak të shkallës së lartë të varfërisë, papunësisë dhe vdekshmërisë së foshnjave që konsiderohet rreth 35 deri 40 promilë në 1.000 lindje gjallë. Pra, më e larta në Evropë.

Dhe, në fund, mund të them se vetëm me punën profesionale dhe përmes programeve të nxjerra nga politikat strategjike të zhvillimit të vendit dhe të matshme konsideroj se gjer në vitin 2015 treguesit negativë të përfshirjes sociale mund t'i kthejmë në tregues pozitivë.

Prandaj, Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike të Kosovës e përkrah draft-dokumentin – Letrën e Bardhë dhe ju falënderoj për vëmendje!

KRYESUESI: Faleminderit, në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, deputeti Ardian Gjini.

ARDIAN GJINI: Faleminderit, zoti kryesues!

Grupi Parlamentar i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës e mbështet votimin dhe do ta votojë Letrën e bardhë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Në emër të Grupit Parlamentar të AKR-së, deputetja Rita Hajzeraj.

RITA HAJZERAJ: Faleminderit, zoti kryesues!

I nderuar ministër,

Të nderuar deputetë,

Sot po e shqyrtojmë rekomandimin lidhur me Letrën e Bardhë – Sfidat e përfshirjes sociale në Kosovë. Gjithashtu, e përshëndes edhe ministren, se nuk e pash.

Ne e dimë fare mirë se në Kosovë kapacitetet buxhetore janë të limituara. Gjithashtu, politikat për përmirësimin e gjendjes mungojnë. Unë bëj thirrje që kjo letër e bardhë të jetë si një udhërrëfyes për Qeverinë e Kosovës që sa më parë të marrë masa për përmirësimin e gjendjes së rëndë sociale në vendin tonë, të planifikohet qartë për mirëmbajtjen e obligimeve shtetërore, duke pasur parasysh se në Kosovë nuk ka financim të mjaftueshëm dhe të qëndrueshëm për shëndetësi. Në parim, të gjithë qytetarët e Kosovës kanë qasje në kujdesin shëndetësor, edhe pse në praktikë nuk është kështu, por ka raste kur individë dhe grupe kanë qasje të kufizuar në shërbime shëndetësore thelbësore, siç është imunizimi, kostoja e shërbimeve shëndetësore dhe kostoja e barnave që duhet të blihen, paraqiten si barrierë për qasjen në kujdesin shëndetësor, financimi i dobët publik në shëndetësi bën shpenzime te pacientët dhe te shfrytëzuesit e shërbimeve shëndetësore duke ndikuar drejtpërsëdrejti në varfëri. Shpenzimet më të larta që i bëjnë qytetarët nga xhepi i tyre për shëndetësi janë shpenzime për barna, si ato esenciale, po ashtu edhe ato që kërkohen gjatë trajtimit dhe trajtimit tjetër shëndetësor.

Shkalla e papunësisë në Kosovë. Kosova nuk ka strategji gjithëpërfshirëse për punësim, në të cilin do të bazoheshin politikat dhe planet më specifike në arritjen e qëllimeve që synojnë punësim më të madh, oferta për punësim mbetet shumë e ulët, ndërsa cilësitë dhe shkathtësitë e fuqisë aktive punëtore jo gjithmonë korrespondojnë me nevojat që shtrun kjo ofertë. Theks i veçantë duhet t'i vihet përmirësimit të klimës së investimeve për ndërmarrjet e vogla dhe ato të mesme, posaçërisht duke vënë në dispozicion energjinë elektrike të përbalueshme dhe për furnizim të besueshëm. Dhe, kjo gjendje ka të bëjë me mungesën dhe përmirësimin e legjislacionit të kësaj fushe, si dhe të infrastrukturës e cila mundëson realizimin efikas të këtij legjislacioni.

Një aspekt tjetër me rëndësi është edhe shpronësimi në mënyrë joadekuate, sepse shpronësimi jo korrekt dhe arbitrar nga ana e institucioneve rrezikon të drejtën e pronësisë, si të drejtë të patjetërsueshme në një shoqëri demokratike. Hapat e parë që duhet të merren nga ana e institucioneve tona është që të bëjnë përmirësimin dhe të formojnë një infrastrukturë të qëndrueshme ligjore.

Problemet dhe lidhja e arsimimit me varfërinë është e pamohueshme. Incidenca e varfërisë në familjet në të cilat kryefamiljari është i paarsimuar ose me nivel të ulët të arsimit është disa herë më i lartë se në familjet që udhëhiqen nga kryefamiljarët e arsimuar. Kjo ndodhë sepse të arsimuarit kanë shans më të mirë për punësim dhe paga më të larta, ndryshe nga objektivat e BE-së për mësim gjatë tërë jetës, ne kemi pasur edhe situata në sektorin e arsimit të Kosovës ku mbeten shumë më shumë probleme dhe pak rezultate në këtë sferë.

Mbrojtja për fëmijët, shëndetin e tyre, shteti ynë fare nuk ka bërë për mbrojtjen e të drejtave të tyre. Shkalla e vdekshmërisë së foshnjave në Kosovë mbetet e lartë, mekanizmat mbrojtës janë të papërshtatshëm për t'i mbrojtur fëmijët nga dhuna, trafikimi i tyre për të arritur përfshirjen e fëmijëve edhe të atyre të cilët janë me nevoja të veçanta.

Të nderuar deputetë,

Në vendin tonë përfshirja sociale paraqet në sferë komplekse të cilës Qeveria e Kosovës duhet t'i qaset me shumë seriozitet dhe duhet t'i qaset me një urgjencë të menjëhershme duke i shfrytëzuar të gjitha kapacitetet politike, ligjore, financiare, si dhe duke kërkuar ndihmë edhe nga organizatat tjera ndërkombëtare. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Në emër të Grupit Parlamentar "7+", deputeti Xhezair Murati.

DŽEZAIR MURATI: Hvala, gospodine predsjedavajući!

Mislim da se pred nama nalazi jedan izveštaj koji sadrži dosta detaljno obradjenju i sveobuhvatnu strukturu socijalnog obuhvatanja svih ugroženih kategorija. Ja bih se ovom prilikom zadržao na onaj segment koji se odnosi na manje brojne zajednice, kao jedan od osnovnih kriterijuma prihvatanja, recimo medjunarodne pomoći i tako dalje. Mi ne možemo kao Skupština samo da kosntatujemo, prihvatamo, uvidjamo, treba li ovo ili ono. To je samo opis situacije i deklarativno slaganje sa stanjem na terenu. Šta je to verbalna podrška? Ona ne predstavlja ništa, samo konkretne mere, sa planom rada i prioriteta kao i sa kaznenim odredbama za neizvršenje planiranog i dogovorenog mogu pomaći napred socijalno stanje zajednica na Kosovu. Napredak odonosno progres socijalnog obuhvatanja predstavlja skup mera i zakona, kao i načina konkretne realizacije. Medjunarodna zajednica samo takav način i takav metod rada može podržati i pomoći. Ne možemo se mi blanko nadati u medjunarodnu zajednicu ako nemamo strategiju pomoći ugroženim grupama. Jedan od najprioritetnijih standarda saradnje institucija Republike Kosova sa Evropskom unijom je upravo konkretno ispunjavanje pomoći ugroženim grupama, mislim na sve vrste ugoženih grupa, recimo hendikepiranih i ovo što su kolege ranije govorili, trafficking i tako dalje, i

tako dalje. To je jedini pravi put ka potpisivanju sporazuma Kosova za stabilizaciju i pridruživanje Evropskoj uniji. Mislim da je politička podloga u Republici Kosovu vrlo solidan okvir i baza za našu ekzekutivu koja treba etapno i u fazama da se strateški utvrde prioritete kako bi se prema unapred utvrdjenom redosledu realizovali ti prioritete.

Komisija za evropske integracije, čiji sam i sam član, bila je vrlo aktivna u analizi izveštaja o progresu i kroz razne vidove rada i saradnje takodje davala značajan doprinos akcionom planu rada Skupštine. Sada je na Vladi, dakle ekzekutivi, da taj zadatak realizuje i od toga će zavisiti naravno i prihvatanje međunarodne zajednice.

Ima elemenata u ovom izveštaju, gde se govori ne precizno, recimo o radu medija manjinskih zajednica. Neprecizni podaci koliko je radio-stanica, recimo pisani mediji, listovi na turskom, recimo bosanskom i tako dalje, ne stoje tačne tvrdnje, kao ni broj radio-stanica. Nigde se ne pominje, recimo u dovoljnoj meri, koliko je zakinjuto pravo informisanja manjinskih zajednica Kosova koje deset godina ponavljaju da nemaju televizijski servis, koji je javni, koji ima predviđenu stopu odnosno procenat emitovanja svog programa, koji nije ispunjen prema podacima koji stoje u izveštaju i tako dalje.

Dakle, mi ga u principu prihvatamo, ali smatramo da ima mnogo toga još konkretnog da se poradi na njemu. Hvala!

KRYESUESI: Faleminderit! Në emër të SLS, a dëshiron ndokush? Slobodan Petroviq.

SLOBODAN PETROVIĆ: Hvala predsedavajući!

Uvaženi ministri,

Kolege narodni poslanici,

Ovaj izveštaj u nečelu je prihvatljiv za Samostalnu liberalnu stranku, ali imajući u obzir da je kolega ispred mene, gospodin Džezair Murati dosta toga rekao, ja sam samo želeo da se pridružim njemu i da kada je u pitanju izveštaj za pisane medije na srpskom, piše da ima tri pisana medija, koje se pišu, a to apsolutno nije tačno, i kada je u pitanju procenat zapošljenosti manjinskih zajednica u institucijama mislim da bi bilo jako dobro ukoliko bi pola toga bilo tačno, svakako da i to nije tačno. Ono što želim da kažem ispred Samostalne liberalne stranke, odnosno poslaničkog kluba svakako da ćemo mi imati u obzir i našu odgovornost u tom smislu, i svakako da ne bežimo od odgovornosti, ali pre svega za radi istine želeo sam samo da dam tu jednu konstataciju da je ta jedna stvar koja se podkrala u ovom izveštaju nije tačna. Svakako, izveštaj je sačinjen opširno, imalo je tu dosta posla i još jednom želim da kažem da ne samo izvestilac, nego kako ova institucija i Vlada imaju punu obavezu da upravo to što je pisano u izveštaju i implementira. Još jednom se zahvaljujem na datu mogućnost za reč.

KRYESUESI: Faleminderit! Grupet parlamentare e përfunduan. Tani sipas radhës janë deputetët. I pari është Driton Tali. Nuk është këtu! Gjylnaze Syla.

GJYLNAZE SYLA: Faleminderit, i nderuari zoti kryesues!

E nderuara ministre, i nderuar ministër,

Deputetë të nderuar,

Dokumenti Letra e Bardhë është më tepër një dokument paralajmërues për gjendjen sociale, i cili identifikon problemet dhe tregon sfidat sociale me të cilat do të ballafaqohet Kosova. Por, nuk është dokument obligativ dhe nuk është dokument që i propozon politika ose strategji ose rekomandime Qeverisë, por është një bazë e mirë për korrektimin e politikave dhe të strategjive ekzistuese.

Reathanat aktuale në Kosovë tregojnë se njerëzit ose së paku individët dhe grupet e caktuara janë të përjashtuara nga jeta institucionale dhe shoqërore në përgjithësi ose së paku një kategori është e përjashtuar, siç janë të varfrit, pastaj personat e moshuar, komunitetet, personat me aftësi të kufizuara, fëmijët, të rinjtë, gratë e tjerë.

Do të ndalem në një fenomen i cili është shumë i shprehur në Kosovë, e që ka rëndësi shumë të madhe edhe në vetë përjashtimin e grupeve, por edhe në mungesën e mirëqenies dhe të jetës më të mirë të qytetarëve të Kosovës, e që është varfëria. Pra, varfëria është shkaktari kryesor që ndikon në përjashtimin social dhe të dhënat tregojnë se 45% të njerëzve janë të varfër, kurse 15% të tyre janë në varfëri të skajshme. Nga varfëria, grupet më të goditura janë femrat, pleqtë, të rinjtë, fëmijët, për arsye se këta, këto grupe përballen me vështirësi shtesë. Janë më të varfra duke marrë parasysh sidomos se mundësitë e tyre janë më të vogla për punësim dhe të ardhurat i kanë më të ulëta dhe kjo është sidomos e shprehur te femrat të cilat janë vetëmbajtëse. Po ashtu, familjet të cilat kanë një numër më të madh të anëtarëve janë më të varfra.

Shkaktari tjetër i përjashtimit social, po aq i rëndësishëm, është papunësia dhe kjo është e shprehur, po ashtu, kryesisht te femrat dhe të rinjtë për shkak të një niveli të lartë të papunësisë, gjegjësisht të papunësisë afatgjate.

Një faktor me rëndësi, dëshiroj të përmend edhe mungesën e regjistrimit të popullsisë, e cila, siç e dimë, do të bëhet tek në vitin 2011, por është një faktor që ndikon në përjashtimin e grupeve sepse mos regjistrimi në një mënyrë e përjashton edhe nga e drejta për të votuar.

Tani më lejoni të fokusohem në 3 sektorë, që është sektori i shëndetësisë, sektori i arsimit dhe punësimi. Sa i përket sektorit të shëndetësisë, identifikimi i problemit qëndron sidomos në financimin e paqëndrueshëm dhe financimin e pamjaftueshëm të sektorit shëndetësor, që është diku vetëm 3% të bruto produktit vendor dhe është nën mesataren e rajonit. Mos financimi i sektorit shëndetësor pastaj rrit barrën te pacientët, të cilët janë shfrytëzues të shërbimeve shëndetësore dhe të cilët vetë i bartin shpenzimet, gjë që drejtpërdrejtë pastaj ndikon edhe në rritjen e varfërisë.

Sa i përket punësimit, dihet se shkalla e papunësisë në Kosovë është 45% dhe se një numër i madh i njerëzve, të cilët janë të aftë për punë, ngelin pa punë, gjegjësisht në tregun e punës çdo vit hyjnë 30 mijë të rinj, kryesisht të moshës 20-24 vjeç, kurse vetëm 15 mijë mund të punësohen, gjë që do të thotë se edhe kjo rritë rrezikun e varfërisë. Po ashtu, të papunët për një kohë të gjatë, përveç që ngelin të pa punë, edhe vetë të punësuarit për shkak të mos rritjes së pagave, gjithashtu nuk kanë cilësi të jetës.

Edukimi luan një rol të rëndësishëm për punësim, për arsye se të dhënat tregojnë se njerëzit të cilët kanë edukim më të lartë universitar, më lehtë punësohen në krahasim me ata të cilët kanë edukim të mesëm ose të ulët.

Arsimimi. Është alarmante sidomos në viset rurale, regjistrimi parashkollor dhe në krahasim me vendet e rajonit përqindja e qytetarëve që me sukses i kryejnë studimet universitare është shumë e ulët, kurse regjistrimi i nxënësve në shkolla të mesme dhe ato të ulëta është i lartë. Megjithatë, është shqetësuese braktisja e nxënësve nga shkolla, kryesisht për çështje ekonomike.

Letra e Bardhë është gjithëpërfshirëse dhe është gurthemel i mirë për iniciimin e procesit të zhvillimit të shoqërisë dhe të mirëqenies së qytetarëve të Kosovës, prandaj e përkrah. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka deputeti Xhevdet Neziraj.

XHEVDET NEZIRAJ: Faleminderit, zoti kryesues!

Të nderuar ministra,

Kolegë deputetë,

Fillimisht do të them se e përkrahim këtë dokument, mirëpo do të ndalem në disa çështje parimore. Këtu në kapitullin e tretë, janë grupet e përjashtuara, siç janë fëmijët, të varfrit, por janë cekur edhe tri komunitetet që janë më të varfra, si komuniteti rom, hashkalinj dhe komuniteti egjiptian. Unë do të fokusohem në këto komunitete, sidomos për komunitetin egjiptas, ku për këtë moment do të njoftoj se jemi duke e monitoruar edhe ligjin për zbatim se sa ndërmarrjet publike janë duke punësuar njerëz dhe këto komunitete dhe më vjen mirë që në këtë komision janë pjesëtarët e të gjitha komuniteteve dhe shohim se çfarë diskriminimi bëhet ndaj këtyre komuniteteve që bëjnë strategji ndaj këtyre komuniteteve që i qesin si të rrezikuar, ndërsa as qeveria dhe asnjë institucion nuk ndërmerr kurrgjë.

Duhet ta përmendi edhe një fakt që sot zoti Rugova e përmendi, që ne duhet të iniciojmë dhe të thithim donacione ndërkombëtare. Sot është humbur një donacion shumë i rëndësishëm mbi 50.000 euro nga CDF për arsye se ka dëshiruar të investojë në lagjen “7 shtatori” për komunitetin egjiptas në Pejë, Ministria për Komunitete dhe Kthim dhe zyra pranë Kryeministrit nuk është në gjendje që të investojë 10.000 euro, ndërsa t’i thithë 50.000 euro, do të thotë, për arsye se aty jeton komuniteti egjiptas dhe nuk jeton komuniteti serb ose dikush tjetër, se me siguri Ministria për Komunitete do t’i kishte gjetur dhe do t’i kishte realizuar. Atëherë, nëse dëshirojmë që këto komunitete dhe kjo pjesë e këtyre grupeve të përjashtuara..., duhet që qeveria të jetë shumë më e fokusuar, duhet Qeveria me të vërtetë të veprojë dhe jo të mbesin të gjitha këto në letër të bardhë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka Emrush Xhemajli.

EMRUSH XHEMAJLI: Faleminderit, zoti kryesues!

Përsëritje të gjithëve!

E di se jemi lodhur, ka qenë ditë e gjatë, por më lejoni, e kam marrë fjalën që të tërheq vëmendjen për diçka. Ne e dimë se së paku për mirësjellje, të gjithë do ta votojnë Letrën e Bardhë, normalisht edhe unë do ta votoj. Kjo u tha se nuk është dhe ashtu është, nuk është obligative. Megjithatë, do të thosha se nuk është një letër që mandej duhet të gjuhet, por unë e konsideroj si një letër shumë të rëndësishme që duhet ta kemi ne si deputetë vazhdimisht, të them kështu, me veti nëpër seanca për një arsye praktike, sepse gjatë hartimit dhe votimit të ligjeve ka nevojë që në politikat konkrete të mos biem në kundërshtim me këtë që do ta votojmë sot, do me thënë, t’i kemi parasysh ato që thuhet në raport dhe të mos shkelen këto kategoritë e varfra dhe kategoritë me nevojë të shoqërisë sonë. Domethënë, ju ftoj që në politikat konkrete të jemi korrekt dhe të mos votojmë vetëm formalisht sot këtu, por të votojmë me gjithë zemër. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Fjalën e ka Driton Tali.

DRITON TALI: Faleminderit, zoti kryesues!

Edhe unë e kam parasysh se kjo ditë ka qenë shumë e gjatë për ne dhe jemi të lodhur dhe atë që do ta them nuk ka të bëjë aq shumë me këto dy komisione të cilat kanë qenë të involvuara për ta prodhuar këtë draft-dokument, mendoj në Komisionin për Shëndetësi dhe Komisionin për Integritet Evropian, por më duhet të reagoj ndaj disa institucioneve që merren me këto statistika, se na mbytnë me këto statistika të vjetruara, statistika konstante, që nga pas lufta merret varfëria apo linja e varfërisë 45%. Tash jepet përshtypja se në Kosovë kurrgjë nuk po ndryshon. Më 2002 - 45%, më 2009 - 45%. Niveli i papunësisë nuk lëviz, është 43% shoqërisht e pranueshme, ndonëse i

kemi tash disa statistika politike tjera, politike në kuptimin partiake, që disa i fryjnë 60-70% e të tjerët i ulin. Ishte rasti i para disa viteve, UNMIK-u që na tha se 30% është papunësia në Kosovë. Këto nuk qëndrojnë.

Shikoni, këto, po them edhe një herë, edhe tash po e them, i adresohet më shumë Bankës Botërore që e kanë zyrën në Kosovë, Departamentit për makro-ekonomi, Entit statistikor e tjera, e tjera. Veç në Kosovë kam parë raportin në mes linjës së varfërisë dhe varfërisë ekstreme të jetë 3. Askund në botë nuk është, madje as në Kinë, edhe pse Kina i zbukuron, dihet që i zbukuron shifrat. Atje, megjithatë, del 2.28. Domethënë, sipas standardeve të Kinës, nëse i përdorin që nuk janë edhe ato standarde të besuara, janë të zbukuruara, atëherë varfëria ekstreme në Kosovë është dashur të jetë 19.7% apo 20%. Nëse e marrim mesataren çdo kund qysh njehsohet, domethënë të jetë 1.8% mesatarja, atëherë varfëria ekstreme del 25% nëse e kemi linjën e varfërisë 45%. Domethënë, situata është shumë më e keqe se sa na është servuar deri më tani. T'i marrim edhe të gjithë faktorët e varfërisë, për shembull, puna e papunësisë, ne themi që nga 2001 se në tregun e Kosovës për çdo vjet hyjnë 30.000 të ri punëkërkues, nga të cilët 15.000 gjejnë punë. Pra, çdo vjet i kemi 15.000 tepriçë dhe nëse e bëjmë një llogari të thjeshtë, për 9 vjet dalin 135.000 veta, është rritur numri i të papunësuarve. Nëse i marrim e i shumëzojmë me 7, pra prej vitit 2002 dalin 105.000. Domethënë papunësia nuk mund të jetë 43% si në 2002 si në 2009, kur i ke edhe 105.000 tjerë të cilët i janë shtuar numrit të papunësisë, të punëkërkuesve.

Pastaj, pa marrë parasysh faktin se ata kanë krijuar familje, një 24 vjeçar në vitin 2002 tash është rreth 30 vjeçar, do me thënë ka krijuar familje dhe statistika e varfërisë është rritur nëse e marrim varfërinë 2 dollarë dhe 1 dollar, do të thotë varfëria ekstreme 1 dollar, që ka qenë, se tash është për 7, për shkak të inflacionit me 1.25 dollarë për ditë. Pastaj, i kemi edhe ata të punësuarit e varfër. Nëse i marrim dhe llogarisim familjen kosovare dhe po e marrim një pagë, çka di unë, që është mbi mesataren, po e marrim e të themi 200 euro, do të shohim se ajo familje 5 anëtarëshe për 30 ditë për krye të familjes, do të thotë të anëtarit, i del 1.33 euro për ditë për të shpenzuar dhe 1.33 euro është më pak se 2 dollarë i linjës së varfërisë ekstreme. Domethënë, nëse e llogarisim, dollari sot është 1.39, do të thotë del diku 1.86 dollarë për ditë, që është shumë më pak se sa 2 dollarë, të cilin Banka Botërore e merr si shifër e cila duhej t'i siguronte njeriut ato 2.500 kalori të domosdoshme për të jetuar dhe gjithmonë po e them këtë shifër, pa i llogaritur shpenzimet e punës, të transportit e tjera, e tjera. Kam parasysh se këto janë më shumë çështje teknike për të cilat duhet në vende tjera t'i diskutojmë dhe kam parasysh se RTK-ja nuk na përcjell, andaj institucionet gjegjëse nuk na përcjellin, por sinqerisht këto statistika pastaj edhe këtë strategji apo letër po i bëjmë jo reale. Po them edhe një herë, për shkak të mirësisë sime, e përkrah këtë draft-dokument, por situata në Kosovës është shumë më e keqe se sa që paraqitet këtu. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Duhet ta kemi parasysh se transmetimi edhe i kësaj pjese bëhet pas orës 24:00. Fjalën e ka deputetja Luljeta Shehu.

LULJETA SHEHU: Faleminderit, i nderuari kryesues!

Të nderuar ministra,

Të nderuar deputetë,

Përfshirja sociale për Kosovën e ka rëndësinë e saj shtesë për shkak të historisë së saj të dhimbshme në kohën e fundit, prandaj ekzistojnë një numër i madh i familjeve që kërkojnë asistencë sociale për shkak të pamundësisë që të punësohen. Grupet e prekura janë të varfrit, fëmijët, të rriturit, të moshuarit, personat me nevoja të veçanta, të zhvendosurit brenda vendit, invalidët e luftës, ata të prekur nga çrregullimet e stresit pos-traumatikë, të burgosurit e luftës, gratë viktime të dhunës familjare, të pastrehët. Mirëpo, për këto grupe që i ceka, nuk shfaqet angazhim i nevojshëm për familjet e të pagjeturve, edhe pse ekziston një numër i familjeve që nuk mund të jetojnë me 130 euro, pasi që numri i anëtarëve të familjes është më i madh mbi 2 deri 3

fëmijë dhe pasi që brenda dhjetë vjetëve fëmijët janë rritur, nënat e tyre janë të papunë, kanë nevojë që të shkollohen, fëmijët e rritur të tyre janë pa punë, për këtë arsye këto familje që i ceka, varfëria është shkaktuar për shkak të papunësisë së grave që kanë mbetur të veja gjatë luftës dhe i rrisin fëmijët e tyre. Sikur të punësoheshin këto nëna, ata nuk do të pritshin ndihmën e dikujt tjetër që do t'u ofronte ndihmë 2-3 herë në vit. Ato do të ishin vetë të zonja që çdo muaj të fitonin me punë të ardhurat e tyre dhe nuk do të vareshin nga të tjerët. Prandaj, varfëria në Kosovë ende ka mbetur e pandryshuar me 45% të njerëzve të varfër dhe 14% me varfëri të skajshme për shkak të papunësisë, por duhet punuar më tepër në këtë drejtim për ta zbutur varfërinë në Kosovë, e cila vlerësohet si shteti më i varfër në Ballkan. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Diskutuesi i fundit ishte. Të nderuar deputetë, vazhdojmë me votimin e dokumentit Letra e Bardhë – Sfida e përfshirjes sociale në Kosovë.

Konstatoj se në sallë janë 66 deputetë. Kemi kuorum për votim. Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim. Votojmë tani:

Me 54 vota me kartelë, plus 4 pa kartelë – 58 vota “për”, 2 abstenime, konstatoj se Kuvendi miratoi dokumentin Letra e Bardhë – Sfidat e përfshirjes sociale në Kosovë.

Pika e shtatëmbëdhjetë e rendit të ditës, është:

- **Njoftim i Grupit Parlamentar të SLS lidhur me zëvendësimin e dy anëtarëve të komisioneve parlamentare**

Të nderuar deputetë,

Ju njoftoj se Grupi Parlamentar i SLS-së ka vendosur që anëtar i Komisionit për Legjislacion dhe Gjyqësi të emërohet deputeti Vlladimir Todoroviq, në vend të deputetit Branisllav Gërbiq, dhe në Komisionin për Integrime Evropiane emërohet deputeti Mursel Haljili, në vend të deputetit Branisllav Gërbiq.

Të nderuar deputetë, me kaq konstatoj përfundimin e punimeve të kësaj seance plenare. Mirupafshim dhe ju falënderoj për qëndresën stoike dhe ju kërkoj falje për parregullsitë, në qoftë se ka pasur.

Përgatiti:

Divizioni i Çështjeve Plenare dhe Procedurale